



BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS  
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA  
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

# Raporti Vjetor 2012

P R I S H T I N Ě , Q E R S H O R 2 0 1 3



BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS  
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA  
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

# Raporti Vjetor 2012



## PËRMBAJTJA

Fjala hyrëse e Kryetarit të Bordit të Bankës Qendrore .....	17
Fjala hyrëse e Guvernatorit .....	19
Bordi i Bankës Qendrore, Bordi Ekzekutiv dhe Komiteti i Auditimit .....	21
Struktura organizative e BQK-së: 31 dhjetor 2012 .....	25
<b>1. Përmbledhje ekzekutive .....</b>	<b>25</b>
<b>2. Mjedisi i jashtëm ekonomik .....</b>	<b>29</b>
2.1. Evropa Juglindore .....	31
<b>3. Ekonomia e Kosovës.....</b>	<b>33</b>
3.1. Sektori real .....	34
3.1.1 Produkti i brendshëm bruto .....	34
3.1.2 Çmimet.....	36
3.1.3 Tregu i punës .....	37
3.2. Sektori fiskal .....	37
3.2.1 Të hyrat buxhetore .....	38
3.2.2 Shpenzimet buxhetore .....	39
3.3. Sektori financiar .....	40
3.3.1 Karakteristikat e përgjithshme.....	40
3.3.2 Sistemi bankar .....	43
3.3.3 Fondet pensionale.....	67
3.3.4 Kompanitë e sigurimit.....	68
3.3.5 Institucionet mikrofinanciare dhe ndihmësit financiar .....	70
3.4. Sektori i jashtëm.....	77
3.4.1 Llogaria rrjedhëse .....	77
3.4.2 Llogaria kapitale dhe financiare .....	80
3.4.3 Pozicioni i investimeve ndërkombëtare dhe borxhi i jashtëm .....	84
<b>4. Mbikëqyrja e Institucioneve Financiare .....</b>	<b>89</b>
4.1. Licencimi dhe Rregullativa .....	89
4.1.1 Licencimi .....	89
4.1.2 Rregullativa .....	91
4.2. Mbikëqyrja Bankare .....	96
4.3. Mbikëqyrja e sigurimeve .....	111
4.4. Mbikëqyrja e Pensioneve.....	122
<b>5. Shërbimet e siguruar për autoritetet, komunitetin financiar dhe publikun .....</b>	<b>125</b>
5.1. Operacionet dhe menaxhimi i parave të gatshme .....	125
5.2. Mirëmbajtja dhe transaksionet e llogarive.....	128

5.3.1 Operimi i Sistemit Elektronik të Kliringut Ndërbankar .....	132
5.3.2 Zhvillimet e përgjithshme, analiza dhe mbikëqyrja e sistemeve të pagesave .....	134
5.4. Menaxhimi i Mjeteve .....	137
5.4.1 Menaxhimi i Mjeteve dhe Politika e Investimeve të BQK-së.....	137
5.4.2 Menaxhimi i Investimeve për vitin 2012 .....	138
5.4.2 Menaxhimi i Rrezikut të Investimeve .....	140
5.4.3 Letrat me vlerë .....	141
5.5. Regjistri i Kredive të Kosovës .....	143
5.6. Aktiviteti në fushën e analizave ekonomike dhe stabilitetit financiar .....	146
5.7. Aktivitetet në fushën e statistikave .....	147
<b>6. Zhvillimet e brendshme .....</b>	<b>149</b>
6.1. Kontrolli i Brendshëm .....	149
6.2. Burimet njerëzore .....	151
6.3. Aktiviteti ligjor i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës gjatë vitit 2012 .....	152
6.4. Teknologjia Informativë .....	153
<b>7. Bashkëpunimi rajonal dhe ndërkombëtar .....</b>	<b>154</b>
7.1. Marrëveshjet, promovimi dhe përfaqësimi ndërkombëtar .....	154
7.2. Asistenca teknike .....	155
<b>8. Pasqyrat financiare të BQK-së .....</b>	<b>157</b>
<b>9. Shtojca Statistikore.....</b>	<b>197</b>
<b>10. Referencat.....</b>	<b>207</b>

## LISTA E SHKURTESAVE

AJN	Asetet e Jashtme Neto
AKP	Agjencioni Kosovar i Privatizimit
ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
ATK	Administrata Tatimore e Kosovës
ATM	Bankomat (angl. Automated Teller Machine)
ATP	Agjencionet për Transferimin e Parave
BB	Banka Botërore
BE	Bashkimi Evropian
BEC	Kategoritë Kryesore Ekonomike (angl. Broad Economic Categories)
BEEP	Projekti mbi Përmirësimin e Ambijentit Biznesor (angl. Business Environment Enhancement Project)
BERZH	Banka Evropiane për Zhvillim dhe Rindërtim
BIC	Business Identifier Code
BIS	Banka për Rregullimin Ndërkombëtar (angl. Bank for International Settlements)
BKS	Byroja Kosovare e Sigurimve
BKT	Banka Kombëtare Tregtare
BPB	Banka për Biznes
BQK	Banka Qendrore e Republikës së Kosovës
CAR	Treguesit e Mjaftueshmërisë së Kapitalit (angl. Capital Adequacy Ratio)
CEFTA	Marrëveshja e Tregtisë së Lirë e Vendeve të Evropës Qendrore (angl. Central European Free Trade Agreement)
CPI	Indeksi i Çmimeve të Konsumit (angl. Consumer Price Index)
DJI	Dow Jones Industrial Average
DPP	Departamenti i Punës dhe Punësimit
DSFAE	Departamenti për Stabilitet Financiar dhe Analiza Ekonomike
DST	Drejtat Speciale të Tërheqjes
ECB	Banka Qendrore Evropiane (angl. European Central Bank)
EFSE	Fondi Evropian për Evropën Juglindore (angl. European Fund for Southeastern Europe)
EJL	Evropa Juglindore
EULEX	Misioni i Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit
EUROSTAT	General Directorate of European Statistics
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
FSKP	Fondi Slloveno-Kosovar i Pensioneve
GBR	Great Britain Pound
HHI	Indeksi Herfindahl-Hirschman (angl. Herfindahl-Hirschman Index)
IAIS	Asociacioni Ndërkombëtar i Mbikëqyrësve të Sigurimeve (angl. International Association for Insurance Supervisors)

IHD	Investimet e Huaja Direkte
IMF	Institucionet Mikrofinanciare
IPI	Indeksi i Çmimeve të Importit (angl. Imports Price Index)
KEK	Korporata Elektroenergjetike e Kosovës
KKP	Këshilli Kombëtar i Pagesave
KMB	Komercijalna Banka
KTD	Korporatat Tjera Depozituese
MF	Ministria e Financave
MPMS	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
MTPL	Sigurimi i Auto-Përgjegjësish
NLB	Nova Ljubljanska Banka
NPL	Kreditë Joperformuese (angl. Non Performing Loans)
OJSHEF	Organizata Jofitimprurëse në Shërbim të Ekonomive Familjare
PBB	Produkti i Brendshëm Bruto
PCB	Procredit Bank
PNI	Pozicioni Ndërkombëtar i Investimeve
POS	Pikë e Shitjes (angl. Point of Sale)
pp	Pikë Përqindje
PPI	Indeksi i Çmimeve të Prodhimit (angl. Producer Price Index)
PPP	Pariteti i Fuqisë Blerëse (angl. Purchasing Power Parity)
PTK	Posta dhe Telekomit i Kosovës
RBK	Raiffeisen Bank of Kosovo
REER	Norma Reale Efektive e Këmbimit (angl. Real Effective Exchange Rate)
RKK	Regjistri i Kredive të Kosovës
ROAA	Kthimi Mesatar në Asete (angl. Return on Average Assets)
ROAE	Kthimi Mesatar në Kapital (angl. Return on Average Equity)
RTGS	Shlyerja e Pagesave në Kohë Reale (angl. Real Time Gross Settlement)
RWA	Asetet e Peshuara ndaj Riskut (angl. Risk Weighted Assets)
SEKN	Sistemi Elektronik i Kliringut Ndërbankar
SEPA	Zona e Përdorimit të Euros si Njësi e Vetme Pagese (angl. Single Euro Payment Area)
SFR	Swiss Franc
SRK	Sistemi i Regjistrimit të Kontabilitetit
SWIFT	Society for Worldwide International Financial Telecommunication
TEB	Türk Ekonomi Bankasi
TKPK	Trusti i Kursimeve Pensionale të Kosovës
TPL	Përgjegjësia ndaj Palës së Tretë (angl. Third Party Liability)
TVSH	Tatimi mbi Vlerën e Shtuar
UNMIK	Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë (angl. United Nations Mission in Kosovo)

---

USAID	Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (angl. United States Agency for International Development)
USD	United States Dollar
VPN	Teknologjia e Enkriptimit dhe Lidhjeve Virtuale

## LISTA E FIGURAVE

1.	Inflacioni në eurozonë dhe në disa vende të zgjedhura të eurozonës -----	29
2.	Papunësia në eurozonë dhe në disa vende të zgjedhura të eurozonës -----	30
3.	Norma e kredive joperformuese në eurozonë dhe në disa vende të zgjedhura të eurozonës -----	30
4.	Treguesi i mjaftueshmërisë së kapitalit në eurozonë -----	31
5.	Norma e rritjes së PBB-së reale në EJL -----	31
6.	Deficiti i llogarisë rrjedhëse në EJL, si përqindje e BB-së -----	32
7.	Norma mesatare vjetore e inflacionit në EJL -----	32
8.	Harta makroekonomike -----	34
9.	Rritja reale e PBB-së -----	34
10.	Kontributi i komponentëve kryesorë në PBB -----	35
11.	PBB sipas aktivitetit ekonomik -----	35
12.	Indeksi i çmimit të konsumit, importit dhe prodhimit -----	36
13.	Peshat e komponentëve në shportën e konsumatorit -----	36
14.	Punësimi formal dhe rritja e punësimit -----	37
15.	Ndërmjetësimi në punësim nga MPMS -----	37
16.	Burimet kryesore të të hyrave kufitare -----	38
17.	Burimet kryesore të të hyrave nga tatimet vendore -----	38
18.	Struktura e kategorive kryesore të shpenzimeve buxhetore -----	40
19.	Struktura e asetëve të sistemit financiar sipas sektorëve -----	41
20.	Asetet e jashtme neto sipas institucioneve -----	41
21.	Struktura e kërkesave ndaj sektorit të jashtëm -----	42
22.	Struktura e detyrimeve ndaj sektorit të jashtëm -----	42
23.	HHI për asetet, kreditë dhe depozitat -----	43
24.	Kontributi në rritjen asetëve të sistemit bankar sipas kategorive -----	44
25.	Norma e rritjes së kredive sipas sektorëve -----	44
26.	Struktura e kredive -----	46
27.	Struktura e kredive sipas veprimtarisë ekonomike -----	46
28.	Trendi i rritjes së kredive sipas sektorëve ekonomik -----	46
29.	Struktura e kredive sipas afatit të maturimit -----	47
30.	Trendi i rritjes së kredive sipas maturitetit -----	47
31.	Trendi i rritjes së depozitave -----	48
32.	Struktura e depozitave sipas sektorëve -----	49
33.	Struktura e depozitave sipas afatit të maturimit -----	49
34.	Mesatarja vjetore e normave të interesit -----	49
35.	Bilanci i të hyrave dhe shpenzimeve -----	50
36.	Normat vjetore të rritjes së të hyrave dhe shpenzimeve -----	50
37.	Struktura e të hyrave -----	50

38.	Struktura e të hyrave sipas kategorive	51
39.	Normat vjetore të rritjes së të hyrave sipas kategorive	51
40.	Struktura e shpenzimeve	52
41.	Normat vjetore të rritjes së shpenzimeve sipas kategorive	52
42.	Treguesit e profitabilitetit	53
43.	Raporti shpenzime të hyra	53
44.	Treguesit e efikasitetit	53
45.	Margjina neto e interesit	54
46.	Kreditë dhe depozitat e sistemit bankar	54
47.	Raporti asete likuide "broad"/detyrime afatshkurtra	55
48.	Struktura e letrave me vlerë	55
49.	Rezervat e sistemit bankar	56
50.	Hendeku i likuiditetit	57
51.	Struktura e kredive sipas klasifikimit	58
52.	Raporti NPL/gjithsej kredi	58
53.	Nroma vjetore e rritjes së gjithsej kredive dhe NPL-ve	59
54.	Struktura e kredive joperformuese	59
55.	NPL-të sipas sektorëve	59
56.	NPL-të dhe provizionet	60
57.	Kapitalizimi i sistemit bankar	60
58.	Gjithsej kapitali dhe kapitali rregullativ	61
59.	Gjithsej kapitali dhe norma vjetore e rritjes	62
60.	Struktura e kapitalit të sistemit bankar	62
61.	Struktura e kapitalit të klasit të parë	63
62.	Struktura e RWA-ve sipas peshës së rrezikut	63
63.	Struktura e investimeve të trustit	67
64.	Asetet e kompanive të sigurimit	68
65.	Struktura e aseteve të kompanive të sigurimit	68
66.	Struktura e detyrimeve të kompanive të sigurimit	69
67.	Primet e pranuar dhe dëmet e paguara	69
68.	Asetet e IMF-ve	70
69.	Struktura e primeve të pranuar të kompanive të sigurimit	70
70.	Asetet e IMF-ve dhe rritja vjetore	71
71.	Struktura e aseteve të IMF-ve	71
72.	Struktura e kredive të IMF-ve	72
73.	Trendi i rritjes së kredive të IMF-ve	72
74.	Struktura e kredive të IMF-ve sipas sektorëve	72
75.	Struktura e kredive të IMF-ve sipas maturitetit	73
76.	Normat e interesit në kreditë e IMF-ve	74

77.	Raporti shpenzime të hyra -----	75
78.	Struktura e shpenzimeve sipas kategorive -----	76
79.	Bilanci i llogarisë rrjedhëse -----	77
80.	Importet, eksportet dhe bilanci tregtar -----	77
81.	Eksportet dhe çmimet ndërkombëtare të metaleve, pa përshtatje sezonale -----	78
82.	Importet dhe çmimet ndërkombëtare të naftës dhe ushqimit, pa përshtatje sezonale -----	78
83.	Struktura e neto eksportit të shërbimeve -----	78
84.	Llogaria e të ardhurave -----	79
85.	Transferet rrjedhëse -----	79
86.	Pranimet e dërgesave të emigrantëve -----	80
87.	Investimet e huaja direkte si përqindje e PBB-së dhe deficitit të llogarisë rrjedhëse -----	81
88.	Struktura e investimeve të huaja direkte sipas komponentëve -----	81
89.	Struktura e IHD-ve sipas shteteve kryesore -----	82
90.	Investimet e huaja direkte sipas sektorëve kryesor ekonomik -----	82
91.	Pozicioni ndërkombëtar i investimeve -----	84
92.	Pozicioni ndërkombëtar i investimeve neto sipas sektorëve institucional -----	84
93.	Asetet sipas formës së investimeve -----	85
94.	Stoku i investimeve portfolio dhe direkte sipas shteteve -----	85
95.	Stoku i aseteve në kapital aksionar dhe instrumente të borxhit -----	85
96.	Detyrimet ndaj sektorit të jashtëm sipas instrumenteve -----	86
97.	IHD-të sipas kapitalit aksionar dhe huave -----	86
98.	Borxi i jashtëm bruto -----	87
99.	Borxhi i jashtëm bruto sipas sektorëve -----	87
100.	Borxhi i jashtëm neto sipas sektorëve -----	88
101.	Norma e rritjes (zvogëlimit) mujore të kredive gjatë vitit 2012 -----	102
102.	Prime të shkruara dhe dëme të paguara -----	112
103.	Prime të shkruara jo jetë -----	112
104.	Portofoli i sigurimeve jo-jetë -----	113
105.	Prime nga MTPL e brendshme -----	113
106.	Produktet vullnetare -----	114
107.	Prime të shkruara nga sigurimi jetë -----	115
108.	Dëme të paguara bruto -----	116
109.	Çmimi i njësisë – janar dhjetor 2012 -----	122
110.	Çmimi i njësisë nga viti 2002-2012 -----	123
111.	Vlera e njësisë së fondit Slloveno-Kosovar të pensioneve 2007-2012 -----	124
112.	Furnizimi me para të gatshme -----	125
113.	Pranimi i parave të gatshme -----	125
114.	Furnizimi me kartmonedha euro sipas denominimeve -----	126
115.	Furnizimi me monedha euro sipas denominimeve -----	126

116.	Kartëmonedha euro të pranuar sipas denominimeve-----	126
117.	Monedha euro të pranuar sipas denominimeve-----	126
118.	Eksporti i parave të gatshme -----	127
119.	Importi i parave të gatshme -----	127
120.	Numri i kartëmonedhave të vjetërsuara të tërhequra nga qarkullimi -----	127
121.	Proporcioni i kartëmonedhave të tërhequra nga qarkullimi -----	127
122.	Furnizimi me kartëmonedha euro -----	128
123.	Proporcioni i kartëmonedhave të reja të futura në qarkullim-----	128
124.	Paratë euro të konfiskuara të falsifikuara në nivel të Kosovës -----	128
125.	Vëllimi i transaksioneve vendore shkuarëse-----	130
126.	Vlera e transaksioneve vendore shkuarëse-----	130
127.	Vëllimi i transaksioneve vendore ardhëse-----	130
128.	Vlera e transaksioneve vendore ardhëse-----	130
129.	Vëllimi i transaksioneve ndërkombëtare ardhëse -----	131
130.	Vlera e transaksioneve ndërkombëtare ardhëse -----	131
131.	Vëllimi i transaksioneve ndërkombëtare shkuarëse -----	131
132.	Vlera e transaksioneve ndërkombëtare shkuarëse -----	131
133.	Evoluimi i depozitave të klientëve kryesorë të BQK-së -----	131
134.	Numri i transaksioneve në SEKN-----	132
135.	Vlera e transaksioneve në SEKN-----	132
136.	Mesatarja ditore e numrit të transaksioneve në SEKN-----	132
137.	Mesatarja ditore e vlerës së transaksioneve në SEKN -----	132
138.	Vëllimi vjetor i transaksioneve të SEKN-së sipas llojeve të tyre -----	133
139.	Vlera vjetore e transaksioneve të SEKN-së sipas llojeve të tyre -----	133
140.	Numri i kartelave të debitit sipas llojit të tyre-----	136
141.	Numri i kartelave të kreditit sipas llojit të tyre-----	136
142.	Numri i terminaleve ATM-----	136
143.	Numri i i terminaleve POS-----	136
144.	Raporti i shpërndarjes së investimeve të portofolit të BQK-së -----	137
145a.	Shuma e përgjithshme e mjeteve në portfolio e investimeve-----	138
145b.	Shpërndarja e portfolios investuese në çdo fundvit-----	138
146a.	Lëvizja e normave në tregun ndërbankar të eurozonës dhe lëvizja e normave në depozita të investuara nga BQK -----	139
146b.	Norma e kthimit të investimeve në portfolio dhe rreziku gjatë vitit 2012-----	139
146c.	Horizonti kohor mesatar i investimeve të mjeteve financiare -----	139
146d.	Performanca e portfolios së investimeve krahas treguesve monetary-----	140
147.	Shpërndarja e portfolios sipas rangimit kreditor afatshkurtër-----	140
148.	Struktura e Letrave me Vlerë të Qeverisë sipas afatit të maturimit -----	141
149.	Ankandet e Letrave me Vlerë të Qeverisë me afat maturimi 182 ditë-----	142

150. Struktura e pjesmarrësve sipas shumave të alokuara -----	142
151. Lëvizja e normës vjetore të kthimit për letrat me vlerë të qeverisë -----	142
152. Ankandet e Letrave me Vlerë të Qeverisë me afat maturimi 91 ditë -----	143
153. Numri i qertifikatave -----	144
154. Numri i hulumtimeve -----	144
155. Numri i kredive të reja -----	144
156. Numri i kredive me klasifikim standard -----	144
157. Numri i kredive me klasifikim vrojtues -----	144
158. Numri i kredive aktive dhe klasifikimet -----	145
159. Produktet kreditore -----	145
160. Përcaktimi i fushave të auditimit në bazë të riskut -----	151
161. Struktura kualifikuese e të punësuarëve të BQK-së -----	152
162. Orgainzatorët e trajnimeve dhe numri i pjesëmarrësve -----	152

## LISTA E TABELAVE

1.	Indikatorët kryesorë makroekonomik -----	29
2.	Rritja vjetore e kredive dhe depozitave -----	33
3.	Pagesat elektronike -----	43
4.	Struktura e asetëve të sistemit bankar -----	45
5.	Struktura e detyrimeve të sistemit bankar -----	48
6.	Përmbledhje e rezultateve të stress-testit: Rreziku i likuiditetit-----	66
7.	Shpërndarja e kredive të IMF-ve në intervale, sipas vlerave dhe numrit -----	73
8.	Indikatorët e profitabilitetit dhe efikasitetit të IMF-ve-----	76
9.	Llogaria kapitale dhe financiare -----	81
10.	Numri i bankave, kompanive të sigurimit dhe fondeve pensionale-----	90
11.	Numri institucioneve mikrofinanciare, jobankare financiare, zyreve të transferit të parave dhe zyreve të këmbimit të valutave -----	91
12.	Numri i ndërmjetësuesëve të sigurimit -----	91
13.	Bankat komerciale-----	93
14.	Kompanitë e sigurimeve -----	94
15.	Institucionet mikrofinanciare -----	94
16.	Institucionet financiare jobankare-----	95
17.	Zyrat për transferin e parave-----	95
18.	Ndërmjetësuesit e sigurimeve -----	95
19.	Zyrat e këmbimit të valutave -----	96
20.	Kreditë sipas degëve të ekonomisë-----	99
21.	Struktura e kapitalit rregullator në sektor dhe ecuria e komponentëve të tij-----	101
22.	Treguesit e kapitalizimit -----	101
23.	Treguesit e cilësisë së kredive -----	103
24.	Kreditë jopërfomuese sipas degëve të ekonomisë-----	103
25.	Treguesit e profitabilitetit-----	104
26.	Treguesit e likuiditetit -----	104
27.	Ecuria e treguesit të cilësisë së kredisë-----	106
28.	Ecuria treguesit të profitabilitetit-----	107
29.	Kreditë – trendi i arkëtimeve -----	110
30.	Depozitat – trendi i rimbursimeve-----	110
31.	Vlera e Primeve të shkruara -----	111
32.	Prime të shkruara bruto, sigurimet jo-jetë -----	113
33.	Sigurime të detyrueshme -----	114
34.	Sigurime Vullnetare -----	114
35.	Sigurime Jetë -----	115
36.	Dëmet e Paguara -----	117

37.	Kalkulimi i Margjinës minimale të Solvencës -----	119
38.	Treguesit e Likuiditetit -----	119
39.	Struktura e investimeve të mjeteve pensionale -----	124
40.	Struktura e investimit të mjeteve pensionale nga FSKP-ja -----	125
41.	Shuma e transaksioneve sipas llojeve kryesore të pagesave -----	129
42.	Treguesit e përqendrimit për transaksionet e iniciuara/dërguara në SEKN -----	134
43.	Treguesit e përqendrimit për transaksionet e pranuar/hyrëse në SEKN -----	134
44.	Numri i llogarive -----	137
45.	Tabela krahasuese e instrumenteve dhe terminaleve të pagesave -----	137
46.	Përcaktimi i fushave të auditimit në bazë të riskut -----	151





## Fjala hyrëse e Kryetarit të Bordit të Bankës Qendrore

Të nderuar lexues,

Viti që lamë pas në nivel botëror u karakterizua me lëvizje të përgjithshme stabile. Produkti i Brendshëm Bruto ndonëse kishte një rritje më të vogël, prapëseprapë ai u karakterizua me rritje pozitive prej 3.2%. Ecuri të mira pozitive u vërejtën në veçanti në ekonominë e SHBA-ve e cila në vitin 2012 shënoi një rritje prej 2.2% krahasuar me 1.8% sa ishte në vitin 2011. Eurozona shënoi rënje prej 0.6%, kurse me gjithë rritjen vjetore më të vogël, vendet në zhvillim në vitin 2012 shënuan rritje të konsiderueshme prej 4.7%. Evropa Qendrore dhe ajo Lindore patën një rritje më të ngadalësuar ndonëse ishte pozitive prej 1.6% në 2012, dukshëm më e vogël se një viti më parë që ishte 5.2%. Inflacioni gjatë vitit 2012 në përgjithësi kishte tendencë rënëse dhe në nivel botërorë ishte 5.5% nga 6.4% në vitin 2011. Pothuajse në të gjitha ekonomitë kryesore pati një rënie të vogël krahasuar me një vit paraprak. Ecuri stabilizuese të inflacionit u vërejtën edhe në Eurozonë dhe në pjesën më të madhe të vendeve të Unionit Evropian. Ecuri negative në veçanti u vërejtën lidhur me punësimin, si një ndër parametrat kyç makroekonomik. Papunësia gjatë vitit 2012 shënoi rritje në nivel botëror në përgjithësi dhe në vendet e evropiane në veçanti, me përjashtim të Gjermanisë që kishte një rënie të vogël krahasuar me një vit paraprak.

Në Evropën Juglindore, si rezultat i ndikimit të ecurive të përgjithshme ekonomike botërore të viteve të kaluara u shënuar rënie e Produktit të Brendshëm Bruto prej 0.2%. Të gjitha vendet shënuan rënie të aktivitetit ekonomik ose kishin nivel dukshëm më të ulët sesa viti paraprak. Ecuritë e përgjithshme të çmimeve kishin tendencë ulje, përjashtim të Serbisë, Malit të Zi dhe Kroacisë. Norma e inflacionit në këto vende kryesisht kishte tendencë ulje ndonëse ajo mbeti në nivelin e vitit paraprak. Papunësia në të gjitha këto vende mbetet një problem shumë i madh.

Në vitin 2012, ecuritë e përgjithshme ekonomike në Kosovë kishin tendencë pozitive. Produkti i Brendshëm Bruto ndonëse pati një rënie të vogël krahasuar me vitin paraprak ai mbeti më i larti në Evropën Juglindore. Ecuritë e përgjithshme të çmimeve ishin stabile, kurse inflacioni shënoi rënie krahasuar me vitin paraprak dhe ishte vetëm 2.5% krahasuar me një vit më parë që ishte 7.3%. Treguesi për numrin e të papunëve në Kosovë tregojnë për një rënie të numrit të atyre që presin për punë.

Sistemi Financiar në Kosovë ishte stabil, ku bankat në përgjithësi vazhduan që të afarojnë në mënyrë pozitive, ashtu sikurse edhe të rrisin numrin e produkteve dhe shërbimeve të ofruara. Ndonëse në mënyrë relative kreditë dhe depozitat shënuan rënie ato vazhduan që të jenë më të larta se një vit paraprak. Po kështu edhe kualiteti i kredive kishte ecuri stabile. Kompanitë e sigurimeve vazhduan që të rrisin llojet e produkteve si dhe kualitetin e shërbimeve të ofruara.

Roli i Bankës Qendrore në mbarëvajtjen e sistemit financiar në Kosovë gjatë vitit të kaluar ka qenë i pakontestueshëm, në veçanti në rolin e rregullatorit dhe të mbikëqyrjes. Me qëllim të rregullimit të funksionimit më të mirë të sistemit financiar, gjatë vitit të kaluar Bordi i Bankës Qendrore ka aprovuar një numër të madh të rregulloreve të reja ose ka amendamentur ato ekzistueset. Po kështu, Banka Qendrore përmes sektorit të mbikëqyrjes ka ushtruar funksionin e vet për të siguruar një sistem stabil, efikas dhe të qëndrueshëm financiar. Në mënyrë të vazhdueshme janë përcjell ecuritë në tregjet financiare dhe në pajtim me to janë marrë vendime lidhur me politikën e investimit të mjeteve, të cilat fatkeqësisht si rezultat i ecurive të përgjithshme nuk kanë qenë të volitshme, por që kanë balancuar menaxhimin e interesit dhe rrezikut. Banka Qendrore ka vazhduar me forma të ndryshme të ngritjes profesionale të stafit

sikurse edhe me plotësimin me staf të ri. Po kështu është rritë shkalla e mbikëqyrjes së brendshme të punë së funksioneve të brendshme të bankës, sikurse edhe mbikëqyrja përmes funksionit të auditimit të brendshëm si dhe punës së Komitetit të Auditimit. Po kështu në mënyrë të vazhdueshme janë prodhuar dhe janë publikuar pasqyra dhe raporte statistikore të cilat janë me rënësi për përcjelljen e ecurive të përgjithshme ekonomike në vend dhe atyre botërore. Një nga to është edhe ky raport vjetor për vitin 2012 i cili paraqet një përmbledhje jo vetëm të punës së Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës por edhe ecurive ekonomike dhe financiare në Kosovë dhe më gjerë.



Kryetari i Bordit të Bankës

Prof. Dr. Sejdi Rexhepi

## Fjala hyrëse e Guvernatorit

Ekonomia vendore vazhdoi me normë pozitive të rritjes, rritje kjo e përkrahur nga stabiliteti financiar dhe fiskal si dhe përmirësimeve në pozicionin tregtar të mallrave dhe shërbimeve, sidomos në kuartalin e fundit të vitit 2012. Rritja reale e ekonomisë vendore për vitin 2012 vlerësohet në 2.9 përqind, rritje kjo e gjeneruar kryesisht nga investimet publike, konsumi privat dhe publik.

Stabiliteti financiar u karakterizua me shëndet të lakmueshëm dhe zgjerim të aktivitetit të sektorit financiar. Përkundër sfidave që rajoni ka përpara kemi arritur të jemi vendi i vetëm në rajon që gjatë vitit 2012 ka licencuar bankë të re dhe atë me kapital të huaj. Bankat si pjesa më e rëndësishme e sistemit financiar kanë vazhduar të zgjerojnë aktivitetin kreditor duke u kujdesur që të mirëmbahet cilësia adekuate e portfolit kreditor, ndërsa kreditë jo-performuese gjatë vitit 2012 shënuan rritje modeste. Depozitat dhe kreditimi kanë vazhduar rritjen, ndërsa kapitalizimi i sistemit bankar ka vazhduar të jetë i lartë përkundër rregulloreve të reja të cilat kanë rritur kërkesat për adekuatshmëri të kapitalit. Kanë vazhduar me rritje edhe pjesët tjera të sektorit financiar. Industria e sigurimeve shënoi rritje të aseteve të përgjithshme dhe rritje të dëmeve të paguara. Gjithashtu, edhe fondi pensional shënoi rritje të aseteve dhe kthim më të mirë nga investimi i tyre, ndërsa institucionet mikrofinanciare shënuan zvogëlim të aktivitetit.

Viti 2012 u karakterizua me aktivitete të rëndësishme për stabilitetin financiar dhe përgjegjësitë e BQK-së. Bashkarisht me FMN-në dhe Bankën Botërore u realizua Programi i Vlerësimit të Sektorit Financiar. Rekomandimet nga ky program janë përfshirë në Planin Strategjik të BQK-së 2013 – 2015, i rishikuar dhe aprovuar në fund të vitit të kaluar. Me aprovimin e Ligji mbi bankat, institucionet mikrofinanciare dhe institucionet financiare jobankare janë aprovuar edhe një numër rregulloresh që avancojnë mëtej sjelljen e kujdesshme të institucioneve financiare. Në këtë kontekst, BQK ka ndërmarrë një mori masash administrative e prudenciale ndaj institucioneve financiare përfshirë edhe ato të hetimit dhe ndalimit të ushtrimit të aktivitetit financiar të palicencuar.

BQK ka vazhduar së avancuari bashkëpunimin me institucione vendore dhe ndërkombëtare. Janë nënshkruar Marrëveshje mirëkuptimi me Doganat e Kosovës dhe me Policinë e Kosovës, pastaj me Agjencionin për mbikëqyrje të financimit kapital të sigurimit pensional të Republikës së Maqedonisë, Agjencionin e mbikëqyrjes së sigurimeve të Sllovenisë dhe me Bankën e Shqipërisë. Njëkohësisht, BQK ka avancuar prezencën e saj në publik brenda dhe jashtë vendit duke marrë pjesë aktive në ngjarje me rëndësi të institucioneve financiare ndërkombëtare si dhe duke organizuar ngjarje të karakterit ndërkombëtar në Kosovë. Veçanërisht duhet theksuar iniciativën e ndërmarrë në bashkëpunimin me partnerë ndërkombëtar rreth kyçjes në rrjetin e SWIFT-it, organizimin e konferencës ndërkombëtare mbi konkurrencën dhe rrezikun bankar, publikimin për herë të parë të statistikave për Pozicionin e investimeve ndërkombëtare dhe borxhin e jashtëm të Republikës së Kosovës, fillimin e tregut të letrave me vlerë të qeverisë, përbushjen e të gjitha zotimeve nga Programi me FMN, realizimin e projektit të Vlerësimit diagnostik të mbrojtjes së konsumatorëve dhe të edukimit financiar dhe operacionalizimin e versionit të ri të Regjistrimit të kredive të mbështetur nga USAID.

Duke marrë parasysh ecuritë aktuale ekonomike në regjion dhe më gjerë, BQK mbetet e fokusuar për ndërmarrjen e veprimeve të duhura me qëllim të sigurimit të stabilitetit financiar në Kosovë.



Guvernator

Bedri Hamza

## Bordi i Bankës Qendrore, Bordi Ekzekutiv dhe Komiteti i Auditimit

### Aktivitetet e Bordit të Bankës Qendrore

Aktivitetet e Bordit të Bankës Qendrore kanë qenë të orientuara në përmbushjen e suksesshme të kompetencave dhe detyrave të përcaktuara me Ligjin për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës. Për këtë qëllim Bordi ka mbajtur takime të vazhdueshme në të cilat është informuar dhe është diskutuar lidhur me ecuritë e përgjithshme të sistemit financiar në Kosovë dhe më gjerë sikurse që ka mbajtur edhe më se 14 mbledhje formale në të cilat ka marrë vendime.

Bordi ka aprovuar me kohë buxhetin vjetor të Bankës Qendrore dhe ka bërë mbikëqyrjen e vazhdueshme të ekzekutimit të tij. Ka shqyrtuar dhe ka aprovuar pasqyrat dhe raportet periodike dhe përfundimtare financiare të BQK-së.

Bordi ka shqyrtuar dhe ka aprovuar planin vjetor të Auditimit të Brendshëm e poashtu ka shqyrtuar dhe ka aprovuar raportet periodike dhe përfundimtare të Komitetit të Auditimit.

Bordi ka shqyrtuar dhe ka aprovuar plotësimin e rregulloreve nga fusha e sistemit financiar sipas kërkesave dhe propozimeve të cilat janë propozuar nga Bordi Ekzekutiv. Gjithashtu si rezultat i nxjerrjes së Ligjit për Banka dhe Institucione Mikrofinanciare Financiare, si dhe të ecurive të përgjithshme ekonomike dhe financiare, Bordi ka miratuar një numër të madh të rregulloreve të cilat janë prezantuar në vazhdim.

- Rregulloren për Mjaftueshmerin e Kapitalit
- Rregulloren mbi Ekspozimet e Rrezikut Kreditor
- Rregulloren mbi Minimumin e Rezervave të Bankës
- Rregulloren për Regjistrin e Kredive
- Rregulloren për Regjistrin e poseduesve të Llogarive bankare
- Rregulloren për Standardet e Raportimit dhe të Mbikëqyrjes së Byrosë Kosovare të Sigurimeve
- Rregulloren për pagesat ndërkombëtare
- Rregulloren për mënyrën e mbajtjes, financimit dhe Përdorimit të Fondit të Kompensimit
- Rregulloren mbi kushtet e përgjithshme të policës së sigurimit nga auto përgjegjësia
- Rregulloren mbi implementimin e sistemit bonus-malus
- Rregulloren për Licencimin e bankave dhe degëve të huaja;
- Rregulloren për hapjen e zyrave përfaqësuese brenda dhe jashtë Republikës së Kosovës;
- Rregulloren për hapjen dhe mbylljen brenda dhe jashtë Republikës së Kosovës të degëve dhe subjekteve të varura të bankave;
- Rregulloren për bashkimet dhe përvetësimet e bankave;
- Rregulloren për publikimin e informacionit nga bankat;
- Rregulloren për Auditimin e jashtëm të bankave;
- Rregulloren për Raportimin e bankave në BQK;
- Rregulloren për menaxhimin e rrezikut kreditor;
- Rregulloren për mbikëqyrjen e konsoliduar të grupeve bankare;

- Rregulloren për Kontrollin e brendshme dhe Auditimin e brendshëm;
- Rregulloren për kufizimet në mbajtjen e pasurisë së paluajtshme dhe të luajtshme;
- Rregulloren për rrezikun nga aktiviteti me valuta të huaja;
- Rregulloren për Depozitën ekuivalente me kapitalin për degët e bankave të huaja;
- Rregulloren për Drejtorët dhe Menaxherët e lartë të bankave; dhe
- Rregulloren për Ekspozimet e mëdha.
- Plotësimin e Rregullores për Ekspozimet e mëdha;
- Rregulloren për Menaxhimin e Rrezikut të Likuiditetit;
- Rregulloren për Menaxhimin e Rrezikut Operacional;
- Rregulloren për Adekuatshmërin e kapitalit të Bankave;
- Rregulloren për Ndryshimet në Llogaritë e Kapitalit të Bankave;
- Rregulloren për Kreditë e Personave të Ndërlidhur;
- Rregulloren mbi Normën Efektive të Interesit dhe Kërkesat për Shpalesje
- Rregulloren Mbi Procedurat e Trajtimin të Kërkesave për Kompensimin e Dëmeve që Rrjedhin nga Sigurimi i Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia.

Bordi i Bankës Qendrore ka miratuar gjithashtu:

- Planin vjetor të Auditimit të Brendshëm për vitin 2012
- Raportin vjetor të Komitetit dhe Shefit të Auditimit të Brendshëm të BQK-së për vitin 2011
- Raportin vjetor financiar të BQK-së për vitin 2011;
- Buxhetin e BQK-së për vitin 2013;
- Raportet dhe pasqyrat periodike të gjendjes financiare të BQK-së;

Me qëllim të përmbushjes së kompetencave të përcaktuara me ligj, Bordi me kohë ka kryer të gjitha detyrat lidhur me:

- Zbatimin e procesit të nominimeve dhe emërimeve në kuadër të kompetencave të përcaktuara me Ligjin e BQK-së;
- Shqyrtimin e të gjitha raporteve dhe rekomandimeve të Bordit Ekzekutiv dhe Guvernatorit, me qëllim të përmbushjes së stabilitetit financiar; dhe
- Çështje të tjera që janë në kompetencën e Bordit të Bankës Qendrore.

Bordi ka ushtruar edhe detyra tjera të cilat kanë qenë në harmonim me Ligjin për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës dhe legjislacionin tjetër në fuqi.

Me 31 dhjetor 2012 Bordi i Bankës Qendrore e Republikës së Kosovës përbëhej nga anëtarët e mëposhtëm:

Sejdi Rexhepi, Kryetar i Bordit të Bankës Qendrore (anëtar jo ekzekutiv);

Gani Gërguri, Guvernator dhe anëtar i Bordit të Bankës Qendrore (anëtar ekzekutiv);

Mejdi Bektashi, anëtar jo ekzekutiv i Bordit të Bankës Qendrore;

Fatmir Plakiqi, anëtar jo ekzekutivë i Bordit të Bankës Qendrore (Drejtor i Thesarit të MF);  
Pozitë vakante e anëtarit joekzekutiv të Bordit të Bankës Qendrore nga 20 nëntor 2012.

Në pajtim me Ligjin Nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës,  
përkatësisht nenin 34 pika 3 Bordi Ekzekutiv përbëhet nga Guvernatori (kryesues i Bordit  
Ekzekutiv) dhe Zëvendësguvernatorët.

Kompetencat dhe detyrat e Bordit Ekzekutiv janë përcaktuar në nenin 36 të Ligjit Nr.  
03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës.

Gjatë vitit 2012, Bordi Ekzekutiv i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës ka mbajtur  
31 takime.

Më 31 dhjetor 2012 Bordi Ekzekutiv përbëhej nga Gani Gërguri (Guvernator/Kryesues i  
Bordit Ekzekutiv), Nexhat Kryeziu ( Zëvendësguvernator për Mbikëqyrjen e Institucioneve  
Financiare) dhe Lulzim Ismajli ( Zëvendësguvernator për Operacione Bankare).

Sekretar i Bordit Ekzekutiv gjatë vitit 2012 ishte Flamur Mrasori (Shef i Kabinetit të  
Guvernatorit).

### **Komiteti i Auditimit**

Në kuadër të qeverisjes transparente në strukturën organizative të BQK-së, në pajtim me nenin  
62 të Ligjit Nr. 03/L-209 mbi Bankën Qendrore të Kosovës dhe statutit të Komitetit të Auditimit,  
vepron edhe Komiteti i Auditimit. Objektivat e Komitetit të Auditimit janë që të asistojnë Bordin  
Drejtues të BQK-së në lidhje me përmbushjen e përgjegjësisë në relacion me veprimin e  
auditimit të brendshëm, kontrollave të brendshme, etikën afariste dhe qeverisjen transparente si  
dhe për raportin financiar të BQK- së.

Komiteti Auditimit emërohet nga Bordi i Bankës Qendrore dhe përbëhet prej tre anëtarëve (dy  
anëtar jo ekzekutivë të zgjedhur nga radhët e Bordit të Bankës Qendrore dhe një anëtar–ekspert  
i jashtëm nga fusha e kontabilitetit dhe auditimit).

Me 31 dhjetor të vitit 2012, Komiteti Auditimit përbëhej nga këta anëtarë:


Sejdi Rexhepi, Kryetar i Bordit të Bankës Qendrore (Gazmend Luboteni deri me 20 nëntor 2012)

Mejdi Bektashi, anëtar i Bordit të Bankës Qendrore;

Arben Dermaku, anëtarë i jashtëm.



Struktura organizative e BQK-së: 31 dhjetor 2012





## 1. Përmbledhje ekzekutive

Aktiviteti ekonomik në nivel global gjatë vitit 2012 kishte zhvillime pozitive por se të kufizuara si rezultat i zhvillimeve të ngadalshme në eurozonë. Gjatë vitit 2012, ekonomia e SHBA-ve u karakterizua me performancë pozitive dhe me rritje më të lartë se në vitin 2011. Në anën tjetër ekonomia e eurozonës gjatë kësaj periudhe u ballafaqua me recesion prej 0.6 përqind si pasojë e dobësimit të konsumit të brendshëm dhe investimeve, shtrëngimit të politikave fiskale dhe papunësisë në rritje. Rrjedhimisht, rritja ekonomike në nivel global gjatë vitit 2012 ishte 3.2 përqind, rritje kjo e nxitur kryesisht nga vendet në zhvillim dhe SHBA-të. Këto zhvillime u reflektuan edhe në vendet e EJL-së duke ndikuar në tkurrje të kërkesës së brendshme si dhe rënie të eksporteve. Përveç këtyre, rajoni gjatë vitit 2012 u ballafaqua me rënie substanciale të Investimeve të Huaja Direkte (IHD), por edhe zvogëlim të dërgesave të emigrantëve. Si rezultat i këtyre zhvillimeve por edhe kujdesit të shtuar të bankave në kreditim, aktiviteti ekonomik në EJL shënoj rënie prej 0.2 përqind.

Përkundër zhvillimeve jo të favorshme në rajon dhe më gjerë, ekonomia e Kosovës edhe gjatë vitit 2012 arriti të shënojë normë pozitive të rritjes. Rritja reale e PBB-së vlerësohet të ketë arritur në 2.9 përqind gjatë vitit 2012, që njëherit paraqet edhe rritjen më të lartë në rajon. Burim kryesor i rritjes ekonomike në vend konsiderohet të ketë qenë rritja e konsumit, si privat ashtu edhe publik. Në anën tjetër, komponenta e investimeve u ballafaqua me zhvillime të ndryshme në krahasim me vitet paraprake, pasi që IHD-të kishin zhvillime negative. Sidoqoftë, këto zhvillime në kuadër të IHD-ve u neutralizuan nga rritja e investimeve publike. Sa i përket pozicionit të jashtëm të Kosovës, deficiti i vazhdueshëm tregtar në mallra dhe shërbime vazhdimisht ndikon negativisht në rritjen ekonomike, por se përmirësimet gjatë vitit 2012 në kuadër të bilancit negativ tregtar ndikuan që efekti të jetë më i ulët se në vitet paraprake. Këto zhvillime gjatë vitit 2012 u përcjellën edhe me normë më të ulët të inflacionit e cila arriti në 2.5 përqind krahasuar me 7.3 përqind sa ishte në vitin 2011.

Sektori financiar në Kosovë u karakterizua me një rikuperim të trendit të rritjes në vitin 2012. Vlera e gjithsej asetëve të sektorit financiar në vend arriti në 3.8 miliard euro në vitin 2012, që paraqet një rritje vjetore prej 9.7 përqind (9.2 përqind në vitin 2011). Rritja më e qëndrueshme e sektorit financiar në vitin 2012 ishte rrjedhojë e rikuperimit të trendit rritës të pothuajse gjithë sektorëve përbërës të tij, me përjashtim të asetëve të sistemit bankar që vazhduan me një trend të ngadalësuar të rritjes. Rritjen më të shpejtë në vitin 2012 e shënuan asetet e fondeve pensionale, duke rritur kështu kontributin e tyre në rritjen e gjithsej asetëve të sektorit financiar në 4.4pp. Përderisa struktura e sistemit bankar në kontekst të pronësisë mbeti e pandryshuar nga viti i kaluar, në vitin 2012, tregut bankar në Kosovë iu shtua një bankë e re duke ngritur kështu numrin e bankave komerciale në nëntë (9). Kreditë e sistemit bankar arritën vlerën prej 1.76 miliard euro, një rritje vjetore prej 3.8 përqind (16.4 përqind në vitin 2011). Ngadalësimi i ritmit të rritjes së kreditimit gjatë vitit 2012 ishte pasojë e zvogëlimit të kërkesës për kredi, por edhe të shtrëngimit të kritereve dhe standardeve të aplikuara në procesin e kreditimit nga ana e bankave në vend si për ndërmarrjet ashtu edhe për ekonomitë familjare. Gjithashtu, në vitin 2012 vlera e gjithsej depozitave në sistemin bankar arriti në 2.2 miliard euro, që tregon për një rritje vjetore 8.3 përqind (8.6 përqind në vitin 2011). Ngadalësimi i rritjes së depozitave ishte kryesisht pasojë e zvogëlimit të depozitave të korporatave publike jofinanciare në këtë periudhë. Sistemi bankar i Kosovës vazhdon të jetë mirë i kapitalizuar edhe përkundër rënies së lehtë të Treguesit të Mjaftueshmërisë së Kapitalit. Në vitin 2012, ky tregues u zvogëlua në 17.9 përqind, nga 18.8 përqind sa ishte në vitin 2011. Gjithashtu, gjatë vitit 2012 raporti ndërmjet kredive joperformuese dhe gjithsej kredive shënoi rritje, duke arritur në 7.5 përqind (5.8 përqind në vitin 2011). Shkalla e likuiditetit në sistemin bankar vazhdoi të jetë e kënaqshme. Raporti ndërmjet

kredive dhe depozitave në vitin 2012 arriti në 77.4 përqind, përderisa rezervat e bankave vazhduan të tejkalojnë nivelin minimal të kërkuar nga Banka Qendrore.

Sa i përket tregut të sigurimeve, në vitin 2012 numri dhe struktura e kompanive të sigurimit mbeten të pandryshuara nga viti i kaluar. Numri i kompanive të sigurimit mbeti trembëdhjetë (13), ku dhjetë (10) prej tyre vazhduan të ofrojnë produkte të sigurimit jo-jetë, ndërsa tri (3) tjera ofruan produkte të sigurimit të jetës. Në vitin 2012, vlera e primeve të shkruara bruto u karakterizua me një rritje prej 3.3 përqind, ku pjesëmarrjen më të lartë të primeve të shkruara vazhdojnë ta kenë produktet e sigurimit Jo-Jetë. Në mars të vitit 2012 është miratuar ligji për mbikëqyrjen e Fondeve Pensionale, ligj ky që ka hyrë në fuqi me 30 mars të vitit 2012. Ligji për mbikëqyrjen e Fondeve Pensionale përcakton dhe rregullon pensionin bazë, pensionet e kursimeve individuale dhe pensionet plotësuese individuale vullnetare. Trusti i Kursimeve Pensionale të Kosovës u karakterizua me një performancë pozitive në vitin 2012. Nga mjetet e investuara në tregjet e jashtme, fondi pensional realizoi kthim pozitiv prej 7.2 përqind apo 53.7 milion euro.

Sikurse në vitin paraprak, edhe në vitin 2012 BQK realizoi në mënyrë të suksesshme furnizimin me kartëmonedha dhe monedha për të siguruar kryerjen e transaksioneve me para të gatshme në ekonomi. Sistemi ndërbankar i Pagesave ka shënuar rritje në vitin 2012, si në vëllim ashtu edhe në vlerë të pagesave, duke reflektuar kështu zvogëlimin e pagesave në para të gatshme dhe rritjen e besueshmërisë në sistemin bankar. Në vitin 2012, përmes SEKN u realizuan rreth 4.3 milionë transaksione, me një vlerë të përgjithshme prej 5.7 miliardë euro. Në kuadër të sistemit të pagesave, vlen të theksohet automatizimi i ndërfaqeve (ndërlidhjeve) të SEKN me Sistemin Qendror të Letrave me Vlerë (DEPO/x) dhe po ashtu implementimi dhe funksionalizimi i Regjistrimit të Poseduesve të Llogarive Bankare për herë të parë në Kosovë. Gjithashtu, disa nga projektet e planifikuara zhvillimore në kuadër të Strategjisë për Zhvillim të Sistemit Kombëtar të Pagesave kanë filluar të zbatohen. BQK realizon investimet e mjeteve konform ligjit mbi BQK-në dhe politikës së investimeve të BQK-së. Në vitin 2012, BQK realizoi kthime pozitive nga investimet. Përderisa gjysma e parë e vitit u karakterizua me kthime më të larta nga investimet, masat e marra nga Banka Qendrore Evropiane (BQE) ndikuan kthimet e realizuara nga investimet në tregun e parase se Euros gjatë gjysmës së dytë të vitit të jenë më të vogla. Në fillim të vitit 2012, është mbajtur ankandi i parë për emetimin e letrave me vlerë, ankand ky që shënoi edhe fillimin e funksionimit të tregut primar për emetimin e letrave me vlerë të Qeverisë së Republikës së Kosovës.

## 2. Mjedisi i jashtëm ekonomik

Rritja vjetore ekonomike në nivel global vlerësohet të ketë arritur normën prej 3.2 përqind përderisa në vitin 2011 ishte shënuar rritje vjetore prej 4.0 përqind (Tabela 1). Ky ngadalësim ishte më i theksuar në vendet evropiane, ku rënia e kërkesës së brendshme si dhe pasiguria e shkaktuar nga zhvillimet në sektorin fiskal gjatë vitit 2012 kanë ndikuar në rënien e konsumit dhe investimeve. Edhe vendet në zhvillim u ballafaquan me ngadalësim të rritjes ekonomike, pasi që rritja e kërkesës së brendshme u frenua nga politikat më të shtrënguara monetare.

Sipas vlerësimeve të FMN-së, gjatë vitit 2012, SHBA-të zgjeruan aktivitetin ekonomik me rritje të PBB-së reale prej 2.2 përqind krahasuar me rritjen prej 1.8 përqind të shënuar në vitin 2011. Kontributin kryesor në rritjen e PBB-së në SHBA e kishin investimet të cilat shënuan rritje prej 6.2 përqind. Në anën tjetër, ekonomia e eurozonës, në vitin 2012, shënoi rënie prej 0.6 përqind krahasuar me rritjen prej 1.4 përqind në vitin 2011. Mirëpo, ndryshe nga SHBA-të, në eurozonë shkaktari kryesor i recesionit ishte rënia e konsumit privat dhe investimeve, të cilat shënuan rënie vjetore prej 1.1 përkatësisht 3.1 përqind. Pothuajse të gjitha vendet e eurozonës shënuan rënie apo normë më të ulët të rritjes ekonomike krahasuar me vitin 2011. Tkurrja ekonomike në eurozonë pritet të bartë pasojë në sektorin fiskal dhe financiar në periudhat në vijim, gjë që do ta vështirësojë tejkalimin e krizës së borxheve publike, e cila është reflektuar në rënien e shkallës së besueshmërisë në tregje si dhe ka ndikuar në rritjen e kostos së financimit dhe rritjen e kredive joperformuese në institucionet financiare.


**Tabela 1. Indikatorët kryesorë makroekonomik**

Përshkrimi	PBB		Inflacioni		Llogaria rrjedhëse (% e PBB-së)	
	2011	2012	2011	2012	2011	2012
Ekonomia botërore	4.0	3.2	6.4	5.5	0.6	0.5
SHBA	1.8	2.2	3.1	2.1	-3.1	-3.0
Eurozona	1.4	-0.6	2.7	2.5	0.6	1.8
Vendet në zhvillim	4.1	4.7	7.5	6.4	1.9	1.4
Evropa Qendrore dhe Lindore	5.2	1.6	5.3	5.8	-6.3	-4.3

Burimi: FMN (2013)

Kriza e fundit financiare globale u pasqyrua në rritjen e vazhdueshme të borxhit publik në vendet e zhvilluara. Në këtë kontekst, performanca më e dobët e sektorit real ka ndikuar në rritjen e mëtejme të pasigurisë së pjesëmarrësve në treg lidhur me qëndrueshmërinë e politikave fiskale dhe borxheve publike. Rrjedhimisht, në fund të vitit 2012, shkalla e borxhit publik në eurozonë arriti në 93.6 përqind të PBB-së (në vitin 2011 ishte 88.0 përqind e PBB). Pothuajse të gjitha shtete e eurozonës e thelluan nivelin e borxhit publik gjatë vitit 2012, veçanërisht shtetet të cilat cilësohen me nivel të lartë të borxhit publik. Për më tepër, borxhi publik në eurozonë u thellua edhe pse deficitit buxhetor shënoi rënie në 3.3 përqind të PBB-së (në

**Figura 1. Inflacioni në eurozonë dhe në disa vendet të zgjedhura të eurozonës**




Burimi: Eurostat (2013)

vitin 2011 ishte 4.1 përqind e PBB). Përkundër rënies së deficitit buxhetor, mungesa e rritjes ekonomike e bën mjaft sfiduese ruajtjen e qëndrueshmërisë së borxheve në eurozonë.

Ekonomia botërore është karakterizuar me rënie të shkallës së inflacionit gjatë vitit 2012. FMN-ja ka vlerësuar shkallën mesatare të inflacionit në nivel global prej 5.5 përqind (6.4 përqind në vitin 2011). Rënia e çmimit të naftës dhe si rrjedhojë edhe rënia e çmimeve të ushqimit dhe energjisë ishin kontribuuesit kryesor për rënien e presioneve inflacioniste si në vendet e zhvilluara ashtu edhe në vendet në zhvillim. Inflacioni në vendet e zhvilluara gjatë vitit 2012 ishte 2.3 përqind (2.9 përqind në vitin 2011), ndërkohë që në vendet në zhvillim inflacioni ishte 6.4 përqind (7.5 përqind në vitin 2011). Sipas të dhënave aktuale, mesatarja e inflacionit në SHBA gjatë vitit 2012 ka rënë në 2.1 përqind (3.1 përqind në vitin 2011), kurse në eurozonë ka rënë në 2.5 përqind (2.7 përqind në vitin 2011). Për shkak të krizës së borxheve e cila ka shkaktuar rënie të kërkesës së përgjithshme, vërehet një rënie më e theksuar e shkallës së inflacionit në Greqi, Spanjë, dhe Portugali (Figura 2).


Figura 2. Papunësia në eurozonë dhe në disa vendet të zgjedhura të eurozonës



Sa i përket papunësisë, të dhënat aktuale tregojnë për zvogëlim të normës së saj në shumicën e ekonomive të fuqishme botërore. Në SHBA norma e papunësisë është zvogëluar në 8.1 përqind në vitin 2012 (8.9 përqind në vitin 2011), 4.3 përqind në Japoni (4.6 përqind në vitin 2011), 4.1 përqind në Kinë (4.1 përqind në vitin 2011) dhe 6.0 përqind në Rusi (6.5 përqind në vitin 2011). Ndërsa, shkalla e papunësisë në vendet e eurozonës ka vazhduar të rritet si rezultat i ngadalësimit të aktivitetit ekonomik në vitin 2012 duke shënuar ngritje nga 10.5 përqind në vitin 2011 në 11.6 përqind në vitin 2012. Greqia, Spanja, dhe Portugalia përveç se janë vendet që i prijnë listës për sa i përket shkallës së papunësisë, gjithashtu paraqesin vende në të cilat papunësia është rritur më së shumti gjatë vitit 2012 krahasuar me vitin 2011 (Figura 2). Në anën tjetër vendet si Gjermania dhe Austria përveç se kanë shkallën më të ulët të papunësisë, janë ndër vendet që kanë arritur të ulin akoma më tej papunësinë gjatë vitit 2012.

Ngadalësimi i rritjes së eksporteve në nivel global gjatë vitit 2012 ka ndikuar në përkeqësimin e llogarisë rrjedhëse. Volumi i eksportit të mallrave dhe shërbimeve për vendet e zhvilluara dhe ato në zhvillim shënoi rritje me vetëm 2.1 përkatësisht 3.6 përqind krahasuar me rritjen prej 5.6 përkatësisht 6.6 përqind të shënuar në vitin 2011. Rritja e eksportit të mallrave shënojë ngadalësim më të madh në vendet e eurozonës (nga 6.1 përqind sa ishte rritja në vitin 2011 në 1.4 përqind në vitin 2012) dhe SHBA (nga 7.4 përqind në vitin 2011 në 4.2 përqind në vitin 2012), ndërsa mesatarja e rritjes së eksporteve në të gjitha vendet tjera të botës shënoi rënie të lehtë (nga 8.0 përqind në vitin 2011

Figura 3. Norma e kredive jopërfomuese në eurozonë dhe në disa vende të zgjedhura të eurozonës



në 7.8 përqind në vitin 2012). Përkundër kësaj, eurozona e rriti shkallën e suficitit të llogarisë rrjedhëse nga 0.6 përqind në vitin 2011 në 1.8 përqind e PBB-së në vitin 2012, SHBA-të shënuan shkallën e njëjtë të deficitit të llogarisë rrjedhëse me vitin e kaluar prej 3.1 përqind e PBB-së, ndërsa suficiti i llogarisë rrjedhëse u zvogëluar në vendet në zhvillim nga 1.9 përqind në vitin 2011 në 1.4 përqind të PBB-së në vitin 2012.

Kreditimi në shumicën e vendeve të zhvilluara vazhdon të jetë në nivele të ulëta, sidomos në vendet që po përballen me krizën e borxheve. Kjo pasi që kriza e borxheve ka rritur pasigurinë e bankave për të lëshuar kredi. Bankat në shumicën e vendeve të Evropës shënuan përqesim të cilësisë së portofolit kreditor (Figura 3). Në anën tjetër, në shumicën e vendeve të eurozonës, bankat raportuan përmirësim në treguesin e mjaftueshmërisë së kapitalit (Figura 4). Mirëpo, në vendet ku kriza e borxheve është më e theksuar, edhe pse është regjistruar përmirësim në nivelin e kapitalizimit, ende janë duke u përballur me vështirësi duke marrë parasysh se kanë investuar mjete të shumta në fletëobligacione qeveritare si dhe në kredi për shtëpi.


Norma bazë e interesit u ndryshua disa herë gjatë vitit 2011, ndërsa në vitin 2012 ajo u ndryshua vetëm një herë. Në korrik 2012, Banka Qendrore Evropiane (BQE) vendosi ta ulë normën bazë të interesit për 0.25pp në 0.75 përqind.

Sa i përket kursit të këmbimit, euro është zhvlerësuar ndaj shumicës së valutave kryesore gjatë vitit 2012. Zhvlerësimin më të theksuar në fund të vitit 2012 e regjistroi ndaj funtës britanike 3.75 përqind, pastaj ndaj frankës zvicerane me 1.50 përqind, si dhe dollarit amerikan me 0.45 përqind. Zhvlerësimi i euros ishte kryesisht pasojë e pasigurisë për shkak të rritjes së rrezikut nga vështirësitë fiskale me të cilat u ballafaquan disa nga vendet e eurozonës.

## 2.1. Evropa Juglindore


Gjatë vitit 2012 edhe vendet e Evropës Juglindore (EJL) u karakterizuan me rënie të aktivitetit ekonomik, kryesisht për shkak të rënies së kërkesës së përgjithshme. Sipas vlerësimeve të FMN-së, PBB reale e vendeve të EJL-së u karakterizua me rënie prej 0.2 përqind krahasuar me rritjen prej 2.3 përqind të shënuar në vitin 2011. Kroacia shënoi nivelin më të lartë të rënies ekonomike krahasuar me vendet tjera (2.0 përqind), pasuar nga Serbia (1.8 përqind), Bosnja e Hercegovina (0.7 përqind), Maqedonia (0.3 përqind) ndërsa vendet tjera vlerësohet të kenë pasur rritje pozitive edhe pse në nivele dukshëm më të ulëta sesa në vitin 2011 (Figura 5). Kjo rënie e aktivitetit ekonomik i adresohet faktit që vendet e rajonit vazhdojnë të jenë të ndjeshme ndaj zhvillimeve në ekonominë e eurozonës në aspektin e tregtisë, investimeve të huaja direkte (IHD-ve), pjesëmarrjes së lartë të bankave të huaja dhe dërgesave të emigrantëve.

Figura 4. Treguesi i mjaftueshmërisë së kapitalit në eurozonë dhe në disa vende të zgjedhura të eurozonës



Burimi: FMN (2013)

Figura 5. Norma e rritjes së PBB-së reale në EJL



Burimi: FMN (2013)


Rënia e aktivitetit ekonomik në vendet e rajonit ka ndikuar edhe në përkeqësimin e gjendjes në tregun e punës. Vlerësimet e fundit të Komisionit Evropian tregojnë për një shkallë mesatare të papunësisë në EJL prej 26.7 përqind (0.7pp më lartë sesa viti 2011). Sidoqoftë, me shkallën më të lartë të papunësisë vazhdojnë të prijnë Bosna e Hercegovina dhe Kosova..

Norma mesatare e deficitit të llogarisë rrjedhëse për vendet e EJL-së në vitin 2012 ishte 10.4 përqind e PBB-së (0.9pp më shumë sesa viti 2011). Të gjitha vendet e EJL-së u karakterizuan me thellim të deficitit të llogarisë rrjedhëse, me përjashtim të Shqipërisë e cila e zvogëloi deficitin e llogarisë rrjedhëse dhe Kosovës e cila kishte nivel pothuajse të njëjtë me vitin 2011 (Figura 6). Mali i Zi, Kosova, dhe Serbia raportuan normat më të larta të deficitit të llogarisë rrjedhëse, ndërsa Kroacia dhe Maqedonia vazhdojnë të jenë vendet me normat më të ulëta të deficitit të llogarisë rrjedhëse.

Sipas vlerësimeve të FMN-së për vitin 2012, pothuajse në të gjitha vendet e EJL-së, eksportet shënuan rritje dukshëm më të ulët sesa në vitin 2011 ndërkohë që importet parashihet të shënojnë rënie. Rritja e eksporteve të mallrave dhe shërbimeve ishte 0.2 përqind krahasuar me rritjen prej 9.5 përqind të shënuar në vitin 2011, ndërsa rënia e importeve ishte 1.7 përqind ndërkohë që në vitin 2011 kishte rritje të importeve prej 5.9 përqind. Deficiti i llogarisë rrjedhëse në vendet e rajonit u përkeqësua edhe si pasojë e zvogëlimit të transfereve rrjedhëse në shumicën e vendeve të rajonit. Në anën tjetër, është përkeqësuar edhe bilanci i IHD-ve, i cili paraqet një komponentë shumë të rëndësishme për financimin e deficitit të llogarisë rrjedhëse. Norma mesatare e neto IHD-ve në raport me PBB-në ishte 5.4 përqind, krahasuar me 6.1 përqind sa ishte në vitin 2011. Sa i përket shteteve individuale, Serbia, Maqedonia, Kosova, dhe Mali i Zi shënuan rënie të raportit ndërmjet IHD-ve dhe PBB-së (2.4, 2.1, 1.8, përkatësisht 0.9pp), ndërsa Shqipëria, Bosnja e Hercegovina, dhe Kroacia shënuan rritje (mesatarisht 0.7pp).


Aktiviteti ekonomik në rënie ka shtyrë disa nga qeveritë e vendeve të rajonit të rrisin shpenzimet qeveritare për të stimuluar kërkesën e përgjithshme në ekonomitë e tyre, gjë e cila është reflektuar në përkeqësim të bilancit të tyre buxhetor. Krahasuar me vitin 2011, Serbia, Maqedonia, dhe Kosova u karakterizuan me rritje më të shpejtë të shpenzimeve krahasuar me të hyrat buxhetore, gjë që ndikoi në zgjerimin e deficitit të tyre buxhetor. Shkallën më të lartë të deficitit buxhetor e shënoi Serbia (6.7 përqind të PBB-së), pasuar nga Kroacia (4.4 përqind e PBB-së), Mali i Zi (4.0 përqind e PBB-së) dhe Maqedonia (3.5 përqind e PBB-së), ndërsa Kosova, Shqipëria, dhe Bosnja e Hercegovina shënuan deficit buxhetor në nivele më të ulëta krahasuar me vendet tjera (mesatarisht 1.9 përqind e PBB-së). Për rrjedhojë, gjatë vitit 2012 është thelluar edhe shkalla mesatare e borxhit publik në EJL, e cila arriti në 45.1 përqind

Figura 6. Deficiti i llogarisë rrjedhëse në EJL, si përqindje e PBB-së



Burimi: Komisioni Evropian (2013)

Figura 7. Norma mesatare vjetore e inflacionit në EJL



Burimi: Komisioni Evropian (2013)

të PBB-së krahasuar me normën prej 39.4 përqind të PBB-së të regjistruar në vitin 2011. Shqipëria dhe Serbia raportuan shkallën më të lartë të borxhit publik prej 63.8 përkatësisht 63.1 përqind të PBB-së, përderisa Kosova vazhdon të ketë shkallën më të ulët të borxhit publik në rajon me vetëm 6.0 përqind të PBB-së në vitin 2012.

Gjatë vitit 2012, shumica e vendeve në EJL u përballën me rënie të presioneve inflacioniste që kryesisht ishin reflektim i rënies së kërkesës si dhe rënies së çmimeve të naftës dhe ushqimit në nivel global. Mesatarja e inflacionit për vitin 2012 ishte 3.5 përqind krahasuar me mesataren prej 4.4 përqind që ishte shënuar në vitin 2011. Serbia, Mali i Zi, Kroacia, dhe Maqedonia raportuan normat më të larta të inflacionit, ndërsa Kosova, Shqipëria, dhe Bosnja e Hercegovina, raportuan nivele më të ulëta të inflacionit (Figura 7).

Sa i përket kursit të këmbimit ndërmjet euros dhe valutave të vendeve të EJJL-së, në dhjetor 2012 krahasuar me dhjetor 2011, euro vlerësimin më të madh e shënoi ndaj dinarit serb 8.5 përqind (113.5 RSD/EUR), pastaj ndaj lekut shqiptar me 1.1 përqind (139.7 ALL/EUR), denarit maqedonas me 1.0 përqind (61.5 MKD/EUR), si dhe kunas kroate me 0.3 përqind (7.5 HRK/EUR).

Si kreditë ashtu edhe depozitat janë karakterizuar me rritje më të ngadalësuar krahasuar me vitin 2011. Të dhënat për vitin 2012 tregojnë se, me përjashtim të Malit të Zi dhe Kroacisë, ku kreditimi shënoi rënie, të gjitha vendet e EJJL-së kanë shënuar rritje të kreditimit, por te shumica e tyre norma e rritjes ishte më e ulët se sa në vitin 2011. Sipas të dhënave të Komisionit Evropian, rritja më e lartë e normës së kreditimit është regjistruar në Serbi (16.0 përqind), ndërsa Mali i Zi raportoi rënien më madhe të aktivitetit kreditor (4.3 përqind).

**Table 2. Rritja vjetore e kredive dhe depozitave**

Përshkrimi	Shqipëria		BH		Kroacia		Maqedonia		Mali i Zi		Serbia		Kosova	
	2011	2012	2011	2012	2011	2012	2011	2012	2011	2012	2011	2012	2011	2012
Kreditë	11.7	7.0	5.6	4.9	6.5	-0.3	8.1	7.0	-11.1	-4.3	7.4	16.0	16.4	3.8
Depozitat	14.5	9.1	2.6	2.5	7.3	7.1	10.9	6.8	1.5	4.2	9.2	13.0	8.6	8.3

Shënim: për vitin 2012 mungon muaji dhjetor andaj është paraqitur mesatarja e muajve tjerë.

Burimi: Komisioni Evropian, Raporti i tremujorit të katërt 2012; për Kosovën të dhënat e BQK-së.

Sa i përket depozitave, të gjitha vendet e EJJL-së shënuan normë pozitive të rritjes. Shqipëria dhe Maqedonia raportuan ngadalësim më të theksuar të rritjes krahasuar me vitin 2011, përderisa Serbia dhe Mali i Zi raportuan përshpejtim të rritjes (Tabela 2). Sistemet bankare në EJJL u karakterizua me përkeqësim të cilësisë së portofolit kreditor gjatë kësaj periudhe. Në vitin 2012, Shqipëria, Kroacia, Bosnja e Hercegovina raportuan normat më të larta të kredive jo-performuese në rajon, me 21.2, 13.2, 12.6 përqind, ndërsa shkallën më të ulët të kredive jo-performuese vazhdon ta ketë Kosova, me vetëm 7.5 përqind.

### 3. Ekonomia e Kosovës

Ekonomia e Kosovës gjatë vitit 2012 shënoi normë pozitive të rritjes. Sidoqoftë, aktiviteti i përgjithshëm ekonomik në vend u sfidua nga zhvillimet në tregjet rajonale dhe evropiane. Gjatë vitit 2012 kishte luhate të theksuar në disa nga burimet e rëndësishme të financimit në vend, veçanërisht investimet e huaja direkte. Me zhvillime negative u karakterizuan edhe eksportet e mallrave, mirëpo, rritja e eksporteve të shërbimeve neutralizoi efektin e gjithsej eksporteve. Përveç kanaleve të sektorit të jashtëm të ekonomisë të cilët po ndikohen nga zhvillimet në ekonominë globale, ekonomia në vend vazhdoi të tregojë performancë solide marrë parasysh se

sistemi financiar i vendit vazhdoi ndërmjetësimin financiar me normë pozitive të rritjes si në kuadër të kredive ashtu edhe në depozita. Përkundër përkeqësimeve në disa sektorë të ekonomisë, sektori financiar e në veçanti sistemi bankar ka pasur performancë pozitive dhe vlerësohet të ketë përkrahur aktivitetin e përgjithshëm ekonomik. Në anën tjetër, dërgesat e emigrantëve, si njëra ndër komponentët kryesore të financimit të konsumit në vend, vazhduan trendin pozitiv të rritjes madje më të theksuar se sa në katër vitet e fundit. Sektori publik gjithashtu vazhdon të ketë rol pozitiv në stabilitetin e ekonomisë së vendit si në kuadër të të hyrave ashtu edhe në kuadër të shpenzimeve buxhetore. Përveç investimeve kapitale, sektori publik gjatë vitit 2012 nëpërmjet subvencioneve ka ndihmuar që të përshejtohet ritmi i zhvillimit në sektorin e bujqësisë, pasi që është shënuar rritje e numrit të ndërmarrjeve të reja në këtë sektor.

Çmimet në Kosovë gjatë këtij viti u karakterizuan me stabilitet duke shënuar normë mesatare të inflacionit prej 2.5 përqind. Zhvillimet në kuadër të përbërjes së shportës së konsumatorit gjatë këtij viti konsiderohen të kenë qenë pozitive pasi që pjesëmarrja e produkteve ushqimore ka shënuar rënie, reflektim ky i përmirësimit të standardit të përgjithshëm në vend.


Sidoqoftë, sfidë e vazhdueshme në Kosovë mbetet norma e lartë e papunësisë, ndërsa norma aktuale e rritjes ekonomike nuk mjafton për të absorbuar rritjen e vazhdueshme të fuqisë punëtore në vend. Megjithatë, niveli relativisht i lartë i dërgesave të emigrantëve po kontribuon në zbutjen e kësaj barre për ekonominë e vendit.

### 3.1. Sektori real

#### 3.1.1 Produkti i brendshëm bruto<sup>1</sup>


Produktit i Brendshëm Bruto (PBB) gjatë vitit 2012 vlerësohet të ketë arritur vlerën 5.02 miliardë euro (2.9 përqind rritje reale). Rritja gjatë vitit 2012 u ngadalësua si rezultat i zhvillimeve në eurozonë dhe në rajon. Bartës kryesor të rritjes ekonomike gjatë vitit 2012 konsiderohet të kenë qenë konsumi privat dhe publik, ndërsa ndikimi i investimeve ishte më i limituar si rezultat i rënies së investimeve të huaja direkte (IHD). Kjo rënie e IHD-ve u neutralizua nga rritja e investimeve publike, ndërsa ndikimi negativ i tregtisë së mallrave dhe shërbimeve në rritjen reale ekonomike komponenti krahasuar me vitin paraprak.

Figura 8. Harta Makroekonomike



Burimi: BQK (2013)

Figura 9. Rritja reale e PBB-së



Burimi: \*ASK (2012) dhe Vlerësimi i BQK-së

është zbutur për shkak të përmirësimit të këtij

<sup>1</sup> Burimi i të dhënave për PBB-në është Agjencia e Statistikave të Kosovës dhe Fondi Monetar Ndërkombëtar, World Economic Outlook, tetor 2012.


Konsumi në ekonominë e Kosovës, përveç kredive të sistemit bankar, është përkrahur edhe nga dërgesat e emigrantëve të cilat arritën në 605.6 milionë euro që paraqet një rritje prej 3.6 përqind. Përkrahës i konsumit ishte edhe rritja e shpenzimeve qeveritare në emër të pagave dhe mëditjeve për mbi 5 përqind. Përveç pagave, edhe konsumit i mallrave dhe shërbimeve qeveritare i ka kontribuar pozitivisht konsumit të përgjithshëm pasi që është rritur me mbi 6 përqind.

Sa i përket investimeve, sjellja e tyre gjatë vitit 2012 ishte më e ndryshme nga vitet paraprake pasi që rënia e IHD-ve dhe rënia e kredive të reja për investime neutralizuan efektin e rritjes së investimeve publike. Bartës në kuadër të investimeve ishte sektori publik, investimet e të cilit gjatë vitit 2012 arritën në mbi 550 milionë euro, që krahasuar me vitin paraprak janë rritur me mbi 4 përqind. Me ndikim negativ në PBB vazhdon të jetë bilanci tregtar si rezultat i deficitit të vazhdueshëm në kuadër të tregtisë së mallrave. Sidoqoftë, gjatë vitit 2012 bilanci tregtar i mallrave dhe shërbimeve përkundër se ishte negativ, kishte nivel më të ulët në krahasim me vitin paraprak për 66.7 milionë euro apo ngushtim i deficitit për 3.7 përqind. Kontribut në ngushtimin e deficitit tregtar, përveç rënies së importeve për 1 përqind, kishte edhe rritja e eksportit të shërbimeve për 3.7 përqind.

Sa i përket PBB-së sipas aktivitetit ekonomik, të dhënat janë në dispozicion vetëm për periudhën 2006-2011. Mirëpo, duke marrë parasysh strukturën ekonomike në Kosovë, nuk pritet të ketë ndryshim substancial në strukturë, me përjashtim të bujqësisë e cila pritet të ketë përmirësim. Struktura e PBB-së gjatë periudhës 2006-2011 është paraqitur në figurën 11.


PBB për kokë banori në Kosovë gjatë vitit 2012 ka arritur nivelin e mbi 2,750 euro krahasuar me 2,650 euro në vitin 2011. Rritja e PBB-së për kokë banori në terma nominal ishte më e ulët në krahasim me vitet paraprake, por se rritja e PBB-së e vlerësuar me Paritetin e fuqisë blerëse (*angl. Purchasing Power Parity: PPP*) ishte më e lartë pasi që ka arritur në mbi 7400 euro. Rrjedhimisht, në kontekst të fuqisë blerëse, PBB për kokë banori është në nivel të ngjashëm me Bosnje e Hercegovinën dhe Shqipërinë ndërsa vazhdon të jetë më e ulët krahasuar me Maqedoninë, Malin e Zi dhe Serbinë.<sup>2</sup>

Figura 10. Kontributi i komponentëve kryesore në PBB



Burimi: ASK (2013)

Figura 11. PBB sipas aktivitetit ekonomik



Burimi: ASK (2013)


<sup>2</sup> Burimi i të dhënave është FMN, me kalkulime shtesë të BQK-së

### 3.1.2 Çmimet

Bazuar në indeksin e çmimeve të konsumit (*angl. Consumer Price Index: CPI*), inflacioni në Kosovë shënoi një normë mesatare prej 2.5 përqind në vitin 2012. Presionet inflacioniste gjatë vitit 2012 ishin më të ulëta në krahasim me vitin e kaluar, ndërsa ishte gjysma e dytë e vitit e cila u karakterizua me presione më të theksuara. Në vazhdimësi, janë produktet e importuara ato të cilat po ndikojnë në nivelin e çmimeve në Kosovë, përfshirë këtu edhe çmimet e prodhimit. Produktet ushqimore në Kosovë konsiderohen si faktori kryesor në nivelin e inflacionit. Kjo për shkak të peshës së madhe të kësaj kategorie në shportën e konsumatorit. Mirëpo, trendet e përgjithshme në kuadër të kësaj kategorie janë pozitive në nivel vendi pasi që kjo kategori gradualisht është duke e zvogëluar pjesëmarrjen në shportën e konsumatorit. Gjatë vitit 2012 pesha e kategorisë ushqimore ka shënuar rënie në 37.8 përqind krahasuar me 42.7 përqind sa ka qenë në vitin paraprak. Gjithashtu, kjo kategori e produkteve gjatë vitit 2012 u karakterizua me stabilitet pasi që çmimet e produkteve ushqimore u rritën me vetëm 0.7 përqind. Rritje më të theksuar të çmimeve gjatë vitit 2012 u shënuan në kategoritë si produktet alkoolike dhe duhani si dhe shërbimet e banimit, energjisë elektrike, ujit, gazit, etj. Mirëpo, që të dyja këto kategori kishin ndikim më të limituar në mesataren vjetore të inflacionit në vend marrë parasysh se pesha e këtyre kategorive në gjithsej shportën e konsumatorit shënoi rënie nga 8 përkatësish 10.4 përqind në 5.1 përkatësish 7.1 përqind. Kategoritë tjera që kishin ndikim në rritje të çmimeve janë transporti me 3.7 përqind rritje të çmimeve si dhe rritje të peshës në shportën e konsumatorit nga 8.1 në 13.3 përqind, rekreacioni dhe kultura me 4.6 përqind rritje të çmimeve si dhe rritje të pjesëmarrjes në shportë nga 1.7 në 4.4 përqind dhe orenditë shtëpiake që nga 4.6 përqind të shportës në vitin 2011 u rritën në 10.0 përqind ndërsa rritja e këtyre çmimeve ishte me 2.4 përqind.


Siç edhe është paraqitur në figurën 12, çmimet në Kosovë kanë prirje të ngjashme me çmimet e importit. Kjo pasi që influenca më e madhe në çmimet vendore vjen pikërisht nga mallrat e importuara si rezultat i varësisë së lartë të ekonomisë së vendit në importin e mallrave. Në vitin 2012, norma mesatare vjetore e rritjes së Indeksit të Çmimeve të Importeve (*angl. Imports Price Index: IPI*) ishte mbi 5 përqind por se ndikimi në këtë vit ishte më i kufizuar në CPI për shkak të rënies së peshës së produkteve ushqimore. Ndikimi i çmimeve të prodhimit (*angl. Producer Price Index: PPI*) në çmimet e konsumit mbetet më i ulët në krahasim me çmimet e importit. Rritja e çmimeve të prodhimit gjatë kësaj periudhe ishte 1.7 përqind që paraqet nivel relativisht të ngjashëm me nivelin e përgjithshëm të inflacionit në vend.

Figura 12. Indeksi i çmimit të konsumit, importit dhe prodhimit



Burimi: ASK (2013)

Figura 13. Peshat e komponentëve në shportën e konsumatorit



Burimi: ASK (2013)

### 3.1.3 Tregu i punës


Një ndër sfidat kryesore dhe të vazhdueshme në Kosovë mbetet norma e lartë e papunësisë e cila konsiderohet si barra kryesore e ekonomisë vendore. Faktor që ndikon në zbutjen e efekteve negative nga norma e papunësisë në vend konsiderohet të jetë niveli relativisht i lartë i dërgesave të emigrantëve. Duke marrë parasysh rritjen e vazhdueshme të fuqisë punëtore në vend e cila rezulton nga struktura e re e popullsisë, norma aktuale e rritjes ekonomike konsiderohet me kapacitete të ulëta absorbimi për fuqinë punëtore.

Sipas rezultateve të Anketës së Fuqisë Punëtore të publikuar nga ASK-ja, shkalla e papunësisë në Kosovë, në gjysmën e parë të vitit 2012, ishte 35.1 përqind. Sipas rezultateve të kësaj ankete, shkalla e papunësisë është më e theksuar në zonat rurale (40.1 përqind) krahasuar me zonat urbane (28.5 përqind), pastaj papunësia është më e lartë tek femrat (44.4 përqind) sesa tek meshkujt (32.0 përqind). Karakteristikë shqetësuese është niveli i lartë i papunësisë tek të rinjtë e moshës 15-24 vjeç (60.2 përqind). Të dhënat për punëkërkuesit e regjistruar gjatë vitit 2012 tregojnë se gjatë vitit 2012 ishin rreth 260 mijë punëkërkues të regjistruar. Sidoqoftë gjatë vitit 2012, numri i punëkërkuesve të rinj që u regjistruan në MPMS ishte 24,879. Prej tyre, MPMS ndërmjetësoi që 7,692 të punësohen, që është numër më i lartë se në vitin paraprak. Siç edhe është paraqitur në figurën 15, vendet e lira të paraqitura në MPMS gjatë vitit 2012 ishin 9,434. Raporti ndërmjet vendeve të paraqitura dhe punësimeve nga MPMS gjatë këtij viti ishte 81.5 përqind (76.5 përqind në vitin paraprak).

### 3.2. Sektori fiskal<sup>3</sup>


Buxheti i Kosovës në vitin 2012 u përmbyll me suficit prej 71.49 milionë euro, krahasuar me deficitin e vitit të kaluar prej 84.48 milionë euro. Përderisa të gjitha vendet e rajonit përmbyllën periudhën raportuese me deficit buxhetor (mesatarisht 3.4 përqind e PBB-së), Kosova ishte vendi i vetëm në rajon me bilanc pozitiv buxhetor, prej 1.5 përqind të PBB-së. Rritja e bilancit buxhetor në vitin 2012 ishte kryesisht rezultat i rritjes së të hyrave nga huamarrjet. Sa i përket progresit të të hyrave dhe shpenzimeve sipas planifikimit, të hyrat buxhetore u realizuan në masën 99.6 përqind të planifikimit buxhetor ndërsa shpenzimet buxhetore u realizuan në masën 94.7 përqind nga sa ishin planifikuar.

Figura 14. Punësimi formal dhe rritja e punësimit



Burimi: ASK (2013)

Figura 15. Ndërmjetësimi në punësim nga MPMS



Burimi: MPMS (2013)

<sup>3</sup> Të dhënat e paraqitura për sektorin fiskal janë të paaudituarashtu siç janë publikuar në faqen zyrtare të Ministrisë së Financave në qershor 2013.

### 3.2.1 Të hyrat buxhetore

Të hyrat buxhetore, pa përfshirë pranimet nga donatorët dhe fondet në mirëbesim, në vitin 2012 arritën vlerën prej 1,537.95 milionë euro dhe shënuan rritje vjetore prej 18 përqind. Si rrjedhojë e rritjes së PBB-së, raporti i të hyrave buxhetore ndaj PBB-së u zvogëlua në 30.6 përqind, krahasuar me raportin prej 37 përqind një vit më parë.


Të hyrat e mbledhura nga tatimet në kufi përfaqësojnë kategorinë me pjesëmarrjen më të lartë në kuadër të gjithsej të hyrave buxhetore (57.6 përqind). Megjithatë, pjesëmarrja e të hyrave nga tatimet kufitare u zvogëlua për 8.5pp, si rrjedhojë e rritjes së kategorive tjera apo krijimit të kategorive të reja në kuadër të të hyrave buxhetore. Vlera e të hyrave kufitare në vitin 2012 arriti në 844.86 milionë euro, dhe shënoi rritje vjetore prej 2.1 përqind (18.1 përqind rritje në vitin 2011). Ngadalësimi i normës së rritjes së të hyrave kufitare në vitin 2012 erdhi

kryesisht si pasojë e rënies së importeve (nominalisht prej 1.0 përqind), si dhe rënies së çmimeve të disa nga kategorive më të rëndësishme, si të metaleve bazë dhe produkteve minerale. Kategoria kryesore në kuadër të të hyrave kufitare është TVSH-ja në kufi, me pjesëmarrje prej 49.6 përqind (Figura 16). Të hyrat nga TVSH-ja në kufi në vitin 2012 u zvogëluan për 0.1 përqind dhe arritën vlerën prej 418.93 milionë euro, zvogëlim ky që përsëri mund t'i atribuohet rënies së importeve. Kategoria e dytë më e madhe në të hyrat kufitare vazhdonë të përfaqësohet nga të hyrat e mbledhura nga akciza, të cilat zënë 34.5 përqind të gjithsej të hyrave kufitare. Kjo pjesëmarrje ishte konsistente me pjesëmarrjen e një viti më parë. Megjithatë, vlera e të hyrave nga akciza shënoi rritje të konsiderueshme prej 45.6 përqind, duke arritur vlerën prej 291.3 milionë euro. Në anën tjetër, të hyrat nga taksa doganore regjistruan rënie të konsiderueshme prej 42.8 përqind dhe arritën vlerën prej 117.72 milionë euro. Pjesa e mbetur e të hyrave nga tatimet në kufi përbëhet nga kategori si të hyrat nga banderolat, akciza e brendshme, të hyrat nga dënimet, etj., të cilat së bashku arritën vlerën prej 16.9 milionë euro dhe kishin pjesëmarrje prej 2 përqind, në gjithsej të hyrat buxhetore.

Të hyrat nga tatimet vendore janë rritur nga 261.13 milionë euro në vitin 2011, në 283.91 milionë euro deri në fund të vitit 2012. Kjo për arsye se kategoritë kryesore të të hyrave nga tatimet vendore u karakterizuan me rritje. Ngjashëm me


TVSH-në në kufi, TVSH-ja e mbledhur brenda vendit përfaqëson kategorinë kryesore në kuadër të tatimeve vendore, me pjesëmarrje 45.6 përqind. Të hyrat nga TVSH-ja arritën vlerën prej 129.58 milionë euro, duke shënuar rritje prej 6.7 përqind (Figura 17). Të hyrat nga tatimi në korporata paraqesin kategorinë e dytë më të madhe në kuadër të tatimeve vendore (22.1 përqind), prej të cilave u gjeneruan 62.68 milionë euro (rritje vjetore prej 14.9 përqind). Njëherit, të hyrat nga tatimi në korporata kontribuuan më së shumti në rritjen e gjithsej të hyrave nga

Figura 16. Burimet kryesore të të hyrave kufitare, në milionë euro



Burimi: Ministria e Financave (2013)

Figura 17. Burimet kryesore të të hyrave nga tatimet vendore, në milionë euro



Burimi: Ministria e Financave (2013)

tatimet vendore, me 14.9pp. Kategori tjetër me pjesëmarrje të ngjashme ishin edhe të hyrat nga tatimi në të ardhura, prej së cilave u gjeneruan 60.1 milionë euro. Të hyrat nga kjo kategori shënuan normë të rritjes vjetore prej 8 përqind.

Kategori tjetër në rritje në kuadër të tatimeve vendore, janë të hyrat nga bizneset individuale të cilat u rritën për 9.1 përqind duke arritur vlerën prej 25.93 milionë euro. Pjesa tjetër e të hyrave nga tatimet vendore, që kryesisht rrjedhin nga mbledhja e të hyrave nga gjambat e ATK-së, tatimi në interes, dividendë e qera, licencat për lojëra të fatit etj., përfaqësojnë një pjesë relativisht më të vogël, që nuk tejkalon 2 përqind, apo 6 milionë euro të gjithsej të hyrave nga tatimet vendore.

Vlenë të ceket se, pas aprovimit të ligjit për borxh publik në fund të vitit 2009 dhe më vonë themelimit të infrastrukturës nga ana e BQK-së, në janar të vitit 2011, për herë të parë në Kosovë filloi emetimi letrave me vlerë nga ana e Qeverisë së Kosovës. Rrjedhimisht, nga gjithsej shtatë ankande të letrave me vlerë që u realizuan gjatë vitit 2012, borxhi brendshëm i Qeverisë arriti në 73.3 milionë euro. Në anën tjetër, nga borxhi i jashtëm publik, ku kryesisht bëjnë pjesë pranimet nga Banka Botërore dhe Fondi Monetar Ndërkombëtar, janë gjeneruar 93.68 milionë euro të hyra. Rrjedhimisht, raporti i gjithsej borxhit publik (borxhi i brendshëm dhe ai i jashtëm) dhe PBB-së në vitin 2012 arriti në 9.5 përqind, që paraqet raport krahasimisht më të ulët se mesatarja e rajonit (rreth 40 përqind e PBB-së).

Pjesë e të hyrave buxhetore jotatimore janë edhe të hyrat vetanake, që gjenerohen nga niveli qendror dhe ai komunal. Në vitin 2012, nga niveli qendror u gjeneruan 44.83 milionë të hyra jotatimore apo 25.2 përqind më pak se në vitin 2011. Të hyrat nga niveli qendror kryesisht gjenerohen nga kategori si të hyrat nga licencat, nga participimet e ministrive dhe institucioneve tjera, inspektimet etj. Në anën tjetër, të hyrat vetanake nga niveli komunal u rritën për 6.9 përqind krahasuar me vitin 2011, dhe arritën vlerën prej 59.44 milionë euro. Këto të hyra gjenerohen nga aktiviteti komunal, dhe atë kryesisht nga gjambat.

Sa i përket të hyrave të njehershme, përkatësisht transferimit të dividendës së PTK-së, në vitin 2012 u transferuan 45 milionë euro në buxhetin e Kosovës, krahasuar me 60 milionë euro një vit më parë. Në vitin 2012, gjithashtu u realizuan edhe 28.93 milionë euro të hyra nga financimi i njehershëm i AKP-së. Gjithashtu, për herë të parë në buxhetin e Kosovës u realizuan edhe 4 milionë euro nga kthimi i huazimeve nga ndërmarrjet publike.

### 3.2.2 Shpenzimet buxhetore

Shpenzimet buxhetore, duke mos përfshirë grantet e përcaktuara të donatorëve si dhe fondet në mirëbesim, në vitin 2012 arritën vlerën prej 1.46 miliardë euro, apo 22.2 përqind e PBB-së (29.5 përqind e PBB-së në vitin 2011). Shpenzimet qeveritare në vitin 2012 shënuan rritje vjetore prej 5.7 përqind, normë kjo më e ngadalshme krahasuar me rritjen prej 9.1 përqind në vitin 2011. Ngadalësimi i rritjes së gjithsej shpenzimeve buxhetore erdhi kryesisht për shkak të ngadalësimit të rritjes së pagave dhe mëditjeve gjatë kësaj periudhe. Shpenzimet qeveritare të dedikuara për konsum ishin 11.5 përqind e PBB-së, ndërsa shpenzimet qeveritare të dedikuara për investime kapitale ishin 11 përqind e PBB-së.<sup>4</sup>

Ngjashëm si në vitet paraprake, shpenzimet kapitale vazhduan të absorbojnë pjesën kryesore të shpenzimeve buxhetore, me pjesëmarrje prej 37.8 përqind (38.3 përqind në vitin 2011). Shpenzimet kapitale në vitin 2012 arritën vlerën prej 550.24 milionë euro që paraqet një rritje vjetore prej 4.2 përqind (Figura 18). Njëherit, shpenzimet kapitale përfaqësojnë një nga kategoritë me kontributin më të lartë në rritjen e gjithsej shpenzimeve buxhetore, me 1.6pp. Pjesa kryesore e shpenzimeve kapitale (61 përqind), kishte për destinim investimet infrastrukturore, të cilat kryesisht orientohen në investime në autostradën Morinë-Merdarë, që

<sup>4</sup> Në shpenzimet për konsum bëjnë pjesë pagat e mëditjet dhe mallrat e shërbimit, ndërsa në investime bëjnë pjesë shpenzimet kapitale.

filloi të ndërtohet në prill të vitit 2010. Kategoria e dytë me radhë për nga madhësia, ishin pagat dhe mëditjet, me pjesëmarrje prej 27.9 përqind në gjithsej shpenzimet buxhetore. Pagat dhe mëditjet në vitin 2012 arritën vlerën prej 409.24 milionë euro, ku 407.71 milionë euro janë ndarë nga fondi i përgjithshëm, ndërsa 1.54 milionë euro tjera nga grantet e përcaktuara të donatorëve. Pagat dhe mëditjet në vitin 2012 u rritën për 5.9 përqind, krahasuar me rritjen prej 26.6 përqind në vitin 2011.<sup>5</sup> Subvencionet dhe transferet vazhdojnë të përfaqësojnë kategorinë e tretë me radhë, me pjesëmarrje prej 19.1 përqind. Në vitin 2012, u shpërndanë gjithsej 280.12 milionë euro transfere dhe subvencione dhe ishte kategoria me normën më të lartë të rritjes vjetore, prej 9.3 përqind. Si zakonisht, pensionet bazë absorbojnë pjesën kryesore të subvencioneve dhe transfereve (39.9 përqind), ndërsa kategoritë si subvencionet për ndërmarrjet publike dhe pagesat për invalidët e luftës kishin pjesëmarrje relativisht më të ulët, prej 18.6 përqind, përkatësisht 11 përqind. Pensionet bazë dhe pagesat për invalidët e luftës u rritën për 19.7 përqind dhe 5.5 përqind, ndërsa subvencionet për ndërmarrje publike u zvogëluan për 13.7 përqind.

Një ndër kategoritë me pjesëmarrje relativisht më të ulët në gjithsej shpenzimet buxhetore, ishin shpenzimet për mallra dhe shërbime, me pjesëmarrje prej 11.8 përqind. Mallrat dhe shërbimet, në vitin 2012 arritën vlerën prej 169.36 milionë euro dhe shënuan rritje vjetore prej 8.2 përqind. Në rritjen e kësaj kategorie të shpenzimeve buxhetore, kryesisht ndikoi rritja e shpenzimeve për furnizime dhe shpenzimeve kontraktuese. Pjesa e mbetur e shpenzimeve buxhetore përbëhet nga këto kategori: pagesat e borxhit qeveritar (kryegjësja, interesi dhe tarifata) prej 21.42 milionë euro, shpenzimet për shërbime komunale prej 21.56 milionë euro dhe kredia dhënë KEK-ut prej 15 milionë euro.


### 3.3. Sektori financiar

#### 3.3.1 Karakteristikat e përgjithshme

Gjatë vitit 2012, sektori financiar në Kosovë u karakterizua me një rikuperim të trendit të rritjes krahasuar me vitin paraprak. Rritja më e qëndrueshme e sektorit financiar në vitin 2012 ishte kryesisht rrjedhojë e rikuperimit të trendit rritës të aseteve të sektorit të sigurimeve dhe fondeve pensionale, përderisa asetet e sistemit bankar vazhduan me një trend të ngadalësuar të rritjes. Vlera e gjithsej aseteve të sektorit financiar në vend arriti në 3.8 miliard euro në vitin 2012, që paraqet një rritje vjetore prej 9.7 përqind (në 2011 kjo rritje ishte 9.2 përqind). Sistemi bankar, si komponent kryesor në sektorin financiar të Kosovës, raportoi një rritje vjetore të aseteve prej 6.8 përqind në vitin 2012 krahasuar me rritjen vjetore prej 7.9 përqind në vitin 2011, kryesisht si rezultat i ngadalësimit të rritjes së kreditimit.

Vlera e aseteve të institucioneve mikrofinanciare zbriti në 115.8 milionë euro në vitin 2012, nga 127.1 milionë euro sa ishte në vitin 2011, kryesisht si pasojë e ngadalësimit të aktivitetit kredidhënës të këtyre institucioneve për shkak të vështirësimit të kushteve të financimit nga tregjet e jashtme. Në anën tjetër, ishin sektorët e kompanive të sigurimit dhe fondet pensionale

Figura 18. Struktura e kategorive kryesore të shpenzimeve buxhetore, në milionë euro



Burimi: Ministria e Financave (2013)

<sup>5</sup> Pagat dhe mëditjet në vitin 2011 kanë shënuar rritje më të konsiderueshme, si rrjedhojë e vendimit për rritjen e pagave në sektorin publik.

që rikuperuan ritmin e rritjes së tyre në vitin 2012 krahasuar me vitin paraprak, duke rritur kështu kontributin e tyre në rritjen e gjithsej asetëve të sektorit financiar.

Vlera e asetëve të kompanive të sigurimit arriti në 130.8 milion euro në vitin 2012, një rritje vjetore prej 16.3 përqind (15.6 përqind në vitin 2011). Gjithashtu, asetet e fondeve pensionale arritën vlerën prej 745 milion euro në vitin 2012, një rritje vjetore prej 25.6 përqind (20.2 përqind në vitin 2011).


Sektori financiar në vend ofron kryesisht shërbime tradicionale financiare. Bankat komerciale vazhdojnë të kenë si aktivitet kryesor kreditimin e ekonomisë vendore të financuar kryesisht nga depozitat e mbledhura brenda vendit, industria e sigurimeve gjeneron primet e pranuar kryesisht përmes veprimtarisë së sigurimit të përgjegjës ndaj palës së tretë (angl. Third Party Liability: TPL) dhe institucionet mikrofinanciare me kredidhënien si aktivitet kryesor të financuar prej fondeve të huazuara nga institucione financiare që operojnë jashtë Kosovës.

Sa i përket strukturës së asetëve të sektorit financiar në Kosovë, bankat komerciale vazhduan të jenë pjesëmarrës kryesor, duke menaxhuar 74.0 përqind të gjithsej asetëve të sektorit. Gjatë kësaj periudhe, është vënë re një rritje e pjesëmarrjes së fondeve pensionale dhe kompanive të sigurimit në 19.5 përqind përkatësisht 3.4 përqind (17.0 përqind përkatësisht 3.2 përqind në vitin 2011). Sikurse në vitin paraprak, institucionet mikrofinanciare dhe ndihmësit financiar janë karakterizuar me zvogëlim të pjesëmarrjes (Figura 19).

Në vitin 2012, numri i bankave komerciale që operojnë në Kosovë është rritur në nëntë (9), ndërkaq numri i kompanive në industrisë e sigurimeve ka mbetur i pandryshuar nga viti i kaluar në trembëdhjetë (13). Duke përfshirë edhe 18 institucionet mikrofinanciare, 38 ndihmësit financiar dhe 2 fondet pensionale, sektori financiar në vend numëroi gjithsej 80 institucione financiare.


Një pjesë e konsiderueshme e asetëve të sektorit financiar të Kosovës vazhdon të investohet në tregjet e jashtme. Vlera e Asetëve të Jashtme Neto (AJN)<sup>6</sup> në vitin 2012 arriti në 2.34 miliardë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 13.0 përqind (5.6 përqind në vitin 2011). Në vitin 2012, AJN të BQK-së, që kanë një pjesëmarrje prej 53 përqind të gjithsej AJN-ve, arritën vlerën 1.2 miliard euro. Ndërkaq, AJN-të e bankave komerciale dhe institucioneve tjera financiare, që kanë një pjesëmarrje prej 21 përkatësisht 26.0 përqind në gjithsej AJN-të, arritën vlerën prej 490.8 përkatësisht 607.6 milionë euro (Figura 20).

Figura 19. Struktura e asetëve të sistemit financiar sipas sektorëve



Burimi: BQK (2013)

Figura 20. Asetet e jashtme neto sipas institucioneve, në milionë euro




Burimi: BQK (2013)

<sup>6</sup> Në këtë kontekst, sektori financiar përfshinë Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës dhe të gjitha institucionet financiare që operojnë në Kosovë.

Përshpejtimi i ritmit të rritjes së AJN-ve gjatë vitit 2012 ishte kryesisht rezultat i normës më të lartë të rritjes së kërkesave që kanë institucionet financiare që operojnë në Kosovë ndaj sektorit të jashtëm. Duke arritur në 2.77 miliard euro në vitin 2012, kërkesat ndaj sektorit të jashtëm shënuan rritje vjetore prej 13.4 përqind, krahasuar me rritjen vjetore prej vetëm 2.4 përqind në vitin 2011. Pjesa më e madhe e kërkesave ndaj sektorit të jashtëm mbeten të investuara në depozita (45.5 përqind), aksione dhe ekuitete tjera (24.0 përqind) dhe letra me vlerë (17.5 përqind). Gjatë vitit 2012, është vënë re një rritje e pjesëmarrjes së investimeve në letra me vlerë dhe rritje e investimeve në aksione dhe ekuitete tjera, kundrejt investimeve në depozita që zvogëluan pjesëmarrjen e tyre (Figura 21).


Figura 21. Struktura e kërkesave ndaj sektorit të jashtëm, në përqindje



Burimi: BQK (2013)

Në vitin 2012, kërkesat e sektorit financiar ndaj sektorit të jashtëm u zhvendosën nga investimet në depozita (45.5 përqind në vitin 2012 dhe 55.6 përqind në vitin 2011) në investime në letra me vlerë (17.5 përqind në vitin 2012 dhe 9.4 përqind në vitin 2011). Gjithashtu, edhe bankat komerciale zhvendosën një pjesë të vogël të mjeteve nga investimet në depozita në investime në letra me vlerë. Investimet në letra me vlerë përbënë 20.8 përqind të gjithë mjeteve të investuara jashtë vendit nga bankat komerciale që operojnë Kosovë (11.1 përqind në vitin 2011), përderisa investimet në depozita vazhdojnë të përfaqësojnë pjesën më të madhe me një pjesëmarrje prej 53.9 përqind (65.7 përqind në vitin 2011).

Figura 22. Struktura e detyrimeve ndaj sektorit të jashtëm, në përqindje



Burimi: BQK (2013)

Në vitin 2012, detyrimet e sektorit financiar ndaj sektorit të jashtëm arritën vlerën prej 436.3 milion euro, një rritje vjetore prej 15.4 përqind krahasuar me vitin paraprak. Depozitat e jorezidentëve në bankat që operojnë në Kosovë shënuan rritje vjetore prej 34.1 përqind në vitin 2012, duke kontribuar në rritjen e gjithë detyrimeve të sektorit financiar ndaj sektorit të jashtëm me 5.9pp. Sidoqoftë, kreditë që institucionet financiare që operojnë në Kosovë kanë pranuar nga institucionet financiare që operojnë jashtë vendit shënuan rënie vjetore prej 34.1 përqind dhe kontribuan negativisht në gjithë detyrimet ndaj sektorit të jashtëm me 15.5pp. Në vitin 2012, kuota e FMN-së arriti në 165.3 milion euro (73.7 milion euro në vitin 2011), duke kontribuar pozitivisht në rritjen e detyrimeve të sektorit financiar ndaj sektorit të jashtëm me 24.2pp dhe rritur pjesëmarrjen në gjithë detyrimet në 37.9 përqind (19.5 përqind në vitin 2011) (Figura 22).

Në vitin 2012, kërkesat neto ndaj sektorit të brendshëm arritën vlerën prej 1.1 miliard euro, që paraqet një rritje prej 9.6 përqind krahasuar me periudhën e njëjtë në vitin paraprak (28.8 përqind në vitin 2011). Rritja më e ngadalshme e kërkesave neto ndaj sektorit të brendshëm kryesisht rezultoi nga rritja e depozitave të qeverise prej 5 përqind në këtë periudhë, si dhe

ngadalësimi i rritjes së kërkesave ndaj sektorit privat për rreth në 3.4 përqind (12.2 përqind në vitin 2011).

### 3.3.2 Sistemi bankar


Në vitin 2012, tregut bankar në Kosovë iu shtua një bankë e re, duke ngritur kështu numrin e bankave komerciale në nëntë (9). Struktura e bankave sipas pronësisë mbeti e pandryshuar: 7 banka me pronësi të huaj dhe 2 banka me pronësi vendore. Bankat e huaja kanë pjesëmarrje prej 89.5 përqind në gjithsej asetet e sistemit bankar të vendit.

Tregu bankar vazhdon të karakterizohet me shkallë relativisht të lartë të koncentrimit, megjithëse kjo shkallë ka treguar një tendencë rënëse në vitet e fundit.

Rritja e vazhdueshme e aktivitetit të bankave të vogla pjesëmarrëse në tregun bankar në vend ka ndikuar që pjesëmarrja e aseteve të tri bankave më të mëdha të jetë 69.3 përqind në vitin 2012, që paraqet rënie krahasuar me vitin e kaluar kur këto tre banka menaxhuan 73.3 përqind të gjithsej aseteve. Kjo rënie e koncentrimit në tregun bankar vërehet edhe përmes Indeksit Herfindahl-Hirschman (IHH), tregues ky që paraqet shkallën e koncentrimit të tregut. Në katër vitet e fundit, IHH për tregun bankar në vend shënon rënie të koncentrimit bankar për gjithsej asetet, kreditë dhe depozitat (Figura 23). Sipas IHH për asete, tregu bankar u karakterizua me një shkallë koncentrimi prej 1,939 pikë në vitin 2012, një rënie e shkallës së koncentrimit prej 150 pikë të IHH krahasuar me vitin 2011.

Infrastruktura bankare mbeti e pandryshuar nga viti i kaluar sa i përket zgjerimit. Numri i degëve dhe nëndegëve të bankave komerciale në vend arriti në 310 në vitin 2012, që paraqet një nivel të njëjtë me vitin e kaluar. Gjithashtu, në vitin 2012 bankat komerciale kishin gjithsej 3,727 punonjës, krahasuar me vitin e kaluar kur sistemi bankar punësonte 3,728 punëtor.

Figura 23. HHI për asetet, kreditë dhe depozitat



Burimi: BQK (2013)

Table 3. Pagesat elektronike, në miliona euro

Përshkrimi	2009	2010	2011	2012
Numri i degëve dhe nëndegëve	295	311	310	310
Numri i të punësuarëve	3,459	3610	3728	3727
Tërheqjet e klientëve të bankave përmes ATM-ve	582	640	790	873
Pagesat e klientëve të bankave përmes POS-ve	68	94	142	178
Pagesat përmes e-banking	607.3	782.4	1,191.8	1,499.1

Burimi: BQK (2013)

Në anën tjetër, ka vazhduar trendi i zgjerimit të rrjetit të pikave të shitjes (angl. Point of Sales: POS), terminaleve, bankomatëve (angl. Automated Teller Machine: ATM) dhe numrit të shfrytëzuesve të llogarive e-banking (Tabela 1). Shfrytëzimi i POS terminaleve ishte më i lartë gjatë vitit 2012, duke arritur në 178 milion euro krahasuar me gjithsej 142 milion euro në vitin paraprak. Me rritje u karakterizuan edhe tërheqjet e klientëve të bankave përmes ATM-ve, që në vitin 2012 arritën shumën prej 873 milion euro (790 milion euro në vitin 2011). Gjithashtu, edhe vlera e pagesave elektronike e-banking shënoi shumën prej 1.5 miliard euro, një rritje krahasuar

me vitin paraprak kur këto pagesa kishin vlerën prej 1.2 miliard euro. Rritja e pagesave elektronike dëshmon zvogëlimin e vazhdueshëm të pagesave me para të gatshme.

### 3.3.2.1 Bilanci i gjendjes i sistemit bankar


#### i. Asetet

Asetet e sistemit bankar u karakterizuan me ritëm të ngadalësuar të rritjes në dhjetor të 2012. Gjithsej asetet e bankave komerciale arritën vlerën 2.83 miliard euro në vitin 2012, që paraqet një rritje vjetore prej 6.8 përqind (7.9 përqind në vitin 2011). Si pjesëmarrje e PBB-së, asetet e sistemit bankar në vend kishin një pjesëmarrje prej 56.3 përqind të PBB-së në vitin 2012.

Rritja e asetëve gjatë kësaj periudhe u realizua kryesisht përmes kredidhënies dhe investimeve në letra me vlerë, përkundër se kontributi që dhanë kreditë ishte dukshëm më i ulët krahasuar me vitin paraprak. Në vitin 2012, rritja e kredive dhe investimeve në letra me vlerë kontribuan me 2.5 përkatësisht 2.1pp në rritjen e gjithsej asetëve të sistemit bankar (9.8 përkatësisht 1.2pp në vitin 2011). Kontributin më të lartë në rritjen e asetëve në vitin 2012 e kishte paraaja e gatshme dhe bilanci me BQK-n, konkretisht rezervat e bankave komerciale në BQK dhe llogaritë tjera, që kontribuan me rreth 3.1pp në rritjen e gjithsej asetëve të sistemit bankar. Në anën tjetër, rritjen e asetëve në këtë periudhë e frenoi bilanci me bankat tjera, duke kontribuar negativisht me rreth 1.6pp në vitin 2012. Bilanci me bankat komerciale kontribuan negativisht në rritjen e gjithsej asetëve të sistemit bankar në këtë periudhë kryesisht për shkak të orientimit të bankave që operojnë në vend drejt investimeve në letra me vlerë dhe kredidhënies, kundrejt plasmanëve në bankat jashtë Kosovës (Figura 24).


Aktiviteti kryesor bankar vazhdon të konsistojë në kreditimin e ekonomisë, përkundër se ritmi i rritjes së kredisë gjatë vitit 2012 paraqitet të jetë ngadalësuar. Struktura e asetëve të sistemit bankar në vitin 2012 vazhdoi të dominohet nga kreditë, që përfaqësuan 62.3 përqind të gjithsej asetëve të bankave komerciale (Tabela 4). Në vitin 2012, kreditë arritën vlerën prej 1.76 miliard euro (1.69 miliard euro në vitin 2011). Përderisa në vitin 2011, kreditimi i ekonomisë u karakterizua me përshpejtim të trendit të rritjes krahasuar me vitin 2010, të dhënat për vitin 2012 tregojnë për ngadalësim të ndjeshëm të rritjes. Norma vjetore e rritjes së kredive të sistemit bankar në vitin 2012 ishte 3.8 përqind, krahasuar me rritje prej 13.2 përkatësisht 16.4 përqind në vitet 2010 dhe 2011 (Figura 25).

Figura 24. Kontributi në rritjen e asetëve të sistemit bankar sipas kategorive, në përqindje



Burimi: BQK (2013)

Figura 25. Norma e rritjes së kredive sipas sektorëve, në përqindje



Burimi: BQK (2013)

Ngadalësimi i ritmit të rritjes së kreditimit gjatë vitit 2012 ishte pasojë e zvogëlimit të kërkesës për kredi, por edhe të shtrëngimit të kriterëve dhe standardeve të aplikuara në procesin e kreditimit nga ana e bankave në vend si për ndërmarrjet ashtu edhe për ekonomitë familjare. Përderisa zvogëlimi i kërkesës për kredi ishte i pranishëm kryesisht tek ndërmarrjet, shtrëngimi i standardeve dhe kriterëve nga ana e bankave për lëshimin e kredive u aplikua si për ndërmarrjet ashtu edhe për ekonomitë familjare.

Kërkesa për kredi nga ndërmarrjet vlerësohet të ketë rënë si pasojë e shtrëngimit të standardeve dhe kriterëve nga ana e bankave. Sipas rezultateve të anketës së realizuar nga BQK me bankat që operojnë në tregun bankar në vend, bankat deklaruan se përpos problemeve specifike që kanë sektorët ku veprojnë ndërmarrjet dhe ndikimit të këtyre specifikave si pasojë në performancën e pagesës së kredisë, faktor kryesor që ndikoi në shtrëngimin e kriterëve dhe standardeve për kreditim ishte perceptimi negativ për ambientin e përgjithshëm të ekonomisë në vend.

**Table 4. Struktura e aseteve të sistemit bankar**

Përshkrimi	Dhjetor 2009		Dhjetor 2010		Dhjetor 2011		Dhjetor 2012	
	Milionë euro	Pjesëmarrja (%)	Milionë euro	Pjesëmarrja (%)	Milionë euro	Pjesëmarrja (%)	Milionë euro	Pjesëmarrja (%)
Paraja e gatshme dhe bilanci me BQK	322.2	14.6	307.5	12.5	331.5	12.5	425.7	15.0
Bilanci me bankat komerciale	405.6	18.4	439.0	17.9	329.5	12.4	287.9	10.2
Letrat me vlerë	97.0	4.4	173.4	7.1	202.0	7.6	256.6	9.1
Kreditë dhe lizingu	1289.0	58.5	1458.7	59.4	1698.1	64.1	1,763.4	62.3
Asetet fikse	43.1	2.0	44.0	1.8	47.4	1.8	57.7	2.1
Asetet tjera	47.7	2.1	32.3	1.3	41.3	1.6	38.1	1.4
Gjithsej	2,204.6	100.0	2,455.0	100.0	2,649.7	100.0	2,829.3	100.0

Burimi: BQK (2013)


Sikurse në vitin paraprak, ritme më të ngadalshme të investimeve të bankave komerciale në tregjet jashtë vendit u evidentuan edhe gjatë vitit 2012. Bilanci i bankave komerciale në Kosovë me bankat jashtë vendit u zvogëlua për 12.6 përqind në vitin 2012, duke arritur vlerën prej 287.9 milion euro. Në anën tjetër, bankat komerciale kanë rritur investimet në letra me vlerë në tregjet e jashtme gjatë vitit 2012. Duke arritur vlerën prej 256.6 milion euro, investimet në letra me vlerë shënuan rritje vjetore prej 27 përqind në vitin 2012 (16.4 përqind në vitin 2011). Bankat komerciale në vend orientuan një pjesë më të madhe të aseteve të tyre drejtë investimeve në letra me vlerë gjatë vitit 2012 (9.1 përqind të gjithsej aseteve në vitin 2012 krahasuar me 7.6 përqind të aseteve në vitin 2011), kryesisht për shkak të ngadalësimit të kreditimit të ekonomisë në të njëjtën periudhë.

## ii. Struktura e kredive

Ngadalësimi i kreditimit të ekonomisë nga bankat komerciale gjatë vitit 2012 u reflektua si tek kreditë për ekonomitë familjare, ashtu edhe te kreditë për ndërmarrjet. Kreditë për ekonomitë familjare shënuan një rritje vjetore prej 6.2 përqind në vitin 2012, krahasuar me rritjen vjetore prej 17.7 përqind në vitin paraprak. Ngjashëm, kreditë për ndërmarrjet u karakterizuan me ngadalësim të rritjes nga 12.3 përqind në vitin 2011 në 3.9 përqind në vitin 2012.

Ngadalësimi i kreditimit nga sistemi bankar peshoi më shumë mbi ndërmarrjet jofinanciare, që treguan për një zvogëlim të kontributit të tyre në rritjen e gjithsej kredive në 2.0pp në vitin 2012 nga 8.8pp sa kontribuan në vitin paraprak. Edhe kontributi i kredive për ekonominë familjare në rritjen e gjithsej kredive të sistemit bankar u zvogëlua në 1.9pp në të njëjtën periudhë, krahasuar me kontributin prej 5.3pp në vitin 2011. Këto zhvillime nuk u reflektuan edhe në strukturën e gjithsej kredive, ku vërehet një rritje e lehtë e pjesëmarrjes së kredive për ekonominë familjare, përderisa pjesëmarrja e kredive për ndërmarrjet mbeti në nivel të ngjashëm me vitin e kaluar (Figura 26). Pjesëmarrja e kredive për ekonominë familjare në gjithsej kreditë e lëshuara nga bankat komerciale në vend arriti në 30.8 përqind në vitin 2012, krahasuar me pjesëmarrjen prej 30.1 përqind në vitin paraprak.


Figura 26. Struktura e kredive, në përqindje



Burimi: BQK (2013)


Sa i përket kredive të sistemit bankar për ndërmarrjet, struktura sipas aktivitetit të tyre ekonomik mbeti e pandryshuar nga vitet paraprake. Sektori i shërbimeve vazhdon të dominojë strukturën e kredive për ndërmarrjet, me 72.0 përqind në vitin 2012 (71.7 përqind në vitin 2011). Në sektorin e shërbimeve, kreditë për ndërmarrjet tregtare vazhdojnë të kenë pjesëmarrjen më të lartë në gjithsej kreditë e sistemit bankar. Në vitin 2012, kreditë për tregtinë përfaqësuan 53.2 përqind të gjithsej kredive të sistemit bankar (52.7 përqind në vitin 2011). Kreditë për minierat, prodhimtarinë dhe ndërtimtarinë, që kategorizohen si kredi për sektorin e industrisë, përfaqësuan 24.3 përqind të gjithsej kredive në vitin 2012 (Figura 27). Kreditë për bujqësinë vijojnë të kenë një pjesëmarrje më të ulët prej 3.7 përqind në vitin 2012 (3.5 përqind në vitin 2011). Duke e vlerësuar si sektor me pasiguri më të lartë, përpos të tjerave, bankat ofrojnë norma më të larta të interesit për kreditë bujqësore duke dekurajuar kështu edhe kërkesën e huamarrësve, pasi që kjo rritë edhe më tej koston e financimit të tyre nga bankat.

Figura 27. Struktura e kredive sipas veprimtarisë ekonomike, në përqindje



Burimi: BQK (2013)

Figura 28. Trendi i rritjes së kredive sipas sektorëve ekonomik, në përqindje




Burimi: BQK (2013)

Trendi i rritjes së kredive sipas sektorëve ekonomik reflekton ngadalësimin e kreditimit për të gjithë sektorët, me përjashtim të kredive për bujqësinë që u karakterizuan me përshpejtim të ritmit të rritjes. Në vitin 2012, kreditë për sektorin e bujqësisë shënuan rritje

vjetore prej 7.7 përqind, krahasuar me rritjen vjetore prej 6.1 përqind në vitin paraprak (Figura 28). Anasjelltas, kreditë që përkonin në sektorin e industrisë, energjetikës dhe ndërtimtarisë pësuan ngadalësim të rritjes në 2.0 përqind në vitin 2012, krahasuar me rritjen vjetore prej 5.7 përqind në vitin paraprak. Gjithashtu, kreditë për sektorin e tregtisë shënuan rritje prej 4.8 përqind në vitin 2012, një ngadalësim krahasuar me rritjen vjetore prej 16.3 përqind në vitin paraprak. Edhe kreditë e klasifikuara për shërbime tjera treguan për ngadalësim të rritjes në periudhën në raportim në 3.1 përqind (12.4 përqind në vitin 2011).


Struktura e kredive sipas afatit të maturimit vazhdon të dominohet nga kreditë me afat më të gjatë maturimi (mbi dy vite), që në vitin 2012 përbënin 71.4 përqind të gjithsej kredive. Edhe kreditë me maturitet deri në një vit kishin një pjesëmarrje të konsiderueshme prej 21.1 përqind në vitin 2012. Megjithatë, sa i përket pjesëmarrjes në gjithsej kreditë e sistemit bankar, të dy këto kategori të kredive shënuan ngadalësim të rritjes në vitin 2012 krahasuar me vitin paraprak, kur kreditë me maturitet mbi dy vite dhe kreditë deri në një vit kishin një pjesëmarrje prej 71.6 përkatësisht 21.2 përqind. Anasjelltas, kreditë me maturitet mbi një vit deri në dy vite rritën pjesëmarrjen e tyre në gjithsej kreditë në 7.4 përqind në vitin 2012, nga 7.2 përqind në vitin 2011 (Figura 29).

Figura 29. Struktura e kredive sipas afatit të maturimit, në përqindje



Burimi: BQK (2013)

Figura 30. Trendi i rritjes së kredive sipas maturitetit, në përqindje



Burimi: BQK (2013)

Sa i përket rritjes vjetore të kredive sipas afatit të maturimit, hezitimi i bankave për zgjerimin e kreditimit gjatë vitit 2012 u reflektua në tërë strukturën e ndarjes së kredive sipas maturimit. Krahasuar me vitin paraprak, në vitin 2012 u evidentua një ngadalësim i rritjes së kredive me maturitet deri në një vit në 3.7 përqind (21.5 përqind në vitin 2011) dhe kredive me maturitet mbi një vit deri në dy vite në 6.9 përqind (28.4 përqind në vitin 2011). Në anën tjetër, kreditë e klasifikuara si kredi me afat më të gjatë maturimi u karakterizuan me ngadalësim të rritjes që nga viti 2010. Në vitin 2012, kreditë me maturitet mbi dy vite ngadalësuan rritjen e tyre vjetore në 3.6 përqind (13.6 përqind në vitin 2011) (Figura 30).

### iii. Detyrimet

Struktura e detyrimeve në sistemin bankar në vend vijoi të dominohet nga depozitat, që njëherit paraqesin edhe burimin kryesor të financimit për bankat komerciale në Kosovë. Në vitin 2012, depozitat e sistemit bankar kishin një pjesëmarrje prej 80.6 përqind, një rritje krahasuar me pjesëmarrjen prej 79.4 përqind në vitin 2011 (Tabela 5).

Vlera e gjithsej depozitave në sistemin bankar në vend, në vitin 2012, arriti në 2.3 miliard euro, që tregon për një rritje vjetore 8.3 përqind krahasuar me rritjen vjetore prej 8.6 përqind në vitin

paraprak (Figura 31). Ngadalësimi i rritjes së depozitave ishte kryesisht pasojë e zvogëlimit të depozitave të korporatave publike jofinanciare në këtë periudhë.

**Table 5. Struktura e detyrimeve të sistemit bankar**

Përshkrimi	Dhjetor 2009		Dhjetor 2010		Dhjetor 2011		Dhjetor 2012	
	Milionë euro	Pjesëmarrja (%)	Milionë euro	Pjesëmarrja (%)	Milionë euro	Pjesëmarrja (%)	Milionë euro	Pjesëmarrja (%)
Bilanci nga bankat tjera	58.5	2.7	94.0	3.8	40.0	1.5	6.0	0.2
Depozitat	1,744.8	79.2	1,936.9	78.9	2,104.0	79.4	2,279.1	80.6
Huatë tjera	0.0	0.0	0.1	0.0	30.4	1.1	18.9	0.7
Detyrimet tjera	171.3	7.8	160.0	6.5	190.1	7.2	223.6	7.8
Borxhi i ndërvarur	24.4	1.1	33.5	1.4	31.0	1.2	31.0	1.1
Mjetet vetanake	205.6	9.3	230.5	9.4	254.3	9.6	270.7	9.6
Gjithsej detyrimet	2,204.6	100.0	2,455.0	100.0	2,649.7	100.0	2,829.3	100.0


Burimi: BQK (2013)

Gjithashtu, pjesëmarrje të konsiderueshme në strukturën e detyrimeve të bankave komerciale në vend vazhdojnë të kenë edhe mjetet vetanake, që në vitin 2012 qëndroi e pandryshuar nga viti paraprak në 9.6 përqind të gjithsej detyrimeve. Mjetet vetanake arritën vlerën prej 270.7 milionë euro në vitin 2012, dhe shënuan rritje vjetore prej 6.5 përqind. Si burim i jashtëm i financimit për bankat komerciale në Kosovë, bilanci nga bankat tjera tregon për rënie në vitin 2012. Bilanci nga bankat tjera jashtë vendit shënoi vlerën prej 6 milion euro, një zvogëlim i theksuar i këtij zëri krahasuar me vlerën prej 40 milionë euro në vitin 2011. Ndërsa, borxhi i ndërvarur (angl. subordinated debt) shënoi vlerën prej 31 milionë euro, një vlerë e ngjashme me vitin paraprak. Krahasuar me vitin paraprak, bankat komerciale në vend zvogëluan shfrytëzimin e huave tjera, që kryesisht janë linja kreditore nga institucione ndërkombëtare. Këto huazime nga bankat kishin vlerën prej 18.9 milion euro në vitin 2012, një zvogëlim krahasuar me vlerën prej 30.4 milion në vitin 2011. Siq po shifet, bankat komerciale në vend në vitin 2012 u përballën me rënie përkatësisht ngadalësim të të gjitha burimeve tradicionale të financimit, gjë që u reflektua në ngadalësimin e rritjes së gjithsej detyrimeve të sistemit bankar në 6.8 përqind (7.9 përqind në vitin 2011).

#### iv. Struktura e depozitave

Sikurse në vitet paraprake, struktura e depozitave në sistemin bankar të Kosovës vazhdon të gjenerohet kryesisht nga ekonomitë familjare, depozitat e të cilave përbëjnë 72 përqind të gjithsej depozitave në vitin 2012. Krahasuar me vitin 2011, depozitat e ekonomive familjare kanë rritur pjesëmarrjen në gjithsej depozitat për 1.1pp, përkundër rritjes me normë më të ulët që kishin në vitin 2012. Depozitat e ekonomive familjare arritën vlerën prej 1.6 miliardë euro dhe shënuan një normë vjetore të rritjes prej 10 përqind në vitin 2012, krahasuar me rritjen prej 14.7 përqind në vitin 2011.

**Figura 31. Trendi i rritjes së depozitave, në përqindje**




Burimi: BQK (2013)

Sa i përket ndarjes sipas sektorëve, depozitat e ndërmarrjeve arritën vlerën prej 528 milion euro, një rritje vjetore prej 0.8 përqind. Në vitin 2012, struktura e depozitave të ndërmarrjeve vazhdoi të dominohet nga depozitat e ndërmarrjeve private me 85.7 përqind të gjithsej depozitave të ndërmarrjeve. Krahasuar me vitin e kaluar kur depozitat e ndërmarrjeve private shënuan rënie vjetore prej 1.1 përqind, në vitin 2012 këto depozita shënuan rritje vjetore prej 14.4 përqind. Depozitat e ndërmarrjeve publike arritën vlerën prej 75.6 milionë euro, një zvogëlim prej 41.2 përqind krahasuar me vitin 2011. Edhe si pjesëmarrje, depozitat e ndërmarrjeve publike u zvogëluan në krahasim me vitin e kaluar nga 24.5 përqind të gjithsej depozitave për ndërmarrjet në vitin 2011 në 14.3 përqind në vitin 2012 (Figura 32). Depozitat e qeverisë u zvogëluan edhe më tej në vitin 2012 në 0.7 milion, nga 2.7 milion në vitin 2011 duke zvogëluar edhe pjesëmarrjen në gjithsej depozitat për 0.1pp gjatë kësaj periudhe. Anasjelltas, depozitat e jorezidentëve rritën pjesëmarrjen e tyre në gjithsej depozitat e sistemit bankar në 3.8 përqind në vitin 2012, nga 3.1 përqind në vitin 2011. Në vitin 2012, vlera e gjithsej depozitave të jorezidentëve arriti në 86.9 milionë euro krahasuar me 64.2 milionë euro në vitin 2011.

Depozitat e sistemit bankar të Kosovës sipas afatit të maturimit ruajtën strukturën e ngjashme me vitet paraprake. Me pjesëmarrje prej 51.4 përqind në gjithsej depozitat e sistemit bankar, depozitat e afatizuara vazhdojnë të dominojnë strukturën e depozitave. Pjesa e mbetur e depozitave përbëhet nga depozitat e transferueshme dhe depozitat e kursimeve, të cilat në fund të vitit 2011 kishin pjesëmarrje prej 33.0 përqind, përkatësisht 15.6 përqind të gjithsej depozitave.


Sipas maturitetit, struktura e depozitave të afatizuara mbeti e dominuar nga depozitat me afat më të shkurtër maturimi. Me një pjesëmarrje prej 56.5 përqind në gjithsej depozitat e sistemit bankar në vitin 2012, depozitat me afat maturimi deri në një vit rritën pjesëmarrjen e tyre për 2.1pp (Figura 33). Depozitat me afat maturimi mbi një vit deri në dy vite përfaqësuan 25.1 përqind të gjithsej depozitave, një zvogëlim i pjesëmarrjes së tyre krahasuar me vitin paraprak kur këto

Figura 32. Struktura e depozitave sipas sektorëve, në përqindje




Burimi: BQK (2013)

Figura 33. Struktura e depozitave sipas afatit të maturimit, në përqindje



Burimi: BQK (2013)

Figura 34. Mesatarja vjetore e normave të interesit, në përqindje



Burimi: BQK (2013)


depozita përfaqësonin 28.5 përqind. Zvogëlimi i pjesëmarrjes së depozitave me afat maturimi mbi një vit deri në dy vite ishte kryesisht ekonomive familjare me këtë afat maturimi në depozita me afat maturimi mbi gjashtë muaj deri në një vit. Pjesa e mbetur e depozitave të sistemit bankar përbëhet nga depozitat me afat maturimi mbi dy vite, të cilat në vitin 2012 kishin pjesëmarrje prej 18.3 përqind (17.1 përqind në vitin 2011). Në vitin 2012, depozitat me afat maturimi deri në një vit u karakterizuan me rritje vjetore prej 14.5 përqind, ndërkaq depozitat me afat maturimi mbi dy vite u karakterizuan me rritje vjetore prej 18 përqind. Përgjithësi, vërehet rritje e depozitave me afat më të gjatë maturimi e cila, mes tjerash, reflekton edhe rritjen e vazhdueshme të besimit të publikut në sistemin bankar të Kosovës. Në një masë kësaj mund ti ketë kontribuar edhe miratimi i ligjit dhe funksionalizimi i skemës për sigurimin e depozitave.

**3.3.2.2 Normat e interesit**

Në vitin 2012, normat e interesit për kredi u karakterizuan me rënie, ndërkaq normat e interesit për depozita me rritje. Norma mesatare e interesit në kredi në vitin 2012 u zvogëluua në 13.4 përqind, krahasuar me 14.1 përqind sa ishte në vitin 2011. Ndërsa, në të njëjtën periudhë, norma mesatare e interesit në depozita u rrit në 3.6 përqind krahasuar me 3.5 përqind sa ishte në vitin 2011. Rrjedhimisht, dallimi në mes të normave të interesit në kredi dhe depozita u zvogëluua në 9.8pp në vitin 2012, nga 10.6pp në vitin 2011 (Figura 36).


Sa i përket depozitave, norma mesatare e interesit për depozitat e ekonomive familjare ishte më e lartë krahasuar me normën mesatare të interesit për ndërmarrjet në vitin 2012. Norma mesatare më e lartë në depozitat e ekonomive familjare në vitin 2012 ishte 5.23 përqind për depozitat me afat maturimi mbi dy vite. Ndërkaq, norma mesatare më e lartë për depozitat e ndërmarrjeve në vitin 2012 ishte 5.09 përqind për depozitat me vlerë nën 250 mijë euro dhe me afat maturimi mbi dy vite.

Figura 35. Bilanci i të hyrave dhe shpenzimeve, në milionë euro




Burimi: BQK (2013)

Figura 36. Normat vjetore të rritjes së të hyrave dhe shpenzimeve



Burimi: BQK (2013)

Figura 37. Struktura e të hyrave, në përqindje



Burimi: BQK (2013)


Normat mesatare të interesit për kredi për ndërmarrjet treguan për një rënie në vitin 2012 krahasuar me vitin 2011 për të gjithë sektorët. Kreditë investive kishin një normë mesatare të interesit prej 12.9 përqind në vitin 2012, krahasuar me mesataren prej 14.2 përqind në vitin 2011. Edhe kreditë tjera biznesore treguan për një zvogëlim të normës mesatare të interesit në 14.6 përqind në vitin 2012, krahasuar me normën mesatare të interesit prej 15.6 përqind në vitin 2011. Gjithashtu, edhe normat mesatare të interesit në mbitërheqje dhe linja kreditore u karakterizuan me rënie të lehtë në 11.0 përkatësisht 12.1 përqind në vitin 2012, krahasuar me 12.1, përkatësisht 13.2 përqind në vitin paraprak. Sa i përket normave mesatare të interesit për kreditë e ekonomive familjare, në vitin 2012 është vënë re një zvogëlim i lehtë prej 0.2 përqind si tek kreditë konsumuese, ashtu edhe tek kreditë hipotekare.

### 3.3.2.3 Performanca e sistemit bankar

Fitimi i sistemit bankar të Kosovës në vitin 2012 zbriti në 18.5<sup>7</sup> milionë euro, duke shënuar rënie vjetore prej 48.7 përqind (Figura 38). Tri nga gjithsej tetë bankat dhe degët bankare, të cilat operuan në Kosovë gjatë tërë vitit 2012, shënuan performancë negative. Rënia e fitimit të sistemit bankar erdhi si rrjedhojë e ngadalësimit të rritjes vjetore të të hyrave të përgjithshme, të cilat u rritën për vetëm 2.9 përqind (10.5 përqind në vitin 2011). Në anën tjetër, shpenzimet shënuan rritje më të theksuar prej 13.0 përqind (10.9 përqind në vitin 2011), duke kontribuar kështu në pothuajse përgjysmimin e profitit neto (Figura 39).


Faktorët kryesorë të cilët ndikuan në zvogëlimin e shkallës së rritjes së të hyrave janë norma më e ulët e rritjes së aktivitetit kreditor dhe rënia e lehtë e normës së interesit në kredi. Kjo për faktin se të hyrat nga interesi (më saktësisht të hyrat nga interesi në kredi), dominojnë strukturën e të hyrave të sistemit bankar (Figura 39). Në fund të vitit 2012, vlera e të hyrave nga interesi arriti në 200.5 milionë euro, duke shënuar rritje vjetore prej vetëm 2.7 përqind (11% në vitin 2011). Në anën tjetër, të hyrat nga jointerеси, të cilat arritën vlerën prej 46.6 milionë euro, treguan volatilitet më të ulët. Rritja vjetore e të hyrave nga jointerеси ishte 3.5 përqind (8.6% në vitin 2011), duke ndikuar që pjesëmarrja e këtyre të fundit në strukturën e gjithsej të hyrave të shënojë rritje të lehtë në nivelin 18.8 përqind (Figura 37). Megjithatë, janë të hyrat nga interesi ato të cilat vazhdojnë të dominojnë dukshëm strukturën e të hyrave të sistemit bankar në Kosovë, që njëherit i bënë të hyrat e sistemit shumë të ekspozuara ndaj ndryshimeve në volumin, strukturën dhe cilësinë e aseteve që gjenerojnë interes, si dhe ndryshimeve në norma të interesit.

Figura 38. Struktura e të hyrave sipas kategorive, në përqindje



Burimi: BQK (2013)

Figura 39. Normat vjetore të rritjes së të hyrave sipas kategorive



Burimi: BQK (2013)

<sup>7</sup> Përfshirë performancën e degës së bankës turke Ish Bankasi, e cila filloi punën në dhjetor të vitit 2012 duke shtuar në nëntë numrin e bankave dhe degëve bankare që operojnë në Kosovë.

Të hyrat nga plasmanet e bankave që operojnë në Kosovë në bankat jashtë vendit, si dhe të hyrat nga investimet në letrat me vlerë shënuan rritje negative krahasuar me vitin 2011, duke zvogëluar kështu pjesëmarrjen e tyre në strukturën e të hyrave (Figura 38), dhe rrjedhimisht duke kontribuar në ngadalësimin e rritjes së gjithsej të hyrave (Figura 39). Të hyrat nga interesi në plasmane jashtë vendit u përgjysmuan si pasojë e zvogëlimit të volumit të plasmanëve me bankat jashtë vendit (rënie për 13% krahasuar me vitin paraprak), si dhe si pasojë e rënies së normave të interesit në këto plasmane, gjë që korrespondon me uljen e normës bazë të interesit nga Banka Qendrore Evropiane në dhjetor të vitit 2011 dhe në korrik të vitit 2012. Të hyrat nga letrat me vlerë u zvogëluan për 29 përqind përkundër rritjes prej 27 përqind të volumit të investimeve në këtë kategori. Kjo performancë e përkeqësuar nga investimet në letra me vlerë reflekton kryesisht uljen e premieeve në tregjet financiare evropiane gjatë gjysmës së dytë të vitit 2012, si dhe mundësinë e një politike investive më konservative nga bankat. Të hyrat nga jo-interesi kryesisht përfshijnë të hyrat nga tarifat dhe komisionet, të cilat në vitin 2012 shënuan rritje prej 5.9 përqind (11.1% në vitin 2011).


Të hyrat nga letrat me vlerë u zvogëluan për 29 përqind përkundër rritjes prej 27 përqind të volumit të investimeve në këtë kategori. Kjo performancë e përkeqësuar nga investimet në letra me vlerë reflekton kryesisht uljen e premieeve në tregjet financiare evropiane gjatë gjysmës së dytë të vitit 2012, si dhe mundësinë e një politike investive më konservative nga bankat. Të hyrat nga jo-interesi kryesisht përfshijnë të hyrat nga tarifat dhe komisionet, të cilat në vitin 2012 shënuan rritje prej 5.9 përqind (11.1% në vitin 2011).

Megjithë ngadalësimin e rritjes, të hyrat nga tarifat dhe komisionet vazhduan trendin mjaft të lehtë rritës të pjesëmarrjes së tyre në strukturën e gjithsej të hyrave, gjë që sugjeron zgjerim të vazhdueshëm të gamës së shërbimeve të ofruara nga bankat dhe rritje të shkallës së përdorimit të këtyre shërbimeve.

Shpenzimet e sistemit bankar gjatë vitit 2012 arritën vlerën prej 224.6 milionë euro krahasuar me 198.8 milionë euro në vitin 2011. Struktura e shpenzimeve


vazhdon të dominohet nga shpenzimet e përgjithshme dhe administrative, të pasuar nga shpenzimet e interesit dhe ato të jo-interesit (Figura 40). Kategoria dominuese e shpenzimeve, shpenzimet e përgjithshme dhe administrative, shënuan ngadalësim të rritjes nga 10.3 përqind në vitin 2011 në 5.4 përqind në vitin 2012. Ngadalësimi i rritjes së shpenzimeve të kësaj kategorie u ndikua dukshëm nga ngadalësimi i rritjes së shpenzimeve të personelit, të cilat dominojnë strukturën e këtyre shpenzimeve, dhe të cilat u rritën për 3.9 përqind krahasuar me 7.7 përqind në vitin 2011. Megjithatë, dy kategoritë tjera të shpenzimeve, shpenzimet e interesit

Figura 40. Struktura e shpenzimeve, në përqindje



Burimi: BQK (2013)

Figura 41. Normat vjetore të rritjes së shpenzimeve sipas kategorive, në përqindje



Burimi: BQK (2013)

dhe ato të jointeresit, pësuan përshejtim të rritjes duke ndikuar kështu në përshejtimin e lehtë të rritjes së gjithsej shpenzimeve krahasuar me vitin 2011 (Figura 41). Rritjen më të theksuar e pësuan shpenzimet e provizioneve, të cilat përbëjnë pjesën dominuese të shpenzimeve të jointeresit.


Në fund të vitit 2012 vlera e tyre arriti në 50.3 milionë euro, që paraqet rritje vjetore prej 44.8 përqind (22.9% në vitin 2011). Këto shpenzime kryesisht përfshijnë provizionet e ndara për mbulimin e humbjeve të mundshme nga kreditë, të cilat u ndanë si rezultat i përkeqësimit të portofolit kreditor dhe rritjes së kredive joperformuese në sektorin bankar. Shpenzimet e interesit gjithashtu përshejtuan rritjen në 8 përqind nga 5.9 përqind në vitin paraprak. Shpenzimet e interesit në depozita, si komponenti kryesorë i shpenzimeve të kësaj kategorie me pjesëmarrje 91 përqind, shënoi rritje prej 12.3 përqind për dallim nga 3.9 përqind në vitin 2011. Kjo rritje i atribuohet kryesisht rritjes së normës së interesit në depozita, meqenëse norma e rritjes së volumit të depozitave mbetet e përafërt me vitin paraprak.

### 3.3.2.3.1 Profitabiliteti dhe efikasiteti i sistemit bankar

Treguesit kryesorë të profitabilitetit shënuan rënie si pasojë e rënies së profitit. Kthimi në mesataren e kapitalit (*angl. Return on Average Equity*) zbriti në 7.1 përqind krahasuar me 14.9 përqind në vitin 2011 (Figura 42). Kthimi në mesataren e aseteve gjatë vitit 2012 (*angl. Return on Average Assets*) gjithashtu shënoi rënie në 0.7 përqind nga 1.4 përqind në vitin paraprak. Rënia e këtyre treguesve të profitabilitetit, megjithatë, nuk paraqet ndonjë rrezik për kapitalizimin e sistemit bankar i cili mbetet në nivel të kënaqshëm.


Treguesit e efikasitetit gjithashtu kanë shënuar rënie. Treguesi i përgjithshëm i efikasitetit, i cili tregon aftësinë e sistemit për të mbuluar shpenzimet e përgjithshme gjatë një periudhe me të hyrat totale të gjeneruara në po të njejtën periudhë, është përkeqësuar. Rritja më e shpejtë e shpenzimeve krahasuar me të hyrat ndikoi që raporti i shpenzimeve ndaj të hyrave të rritet në 90.9 përqind në vitin 2012, rritje kjo prej 8.1pp krahasuar me vitin paraprak

Figura 42. Treguesit e profitabilitetit




Burimi: BQK (2013)

Figura 43. Raporti shpenzime/të hyra, në përqindje



Burimi: BQK (2013)

Figura 44. Treguesit e efikasitetit




Burimi: BQK (2013)

(Figura 43). Një tregues tjetër i efikasitetit, shpenzimet operacionale ndaj të hyrave totale, gjithashtu ka shënuar përkeqësim, mirëpo në shkallë më të ulët prej 1.0pp (Figura 44). Kjo sugjeron se përkeqësimi i treguesit të përgjithshëm të efikasitetit nuk është pasojë e rënies së efikasitetit në menaxhimin e shpenzimeve operuese, mirëpo është ndikuar kryesisht nga përkeqësimi i efikasitetit në menaxhimin e aktiviteteve të lidhura me shpenzimet tjera, siç është menaxhimi i riskut kreditor që shkaktoi rritjen e shpenzimeve për provizione.

Margjina neto e interesit, që është një indikator tjetër i rëndësishëm i performancës dhe efikasitetit të investimeve të bankës, ka shënuar rënie (Figura 45). Të hyrat neto nga interesi kanë shënuar rritje të lehtë, mirëpo volumi i mesatares së aseteve që gjenerojnë interes ka shënuar rritje më të theksuar, duke ndikuar kështu në zvogëlimin e margjinës neto të interesit, apo kthimit nga investimet në këto asete, për 0.25pp.

Figure 45. Margjina neto e interesit



Burimi: BQK (2013)

### 3.3.2.4 Rreziqet e sistemit bankar


#### i. Rreziku i likuiditetit

Të gjithë indikatorët mbi likuiditetin e sistemit u mirëmbajtën në nivele të kënaqshme dhe në pajtueshmëri me rekomandimet e BQK-së. Gjendja e kënaqshme e likuiditetit konfirmohet edhe me anë të analizës stres-test, rezultatet e së cilës sugjerojnë se edhe në skenarët më të ashpër të lëvizjes së depozitave problemet e mundshme me likuiditet do të ishin të përballueshme nga ana e sistemit bankar, dhe të izoluara në banka individuale.

Duke marrë parasysh treguesit e likuiditetit si dhe vazhdimin e rritjes së qëndrueshme të depozitave në sistemin bankar, që reflekton edhe besimin e qëndrueshëm të qytetarëve në këtë sistem, rreziku i likuiditetit në sistemin bankar të Kosovës vazhdon të konsiderohet i ulët.

Niveli i lartë i mjeteve likuide dhe ekspozimi i ulët ndaj rrezikut të likuiditetit lidhet drejtpërdrejtë me strukturën e aktivitetit të sistemit bankar të Kosovës i cili konsiderohet të jetë një sistem i bazuar në aktivitetet e bankingut tradicional, me kreditë dhe depozitat si përbërës kryesor të bilancit të gjendjes së sistemit. Mbështetja e lartë në depozita si burim financimi ka bërë që bankat të kenë një burim më stabil të financimit dhe mos të bazohen në fonde afatshkurtra, oferta e të cilave është më e luhatshme dhe kanë kosto më të lartë të financimit, sidomos në kohët e vështirësive ekonomike dhe financiare si këto nëpër të cilat po kalojnë ekonomitë e vendeve të zhvilluara.

Figura 46. Kreditë dhe depozitat e sistemit bankar, në milionë euro




Burimi: BQK (2013)

Fakti se depozitat bankare përbëjnë 80.6 përqind të gjithsej detyrimeve gjithashtu tregon mbështetjen e lartë të bankave në fonde vendore (79.4 përqind në vitin 2011). Përparësia e mbështetjes në depozita qëndron në faktin se këto fonde paraqesin burim stabil dhe që kanë shënuar rritje pozitive disa vite me radhë, si dhe kanë kosto relativisht më të ulët, krahasuar me fondet tjera, siç mund të jenë financimet nga jashtë.

Një nga indikatorët e rëndësishëm të likuiditetit në sistemin bankar është raporti kredi/depozita, që tregon për kapacitetin bankave në mbulimin e kredive me depozita. Ky raport në vitin 2012 u zvogëluar në 77.4 përqind, krahasuar me 80.7 në vitin e kaluar (Figura 46). Zvogëlimi i këtij indikator reflektonte rritjen më të ngadalshme të kredive gjatë vitit 2012, krahasuar me rritjen e depozitave, të cilat nuk ndryshuan shumë krahasuar me vitin e kaluar. Siç mund të vërehet në figurën 46, raporti kredi/depozita zakonisht influencohet nga faktorët sezonalë. Për shembull, në tremujorët e parë, ky raport shënon ngritje të lehtë dhe arrin pikën më të lartë zakonisht në tremujorin e dytë. Tremujori i katërt kryesisht karakterizohet me rënie të raportit kredi/depozita. Rrjedhimisht, edhe zvogëlimi i raportit kredi/depozita pjesërisht reflekton edhe efektin sezonal në këtë periudhë.


Një tjetër tregues i rëndësishëm i gjendjes së likuiditetit në sistemin bankar është edhe raporti ndërmjet aseteve likuide dhe gjithsej aseteve. Sipas një definicioni të Fondit Monetar Ndërkombëtar, asetet likuide ndahen në asete 'themelore' dhe asetet 'gjithëpërfshirëse' (*angl. core liquid assets dhe broad liquid assets*).<sup>8</sup> Në dhjetor të vitit 2012, pjesëmarrja e aseteve likuide 'core' ishte 25.3 përqind, krahasuar me 26.6 përqind në dhjetor të vitit 2011. Rënia e aseteve likuide 'core' gjatë kësaj periudhe erdhi si pasojë e përgjysmimit të investimeve të bankave në plasmanet në bankat tjera jashtë vendit. Ndërkohë, gjatë vitit 2012, bankat në Kosovë orientuan rreth 5 milionë euro investime në asete të tregtueshme si dhe rritën rreth 72 milionë euro (60 përqind më shumë) investime në letrat me vlerë, investime këto që karakterizohen me një rrezikshmëri më të lartë, por njëherit edhe me kthim më të lartë. Rrjedhimisht, pjesëmarrja e aseteve likuide 'broad' në gjithsej asetet e sistemit bankar u rrit në 32.6 përqind, krahasuar me 31.3 përqind në dhjetor të vitit 2011. Gjithsesi, shkalla e likuiditetit si e aseteve 'core' ashtu edhe e atyre 'broad' sugjeron se niveli i likuiditetit në sistemin bankar të Kosovës është në pozicion të kënaqshëm, megjithëse bankat duhet të tregohen të kujdesshme në diversifikimin e portfolios së investimeve, veçanërisht të atyre me rrezik më të lartë.

Figura 47. Raporti asete likuide 'broad'/detyrime afatshkurta



Burimi: BQK (2013)

Figura 48. Struktura e letrave me vlerë, në përqindje



Burimi: BQK (2013)

<sup>8</sup> Asetet likuide 'core' përfshijnë paratë e gatshme dhe gjendjen (bilancin) e bankave në BQK, si dhe llogaritë rrjedhëse në bankat tjera dhe plasmanet në bankat tjera me maturitet deri në 90 ditë.

Tregues tjetër i rëndësishëm për shkallën e likuiditetit është raporti ndërmjet aseteve dhe detyrimeve afatshkurta, i cili vlerëson aftësinë e bankave në përmbushjen e detyrimeve me maturitet të shkurtë kohor, siç mund të jenë kërkesat për tërheqjen e depozitave apo pagesat e borxhit afatshkurtër. Në dhjetor të vitit 2012, raporti ndërmjet aseteve likuide 'core' dhe detyrimeve afatshkurta qëndroi në 31.7 përqind, që paraqet një rënie prej 2pp. Gjithsesi, pjesa e dytë e vitit 2012 u karakterizua me trend rritës të këtij raporti. Në periudhën e njëjtë raportuese, raporti ndërmjet aseteve likuide 'broad' dhe detyrimeve afatshkurtëra u rrit në


40.8 përqind, krahasuar me 39.6 përqind në dhjetor të vitit 2011, që paraqet raport më të lartë se sa raporti i përcaktuar për bankat, që duhet të jetë 25 përqind i detyrimeve afatshkurte (Figura 47).<sup>9</sup> Asetet likuide 'core' ndaj detyrimeve afatshkurtera, në pjesën e parë të vitit 2012, shënuan trend rënës nga 29.4 përqind në Mars, në 28.3 në qershor 2012, përderisa pjesa e dytë e vitit u karakterizua me rritje të këtij indikatori në 30.3 në shtator dhe 31.7 përqind në dhjetor 2012. Rrjedhimisht, raporti në pjesën e parë të vitit ndikoi edhe në zvogëlimin e pjesëmarrjes së aseteve likuide 'core' në detyrimet afatshkurtëra, krahasuar me pjesëmarrjen e vitit të kaluar. Përkundër rënies së aseteve likuide 'core' ndaj detyrimeve afatshkurtëra, ky raport, bashkë me shkallën e aseteve 'broad' konsiderohen se qëndrojnë në nivele të kënaqshme, duke sugjeruar se bankat në Kosovë kanë aftësi të ballafaqohen me rrezikun eventual të likuiditetit.

Koncentrimi i lartë i depozitave gjithashtu shërben si një tregues i rrezikut të likuiditetit, sidomos në kategorinë e depozitave që mund të tërhiqen në çdo kohë (depozitat e transferueshme). Pjesa kryesore e depozitave vazhdon të mbetet e koncentruar në bankat me mëdha, por që gjithsesi, pjesëmarrja e depozitave të transferueshme në gjithsej depozitat ka shënuar trend rënës gjatë viteve të fundit që tregojnë për përmirësim të menaxhimit të likuiditetit nga ana e bankave (33 përqind në 2012, 33.2 përqind në 2011, 34.6 përqind në 2010). Në kuadër të depozitave të transferueshme, bankat kanë raportuar për një rritje të koncentrimin në depozitat e transferueshme të ekonomive familjare dhe korporatave jofinanciare për 12.8 përqind, përkatësisht 23.8 përqind. Vlenë të ceket se pjesëmarrja e 20 depozitesve më të mëdhenj në sistemin bankar ishte mesatarisht 16.2 përqind egjithsej depozitave, që tregojnë për një koncentrim më të ulët të depozitave të qytetarëve të Kosovës, në krahasim me disa nga vendet e rajonit (p.sh. Maqedonia)

Struktura e investimeve të bankave jashtë vendit kryesisht përqendrohet në produkte që karakterizohen me shkallë relativisht më të ulët të rrezikut të moskthimit, siç janë investimet në fletëobligacione të qeverisë, korporata financiare dhe korporata jo-financiare. Njëherit, diversifikimi i portfolios së investimeve sipas shteteve të përzgjedhura, si Francë, Gjermani, Shtete të Bashkuara, Holandë etj., gjithashtu tregojnë për një orientim të investimeve bankare në tregje me siguri më të lartë.

Mjetet e investuara në tregjet e jashtme gjatë vitit 2012, mirëmbajtën strukturën e tri viteve të fundit (të iniciuar në fund të vitit 2009), ku pjesa më e madhe e tyre është investuar në fletëobligacione qeveritare e më pak në ato të korporatave financiare (Figura 48). Në dhjetor të vitit 2012, pjesa më e madhe prej 61.3 përqind e investimeve ishte investuar në fletëobligacionet

Figura 49. Rezervat e sistemit bankar bankar, në milionë euro



Burimi: BQK (2013)

<sup>9</sup> Sipas rregullores së re për menaxhimin e likuiditetit, e cila hyri në fuqi me 3 dhjetor 2012, bankat duhet të mbajnë në çdo kohë mjete likuide ndaj detyrimeve afatshkurte: a) në valutën Euro dhe valuta të huaja në nivel prej 20 përqind, b) valutat totale në nivel minimal prej 25 përqind.

e lëshuara nga qeveritë e huaja. Investimet në fletëobligacionet e korporatave financiare zakonisht kanë zënë një përqindje relativisht të vogël të gjithsej investimeve në letra me vlerë (mesatarisht 0.5 përqind), megjithatë, gjatë vitit 2012 bankat hezituan të investojnë në këto letra me vlerë, prandaj edhe pjesëmarrja e tyre në gjithsej portofolin e investimeve me letra në vlerë jashtë vendit, ishte pothuajse zero.


Që nga fillimi i vitit 2012, për herë të parë filloi emetimi i letrave me vlerë të Qeverisë së Republikës së Kosovës, me ç'rast u krijua mundësia e shfrytëzimit të likuiditetit të tepërt për investim në një produkti të ri, përkatësisht në bono të thesarit.<sup>10</sup> Në dhjetor të vitit 2012, investimet në letrat me vlerë të Qeverisë së Republikës së Kosovës regjistruan 23.3 përqind të gjithsej letrave me vlerë, që tregojnë për një interesim relativisht të lartë të bankave për investimet në bonot e thesarit brenda vendit, gjatë një periudhe relativisht të shkurtër kohore (Figura 49).

Struktura e deritanishme e investimeve në letra me vlerë tregojnë për një çasje më konzervative si dhe më të kujdesshme të bankave komerciale në vend. Gjithsesi, investimet me rrezik të ulët apo pothuajse pa rrezik, siç janë letrat me vlerë të qeverive, nënkuptojnë edhe kthyeshmëri më të ulët në investim, gjë që karakterizon momentalisht sistemin bankar të Kosovës.

Fakti se sistemi bankar i Kosovës ka ekspozim të ulët ndaj rrezikut të likuiditetit konfirmohet edhe përmes shkallës së rezervave të detyrueshme, të cilat bankat në Kosovë vazhdimisht i mirëmbajnë në nivel më të lartë se sa niveli minimal i kërkuar nga ana e rregullatorit (Figura 50). Në dhjetor të vitit 2012, vlera totale e rezervave të likuiditetit të sistemit bankar në BQK ishte 360.3 milionë euro, apo për 48 përqind më e lartë se sa rezerva e kërkuar (rezerva e detyrueshme për sistemin bankar në dhjetor 2012 ishte 187.1 milionë euro). Mbajtja e rezervave shtesë ndihmon në uljen e rrezikut të likuiditetit në sistemin bankar, por gjithashtu nënkupton edhe kosto oportune të mosshfrytëzimit të këtyre mjeteve në investime, duke marrë parasysh se përveç rezervës së detyrueshme, pjesa tjetër nuk kompenzohet me kthim nga interesi.

Analiza e hendekut të likuiditetit (*angl. liquidity gap*), përfaqëson një tjetër mënyrë të vlerësimit të rrezikut të likuiditetit, e cila vlerëson mjaftueshmërinë e aseteve me afat të caktuar maturiteti për përmbushjen e detyrimeve me po atë afat maturimi. Dallimi i vlerës së aseteve me afat të caktuar dhe vlerës së detyrimeve me të njëjtin afat maturimi, jep hendekun apo mospërputhjen e maturitetit. Rezultatet me vlerë pozitive në figurën 50, tregojnë se hendeku i likuiditetit është pozitiv, me ç'rast, vlera e aseteve me një afat të caktuar është më e lartë se detyrimet me afat të njëjtë, që domethënë se këto detyrime mund të shlyhen në kohë. Në rastin e kundërt, hendeku negativ tregon se vlera e aseteve me afat të caktuar maturimi është më e ulët sesa detyrimet e atij afati maturimi.<sup>11</sup> Duke psur parasysh se pjesa më e madhe e aseteve në sistemin bankar përbëhet nga kreditë, ndërsa e detyrimeve nga depozitat, atëherë edhe hendeku i likuiditetit kryesisht pasqyron dallimin në maturitet të kredive dhe depozitave. Siç mund të vërehet në figurën 50, periudhat me afat më të shkurtër maturimi zakonisht karakterizohen me hendek negativ të likuiditetit, meqë detyrimet tejkalojnë

Figura 50. Hendeku i likuiditetit, në milionë euro



Burimi: BQK (2013)

<sup>10</sup> Për më tepër, shih Kutia 1, Buletini Mujor Statistikor No. 127, <http://www.bqk-kos.org/repository/docs/2012/BMS%20nr%20127%20shqip.pdf>

<sup>11</sup> Maturiteti i aseteve dhe detyrimeve ndahet në këto periudha: 1 deri 7 ditë, 8 deri 30 ditë, 31 deri 90 ditë, 91 deri 180, 181 deri 365 ditë dhe më shumë se 1 vit.

asetet dhe daljet e parave në banka janë më të larta (zakonisht depozitat e pa afatizuara). Me rritjen e afatit të maturimit, edhe mospërputhja e likuiditetit kalon në hendek pozitiv, meqë vlera e aseteve me afat më të gjatë maturimi tejkalon kreditë e lëshuara (p.sh. me afat maturimi mbi 1 vit.)


**ii. Rreziku kreditor**

Gjatë vitit 2012, performanca më e dobët ekonomisë në përgjithësi, dhe sistemit bankar në veçanti, ndikoi në uljen e cilësisë së portfolios kreditor. Duke marrë parasysh vështirësitë me të cilat po përballen vendet e eurozonës, si dhe përkeqësimin e portfolios kreditor në shumicën e vendeve të rajonit, duhet theksuar se portfolio kreditore e sistemit bankar të Kosovës në përgjithësi vazhdon të ketë një cilësi të mirë sa i përket klasifikimit të kredive. Mirëpo, vlen të përmendet fakti se gjatë vitit 2012 është vërejtur një rënie e cilësisë së portfolios kreditore.

Sa i përket strukturës së kredive sipas klasifikimit në bazë të cilësisë, vërehet një migrim i kredive nga kategoria standarde (që paraqet kreditë të cilat nuk kanë probleme të kthimit) drejtë kategorive që karakterizohen me cilësi më të dobët.<sup>12</sup> Në figurën 51 mund të vërehet se pjesëmarrja e kredive që bëjnë pjesë në kategorinë standarde shënoi një ulje prej 2.9pp krahasuar më vitin paraprak dhe qëndroi në 87.1 përqind të gjithsej kredive të sistemit bankar. Gjatë vitit 2012, pjesëmarrja e kredive të klasifikuara në gjithsej kreditë ka shënuar rritje duke qëndruar në 12.9 përqind (10.0 përqind në dhjetor 2011). Po ashtu, pjesëmarrja e kredive me probleme në gjithsej kreditë, në dhjetor 2012, ishte 10.0 përqind (8.3 përqind në dhjetor 2011).


Rritje më të theksuar kanë shënuar kreditë e klasifikuara në kategoritë si ‘të humbura’ dhe ‘të dyshimta’, këto dy kategori së bashku përbëjnë portofolion e Kredive Joperformuese (angl. *Non-Performing Loans: NPL*). Njëherazi, kjo është kategoria më e rëndësishme për sa i përket përshkrimit të cilësisë së portfoliot kreditor. Në dhjetor 2012, pjesëmarrja e NPL-ve në gjithsej portofolion kreditor të sistemit bankar arriti në 7.5 përqind nga 5.7 përqind sa ishte në dhjetor 2011. Në figurën 52 mund të shihet se gjatë gjithë vitit 2012 shkalla e NPL-ve shënoi rritje graduale. Niveli aktual i NPL-ve paraqet nivelin më të lartë të NPL-ve që nga fillimi i funksionimit të sistemit bankar në Kosovë.

Figura 51. Struktura e kredive sipas klasifikimit



Burimi: BQK (2013)

Figura 52. Raporti NPL/gjithsej kredite, në përqindje



Burimi: BQK (2013)

<sup>12</sup> Bazuar në rregulloret e BQK, kreditë në sektorin bankar të Kosovës klasifikohen në pesë kategori kryesore: standarde, vrojtuese, nënstandarde, të dyshimta dhe të humbura. Kreditë e klasifikuara përfshijnë kategoritë: vrojtuese, nënstandarde, të dyshimta dhe të humbura. Kreditë me probleme përfshijnë kategoritë: nënstandarde, të dyshimta dhe të humbura. Kreditë joperformuese përfshijnë kategoritë: të dyshimta dhe të humbura.


Rritja vjetore e gjithsej kredive ishte 3.8 përqind, krahasuar me 16.4% përqind sa ishte në dhjetor 2011 (Figura 53), ndërsa rritja vjetore e NPL-ve arriti në 35.8 përqind nga 13.6 përqind sa ishte në fund të vitit 2011. Ngadalësimi i rritjes së kredive në përgjithësi ka ndikuar në mënyrë indirekte në rritjen e nivelit nominal të NPL-ve.

Sa i përket strukturës së NPL-ve, në fund të vitit 2012 kreditë e klasifikuara si ‘të humbura’ përfaqësonin 66.2 përqind të gjithsej NPL-ve, ndërsa kreditë e klasifikuara si ‘të dyshimta’ qëndronin në 33.8 përqind (Figura 54). Gjatë periudhës në fjalë kreditë ‘e dyshimta’ arritën në 44.2 milionë euro duke shënuar rritje për 29.3 përqind, ndërsa kreditë ‘e humbura’ u rritën për 39.4 përqind duke arrit në 86.5 milionë euro krahasim me vitin paraprak.

Me gjithë rritjen e raportit të NPL-ve, sistemi bankar i Kosovës vazhdon të ketë nivel të lartë të qëndrueshmërisë, duke u mbështetur në nivelin e lartë të kapitalizimit që ka. Mirëpo, përkeqësimi i mëtutjeshëm i cilësisë së portofolit kreditor, duhet të ndikojë në rritjen e kapaciteteve për menaxhimin e rrezikut kreditor nga ana e bankave komerciale në mënyrë që të mos ndikohet performanca e sistemit bankar. Po ashtu, bankat komerciale duhet të vazhdojnë zgjerimin e mëtutjeshëm të kreditimit në mënyrë që to mos ndikohet performanca e përgjithshme e sistemit ekonomik.


Rritja e NPL ishte prezentë pothuajse në të gjithë sektorët e ekonomisë. Sidoqoftë, përkeqësimi i cilësisë ishte më i theksuar te kreditë prodhimitarise, energjise si dhe shërbimeve të hotelerise (Figura 55). Duke marrë parasysh ekspozimin e lartë ndaj sektorit të tregtisë, përkeqësimi më i theksuar në cilësinë e portfolios kreditorë të destinuar për tregti, ndikon në masë të madhe edhe në performancën e përgjithshme të sistemit bankar. Gjatë vitit 2012, pjesëmarrja e NPL-ve në gjithsej kreditë e lëshuara për sektorin e tregtisë u rrit nga 7 përqind sa ishte në dhjetor 2011 në 10 përqind në dhjetor 2012. Përkeqësimi i cilësisë së kredive gjatë kësaj periudhe u regjistrua edhe te kreditë e lëshuara për sektorin e shërbimeve të hotelerise, ku NPL-të pothuajse u dyfishuan duke ngrit pjesëmarrjen në 10.5 përqind të gjithsej kredive te destinuar për këtë sektor,

Figura 53. Norma vjetore e rritjes së gjithsej kredive dhe NPL-ve




Burimi: BQK (2013)

Figura 54. Struktura e kredive joperformuese, në përqindje



Burimi: BQK (2013)

Figura 55. NPL-të sipas sektorëve




Burimi: BQK (2013)

krahasuar me 5.9 përqind në dhjetor 2012 . Po ashtu në sektorin e prodhimitarisë dhe ndërtimtarisë që janë edhe dy sektorët kyç në zhvillimin e qëndrueshëm ekonomikë, cilësia e portofolios kreditor shënoi rënie. Në këtë kontekst, rritja e NPL te kreditë e sektorit të prodhimitarisë deri në një masë mund t'i atribuohet rënies së kërkesës për produktet vendore, si dhe zvogëlimin të kërkesës për eksportet kosovare. Po ashtu, rritja e NPL-ve për sektorin e ndërtimtarisë, ka rezultuar në rënien e kërkesës për blerje të banesave. Ndërsa, gjatë vitit 2012, cilësia e portofolios kreditorë për sektorët si bujqësia, minierat dhe kreditë e tjera mbeti e pandryshuar krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Mirëpo, bankat në vazhdimësi janë treguar më të kujdesshme në kreditimin e këtyre sektorëve duke mbajtur ekspozim kreditor të ulët ndaj këtyre sektorëve.

Sistemi bankar i Kosovës në vazhdimësi është treguar mjaft konservativ për sa i përket mbulimit të NPL-ve me provizione për humbje nga kreditë. Mirëpo, gjatë vitit 2012 rritja më e lartë e pjesëmarrjes së NPL-ve në gjithsej portofolin kreditor ka ndikuar në zvogëlimin e mbulueshmërisë së kredive me provizione. Po ashtu duhet të theksohet se vlera e mjeteve e ndarë për provizione gjithmonë tejkalon vlerën e tërësishme të NPL-ve. Në dhjetor 2012, shkalla e mbulimit të NPL-ve me provizione për humbje nga kreditë ishte 112 përqind, kurse mesatarja për katër vitet e fundit ishte 123 përqind (Figura 56). Shkalla e lartë e mbulueshmërisë së NPL me provizione bënë që niveli aktual i NPL-ve të mos kërcënojë stabilitetin e sistemit bankar.

Figura 56. NPL-të dhe provizionet



Burimi: BQK (2013)


## ii. Rreziku i solvencës

### Treguesi i mjaftueshmërisë së kapitalit

Sistemi bankar i Kosovës karakterizohet me një shkallë të lartë të kapitalizimit që në vazhdimësi ka tejkaluar minimumin e kërkuar rregullativ. Shkalla e kapitalizimit paraqet një tregues të rëndësishëm të qëndrueshmërisë së sistemit bankar, duke pasur parasysh faktin që kapitali konsiderohet të jetë shtylla kryesore për mbulimin e humbjeve potenciale në rast të ndonjë tronditje në sistemin bankar.

Treguesi i Mjaftueshmërisë së Kapitalit (*angl. Capital Adequacy Ratio: CAR*)<sup>13</sup> në sistemin bankar të Kosovës në dhjetor 2012 qëndroi në 14.2 përqind, krahasuar me 17.5 përqind sa ishte në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar (Figura 57). Ndërsa, gjatë periudhës në fjalë, raporti ndërmjet Kapitalit të klasit të parë dhe Mjetet e Peshuara me Rrezik (*angl. Risk Weighted*

Figura 57. Kapitalizimi i sistemit bankar



Burimi: BQK (2013)

<sup>13</sup> Sipas Rregullës për Adekuatshmërinë e Kapitalit të BQK-së, bankat janë të obliguara të mbajnë raportin ndërmjet kapitalit dhe asetëve të peshuara me rrezik në nivelin prej së paku 12%.

*Assets: RWA*) qëndroi në 11.6 përqind krahasuar me 14.7 përqind në dhjetor 2011<sup>14</sup>. Niveli më i ulët i këtyre dy treguesve arsyetohet me faktin se kapitali ka shënuar normë vjetore të rritjes negative prej 7.6 përqind, ndërsa RWA kanë shënuar një normë të rritjes vjetore prej 14.0 përqind. Ndryshimet në nivelin e kapitalit si dhe RWA në një masë të madhe ndërlidhen me ndryshimet e rregullores mbi Adekuatshmërinë e Kapitalit të Bankave që filloi së zbatuari në dhjetor të vitit 2012<sup>15</sup>. Në bazë të kësaj rregullore ka ndryshuar mënyra e përlogaritjes së kapitalit si dhe RWA-ve. Në rastin e kapitalit, përkatësisht përlogaritjes së kapitalit të klasit të parë, janë shtuar dy pozicione të cilat janë deduktuar nga shuma e përgjithshme e kapitalit të klasit të parë. Pozicioni i parë që është shtuar ndërlidhet me 'Investimet në ekuitetin e bankave tjera apo institucione kreditore' ndërsa pozicioni i dytë ndërlidhet me 'Huazimet e personave të ndërlidhur me bankën'. Këto dy pozicione së bashku kanë ndikuar në uljen e nivelit të kapitalit të klasit të parë për rreth 31.9 milionë euro. Po ashtu ka ndryshuar metodologjia në përlogaritjen e RWA, ku duhet të veçohet shtimi i pozicionit të 'Rrezikut operacional' gjë që ka ndikuar në rritjen e shumës së përgjithshmen të RWA-ve.


Përkundër zvogëlimit të kapitalit dhe rritjes së RWA-ve, duhet të theksohet se niveli aktual i kapitalizimit (mbulueshmëria me kapital) të sistemit bankar të Kosovës, shprehur përmes këtyre treguesve, është mjaft i kënaqshëm duke marrë parasysh se dukshëm tejkalon normat minimale prej 12 përqind të përcaktuar nga BQK-ja.

Bazuar në Rregullen e BQK-së<sup>16</sup>, në dhjetor 2012, bankat ishin të obliguara të mbanin shkallën e kapitalit në nivelin prej 234.7 milionë euro. Mirëpo, në vazhdimësi bankat kanë mbajtur nivel më të lartë të kapitalit rregullativ se sa që u është kërkuar. Në dhjetor 2012, gjithsej kapitali rregullativ ishte 277.1 milionë, që paraqet një tepriçë të kapitalit rregullativ prej 42.4 milionë euro (Figura 58). Në mënyrë për të ruajtur stabilitetin dhe qëndrueshmërinë financiare BQK-ja përmes rregullores së re për kapital ka filluar të aplikoj edhe një masë të re prudenciale që ka të bëjë me shkallën e levës<sup>17</sup>. Në bazë të rregullores së re bankat komerciale janë të obliguara të mirëmbajnë raportin minimal të levës prej shtatë për qind (7%). Në dhjetor të vitit 2012, raporti i levës për gjithë sistemin bankar qëndronte në 9.8 përqind, që është një nivel mjaft i kënaqshëm krahasuar me minimumin e kërkuar rregullativ.

## Kapitali

Në dhjetor 2012, kapitali i sistemit bankar arriti në 277.1 milionë euro, duke regjistruar rënie vjetore prej 7.6 përqind (300.0 milionë euro në dhjetor 2012). Siç mund të shihet në figurën 59, përjashtuar vitin 2012 kur edhe u miratuan rregulloret e reja për përlogaritjen e kapitalit, kapitali bankar ka ndjekur një trend rritës, por norma e rritjes shënoi ngadalësim të vazhdueshëm. Gjatë vitit 2012, rënia e nivelit të gjithsej kapitalit ishte kryesisht rezultat i rënies

Figura 58 Gjithsej kapitali dhe kapitali rregullativ, në milionë euro



Burimi: BQK (2013)

<sup>14</sup> Sipas Rregullës për Adekuatshmërinë e Kapitalit të BQK-së, bankat janë të obliguara të mbajnë raportin ndërmjet kapitalit të klasit të parë dhe asetëve të peshuara me rrezikut në nivelin prej së paku 8%.

<sup>15</sup> Bordi i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës në mbledhjen e mbajtur më 29 nëntor 2012, miratoi rregulloren e re Për Adekuatshmërinë e Kapitalit të Bankave, e cila hyri në fuqi me 3 dhjetor 2012. <http://www.bqk-kos.org/repository/docs/2012/Rregullore%20per%20Adekuatshmerine%20e%20Kapitalit%20te%20Bankave.pdf>

<sup>16</sup> Sipas Rregullës për Adekuatshmërinë e Kapitalit të BQK-së, bankat janë të obliguara të mbajnë raportin ndërmjet kapitalit dhe asetëve të peshuara ndaj rrezikut në nivelin prej së paku 12%.

<sup>17</sup> Bazuar në rregulloren për Adekuatshmërinë e Kapitalit të BQK-së, raporti i levës është i barabartë me totalin e ekuitetit / totalin e mjeteve Rregullës për Adekuatshmërinë e Kapitalit të BQK-së

së fitimit për vitin aktual, si dhe zbritjes së portfolios së huazimeve të personave të ndërlidhur me bankën nga gjithsej kapitali.

Përkundër zvogëlimit të gjithsej kapitalit, Kosovës në vazhdimësi është karakterizuar me cilësi të mirë. Një tregues i cilësisë dhe qëndrueshmërisë së kapitalit të një banke është pjesëmarrja e kapitalit aksionar në gjithsej kapitalin dhe kjo pjesëmarrje në rastin e sistemit bankar të Kosovës është 72.2 përqind.

Struktura e kapitalit të sistemit bankar vazhdoi të dominohet nga kapitali i klasit të parë që arriti vlerën 227.0 milionë euro (në dhjetor 2011 ishte 252.0 milionë euro). Ndërsa, kapitali i klasit të dytë shënoi vlerën prej 50.1 milionë euro (48.0 milionë euro në dhjetor 2011). Në dhjetor 2012, pjesëmarrja e kapitalit të klasit të parë në gjithsej kapitalin shënoi rënie prej 2.1 pp duke qëndruar në 81.9 përqind krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar (Figura 60). Ndërsa, kapitalit i klasit të dytë ngriti pjesëmarrjen nga 16.0 përqind sa ishte në vitin 2011, në 18.1 përqind në vitin 2012.


### Kapitali i klasit të parë

Në fund të vitit 2012, shuma e përgjithshme e kapitalit të klasit të parë në sistemin bankar ishte 227.0 milionë euro krahasuar me 252.0 milionë euro në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, që paraqet një rënie vjetore prej 9.9 përqind. Gjatë periudhës në fjalë, kapitali aksionar, si kategoria kryesore e kapitalit të klasit të parë shënoi rritje vjetore 13.3 përqind, duke arritur vlerën prej 200.0 milionë euro. Po ashtu, fitimi i pashpërndarë nga vitet paraprake ka regjistruar një rritje vjetore prej 5.8 përqind, duke arrit në 44.3 milionë euro.

Ndërsa, vlera e fitimit të vitit aktual arriti në 18.7 milionë euro, duke shënuar një rënie vjetore prej 49.1 përqind. Kategoritë si mjetet jo materiale dhe vlera e emrit të mirë, huazimet e personave të ndërlidhur me bankën si dhe investimet në ekuitetin e bankave tjera apo institucione kreditore janë kategori të cilat zbriten nga vlera e përgjithshme e kapitalit të klasit të parë. Mjetet jomateriale dhe emri i mirë përbënin rreth 5 milionë euro të gjithsej kapitalit të klasit të parë, që është më i lartë krahasuar me vitin paraprak (3.82 milionë euro në dhjetor 2011). Kategoritë e shtuara në përlllogaritjen e kapitalit, huazimet e personave të ndërlidhur me bankën si dhe investimet në ekuitetin e bankave tjera apo institucionet kreditore qëndronin në 31.5 milionë euro, përkatësisht 333 mijë euro.

mund të thuhet se kapitali i sistemit bankar të


Figura 59. Gjithsej kapitali dhe norma vjetore e rritjes, në milionë euro



Burimi: BQK (2013)

Në dhjetor 2012, pjesëmarrja e kapitalit të klasit të parë në gjithsej kapitalin shënoi rënie prej 2.1 pp duke qëndruar në 81.9 përqind krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar (Figura 60). Ndërsa, kapitalit i klasit të dytë ngriti pjesëmarrjen nga 16.0 përqind sa ishte në vitin 2011, në 18.1 përqind në vitin 2012.


Figura 60. Struktura e kapitalit të sistemit bankar



Burimi: BQK (2013)

Struktura e kapitalit të klasit të parë ka ndryshuar në krahasim me vitet paraprake. Mirëpo, duhet theksuar se ndryshimi nuk ka ndodhur si rrjedhojë e ndryshimit në menaxhimin e kapitalit nga ana e bankave, por si pasojë e ndryshimit të rregullores mbi përllogaritjen e kapitalit. Në figurën 61, mund të shihet se kapitali aksionar vazhdon të dominojë strukturën e përgjithshme të kapitalit të klasit të parë. Në dhjetor 2012, kjo kategori përfaqësonte 88.1 përqind të gjithëj kapitalit të klasit të parë. Ndërsa, kategoria e dytë për nga madhësia përbëhet nga fitimi i pashpërndarë i cili në këtë periudhë përfaqësoi 19.5 përqind të gjithëj kapitalit të klasit të parë. Ndërsa, pjesëmarrja e fitimit aktual ishte 8.2 përqind. Mjetet jomateriale (*angl. intangible assets*) dhe vlera e emrit të mirë (*angl. goodwill*) morën pjesë me 2.2 përqind në gjithëj kapitalin e klasit të parë (1.5 përqind në dhjetor 2012). Ndërsa, huazimet e personave të ndërlidhur me bankën si dhe investimet në ekuitetin e bankave tjera apo institucione kreditore përfaqësonin rreth 13.9 përqind përkatesisht 0.1 përqind të gjithëj kapitalit të klasit të parë.

Figura 61. Struktura e kapitalit të klasit të parë




Burimi: BQK (2013)

### Asetet e peshuara ndaj rrezikut

Gjithëj vlera e RWA të sektorit bankar të Kosovës, në dhjetor 2012, arriti vlerën prej 1.95 miliardë euro duke regjistruar një normë të rritjes vjetore prej 14.0 përqind. Rritja e RWA në masë të madhe i atribuohet ndryshimit në Rregulloren për adekuatshmërinë e kapitalit. Janë dy pozicione që kanë ndikuar në ndryshimin e strukturës së RWA. Së pari, është shtuar kategoria e aseteve me peshë të rrezikut prej 150 përqind, gjë që ka ndikuar në rritjen e RWA për rreth 31.7 milionë euro (pjesëmarrja e të cilave arriti në 1.6 përqind figura 62). Së dyti, është shtuar kategoria e mjeteve të rrezikuara për rrezikun operacional<sup>18</sup>, duke ndikuar në rritjen e aseteve për rreth 180 milionë euro (pjesëmarrja e rrezikut operacional arriti në 9.2 përqind). Pjesa tjetër e strukturës së RWA nuk ka pësuar ndonjë ndryshim të theksuar, ku vlen të ceket se asetet me peshë të rrezikut prej 100 përqind vazhdojnë të kenë pjesëmarrjen më të lartë prej 70.4 përqind të gjithëj. Kjo kategori përbëhet nga kreditë<sup>19</sup> si dhe zërat jashtëbilancorë që së bashku shënuan një rritje vjetore prej 4.3 përqind duke arritë në 1.37 miliardë euro. Pjesëmarrja e aseteve me peshë të rrezikut prej 75 përqind në gjithëj RWA-të u zvogëlua në 14.0 përqind nga 16.1 përqind sa ishte në fund të vitit 2011. Kjo kategori përbëhet nga kreditë e garantuara me hipotekën e parë në pasuri të patundshme dhe që kanë vonesë kthimi prej më pak se 30 ditë si dhe kreditë për ndërtuesit për të financuar ndërtimin e pasurive të patundshme, ku prona e

Figura 62. Struktura e RWA-ve sipas peshës së rrezikut



Burimi: BQK (2013)

<sup>18</sup> Mënyra e llogaritjes së rrezikut operacional është paraqitur në rregulloren për Adekuatshmërinë e Kapitalit të Bankave <http://www.bqk-kos.org/repository/docs/2012/Rregullore%20per%20Adekuatshmerine%20e%20Kapitalit%20te%20Bankave.pdf>

<sup>19</sup> Për klasifikimin e detajuar të RWA-ve referoju rregullores për Adekuatshmërinë e Kapitalit të Bankave.

financuar ka qenë e shitur apo e lëshuar me qira, të cilat së bashku arritën në 273.3 milionë euro (rënie vjetore prej 1 përqind).

#### 3.3.2.4.1 Analiza stres-test

Krahas analizimit të gjendjes aktuale të ekspozimit të sistemit bankar ndaj rrezikut kreditor, rrezikut të likuiditetit dhe rrezikut të solvencës, analiza stres-test paraqet një vegël shtesë përmes së cilës është vlerësuar qëndrueshmëria e sektorit ndaj tronditjeve potenciale, si në portofolin kreditor ashtu edhe në asetet likuide. Rezultatet e shtjelluara më poshtë kanë për bazë të dhënat e sektorit bankar për muajin dhjetor 2012. Gjatë kësaj analize është testuar qëndrueshmëria e sistemit bankar të Kosovës ndaj rrezikut kreditor, të kombinuar me rrezikun nga norma e interesit dhe rrezikun nga norma e këmbimit, si dhe është testuar aftësia e sitemit bankar që të ruaj gjendjen e likuiditetit nën supozime hipotetike mbi tërheqjen e depozitave.

### Rreziku kreditor

#### Metodologjia

Analiza mbështetet në skenarin hipotetik se kriza ekonomike në vendet e Bashkimit Evropian do të vazhdojë të reflektohet në ekonominë e Kosovës përmes zvogëlimit të dërgesave të emigrantëve dhe eksporteve, duke dekurajuar kështu kërkesën e përgjithshme në vend. Si rezultat, kjo supozohet të ndikojë negativisht në rritjen ekonomike, duke zgjeruar kështu hendekun e prodhimit dhe duke ndikuar negativisht në cilësinë e portofolit kreditor. Në këtë skenar është marrë parasysh norma mesatare e rritjes ekonomike në Kosovë prej rreth 4 përqind në pesë vitet e fundit si dhe është supozuar një rënie ekonomike më e theksuar prej 2.0 përqind për vitin 2012, gjë që do të rriste hendekun e prodhimit për 6.0 përqind. Për të vlerësuar ndikimin e hendekut të prodhimit në cilësinë e portofolit kreditor, gjegjësisht në kreditë joperformuese (*angl. Non-Performing Loans: NPL*), janë shfrytëzuar koeficientët e elasticitetit nga një analizë e papublikuar e FMN-së për disa vende të Evropës qendrore dhe juglindore.<sup>20</sup> Rrjedhimisht, duke konsideruar një koeficient të elasticitetit të NPL ndaj hendekut të prodhimit prej 0.8, pjesëmarrja e NPL-ve në gjithsej kreditë e sektorit bankar do të rritej për 4.8pp. Rreziku kreditor është kombinuar me rrezikun nga norma e interesit dhe rrezikun nga norma e këmbimit, ku është supozuar rënie e normave të interesit dhe zhvlerësim i valutës euro ndaj valutave të tjera si rezultat i zhvillimeve në disa nga vendet e eurozonës, si p.sh Greqia, Spanja dhe Qiproja. Rrjedhimisht, përveç rritjes së pjesëmarrjes së NPL-ve në gjithsej kreditë, në këtë skenar po ashtu është konsideruar zhvlerësimi i euros ndaj dollarit amerikan për 20 përqind<sup>21</sup> si dhe zvogëlimi i normave të interesit për 2.0 pp. Rritja e pjesëmarrjes së NPL-ve në gjithsej kreditë ndikon në rritjen e provizioneve, zhvlerësimi i euros ndikon në rivlerësimin e humbjes/fitimit nga pozicionet e hapura neto, si dhe zvogëlimi i normave të interesit ndikon humbjet/fitimet në të hyrat neto nga interesi duke marrë parasysh hendekun e maturiteteve të kredive dhe depozitave.

Krahas supozimeve për tronditjet e lartpërmendura, po ashtu është marrë parasysh profiti i pritur si një absorbues i humbjeve nga këto tronditje. Në këtë kontekst, është supozuar se profiti neto pas tatimit në vitin 2013 do të jetë ekuivalente me profitin neto për vitin 2012 (kjo për shkak se është supozuar se nuk do të ketë rritje të kredive – mbeten në nivel të njëjtë), po ashtu duhet theksuar se për bankat të cilat kanë regjistruar profit neto pas tatimit negativ për vitin 2012, është supozuar se gjatë vitit 2013 profiti neto pas tatimit do të jetë zero.

Rritja e supozuar e NPL është shprehur përmes migrimit të kredive nga kategoritë performuese (standarde, në vëzhgim, nënstandarde) drejtë kategorive joperformuese (të dyshimta dhe të

<sup>20</sup> IMF unpublished note "CESE Bank Loss Projection and Stress Testing Exercise", July 2009.

<sup>21</sup> Supozim i bazuar në të dhënat historike mbi luhatjen e kursit të këmbimit valutor euro/dollar amerikan.

humbura). Rritja e NPL-ve është shpërndarë proporcionalisht në kuadër të kategorisë së kredive të dyshimta dhe të kredive të humbura, duke marrë për bazë pjesëmarrjen fillestare të këtyre kategorive në gjithsej NPL. Rritja e NPL reflektohet në nivelin e provizioneve bazuar në rregulloren e BQK-së për provizionimin e kredive sipas klasifikimit. Supozimi për rritjen e NPL aplikohet edhe te zërat jashtë-bilancor që përfshijnë zotimet e pashfrytëzuara, garancionet, letër kreditë në dispozicion, dhe letër kreditë komerciale.

Me gjithë faktin se në skenarin e analizuar është konsideruar zhvlerësimi i euros ndaj dollarit amerikan për të vlerësuar rrezikun e normës së këmbimit valutor, është me rëndësi të potencohet se ndikimi i këtij rreziku në bilancin e gjendjes së sistemit bankar vazhdon të jetë shumë i vogël. Pjesa dërmuese e portofolios së kredive është në euro, kreditimi në valutë të huaj pothuaj se nuk ekziston, duke bërë që rreziku nga norma e këmbimit valutor të mbetet minor.

Skenari mbi rrezikun nga norma e interesit nënkupton zvogëlimin e normave të interesit për 2pp (si për asetet ashtu edhe për detyrimet në bilancin e gjendjes). Zvogëlimi i normave të interesit mund të ndikojë në margjinën neto të interesit (*angl. Net Interest Margin: NIM*), duke marrë parasysh afatin e maturimit të kredive dhe depozitave. Sistemi bankar i Kosovës ka ekspozim të ulët edhe ndaj këtij rreziku, me që pjesa dërmuese e kredive dhe depozitave në sistemin bankar të Kosovës kanë normë fikse të interesit. Andaj, sistemi bankar është shumë pak i ndjeshëm ndaj lëvizjeve të normave të interesit në periudhë afatshkurtër.

Qëndrueshmëria e sektorit bankar në këtë analizë është vlerësuar në kuptim të ndikimit të rritjes së NPL, zhvlerësimit të valutës euro dhe rënies së normave të interesit në nivelin e kapitalit rregullativ të sektorit bankar, aseteve të peshuara me rrezik dhe, rrjedhimisht, treguesin e mjaftueshmërisë së kapitalit (*angl. Capital Adequacy Ratio: CAR*).

## Rezultatet

Nga të dhënat në dispozicion të BQK-së mund të vlerësohet se gjendja ekzistuese e sistemit bankar të Kosovës për sa i përket kapitalizimit të bankave është e favorshme, me treguesin e mjaftueshmërisë së kapitalit në 14.2 përqind<sup>22</sup>. Po ashtu, sistemi bankar vazhdon të qëndroj relativisht mirë edhe për sa i përket nivelit të kredive jo-performuese në raport me gjithsej kreditë (7.5 përqind) dhe mbulueshmërisë së humbjeve eventuale nga këto kredi me anë të provizioneve, të cilat mbulojnë NPL-të me 112 përqind. Si rrjedhojë, mund të thuhet sistemi bankar tregon nivel të kënaqshëm të qëndrueshmërisë ndaj rrezikut kreditor edhe nën kushtet e paraqitjes së skenarit hipotetik të përshkruar më lartë.

Nën supozimin se pjesëmarrja e NPL-ve në portfolion e kredive të sektorit do të rritet për 4.8pp<sup>23</sup>, euro do të zhvlerësohet ndaj dollarit amerikan për 20 përqind, dhe normat e interesit do të zvogëlohen për 2.0pp si dhe supozimit për profitin, në nivel të sistemit bankar në tërësi CAR do të mbetet në 13.3 përqind, që do të thotë mbi 12 përqind të kërkuar nga Banka Qendrore.

Megjithatë, edhe pse niveli i CAR për gjithë sistemin bankar do të jetë mbi 12 përqind, për katër nga bankat të cilat operojnë në Kosovë do të duhej një injektim kapitali prej 30.8 milionë euro (ekuivalent me vetëm 0.61 përqind të PBB-së). Në këto rrethana, niveli i ri i pjesëmarrjes së NPL në gjithsej kreditë e sistemit bankar do të arrijte në 12.3 përqind, ndërsa në nivel të bankave individuale, niveli më i ulët i NPL do të ishte 4.8 përqind dhe niveli më i lartë do të ishte 15.9 përqind. Duke u bazuar në supozimet e sipërpërmendura të tronditjeve, rritja e pjesëmarrjes së NPL, zhvlerësimi i euros ndaj dollarit amerikan, zvogëlimi i normave të interesit si dhe supozimi mbi profitin neto do të bënte që gjithsej humbja e sistemit bankar të arrijte vlerën prej 54.5

<sup>22</sup> Zvogëlimi i CAR kryesisht ndërlidhet me ndryshimin në Rregulloren për Adekuatshmërinë e Kapitalit për Bankat

<sup>23</sup> Norma e supozuar e rritjes së NPL-ve është përcaktuar duke marrë për bazë normën mesatare të rritjes ekonomike në Kosovë në vitet e fundit, supozimin për rënien ekonomike dhe koeficientin e elasticitetit të NPL-ve ndaj hendekut të prodhimit, që është bazuar në një analizë të papublikuar të FMN-së "CESE Bank Loss Projection and Stress Testing Exercise", Korrik 2010.

milione euro (1.1 përqind të PBB-së). Megjithatë, jo e tëra kjo vlerë mund të konsiderohet si humbje eventuale me që duhet të merret parasysh fakti se një pjesë e madhe e kësaj humbje do të absorbohej nga profiti i pritur për periudhën e konsideruar.

## Rreziku i likuiditetit.

### Metodologjia

Analiza e rrezikut të likuiditetit mbështetet në skenarin e tërheqjes së një vlere më të theksuar të depozitave nga sistemi bankar dhe matë aftësinë e sistemit që të përballojë një tronditje të tillë. Në këtë analizë është konsideruar tërheqja e depozitave përgjatë një periudhe pesë ditore, duke mos marrë parasysh mundësinë e qasjes së bankave në financim nga jashtë. Skenari mbi rrezikun e likuiditetit është bazuar në një supozim mjaft konservativ: tërheqje të depozitave me një normë prej 10 përqind të gjithsej depozitave në baza ditore përgjatë një periudhë pesë ditore. Skenari po ashtu është ndërtuar mbi supozimin se gjatë kësaj periudhe mundësia e konvertimit të mjeteve likuide në para të gatshme do të ishte 80 përqind e mjeteve likuide, përderisa mundësia e konvertimit të mjeteve jolikuide në para të gatshme do të ishte vetëm një përqind e këtyre mjeteve brenda ditës. Gjithashtu është supozuar se bankat kanë qasje të plotë në rezervat e tyre, ndërsa nuk është marrë parasysh mundësia e financimit të bankave përmes burimeve të jashtme të financimit.

Qëndrueshmëria e sistemit bankar në këtë analizë është testuar në kuptim të vlerësimit të mjaftueshmërisë së aseteve likuide të bankave për të përballuar një tërheqje të tillë të depozitave.

### Rezultatet

Gjendja ekzistuese e sistemit bankar për sa i përket nivelit të likuiditetit konsiderohet të jetë mjaft e favorshme. Në fund të vitit 2012, Asetet themelore (core) likuide dhe ato gjithëpërfshirëse (broad) përbenin 25.3 përqind, përkatësisht 32.5 përqind të gjithsej aseteve të sistemit bankar.

**Tabela 6. Përmbledhje e rezultateve të stress-testit: Rreziku i likuiditetit**

Përshkrimi	Numri i bankave 1/	Mjete likuide shtesë të nevojshme (mijëra euro)	Raporti kredi/depozita (përqindje)
Pas ditës së parë	0	0	85.5
Pas ditës së dytë	0	0	95.0
Pas ditës së tretë	1	161	105.5
Pas ditës së katërt	2	21,690	117.2
Pas ditës së pestë	4	73,574	130.3

Shënim:1/ Numri i bankave të cilat do të kishin nevojë për mjete likuide shtesë.

Burimi: BQK (2013)

Nën supozimin e skenarit të tërheqjes së vazhdueshme pesë-ditore të depozitave, rezultat e stress-testit sugjerojnë se sistemi bankar i Kosovës paraqitet të ketë nivel të kënaqshëm të qëndrueshmërisë edhe në rast se do të paraqiteshin norma më të larta të tërheqjes së depozitave. Nën supozimin hipotetik të tërheqjes së depozitave në mënyrë të vazhdueshme për pesë ditë me radhë me normën e supozuar më lartë, problemet e para të likuiditetit në banka fillojnë të shfaqen vetëm pas ditës së tretë, dhe atë në njërin prej bankave. Niveli i tërheqjes së depozitave nga secila bankë është konsideruar të jetë 10 përqind e gjithsej depozitave të tyre. Siç shihet në tabelën 1, pas ditës së tretë, shuma e mjeteve likuide shtesë për bankën e afektuar do të ishte vetëm 161 mijë euro (0.003 përqind e PBB-së). Përderisa, raporti kredi/depozita do të arrinte në

85.5 përqind (duke supozuar se niveli i kredive nuk do të vazhdonte të rritej gjatë kësaj periudhe).

Pas ditës së katërt, vetëm dy nga tetë bankat që operojnë në Kosovë, do të kishin nevojë për mjete shtesë në vlerë prej 21.6 milionë euro (0.43 përqind e PBB-së). Pas ciklit pesë-ditor të tërheqjes së depozitave, numri i bankave të cilat shfaqeshin problemet e likuiditetit do të mbetej në katër, përderisa vlera e mjeteve likuide shtesë do të arrinte në 73.5 milionë euro (1.47 përqind e PBB-së). Në këtë fazë, nën supozimin se vlera e kredive nuk ndryshon, raporti kredi/depozita do të arrinte në 130.3 përqind në nivel të sistemit bankar. Andaj, mund të konstatohet se edhe në rast se skenarët e lartpërmendur do të shfaqeshin në praktikë, sistemi bankar do të tregonte një qëndrueshmëri mjaft të lartë kundrejt rrezikut të likuiditetit.

### 3.3.3 Fondet pensionale


Ndër sistemet me rritjen më të konsiderueshme në kuadër të sektorit financiar ishte sistemi i fondeve pensionale të Kosovës, asetet e së cilit në vitin 2012 arritën vlerën prej 745 milionë dhe regjistruan rritje prej 15.9 përqind (19.5 përqind në vitin 2011). Njëherit, sistemi pensional i Kosovës përfaqëson edhe sistemin e dytë më të madh në sektorin financiar me pjesëmarrje prej 19.5 përqind (15.3 përqind e PBB-së). Pjesa kryesore e aseteve të sistemit pensional menaxhohet nga Trusti i Kursimeve Pensionale të Kosovës (TKPK), ndërsa pjesa prej 0.7 përqind e gjithsej aseteve të sistemit pensional i takon Fondit Sllovenoko-sosvar të Pensioneve (FSKP).

Gjatë vitit 2012, performanca e TKPK-së u konsiderua si e suksesshme duke marrë parasysh se u realizua kthim vjetor pozitiv nga investimet në vlerë prej 54 milionë eurosh. Kjo për arsye se vlera e çmimit të aksionit në dhjetor të vitit 2012 arriti në 1.117 euro dhe shënoi rritje vjetore prej 8 përqind (1.0347 euro në dhjetor 2011). Gjithsesi, kthimi pozitiv i investimeve të TKPK-së më shumë reflekton zhvillimet pozitive të pjesës së dytë të vitit 2012.

Kthimi pozitiv në mjetet e investuara nga TKPK gjatë vitit 2012 reflekton përmirësimin e performancës së tregjeve ndërkombëtare të aksioneve, ku edhe janë të investuara pjesa më e madhe e mjeteve të TKPK-së. Në rritjen e besueshmërisë në tregjet globale financiare, e rrjedhimisht edhe në performancën e tyre, ndër tjerash, veçanërisht ka ndikuar edhe përkushtimi i vendeve të BE-së dhe institucioneve ndërkombëtare financiare në shpëtimin e vendeve me probleme të borxhit publik. Sidoqoftë, përkundër rritjes së çmimit të aksionit, vlera e çmimit të aksionit të TKPK-së akoma nuk është kthyer në nivelet të cilat ishte para krizës globale financiare. Ndërsa, vlera e aseteve nën menaxhimin e TKPK-së, në vitin 2012 u rrit për 152 milionë euro më shumë, që paraqet rritjen më të lartë që prej themelimit të TKPK-së. Rritja e mjeteve nën menaxhimin e TKPK-së erdhi si rezultat i rritjes së kontributeve të paguara gjatë këtij viti.

Në anën tjetër, zhvillimet në FSKP-në në vitin 2012 ishin konsistente me ato të një viti më parë, meqë asetet e menaxhuara qëndruan në nivel të njëjtë prej 4.9 milionë euro.

Figura 63. Struktura e investimeve të trustit



Burimi: BQK (2013)

Sa i përket strukturës së investimeve të TKPK-së, 42 përqind e të gjitha mjeteve të investuara ishin të koncentruara në tregun e aksioneve, të cilat karakterizohen si investime me rrezik relativisht më të lartë por edhe me kthim më të lartë (Figura 63). Pjesa e mbetur e mjeteve të TKPK-së kryesisht është plasuar në investime me kthime të sigurta. Për shembull, 25.7 përqind të investimeve të TKPK-së gjatë vitit 2012 ishin të investuara në bono të qeverive të huaja, dhe bono të lidhura me inflacion, rreth 2.9 përqind në tregun e kredive, ndërsa investimet në bankat lokale në Kosovë kishin pjesëmarrje prej 4.3 përqind. Vlenë të ceket se në vitin 2012, TKPK për herë të parë ka investuar 14 milionë euro (0.2 përqind e gjithsej mjeteve të investuara) në letrat me vlerë të Qeverisë së Kosovës.

Në anën tjetër, struktura e aseteve të FSKP-së gjatë vitit 2012 ishte e dominuar nga investimet në fletëobligacione e më pak nga investimet në depozita, aksione dhe para të gatshme.

### 3.3.4 Kompanitë e sigurimit


Industria e sigurimeve paraqet një nga sistemet e sektorit financiar që gjatë vitit 2012 u karakterizua me zgjerim. Megjithatë, pjesëmarrja e këtij sistemi në gjithsej asetet e sektorit është relativisht e ulët dhe zë vetëm 3.4 përqind. Prej gjithsej 13 kompanive të sigurimit që operuan në Kosovë gjatë vitit 2012, 10 ofruan sigurime jojetë, ndërsa 3 tjera ofruan edhe sigurime jetësore. Struktura e pronësisë së kompanive të sigurimit ishte e ngjashme me atë të një viti më parë, ku 10 kompani janë me pronësi të huaj dhe 3 tjera janë me pronësi vendore.

Relacion i ngjashëm karakterizon edhe strukturën e aseteve sipas pronësisë, ku rreth 77 përqind e aseteve menaxhohen nga kompanitë e huaja, ndërsa pjesa tjetër e aseteve menaxhohet nga kompanitë vendore.

Tregu i kompanive të sigurimit vazhdimisht është karakterizuar me një shkallë më të ulët të koncentrimit në treg, në krahasim me bankat apo institucionet mikrofinanciare. Megjithatë, gjatë vitit 2012, koncentrimi i aseteve të tri kompanive më të mëdha të sigurimit është rritur në 34.3 përqind të gjithsej aseteve (32.3 përqind në vitin 2011 (Figura 64). Lëvizje e ngjashme në tregun e sigurimeve sugjerohet edhe përmes indeksit Herfiendahl-Hirschman (HHI), i cili tregon se shkalla e koncentrimit në vitin 2012 është rritur në 937.7 pikë, krahasuar me 882.3 pikë në vitin 2011. Kjo për arsye se tri kompanitë më të mëdha të sigurimit kanë rritur ndjeshëm vlerën e aseteve gjatë vitit 2012.


Gjithsej asetet e kompanive të sigurimit në vitin 2012 arritën vlerën prej 130.8 milionë euro dhe shënuan rritje prej 16.3 përqind. Struktura e aseteve të kompanive të sigurimit dominohet nga

Figura 64. Asetet e kompanive të sigurimit, në milionë euro



Burimi: BQK (2013)

Figura 65. Struktura e aseteve të kompanive të sigurimit



Burimi: BQK (2013)

depozitat, me pjesëmarrje prej 58.6 përqind të gjithsej asetëve (56.1 përqind në vitin 2011), (Figura 65).

Në anën e detyrimeve, kapitali vetanak dhe rezervat teknike përfaqësojnë kategoritë më të mëdha, me pjesëmarrje prej 35.4 përqind, përkatësisht 34.4 përqind të gjithsej asetëve (Figura 66). Një kategori më e vogël, por në rritje, janë edhe kreditë e huazuara nga kompanitë e sigurimit, të cilat në vitin 2012 dyfishuan vlerën në 7.2 milionë dhe kishin pjesëmarrje prej 5.5 përqind. Kreditë e kompanive të sigurimit kryesisht janë kredi të huazuara nga bankat vendore.


Raporti ndërmjet kapitalit dhe asetëve, që shprehë nivelin e kapitalizimit të kompanive të sigurimit, në vitin 2012 u zvogëluua në 35.4 përqind, krahasuar me 41.2 përqind sa ishte në vitin 2011. Zvogëlimi i këtij raporti erdhi si pasojë e zvogëlimit të kapitalit vetanak për 0.4 përqind, si dhe rritjes së vlerës së asetëve në vitin 2012. Ndërsa, raporti ndërmjet të kapitalit vetanak dhe rezervave teknike, që tregon aftësinë e kompanive të sigurimit për të përballuar humbjet potenciale, u zvogëluua në 66.1 përqind, krahasuar me 85 përqind në vitin 2011.<sup>24</sup> Ky raport u zvogëluua për shkak të rritjes më të shpejtë të rezervave teknike (28 përqind rritje vjetore).

Përkundër zgjerimit të asetëve të kompanive të sigurimit, në vitin 2012 industria e sigurimeve përmbylli periudhën raportuese me humbje neto prej 2.3 milionë euro. Përmbyllja e vitit me fitim negativ ndikoi edhe në përkeqësimin e dy indikatorëve të performancës, përkatësisht në Kthimin Mesatar në Asete (angl. Return on Average Assets: ROAA) dhe Kthimin Mesatar në Kapital (angl. Return on Average Equity: ROAE). Indikator ROAA në vitin 2012 qëndroi në -1.9 përqind, krahasuar me 0.9 përqind në vitin 2011, ndërsa indikator ROAE në vitin 2012 ishte -4.7 përqind, krahasuar me 2.2 përqind një vit më parë.

Deri në fund të vitit 2012, numri i policave të shitura nga kompanitë e sigurimit që operojnë në Kosovë arriti në 757.2 mijë polica, që paraqet një rritje vjetore prej 25.1 përqind, krahasuar me numrin e policave të shitura një vit më parë. Ndërsa, vlera e primeve të pranuar nga policat e shitura, në vitin 2012 arriti në 81.5 milionë euro, duke shënuar rritje vjetore prej 4.4 përqind (Figura 67). Në rritjen e primeve të pranuar kryesisht kontribuuan policat kufitare.


Në anën tjetër, vlera e dëmeve të paguara nga kompanitë e sigurimit u karakterizua me rritje më të shpejtë vjetore prej 14.1 përqind (1.1 përqind në vitin 2011). Rrjedhimisht, edhe raporti

Figura 66. Struktura e detyrimeve të kompanive të sigurimit



Burimi: BQK (2013)

Figure 67. Primet e pranuar dhe dëmet e paguara, në milionë euro



Burimi: BQK (2013)

<sup>24</sup> Rezervat teknike janë të nevojshme për të siguruar pëmbushjen e përhershme të detyrimeve të kompanive të sigurimit ndaj të siguruarve deri në skadim të marrëveshjes së sigurimit.


ndërmjet dëmeve të paguara dhe primeve të pranuar në vitin 2012 u rrit në 38 përqind, krahasuar me 34 përqind sa ishte në vitin 2011.

Aktiviteti i kompanive të sigurimit në Kosovë, bazohet në një model relativisht të thjeshtë, i cili koncentrohet në ofrimin e policave të sigurimit jovullnetar. Pjesa më e madhe e sigurimeve jovullnetare përbëhet nga policat e sigurimit të palës së tretë (*angl. Third Party Liability: TPL*), me pjesëmarrje prej 54.2 përqind të gjithsej primeve të pranuar (Figura 69). Vlera e primeve të pranuar nga TPL-të në vitin 2012 arriti në 44.1 milionë dhe u zvogëlua për 3.4 përqind. Pjesë e rëndësishme e policave të sigurimit jovullnetar janë edhe policat kufitare, të cilat përfaqësojnë 18.1 përqind të gjithsej primeve të pranuar. Primet e pranuar nga policat kufitare shënuan rritje të konsiderueshme prej 52.6 përqind, duke arritur vlerën prej 14.7 milionë euro.<sup>25</sup>

Një pjesë e rëndësishme e primeve të pranuar përbëhet edhe nga policat vullnetare, vlera e së cilave në vitet e fundit ka qëndruar në nivel të njëjtë, prej rreth 20 milionë eurosh. Në policat vullnetare bëjnë pjesë sigurimet shëndetësore, sigurimet kasko, sigurimet e pasurisë, etj.


Në kuadër të dëmeve të paguara, pagesat për TPL gjithashtu zënë pjesën dominuese, me pjesëmarrje prej 61.9 përqind (Figura 69). Në vitin 2012 vërehet përmirësim në pagesat e policave TPL, duke marrë parasysh rritjen vjetore prej 5.2 përqind, si dhe faktin se një vit më parë pagesat për këto polica ishin zvogëluar për 6.2 përqind. Dëmet e paguara për policat kufitare arritën vlerën prej 1.1 milionë euro, që paraqet një nivel të ngjashëm me vitet paraprake. Gjithsesi, pagesat për këto polica kanë një pjesëmarrje relativisht të vogël në gjithsej dëmet e paguara, prej 3.7 përqind. Në vitin 2012, me rritje prej 33.8 përqind u karakterizuan edhe dëmet e paguara për policat vullnetare, duke arritur vlerën prej 10.5 milionë euro.

Figura 68. Asetet e IMF-ve, në milionë euro



Burimi: BQK (2013)

Figura 69. Struktura e primeve të pranuar të kompanive të sigurimit



Burimi: BQK (2013)

### 3.3.5 Institucionet mikrofinanciare dhe ndihmësit financiar

Në vitin 2012 në industrinë mikrofinanciare operuan gjithsej 18 institucione mikrofinanciare (IMF) dhe 38 ndihmës financiarë. Gjatë vitit 2012 i është revokuar licenca dy IMF-ve: 'Agro Invest' dhe 'Fund Way Mortgages', ndërsa IMF të reja nuk kanë hyrë të tregun mikrofinanciar. Sa i përket strukturës së pronësisë, dy IMF janë institucione të themeluara me kapital vendor, një IMF është themeluar me kapital vendor dhe të huaj, ndërsa pjesa tjetër e IMF-ve janë institucione të huaja.

<sup>25</sup> Rritja e primeve të pranuar si dhe dëmeve të paguara për policat kufitare gjatë vitit 2012 erdhi si rrjedhojë e marrëveshjes për menaxhimin e integruar të kufirit mes Kosovës dhe Serbisë (*angl. Integrated Border Management: IBM*).

Përkundër faktit se industria mikrofinanciare vazhdimisht është karakterizuar me shkallë të lartë të koncentrimit, vitet e fundit trendi i koncentrimit në treg ka rënë në mënyrë të njëpasnjëshme. Rënia e shkallës së koncentrimit në këtë industri tregon për përmirësimin e konkurrueshmërisë në këtë industri, në radhë të parë sepse shumica e IMF-ve më të vogla vazhdimisht kanë rritur pjesëmarrjen në treg, mirëpo edhe si pasojë e zvogëlimit të aseteve të tri IMF-ve më të mëdha. Siç mund të vërehet në figurën 9, në vitin 2012 shkalla e koncentrimit të tri IMF-ve më të mëdha ka rënë në 45 përqind (49 përqind në vitin 2011), ndërsa pjesa e mbetur prej 45 përqind i takoi IMF-ve tjera bashkërisht. Po ashtu, Indeksi Herfindahl-Hirschman, si një matës i shkallës së koncentrimit në treg, tregon për rënie të shkallës së koncentrimit në 1,138 pikë, krahasuar me 1,293 pikë në vitin e kaluar.

Infrastruktura e industrisë mikrofinanciare u karakterizua me një trend ngadalësues. Numri i degëve të IMF-ve filloi me 119 degë në janar dhe u zvogëlua në 111 degë në dhjetor të vitit 2012. Numri i të punësuarve në IMF gjatë vitit 2012 u karakterizua me lëvizje të ngjashme, ku në janar të vitit 2012 kjo industri regjistroi gjithsej 934 punëtorë, ndërsa në dhjetor të vitit 2012 numri i punëtorëve u zvogëlua në 904.


### 3.3.5.1 Bilanci i gjendjes së institucioneve mikrofinanciare

Bashkë me zvogëlimin e numrit të pjesëmarrësve në industrinë mikrofinanciare, edhe vlera e aseteve në dy vitet e fundit ka shënuar rënie prej 5 përqind, përkatësisht 4.6 përqind (Figura 70). Ndryshe, vlera e aseteve të IMF-ve në vitin 2012 ishte 115.8 milionë euro (rreth 2.4 përqind e PBB-së), krahasuar me 121.9 milionë euro në vitin 2011.

Në zvogëlimin e aseteve të IMF-ve më së shumti kontribuuan kreditë e lëshuara me 7.7 pp.


Në kuadër të aseteve të IMF-ve, kreditë përfaqësojnë kategorinë më të rëndësishme, me pjesëmarrje prej 66.9 përqind (71.3 përqind në vitin 2011), (Figura 71). Megjithatë, gjatë katër viteve të fundit vërehet se pjesëmarrja e kredive në gjithsej asetet e IMF-ve ka shënuar rënie dhe kjo për arsye se IMF-të kanë zhvilluar edhe produkte tjera, siç është lizingu. Pjesëmarrja e kredive me lizing u rrit për 3.6pp në vitin 2012, apo 18 përqind në gjithsej asetet e IMF-ve. Përkundër faktit se kreditë me lizing ofrohen vetëm nga dy IMF në treg, që nga viti 2009 kur për herë të parë edhe filloi funksionalizimi i tyre, kreditë me lizing vazhdimisht kanë shënuar trend rritës. Vlera e kredive me lizing në vitin 2012 arriti në 20.8 milionë euro dhe regjistroi rritje prej 19.1 përqind (62 përqind rritje në vitin 2011).

Figura 70. Asetet e IMF-ve dhe rritja vjetore



Burimi: BQK (2013)

Figura 71. Struktura e aseteve të IMF-ve



Burimi: BQK (2013)

Paraja e gatshme dhe bilanci në BQK paraqesin kategorinë e tretë më të rëndësishme në kuadër të IMF-ve, e cila zvogëloi pjesëmarrjen në 8.1 përqind (11.9 përqind në vitin 2011). Vlera e kësaj kategorie po ashtu u zvogëlua në 9.4 milionë euro (14.5 milionë në vitin 2012). Dy kategori tjera me pjesëmarrje më të vogël janë edhe asetet fikse dhe asetet tjera, me pjesëmarrje prej 4.4 përqind, përkatësisht 2.5 përqind. Në kuadër të aseteve të IMF-ve, investimet në letra me vlerë mbeten si një instrument akoma i pazhvilluar në industrinë mikrofinanciare.


### 3.3.5.2 Kreditë e institucioneve mikrofinanciare

Siç vërehet në figurën 72, vlera e kredive të lëshuara nga IMF-të ka shënuar trend rënës në vitet e fundit. Vlera e kredive të IMF-ve në vitin 2012 arriti në 77.5 milionë euro dhe u zvogëlua për 10.8 përqind (18 përqind rënie në vitin 2011). Njëherit, edhe numri i kredive aktive gjatë vitit 2012 u zvogëlua për 8.1 përqind, apo nga 57,536 kredi në vitin 2011, u zvogëluan në 52,885 kredi në vitin 2012.

Një nga arsyet shtrëngimit të kredidhënies nga IMF-të vjen nga vetë fakti i mbylljes së dy IMF-ve gjatë vitit 2012. Në anën tjetër, zvogëlimi i kredive të lëshuara nga IMF-të gjatë vitit 2012 pjesërisht është edhe rrjedhë e vështirësimit të kushteve të financimit për këto institucione nga tregjet e jashtme. Kjo për arsye se IMF-të që operojnë në Kosovë për burim kryesor të financimit kanë linjat kreditore nga tregjet e jashtme, sepse sipas legjislacionit depozitave, përveç në formë të garancioneve për marrjen e kredive. Gjithashtu, duke marrë parasysh edhe ngadalësimin e rritjes ekonomike në vend, edhe kërkesa për kreditë e IMF-ve mund të ketë rënë.

Aktiviteti i IMF-ve në Kosovë kryesisht përqendrohet në financimin e ekonomive familjare dhe bizneseve të vogla. Ndryshe nga bankat komerciale, ku kreditë e ndërmarrjeve dominojnë strukturën e kredive, në rastin e IMF-ve kreditë e lëshuara për ekonomitë familjare zënë pjesën kryesore të kredive të IMF-ve me pjesëmarrje prej 64 përqind (Figura 73). Në nga arsyet e kësaj strukture të kredive qëndron në faktin se institucionet mikrofinanciare kryesisht ofrojnë kredi më të vogla në vëllim, që

Figura 72. Struktura e kredive të IMF-ve, në




■ Ekonomitë familjare ■ Ndërmarrjet

Burimi: BQK (2013)

18 përqind rënie në vitin 2011). Njëherit, edhe numri i


Figura 73. Trendi i rritjes së kredive të IMF-ve, në përqindje



Burimi: BQK (2013)

në fuqi IMF-të nuk kanë të drejtën e pranimit të

Figura 74. Struktura e kredive të IMF-ve sipas sektorëve



Burimi: BQK (2013)

destinohen për nevoja konsumuese të ekonomive familjare. Gjithashtu, kapaciteti i kredive të vogla jo domosdo përmbush nevojat financuese të ndërmarrjeve.

Vlera e kredive të destinuara për ndërmarrje në vitin 2012 arriti në 27.9 milionë euro. Pjesa më e madhe e këtyre kredive në vitin 2012 u lëshuan për sektorin e shërbimeve (44.7 përqind), dhe atë 17.2 përqind vetëm për sektorin e tregtisë. Sektori i bujqësisë përkrahet nga IMF-të më shumë se nga bankat, duke marrë parasysh se 28.8 përqind të gjithsej kredive për ndërmarrjet destinuan për këtë sektor. Një pjesë të konsiderueshme të kredive për ndërmarrjet gjithashtu zënë edhe kreditë për ndërtimtari (19 përqind) dhe ato industriale (7.5 përqind), (Figura 74). Në kuadër të kredive për ndërmarrje, vlera maksimale e një kredie të re të lëshuar gjatë vitit 2012 ishte 1.2 milionë euro, ndërsa vlera maksimale e një kredie të lëshuar për ekonomitë familjare ishte 1.7 milionë euro.

Sa i përket shpërndarjes së numrit të gjithsej kredive të lëshuara nga IMF-të, vlera minimale e një kredie të lëshuar gjatë vitit 2012 ishte 100 euro, ndërsa vlera maksimale e një kredie të lëshuar nga IMF-të ishte 358,267 euro. Vlera mesatare e një kredie të lëshuar gjatë vitit 2012 ishte 1,869.6 euro, krahasuar me 1,829.1 euro në vitin 2011.

**Tabela 7. Shpërndarja e kredive të IMF-ve në intervale, sipas vlerave dhe numrit**


Kreditë e IMF-ve	2012			
	0 ≤ 5,000	5001 ≤ 10,000	10,001 ≤ 25,000	> 25,000
Vlera (në milionë euro)	48.8	7.1	4.8	12.1
Numri i kredive	31,879	905	290	194

Burimi: BQK (2013)

Në tabelën 1, kreditë e lëshuara nga IMF-të në vitin 2012 janë ndarë në 4 intervale: kreditë me vlerë 0 – 5,000 euro, 5,001 – 10,000, 10,001 – 25,000 dhe kreditë me vlerë mbi 25,001 euro. Siç mund të vërehet në tabelën 1, kreditë me vlera më të vogla të cilat shpërndahen në intervalin prej 0 deri në 5,000 euro, janë kreditë që lëshohen më shpesh nga IMF-të. Kreditë e lëshuara deri në vlerën 5,000 euro kanë pjesëmarrje prej 67.1 përqind të gjithsej shumës së kredive të lëshuara gjatë vitit 2012. Gjithashtu, numri i kredive të lëshuara për këtë interval dominon numrin e gjithsej kredive të lëshuara nga IMF-të, që konfirmon edhe natyrën e ndërmjetësimit të kësaj industrie. Në intervalin e kredive 5,001 deri në 10,000 euro janë lëshuar gjithsej kredi me vlerë prej 7.1 milionë euro, ndërsa numri i kredive në këtë interval ishte 290 kredi. Pjesa më e vogël e kredive të lëshuara nga IMF-të janë kreditë me vlera të mëdha, përkatësisht kreditë mbi 25,000 euro, prej të cilave në vitin 2012 janë lëshuar 194 kredi.

Struktura e kredive të IMF-ve sipas maturitetit kryesisht dominohet nga kreditë me afat maturimi të shkurtë dhe të mesëm. Kreditë afatmesme, që maturojnë në periudhë prej 1 deri në 5 vite dominojnë strukturën e kredive sipas maturitetit me pjesëmarrje prej 77.8 përqind (Figura 75). Kreditë afatshkurte, deri në 1 vit gjithashtu përbëjnë një pjesë të konsiderueshme të kredive

**Figura 75. Struktura e kredive të IMF-ve sipas maturitetit**



Burimi: BQK (2013)

me pjesëmarrje prej 21.6 përqind. Ndërsa, kreditë me maturitet mbi 5 vite hasen më rrallë në rastin e IMF-ve, të cilat në vitin 2012 përbënin vetëm 0.6 përqind të gjithsej kredive.

### 3.3.5.3 Detyrimet e institucioneve mikrofinanciare


Pjesa kryesore e detyrimeve të institucioneve mikrofinanciare përbëhet nga obligimet siç janë llogaritë e pagueshme. Llogaritë e pagueshme në vitin 2012 regjistruan vlerën prej 84.6 milionë euro, me një pjesëmarrje prej 54.6 përqind të gjithsej detyrimeve. Në kuadër të kësaj kategorie kryesisht bëjnë pjesë depozitat e sektorit financiar, ndërmarrjeve, klientëve etj., të cilat kanë natyrë garantuese dhe bashkë me maturimin e kredisë iu kthehen klientëve, meqë sipas ligjit për IMF, këto institucione nuk kanë të drejtë të mbajnë depozita të klientëve.<sup>26</sup> Pjesë e rëndësishme e detyrimeve të institucioneve mikrofinanciare është edhe kapitali vetanak. Në tri vitet e mëparshme, kapitali vetanak i IMF-ve kryesisht ka qëndruar në një nivel të qëndrueshëm. Megjithatë, në vitin 2012 vlera e kapitali vetanak arriti në 31.2 milionë euro dhe regjistroi rënie prej 20.2 përqind. Në zvogëlimin e kapitalit vetanak kryesisht ka ndikuar bilanci negativ mes të hyrave dhe shpenzimeve të vitit 2012, prej 4.5 milionë euro. Pjesa kryesore e kapitalit vetanak përbëhet nga kapitali aksionar (57.4 përqind).

### 3.3.5.4 Normat e interesit të institucioneve mikrofinanciare

Normat mesatare të interesit në kreditë e lëshuara nga institucionet financiare, kryesisht karakterizohen me një nivel relativisht më të lartë, krahasuar me normat mesatare në kreditë e lëshuara nga bankat. Një nga faktorët që ndikojnë në norma më të larta të interesit në kreditë e IMF-ve qëndron në faktin se IMF-të nuk e kanë të drejtën e pranimit të depozitave nga qytetarët, dhe rrjedhimisht IMF-të drejtohen në kërkimin e fondeve tjera financuese, si institucione ndërkombëtare financiare, tregje të kapitalit apo edhe banka lokale, të cilat kanë norma të larta huazuese. Gjithashtu, një pjesë e konsiderueshme kredive të IMF-ve destinohen për sektorë ekonomikë që konsiderohen me rrezikshmëri më të lartë, siç është sektori i bujqësisë. Po ashtu, kërkesat për kolateral, garancione etj., dhe në përgjithësi procedurat më të lehta për kredimarrje mund të arsyetojnë normat më të larta të interesit në kredi, si mbulesë për rrezikun e moskthimit të kredive.

Norma mesatare e interesit në kreditë e IMF-ve në vitin 2012 ishte 23.47 përqind. Megjithatë, nëse përcillet trendi i normave mujore të interesit, vërehet se normat e interesit kanë pësuar ndryshim gjatë vitit 2012. Për shembull, në periudhën janar-mars, normat e interesit në kredi qëndruan në një nivel jo shumë të ndryshueshëm. Megjithatë, prej muajit maj deri në muajin korrik kur edhe u shënuar norma më ulët e interesit prej 21.73 përqind, vërehet një rënie e njëpasnjëshme e kamatave (Figura 76). Një nga arsytet e rënies së normave të interesit në këtë periudhë janë edhe faktorët sezonal, si rritja e dërgesa të emigrantëve apo rritja e të ardhurave të ekonomive familjare nga burimet e tjera përveç kredisë, gjë që ka mundur të ndikojë edhe në uljen e kërkesës për kredi të IMF-ve. Rënia e kërkesës për kredi të IMF-ve në këtë periudhë mund të konfirmohet edhe nga numri i kredive të reja, të cilat nga muaji qershor në muajin

Figura 76. Normat e interesit në kreditë e IMF-ve



Burimi: BQK (2013)

<sup>26</sup> Sipas ligjit për IMF Nr. 04/L-093, neni 91.6, institucionet mikrofinanciare nuk mund të angazhohen në mbledhjen e depozitave që kalojnë shumën prej 50 përqind të suficitit të kapitalit të tij ose shumën maksimale prej 125,000 euro

korrik u zvogëluan për 14.5 përqind (2.6 përqind rënie në muajin qershor krahasuar me muajin maj). Prej muajit gusht e tutje, normat e interesit përsëri kthehen në nivelet e mëparshme.

Sipas afatit të maturimit, normat më të larta të interesit u regjistruan në kreditë me afat maturimi deri në 1 vit, me një mesatare prej 24.78 përqind për vitin 2012. Norma më e lartë e kredisë në kuadër të kredive me afat maturimi të shkurtër ishte 29.34 përqind, ndërsa norma më e ulët e interesit në këto kredi ishte 25.88 përqind. Norma mesatare e interesit në kreditë me afat maturimi prej 1 deri në 5 vite ishte 23.49 përqind, ku norma më e lartë që u evidentua ishte 28.57 përqind, ndërsa norma më e ulët ishte 24.53 përqind.

Sipas qëllimit të shfrytëzimit, normat e interesit në kreditë e ekonomive familjare gjatë vitit 2012 ishin relativisht më të larta se normat e interesit në kreditë e ndërmarrjeve. Në kuadër të kredive për ekonomitë familjare, normat më të larta të interesit u evidentuan te kreditë për qëllime konsumi, e pastaj te ato për qëllime investuese. Normat më të larta e interesit te kreditë konsumuese që u regjistruan gjatë vitit 2012 ishte 29.34 përqind, ndërsa norma më e ulët ishte 21.66 përqind. Norma mesatare e interesit në kreditë investuese ishte 25.13 përqind. Gjatë vitit 2012, normat e interesit në kreditë investuese të ekonomive familjare u karakterizuan me normat më të ulëta, mesatarisht, prej 24.84 përqind. Sa i përket kredive për ndërmarrjet, kreditë për qëllime investuese u karakterizuan me norma relativisht më të larta, mesatarja e së cilave gjatë vitit 2012 ishte 21.96 përqind. Norma mesatare e interesit në kreditë për qëllime investuese u karakterizuan me norma mesatare të interesit prej 20.8 përqind gjatë vitit 2012.


### 3.3.5.5 Performanca e institucioneve mikrofinanciare

Industria mikrofinanciare në vitin 2012 përmbylli periudhën raportuese me bilanc negativ mes të hyrave dhe shpenzimeve. Një nga arsyet e performancës negative ishin rritja e shpenzimeve të jointeredit si dhe mungesa e efikasitetit në menaxhimin e shpenzimeve të personelit.

Në vitin 2012, institucionet mikrofinanciare shënuan humbje prej 4.5 milionë euro. Të hyrat e IMF-ve në vitin 2012 shënuan vlerën prej 20.8 milionë euro, përderisa shpenzimet ishin 25.3 milionë euro. Siç mund të vërehet në figurën 77, shpenzimet e IMF-ve gjatë vitit 2012 vazhdimisht kanë qëndruar në nivele më të larta se sa të hyrat e IMF-ve. Rrjedhimisht, edhe raporti ndërmjet shpenzimeve dhe të hyrave të IMF-ve, në fund të vitit 2012 qëndroi në 121.6 përqind.

Sa i përket strukturës së të hyrave të IMF-ve, në vitin 2012 këto të hyra u dominuan nga të hyrat e interesit, përkatësisht, të hyrat nga interesi në kredi, që paraqesin edhe burimin kryesor të të hyrave për IMF-të (Figura 77). Të hyrat nga interesi në kredi në vitin 2012 kishin një pjesëmarrje prej 82.8 përqind. Pjesa e mbetur e të hyrave që gjenerohen nga IMF-të përbëhen nga të hyrat e jointeredit, ku pjesa kryesore përbëhet nga të hyrat tjera operuese (12.4 përqind e gjithsej të hyrave të IMF-ve). Dy kategori tjera me pjesëmarrje më të vogël në të hyrat e IMF-ve janë të hyrat nga administrata (4 përqind) dhe të hyrat nga shërbimet (0.9 përqind).


Figura 77. Raporti shpenzime/të hyra, të dhëna jo kumulative



Burimi: BQK (2013)

Ndryshe nga struktura e të hyrave të bankave, struktura e shpenzimeve të IMF-ve dominohet nga shpenzimet e jointeredit, përkatësisht ato administrative, të cilat kanë pjesëmarrje prej 49.3 përqind të gjithsej shpenzimeve (Figura 78). Pjesëmarrja relativisht e lartë e shpenzimeve administrative mund të jetë pasojë e mungesës së efikasitetit të IMF-të krahasuar me bankat komerciale, kryesisht për shkak të natyrës së institucioneve mikrofinanciare që operojnë si organizata joqeveritare. Në kuadër të shpenzimeve të jointeredit edhe shpenzimet për provizione gjithashtu kanë një pjesëmarrje të konsiderueshme prej 20.1 përqind. Duke marrë parasysh se institucionet mikrofinanciare sipas definicionit nuk përfaqësojnë institucione depozituese, shpenzimet e interesit përbëjnë një pjesë më të vogël të gjithsej shpenzimeve, prej 18.6 përqind. Në shpenzimet e interesit të IMF-ve kryesisht bëjnë pjesë pagesat e interesit në fondet e huazuara nga institucionet financiare ndërkombëtare apo tregjet e kapitalit si EFSE, BERZH, Blueorchard, Credit Swiss, etj.

Figura 78. Struktura e shpenzimeve sipas kategorive, në përqindje



Burimi: BQK (2013)

Tabela 8. Indikatorët e profitabilitetit dhe efikasitetit të IMF-ve

Treguesit	ROAA	ROAE	Asete/nr. Punëtorëve	Profiti/nr. Punëtorëve	Numri i kredive/nr. Punëtorëve	NIM
Rezultati në vitin 2012	-3.7%	-14%	128,097.3	4,977.9 euro	44.5	14.5%

Burimi: BQK (2013)

Bilanci negativ mes të hyrave dhe shpenzimeve në vitin 2012, bashkë me zvogëlimin e aseteve dhe mjeteve vetanake (kapitalit vetanak) ndikuan edhe në përkeqësimin e indikatorëve të profitabilitetit të IMF-ve, si Kthimi Mesatar në Asete (angl. Return on Average Assets: ROAA) dhe Kthimin Mesatar në Kapital (angl. Return on Average Equity: ROAE). Në vitin 2012, indikator ROAA shënoi rënie duke zbritur në -3.7 përqind, krahasuar me 0.9 përqind sa ishte në vitin 2011 (Tabela 2). Ngjashëm me ROAA, edhe kthimi në kapital (ROAE) ishte negativ në vitin 2012, prej -14 përqind krahasuar me 2.5 përqind në vitin 2011. Margjina Neto e Interesit (angl. Net Interest Margin: NIM), që shprehë raportin mes të hyrave neto nga interesi dhe aseteve që sjellin interes, në vitin 2012 ishte 14.5 përqind.<sup>27</sup>

Zvogëlimi i aseteve në njërën anë, mirëpo edhe zvogëlimi i numrit të punëtorëve në institucionet mikrofinanciare ndikuan në rënien e efikasitetit në menaxhimin e aseteve nga punëtorët. Vlera mesatare e aseteve të menaxhuara nga një punëtor në vitin 2012 ishte 128.1 mijë, ndërsa një vit më herët një punëtor mesatarisht menaxhonte rreth 129.6 mijë euro asete. Në vitin 2012, numri mesatar i kredive të lëshuara nga një punëtor ishte 44.5, ndërsa profiti i gjeneruar në vitin 2012 për punëtor ishte 4.9 mijë euro.

<sup>27</sup> Indikator NIM dallon nga indikator që matë diferencën mes interesit në kredi dhe atij në depozita (angl. Interest rate spread), meqë NIM gjithashtu konsideron edhe vëllimin e aseteve që sjellin interes si dhe vëllimin e fondeve të huazuara.

### 3.4. Sektori i jashtëm

Bilanci i Pagesave në Kosovë vazhdon të karakterizohet me deficit të llogarisë rrjedhëse dhe me pozicion pozitiv në llogarinë kapitale dhe financiare. Deficiti i llogarisë rrjedhëse (i prirë kryesisht nga deficitin në bilancin tregtar) përkundër përmirësimeve gjatë vitit 2012 vazhdon të mbetet në nivel relativisht të lartë. Në anën tjetër, financimi i këtij deficiti nga llogaria kapitale dhe financiare, përkundër qëndrueshmërisë së vazhdueshme, gjatë vitit 2012 u ballafaqua me sfida si rezultat i rënies së IHD-ve dhe kredive tregtare.

#### 3.4.1 Llogaria rrjedhëse


Deficiti i llogarisë rrjedhëse në Kosovë gjatë vitit 2012 shënoi rënie të konsiderueshme duke arritur nivelin prej 379.4 milionë euro, nivel ky i cili në krahasim me vitin 2011 paraqet rënie prej 42.4 përqind. Si përqindje e PBB-së, deficitin e llogarisë rrjedhëse gjatë vitit 2012 kishte nivelin më të ulët në vitet e fundit duke arritur në 7.7 përqind të PBB-së.

Rënia substanciale e deficitit të llogarisë rrjedhëse është ndikuar kryesisht nga importet të cilat gjatë vitit 2012 ishin më të ulëta për 1.0 përqind në krahasim me vitin paraprak. Gjithashtu, edhe rritja e eksporteve të shërbimeve gjatë vitit 2012 ndikoi në zvogëlimin e deficitit të llogarisë rrjedhëse. Pastaj, ndikim në zvogëlim të deficitit të llogarisë rrjedhëse kishte edhe kategoria e të ardhurave si dhe kategoria e transfereve rrjedhëse. Siç edhe është paraqitur në Figurën 80, deficitin tregtar është kontribuesi kryesor në deficitin e llogarisë rrjedhëse, ndërsa kategoritë tjera si tregtia në shërbime, llogaria e të ardhurave si dhe transferet rrjedhëse janë faktorët kryesor që ndikojnë në ngushtimin e deficitit të llogarisë rrjedhëse.

##### 3.4.1.1 Mallrat dhe shërbimet


Aktiviteti tregtar gjatë vitit 2012 ka shënuar ngadalsim të theksuar si në anën e eksporteve ashtu edhe të importeve. Raporti i aktivitetit tregtar ndaj PBB-së gjatë vitit 2012 ishte 53.9 përqind krahasuar me 57.1 përqind në vitin 2011. Ekonomia vendore konsiderohet se ka mungesë të konkurrueshmërisë në tregtinë me mallra kur merret parasysh nivel i lartë i deficitit tregtar (Figura 80). Niveli relativisht i ulët i prodhimit në ekonominë e Kosovës bënë që varshmëria nga importet të jetë relativisht e lartë dhe, njëkohësisht, reflektimet nga ndryshimet në çmime të produkteve kryesore që importohen të jenë të theksuara në kuadër të çmimeve vendore.

Figura 79. Bilanci i llogarisë rrjedhëse, në milionë euro



Burimi: BQK (2013)

Figura 80. Importet, eksportet dhe bilanci tregtar, jo kumulative




Burimi: BQK (2013)

Eksportet e Kosovës gjatë vitit 2012 arritën shumën prej 286.9 milionë euro, që paraqet një rënie prej 11.7 përqind në terma nominal. Në terma real, rënia e eksporteve ishte më e lartë duke arritur në rreth 13 përqind, Rënia e eksporteve nga Kosova përveç se është shkaktuar nga rënia e përgjithshme e kërkesës në rajon dhe në vendet e BE-së, është ndikuar edhe nga rënia e çmimeve të komponentëve kryesorë të cilët i eksporton Kosova. Mbi 60 përqind e mallrave të eksportuara nga Kosova përbëhet nga produktet e metaleve bazë dhe ndryshimet në çmimet e metaleve reflektojnë në vlerën nominale të eksporteve. Çmimet e metaleve bazë gjatë vitit 2012 shënuan rënie të përafërt me rënien e eksporteve vendore. Për shembull, plumbi, alumini, zinku dhe bakri u karakterizuan me rënie të çmimeve ndërmjet 7-9 përqind, ndërsa nikeli kishte rënien më të theksuar për 20 përqind. Ky raport vërehet edhe në figurën 81 ku prirja e përgjithshme e eksporteve ishte e ngjashme me çmimet e metaleve bazë në tregun ndërkombëtar. Përveç zhvillimeve në kuadër të çmimeve, parashikimet e përgjithshme të aktivitetit ekonomik në nivel global janë për një nuancë të lehtë më të mira se në vitin 2012, që gjithashtu pritet të ketë efekte pozitive në eksportet e Kosovës. Si rezultat, pritet rikuperim i eksporteve gjatë vitit 2013, me një normë të rritjes 8 deri në 10 përqind. Stabilizimi i çmimeve të produkteve kryesore që eksporton Kosova (si p.sh. metalet bazë) pritet të jetë faktori kyç që do të nxitë rritjen e eksporteve gjatë vitit 2013.

Në anën tjetër, vlera e importeve gjatë vitit 2012 arriti në 2.36 miliardë euro që paraqet një rënie prej 1.0 përqind. Rënia e importeve gjatë kësaj periudhe mund të jetë shkaktuar si rezultat i stabilizimit dhe rënies së çmimeve të produkteve kryesore që importon Kosova siç janë produktet ushqimore dhe produktet minerale, të cilat kryesisht përbëhen nga derivatet e naftës (Figura 82).

Tregtia në shërbime gjatë vitit 2012 u karakterizua me bilanc pozitiv prej 346.2 milionë euro që krahasuar me vitin paraprak (265 milionë euro) paraqet një rritje vjetore prej 30.3 përqind.


Figura 81. Eksportet dhe çmimet ndërkombëtare të metaleve, pa përshtatje sezonale



Burimi: BQK (2013) dhe Bloomberg.

Për shembull, plumbi, alumini, zinku dhe bakri u karakterizuan me rënie të çmimeve ndërmjet 7-9 përqind, ndërsa nikeli kishte rënien më të theksuar për 20 përqind.


Figura 82. Importet dhe çmimet ndërkombëtare të naftës dhe ushqimit, pa përshtatje sezonale



Burimi: BQK (2013) dhe IFS dhe FAOUN

(si p.sh. metalet bazë) pritet të jetë faktori kyç që do të nxitë rritjen e eksporteve gjatë vitit 2013.

Figura 83. Struktura e neto eksportit të shërbimeve, në milionë euro



Burimi: BQK (2013)

Komponenta kryesore në kuadër të tregtisë në shërbime vazhdon të jetë kategoria e udhëtimit që përbëhet nga shitja e shërbimeve për jo-rezidentët. Krahasuar me vitin paraprak, gjatë vitit 2012 bilanci i llogarisë së shërbimeve të udhëtimit arriti në 309.3 milionë euro që paraqet një rritje vjetore prej 31.3 përqind. Rritja e bilancit të kësaj llogarie ishte rezultat i rënies së importit të shërbimeve të udhëtimit për 28.1 përqind dhe rritjes së eksportit të këtyre shërbimeve për 13.4 përqind.


Kategori me rëndësi brenda shërbimeve ishte aktiviteti tregtar në shërbimet e komunikacionit. Pozicioni në kuadër të shërbimeve të komunikacionit gjatë vitit 2012 arriti në 70.3 milionë euro eksport dhe 22.0 milionë euro import duke rezultuar në bilanc pozitiv prej 48.3 milionë euro. Sidoqoftë, në krahasim me vitin parapak kjo kategori ka shënuar rënie prej 37.3 përqind. Kategori tjetër e rëndësishme në kuadër të shërbimeve ishte eksporti i shërbimeve për qeverinë dhe ka të bëjë me shërbimet e ofruara ndaj prezencës ndërkombëtare në Kosovë siç janë misionet diplomatike dhe prezenca e institucioneve tjera ndërkombëtare (Eulex dhe KFOR). Bilanci i kësaj kategorie është 30.9 milionë euro. Me bilanc negativ në kuadër të tregtisë në shërbime vazhdon të jetë transporti me 50.9 milionë euro dhe shërbimet e sigurimit me 4.0 milionë euro (Figura 83).

### 3.4.1.2 Të ardhurat dhe transferet rrjedhëse

Llogaria e të ardhurave gjatë vitit 2012 kishte bilanc pozitiv prej 154.1 milionë euro kundrejt 113.8 milionë euro në vitin 2011. Rritja e bilancit pozitiv në kuadër të kësaj kategorie ishte si rezultat i rënies së pagesave në kuadër të investimeve. Në anën tjetër kategoria e pranimeve në kuadër të kompensimit të punonjësve u karakterizua me stabilitet.


Kategoria më e madhe në kuadër të llogarisë së të ardhurave vazhdon të jetë kompensimi i punonjësve e cila gjatë vitit 2012 kishte bilanc prej 219.9 milionë euro (221.2 milionë euro gjatë vitit 2011). Kjo kategori kryesisht përbëhet nga të ardhurat e punonjësve jashtë vendit siç janë punëtorët sezonal si dhe punonjësit në Afganistan dhe Irak. Në anën tjetër, kategori me bilanc të vazhdueshëm negativ është kategoria e të ardhurave nga investimet. Kjo kategori paraqet shpërndajen e dividendës nga kompanitë e huaja që kanë investuar në Kosovë. Gjatë vitit 2012, kjo kategori kishte bilanc negativ prej 60.1 milionë euro e cila krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak ka shënuar rënie prej 36.2 përqind (94.3 milionë euro gjatë vitit 2011). Llogaria e të ardhurave gjatë kësaj periudhe u karakterizua me rritje të bilancit pozitiv prej 35.4 përqind (Figura 84).

Figura 84. Llogaria e të ardhurave, në milionë euro



Burimi: BQK (2013)


Figura 85. Transferet rrjedhëse, në milionë euro



Burimi: BQK (2013)

Kategoria me kontributin më të madh në ngushtimin e deficitit të llogarisë rrjedhëse është llogaria e transfereve rrjedhëse. Kjo kategori përbëhet nga transferet për qeverinë si dhe nga transferet private të cilat dominohen nga dërgesat e emigrantëve. Llogaria e transfereve rrjedhëse gjatë vitit 2012 ka shënuar rritje më të lartë në krahasim me llogaritë tjera. Rritja vjetore e transfereve rrjedhëse arriti në 16.8 përqind duke rezultuar në bilanc prej 1.2 miliardë euro. Pranimet në kuadër të transfereve ndaj qeverisë qendrore kishin normën më të lartë të rritjes vjetore prej 24.6 përqind duke arritur në nivelin prej 401.6 milionë euro. Në kuadër të transfereve rrjedhëse qeveritare kryesisht hyjnë transferet e donatorëve, EULEX-it dhe UNMIK-ut. Kategori tjetër me peshë më të madhe është ajo e sektorëve tjerë që më së shumti përmbanë dërgesat e emigrantëve. Pagesat nga ekonomia e Kosovës në kuadër të transfereve private shënuan rënie prej 7.4 përqind duke kontribuar në rritjen e përgjithshme (Figura 86). Dërgesat e emigrantëve vazhdojnë të jenë komponenta kryesore në kuadër të transfereve të sektorit privat (67.7 përqind e gjithsej transfereve të sektorit privat). Të hyrat nga dërgesat e emigrantëve në vitin 2012 arritën në 605.6 milionë euro që krahasuar me vitin 2011 paraqet rritje prej 3.6 përqind. Si përqindje e PBB-së, dërgesat e emigrantëve në 2012 kishin nivel të njëjtë me vitin paraprak duke pasur një pjesëmarrje prej 12.5 përqind.

Figura 86. Pranimet e dërgesave të emigrantëve, në milionë euro



Burimi: BQK (2013)

Dërgesat e emigrantëve vazhdojnë të kenë burim kryesor Gjermaninë dhe Zvicrën me 34 përkatësisht 23 përqind të gjithsej dërgesave të pranuar në Kosovë, ndërsa vendet tjera përfaqësohen me përqindje më të ulëta. Italia dhe Austria përbëjnë 7 përkatësisht 6 përqind të gjithsej dërgesave, pasuar nga Belgjika me 3 përqind, SHBA-të me 4 përqind dhe Suedia me 3 përqind. Rreth 20% e dërgesave të emigrantëve transferohen përmes sistemit bankar, ndërsa 36 përqind transferohen përmes agjensioneve për transferimin e parave. Pjesa tjetër e dërgesave transferohen përmes kanaleve të tjera që përfshijnë edhe kanalet joformale.

### 3.4.2 Llogaria kapitale dhe financiare

Llogaria kapitale dhe financiare vazhdon të karakterizohet me bilanc pozitiv, por dukshëm më të ulët krahasuar me vitet paraprake (Tabela 9). Në vitin 2012, bilanci i kësaj llogarie arriti vlerën prej 140.1 milionë euro që paraqet një rënie prej 66.6 përqind krahasuar me vitin paraprak. Për shkak të rënies së granteve për investime kapitale, bilanci i llogarisë kapitale u zvogëluar në 13.0 milionë euro, krahasuar me 42.0 milionë euro në vitin 2011.

Në kuadër të bilancit prej 127.1 milionë euro të llogarisë financiare, u regjistrua rritje e aseteve për 322.3 milionë euro si dhe rritje e detyrimeve për 449.4 milionë euro. Kontribuuesi kryesor në kuadër të bilancit pozitiv të llogarisë financiare vazhdon të jetë kategoria e investimeve të huaja direkte (IHD), pasuar nga investimet tjera, ndërsa ndikim negativ në bilancin e llogarisë financiare vazhdon të ketë rritja e vazhdueshme e investimeve portfolio dhe aseteve rezervë jashtë ekonomisë së Kosovës.

Tabela 9. Llogaria kapitale dhe financiare, në milionë euro

Përshkrimi	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012
LLOGARIA KAPITALE DHE FINANCIARE	-14.9	10.7	298.9	213.3	297.2	419.6	140.1
Llogaria kapitale	20.8	16.5	10.5	100.3	21.3	42.0	13.0
Llogaria financiare	-35.7	-5.8	288.5	113.1	275.9	377.5	127.1
<i>Asetet</i>	367.5	508.5	227.8	230.6	402.9	93.9	322.3
Investimet direkte	5.6	9.7	25.0	10.5	34.7	15.7	15.8
Investimet portfolio	65.4	34.5	109.9	124.8	48.6	57.8	185.7
Investimet tjera	218.7	170.0	74.7	190.1	266.2	81.7	-146.4
Asetet rezerve	77.9	294.3	18.2	-94.8	53.4	-61.2	267.2
<i>Detyrimet</i>	331.8	502.7	516.3	343.7	678.7	471.4	449.4
Investimet e huaja direkte	294.8	440.7	366.5	291.4	365.8	394.6	232.0
Investimet portfolio	0.0	0.0	0.0	0.5	-0.7	0.8	0.7
Investimet tjera	37.0	61.9	149.8	51.8	313.6	76.0	216.6

Burimi: BQK (2013)


### 3.4.2.1 Investimet e Huaja Direkte

IHD-të në Kosovë ishin 232.0 milionë euro ose 41.2 përqind më të ulëta sesa viti 2011, ndërsa investimet e rezidentëve të Kosovës në vende tjera shënuan ngritje të lehtë prej 0.8 përqind dhe arritën vlerën prej 15.8 milionë euro. Investimet direkte të rezidentëve kosovarë jashtë ekonomisë së Kosovës janë kryesisht investime kapitale, të cilat në të shumtën e rasteve janë blerje e patundshmërive.

Siç edhe është paraqitur në figurën 87, IHD-të në Kosovë gjatë periudhës 2008 – 2011 kanë mbajtur një nivel të ngjashëm prej mesatarisht 8.3 përqind të PBB-së. Si rezultat i krizës globale financiare, gjatë vitit 2009 IHD-të shënuan rënien më të theksuar, ndërsa në vitet 2010-2011 vlera e këtyre investimeve filloi të rritet përsëri megjithëse me një ritëm të ngadalshëm. Ndërkohë, trendi u përkeqësua dukshëm në vitin 2012 duke arritur në rreth 5 përqind të PBB-së. Ky përkeqësim i trendit dëshmon për ndjeshmërinë që kanë IHD-të ndaj zhvillimeve në ekonominë e vendeve të eurozonës, të cilat njëkohësisht paraqesin burimin kryesor të IHD-ve në Kosovë.

Ndjeshmëria e IHD-ve ndaj zhvillimeve në eurozonë ilustron edhe me faktin se investimet tjera (kreditë ndërmjet ndërmarrjeve) kanë shënuar rënie më të theksuar (46.6 përqind) krahasuar me kapitalin aksionar (45.3 përqind rënie) apo fitimin i ri-investuar (16.1 përqind rënie).


Figura 87. Investimet e huaja direkte si përqindje e PBB-së dhe deficitit të llogarisë rrjedhëse



Burimi: BQK (2013)

rezultat i krizës globale financiare, gjatë vitit 2009

Figura 88. Struktura e investimeve të huaja direkte sipas komponenteve, në milionë euro




Burimi: BQK (2013)

IHD-të në Kosovë kryesisht janë përqendruar në sektorët e ekonomisë si patundshmëria me 31.7 përqind të gjithsej IHD-ve, ndërtimtaria me 20.8 përqind, prodhimit me 12.1 përqind, sektori financiar me 10.4 përqind, pasuar nga sektori i transportit dhe telekomunikacionit me një pjesëmarrje prej 7.9 përqind të gjithsej IHD-ve. Siç edhe është paraqitur në figurën 88, viti 2012 u karakterizua me ndryshime për sa i përket strukturës së IHD-ve sipas sektorëve. Vlera e investimeve në patundshmëri është pothuajse e ngjashme me vitin paraprak, mirëpo për shkak të rënies së investimeve në sektorin e ndërtimit dhe të prodhimit vërehet një pjesëmarrje më e madhe e këtij sektori në gjithsej IHD-të. Sektori financiar i cili në dy vitet paraprake vërehet se ka shënuar rënie të theksuar në gjithsej IHD-të, në vitin 2012 shënoi ngritje të lehtë dhe pritjet të ketë ngritje edhe në vitin 2013 pasi që një bankë e re ka filluar operimin në sistemin bankar të Kosovës.


Vendet e BE-së vazhdojnë të paraqesin burimin kryesor të IHD-ve në Kosovë. Për dallim nga viti i kaluar, kur pjesa më e madhe e IHD-ve ishte nga Britania e Madhe (20.3 përqind e gjithsej IHD-ve), në vitin 2012 Turqia paraqet vendin prej nga kanë ardhur më së shumti IHD në Kosovë (28.3 përqind të gjithsej IHD-ve). Investimet nga ky shtet, në vitin 2012 ishin të orientuara kryesisht në sektorin e transportit dhe telekomunikacionit (53.8 përqind), shërbime financiare (19.6 përqind), prodhim (14.2 përqind), etj. Rritje të theksuar të IHD-ve ka pasur edhe nga Zvicra, që gjatë kësaj periudhe paraqet vendin e tretë për nga shuma e IHD-ve në Kosovë (18.9 përqind). Për dallim nga Turqia, IHD-të nga Zvicra gjatë vitit 2012 ishin të koncenturara kryesisht në patundshmëri (66.1 përqind) dhe në ndërtim (18.5 përqind). Nga shumica e vendeve të BE-së, përfshirë edhe Gjermaninë, ka pasur rënie të IHD-ve, mirëpo për shkak se rënia e IHD-ve nga Britania e Madhe ishte mjaft e madhe, tek disa prej vendeve tjera vërehet rritje e pjesëmarrjes në strukturën e IHD-ve (Figura 90).

Figura 89. Struktura e IHD-ve sipas shteteve kryesore, në përqindje



Burimi: BQK (2013)

Figura 90. Investimet e huaja direkte sipas sektorëve kryesor ekonomik, në përqindje



Burimi: BQK (2013)

### 3.4.2.2 Portfolio investimet, investimet tjera dhe asetet rezervë

Bilanci i investimeve portfolio në vitin 2012 ishte -184.9 milionë euro (-57.0 milionë euro në vitin 2011). Investimet portfolio jashtë vendit në vitin 2012 shënuan rritje të theksuar në krahasim me vitin paraprak. Kjo rritje është shënuar për shkak të investimit të depozitave jashtë vendit në letra me vlerë. Vlera e investimeve portfolio jashtë vendit arriti në 185.7 milionë euro (57.8 milionë euro në 2011). Nga kjo shumë, 61.9 përqind u investua në letra me vlerë të kapitalit ndërsa pjesa tjetër prej 38.1 përqind u investua në letra me vlerë të borxhit. Ky proporcion i investimeve portfolio reflekton perceptimet e institucioneve financiare vendore mbi përmirësimin

e ambientit të përgjithshëm në tregjet globale financiare pasi që investimet në letra me vlerë të kapitalit konsiderohen me rrezikshmëri më të lartë e rrjedhimisht edhe mundësia e përfitimeve është më e madhe sesa te investimet në letra me vlerë të borxhit.

Sa i përket institucioneve, pjesa më e madhe e investimeve portfolio i takon Bankës Qendrore dhe bankave komerciale, ndërsa pjesa tjetër përbëhet nga investimet e fondeve pensionale në instrumente të ndryshme financiare jashtë vendit. Detyrimet në formë të investimeve portfolio, të cilat kryesisht përbëhen nga fitimi i riinvestuar i aksionarëve të bankave komerciale të cilët posedojnë më pak se 10% të aksioneve, në vitin 2012 ishin vetëm 0.7 milionë euro. Ky nivel i ulët i detyrimeve në formë të investimeve portfolio është për shkak se zhvillimi i tregut të kapitalit ende ndodhet në fazën fillestare.

Kategoria e investimeve tjera, si njëra ndër kategoritë më me peshë në kuadër të llogarisë financiare kishte një bilanc prej 363.0 milionë euro (-5.7 milionë euro në 2011). Bilanci pozitiv i kësaj kategorie shënoi rritje për shkak të zvogëlimit të aseteve për 146.4 milionë euro dhe rritjes së detyrimeve për 216.6 milionë euro. Rritja e detyrimeve të rezidentëve ndaj jo-rezidentëve përfaqëson hyrje të kapitalit në vend sikurse që zvogëlimi i aseteve rezulton në hyrje të kapitalit në vend. Në kuadër të aseteve, kategoria e depozitave u zvogëlua për 179.8 milionë euro (tërheqje e depozitave të plasuara jashtë ekonomisë së Kosovës gjatë viteve paraprake dhe investimi i tyre në letra me vlerë). Pjesa dërmuese e kësaj shume i takon Bankës Qendrore ndërsa pjesa tjetër bankave komerciale dhe sektorëve tjerë. Kreditë ndaj jorezidentëve shënuan rritje për 27.1 përqind apo 31.3 milionë euro. Rritja e kredive ishte kryesisht rezultat i dhënies së kredive jorezidentëve nga ana e bankave komerciale, ndërsa pjesëmarrja e sektorëve tjerë<sup>28</sup> në kuadër të kredive ishte shumë e ulët (vetëm 6.8 përqind).

Sa i përket detyrimeve, komponenti kryesor vazhdon të jetë kategoria e kredive tregtare<sup>29</sup> të cilat gjatë vitit 2012 arritën vlerën prej 100.3 milionë euro (rritje vjetore prej 7.7 përqind). Rritja e kredive tregtare mund të jetë indikator i mungesës së aftësisë paguese të kompanive vendore, por gjithashtu, mund të shërbejë edhe si matës i besueshmërisë së kompanive ndërkombëtare ndaj atyre vendore. Kategoria e depozitave, që janë kryesisht depozita të jo-rezidentëve në bankat vendore, arriti në 97.0 milionë euro (-1.3 milionë euro në 2011). Në anën tjetër, detyrimet në formë të kredive shënuan rritje për 19.4 milionë euro (15.8 milionë euro ishte vlera kredive të shlyera në vitin 2011).

Asetet rezervë janë mjete jashtë ekonomisë së caktuar të cilat janë të gatshme për përdorim dhe të kontrolluara nga autoritetet monetare për financimin direkt të nevojave të bilancit të pagesave përmes intervenimit në tregjet e këmbimit valutor për të influencuar normën e këmbimit valutor, dhe për qëllime të tjera (ruajtja e besimit në monedhë dhe ekonomi, si dhe duke shërbyer si një bazë për marrjen e kredive jashtë vendit). Duke pasur parasysh këtë definim, mund të konsiderohet se asetet rezervë në Kosovë nuk kanë rëndësi të madhe në krahasim me shumicën e vendeve tjera, me që në Kosovë përdoret Euro si valutë zyrtare, e cila është e pranueshme në çdo transaksion ndërkombëtar. Sidoqoftë, asetet rezervë në vitin 2012 u rritën për 267.2 milionë euro. Kjo rritje e aseteve rezervë ishte rreth 56.7 përqind në instrumente të tregut të parasë dhe pjesa tjetër në depozita.

<sup>28</sup> Në kuadër të sektorëve tjerë përfshihen: fondet pensionale, ndihmësit financiar, kompanitë e sigurimeve, organizatat joqeveritare, kompanitë private, dhe individët.

<sup>29</sup> Kreditë tregtare dhe paradhëniet lindin në momentin kur pagesat për mallrat ose shërbimet nuk bëhen në të njëjtën kohë me ndryshimin e pronësisë së atij malli ose shërbimi. Nëse pagesa bëhet pas ndryshimit të pronësisë regjistrohet si kredi tregtare, ndërsa nëse pagesa bëhet përpara ndryshimit të pronësisë regjistrohet si paradhënie.

### 3.4.3 Pozicioni i investimeve ndërkombëtare


Pozicioni ndërkombëtar i investimeve (PNI)<sup>30</sup> neto në fund të vitit 2011 ishte pozitiv (330.5 milionë euro). Bilanci pozitiv i PNI-së ka ndjekur trend rënës deri në vitin 2011, ku si përqindje e PBB-së kishte arritur në 2.2 përqind, ndërsa ka filluar të rritet përsëri në vitin 2012 duke arritur në 6.7 përqind të PBB-së. Ky përmirësim i bilancit ishte për shkak të rritjes më të lartë të aseteve të Kosovës jashtë vendit kundrejt detyrimeve që ka Kosova ndaj vendeve tjera (11.3 përkatësisht 4.7 përqind) (Figura 91). Në këtë kontekst, asetet rezervë dhe investimet portfolio neto regjistruan kontributin kryesor në përmirësimin e bilancit të PNI-së duke shënuar rritje prej 46.2 përkatësisht 33.0 përqind në fund të vitit 2012 krahasuar me fundin e vitit 2011. Në anën tjetër, investimet tjera neto shënuan rënie prej 20.5 përqind, ndërsa bilanci i investimeve direkte vazhdoi të jetë negativ dhe shënoi një rritje prej 3.1 përqind në vitin 2012.

Sa i përket sektorëve institucional, Banka Qendrore dhe bankat komerciale kanë pasur në vazhdimësi bilanc kreditor (1.3 miliardë përkatësisht 457.5 milionë euro në fund të vitit 2012), ndërsa sektorët tjerë dhe qeveria bilanc debitor (1.1 miliardë përkatësisht 336.5 milionë euro). Bilanci pozitiv i Bankës Qendrore dhe bankave komerciale shënoi rritje prej 21.3 përkatësisht 84.5 përqind, ndërsa sektorët tjerë dhe qeveria e thelluan bilancin negativ me rreth 13.7 përkatësisht 32.7 përqind (Figura 92).

#### 3.4.3.1 Asetet dhe Detyrimet në Pozicionin e Investimeve ndërkombëtare


Vlera e stokut të aseteve në fund të vitit 2012, arriti në 3.7 miliardë euro (rritje vjetore prej 11.3 përqind). Rritjes së aseteve më së shumti i kanë kontribuar asetet rezervë të cilat shënuan rritje prej 46.2 përqind dhe investimet portfolio të cilat shënuan rritje prej 32.7 përqind (Figura 93). Investimet portfolio, të cilat kanë një pjesëmarrje të konsiderueshme në stokun e aseteve jashtë vendit (26.6 përqind), janë të investuara kryesisht në letra me vlerë të borxhit (64.1 përqind), ndërsa pjesa tjetër (35.9 përqind) në letra me vlerë të kapitalit. Mbi 90 përqind e investimeve portfolio janë të koncentruara në shtete e eurozonës, kryesisht në Irlandë (31.1 përqind), Luksemburg (23.5 përqind), Belgjikë (22.2 përqind), etj.

Figura 91. Pozicioni ndërkombëtar i investimeve, në milionë euro



Burimi: BQK (2013)

Figura 92. Pozicioni ndërkombëtar i investimeve neto sipas sektorëve institucional, në milionë euro



Burimi: BQK (2013)

<sup>30</sup> Pozicioni Neto i Investimeve paraqet gjendjen në fund të një periudhe të caktuar kohore të aseteve dhe detyrimeve të jashtme financiare. Gjendja në fund të periudhës është rezultat i gjithë transaksioneve që rrjedhin nga e kaluara, përfshirë edhe korigjimet si pasojë e lëvizjeve në kursin e këmbimit për të llogaritur vlerën e mjeteve/detyrimeve financiare në ditën e raportimit apo ndryshimet në çmimin e tregut.

(Figura 94). Asetet rezervë kanë një pjesëmarrje prej 22.7 përqind në gjithsej asetet dhe mbahen kryesisht në formë të depozitave jashtë vendit (71.1 përqind) dhe në instrumente të tregut të parasë (19.4 përqind), ndërsa pjesa tjetër mbahen në formë të të Drejtave Speciale të Tërheqjes (7.5 përqind) dhe rezervës së Kosovës në FMN (2.0 përqind).


Investimet direkte të rezidentëve kosovar jashtë vendit shënuan rritje për 15.5 përqind, mirëpo kontributi në rritjen e stokut të aseteve është i vogël pasi që vetëm 3.2 përqind e gjithsej aseteve i përkasin kësaj kategorie. Sa i përket investimeve direkte, ato janë të gjitha në formë të kapitalit aksionar dhe janë të orientuara kryesisht në blerje të patundshmërive në shtete e rajonit. Shqipëria paraqet vendin ku është investuar pjesa më e madhe e investimeve direkte nga investitorët kosovar (26.3 përqind të gjithsej investimeve direkte të rezidentëve kosovar jashtë vendit), pasuar nga Gjermania (10.9 përqind), Maqedonia (7.5 përqind), etj. (Figura 94).

Kategoria e investimeve tjera, e cila paraqet kategorinë kryesore në kuadër të aseteve të Kosovës jashtë vendit (47.5 përqind të gjithsej aseteve), ishte e vetmja kategori që shënoi rënie dhe atë prej 7.7 përqind krahasuar me fundin e vitit 2011.

Mbi 95 përqind e aseteve në kuadër të kësaj kategorie janë në formë të depozitave, prej të cilave mbi 50 përqind janë depozita të sektorëve tjerë ndërsa pjesa tjetër janë depozita të Bankës Qendrore (27.1 përqind) dhe bankave komerciale (21.0 përqind). Kreditë përbëjnë 4.6 përqind të investimeve tjera dhe në tërësi u përkasin kredive të bankave komerciale. Në kuadër të investimeve tjera bëjnë pjesë edhe kreditë tregtare dhe asetet tjera të cilat kanë një pjesëmarrje të ulët (0.1 përqind secila).

Nga ajo që është shtjelluar më lartë shihet se komponentë të caktuar marrin pjesë në më shumë se një zë (për shembull, depozitat përbëjnë pjesë të aseteve rezervë por edhe të investimeve tjera). Andaj, është me rëndësi edhe shtjellimi i aseteve sipas dy grupeve kryesore, kapitalit aksionar dhe instrumenteve të borxhit. Asetet e Kosovës janë të investuara kryesisht në instrumente të borxhit (87.3 përqind) dhe kapital aksionar (12.7 përqind). Siç shihet edhe nga figura 95, kapitali aksionar edhe pse në nivel


Figura 93. Asetet sipas formës së investimeve, në milionë euro



Burimi: BQK (2013)


orientuara kryesisht në blerje të patundshmërive në

Figura 94. Stoku i investimet portfolio dhe direkte sipas shteteve, në përqindje



Burimi: BQK (2013)

Figura 95. Stoku i aseteve në kapital aksionar dhe instrumente të borxhit, në milionë euro



Burimi: BQK (2013)

të ulët, në vazhdimësi e ka shtuar pjesëmarrjen në kuadër të gjithsej aseteve. Në kuadër të kapitalit aksionar pjesa dërmuese përbëhet nga investimet në letra me vlerë të kapitalit (75.0 përqind) ndërsa pjesa tjetër (25.0 përqind) në investime direkte të rezidentëve kosovar jashtë vendit. Strukturë pothuajse e ngjashme ishte edhe në fund të vitit 2011. Asetet e investuara në formë të instrumenteve të borxhit janë të koncentruara në kategorinë e investimeve tjera (54.5 përqind), pastaj në asete rezervë (26.0 përqind) dhe letra me vlerë të borxhit (19.6 përqind). Ky koncentrim i investimeve në kategorinë e investimeve tjera ishte edhe më i theksuar në fund të vitit 2011 (65.1 përqind). Me fjalë të tjera, krahasuar vitin 2012 me vitin 2011 vërehet një zhvendosje e investimeve nga kategoria e investimeve tjera drejt aseteve rezervë dhe letrave me vlerë.

Sipas sektorëve institucional, pronarë kryesor të aseteve të Kosovës jashtë vendit janë sektorët tjerë me 45 përqind, Banka Qendrore me 38 përqind dhe bankat komerciale me 17 përqind.


Vlera e stokut të detyrimeve në fund të vitit 2012 arriti në 3.4 miliardë euro (4.7 përqind më shumë se viti 2011). Përderisa shumica e aseteve të Kosovës janë të investuara në instrumente borxhi, detyrimet e ekonomisë së Kosovës janë të dominuara nga IHD-të (72.5 përqind), gjë që paraqet një tipar të favorshëm struktural të detyrimeve (Figura 96). Detyrimet në formë të investimeve tjera kanë një pjesëmarrje prej 27.5 përqind, ndërsa detyrimet në formë të investimeve portfolio marrin pjesë me vetëm 0.02 përqind.

Detyrimet mund të grupohen në dy llojet kryesore të tyre: detyrimet në formë të borxhit (investimet tjera, investimet portfolio, si dhe IHD-të në formë të huave ndër-kompani), të cilat do të shtjellohen në kuadër të borxhit të jashtëm si dhe detyrimet tjera jo-borxh (IHD-të në formë të kapitalit aksionar edhe investimet portfolio në formë të letrave me vlerë të kapitalit).

Stoku i IHD-ve si një ndër komponentët më të rëndësishëm të detyrimeve ka arritur vlerën prej 2.4 miliardë euro. Prej kësaj shume, 75.9 përqind janë në formë të kapitalit aksionar ndërsa pjesa tjetër (24.1 përqind) i përket IHD-ve në formë të huave që kanë marrë ndërmarrjet investuese direkte në Kosovë nga investitorët direkt. Strukturë pothuajse e ngjashme ishte edhe në vitet e kaluara (Figura 97). Prej 1.9 miliardë eurove sa janë IHD-të në formë të kapitalit aksionar, Gjermania prinë me 10.1 përqind e pasuar nga Sllovenia dhe Austria me nga 5.7 përqind, Zvicra, Turqia, dhe Mbretëria e Bashkuar kanë një pjesëmarrje prej përafërsisht 4 përqind secila, ndërsa Shqipëria merr pjesë me 2.2 përqind, pasuar nga vendet tjera me pjesëmarrje më të ulët.


Detyrimet në kuadër të investimeve portfolio në formë të letrave me vlerë të kapitalit, të cilat i përkasin kryesisht bankave vendore,

Figura 96. Detyrimet ndaj sektorit të jashtëm sipas instrumenteve, në milionë euro



Burimi: BQK (2013)

Figura 97. IHD-të sipas kapitalit aksionar dhe huave, në milionë euro



Burimi: BQK (2013)

mbeten në nivel të ulët (0.5 milionë euro) për shkak se zhvillimi i tregut të kapitalit ende ndodhet në fazën fillestare.

### 3.4.4.2 Borxhi i jashtëm


Borxhi i jashtëm bruto i Kosovës, i cili përfshinë borxhin privat dhe borxhin publik<sup>31</sup>, në vitin 2012 arriti në 1.5 miliardë euro që është për 6.4 përqind më i lartë se sa në vitin 2011. Ekonomia e Kosovës e ka nivelin më të ulët në rajon për sa i përket ngarkesës me borxhe. Si përqindje e PBB-së, borxhi i jashtëm bruto në fund të vitit 2012 arriti në 31.2 përqind nga 29.9 përqind sa ishte në fund të vitit 2011 (Figura 98). Kosova qëndron mirë në krahasim me vendet tjera të rajonit edhe për faktin se borxhi publik ka një pjesëmarrje të ulët në gjithsej borxhin e jashtëm bruto (401.4 milionë euro apo 26.4 përqind e borxhit të jashtëm bruto). Si përqindje e PBB-së, borxhi publik në fund të vitit 2012 ishte vetëm 8.3 përqind. Në anën tjetër borxhi privat i cili arriti në 1.1 miliardë euro përbën 73.6 përqind të borxhit të jashtëm bruto.

Pjesa më e madhe e borxhit të jashtëm i takon formës së huave midis kompanive në kuadër të IHD-ve (Figura 99). Rrjedhimisht, kompanitë e huaja që operojnë në Kosovë i detyrohen sektorit të jashtëm me 589.7 milionë euro apo 38.9 përqind të gjithsej borxhit të jashtëm. Investitorët direkt nga Sllovenia dhe Turqia u kanë dhënë më së shumti kredi ndërmarrjeve të tyre që zhvillojnë afarizmin në Kosovë, me 25.6 përkatësisht 13.2 përqind të gjithsej kredive ndërmjet ndërmarrjeve, pasuar nga Zvicra dhe Shqipëria me 3.0 përkatësisht 2.6 përqind, etj.

Me pjesëmarrje të konsiderueshme në gjithsej borxhin e jashtëm të Kosovës janë edhe 'sektorët tjerë'<sup>32</sup> (350.9 milionë euro ose 23.1 përqind e borxhit të jashtëm). Stoku i borxhit të sektorëve tjerë dominohet nga kreditë tregtare (56.9 përqind), ndërsa pjesa tjetër janë kredi tjera (43.1 përqind). Pjesa dërmuese e borxhit të sektorëve tjerë është borxh afatshkurtër (90.5 përqind), ndërsa pjesa tjetër borxh afatgjatë (9.5 përqind).


Borxhi i jashtëm i qeverisë në vlerë prej 336.5 milionë euro është kryesisht borxh i trashëguar që nënkuptohet se është borxh afatgjatë dhe përbën 22.2 përqind të borxhit të jashtëm bruto. Borxhi i qeverisë i përket kryesisht Bankës Botërore (66.4 përqind), ndërsa pjesa tjetër FMN-së (33.6 përqind). Rritja e

Figura 98. Borxhi i jashtëm bruto, në milion euro



Burimi: BQK (2013)

Figura 99. Borxhi i jashtëm bruto sipas sektorëve, në milion euro



Burimi: BQK (2013)

<sup>31</sup> Në kuadër të borxhit publik përfshihen qeveria dhe banka qendrore, ndërsa në kuadër të borxhit privat përfshihen huatë midis kompanive në kuadër të IHD-ve, sistemi bankar, dhe sektorët tjerë.

<sup>32</sup> Në kuadër të sektorëve tjerë përfshihen: fondet pensionale, ndihmësit financiar, kompanitë e sigurimeve, organizatat joqeveritare, kompanitë private, dhe individët.


borxhit të qeverisë prej 32.7 përqind në vitin 2012 krahasuar me vitin 2011, kryesisht i atribuohet kredisë nga FMN-ja në kuadër të programit Stand-by-Arrangement.

Stoku i borxhit të jashtëm bruto i sistemit bankar në fund të vitit 2012 ishte 175.6 milionë euro ose 11.6 përqind e gjithë borxhit të jashtëm. Ky borxh është afatshkurtër dhe pjesën më të madhe të tij e përbëjnë depozitat e jo-rezidentëve me 68.6 përqind, pasuar nga kreditë me 28.6 përqind, dhe detyrimet tjera me 2.8 përqind. Me pjesëmarrjen më të ulët në gjithë borxhin e jashtëm është Banka Qendrore (65.0 milionë euro apo 4.3 përqind e gjithë borxhit të jashtëm). Detyrimet e Bankës Qendrore i përkasin kryesisht stokut të alokimeve të Drejtave Speciale të Tërheqjes (anglisht: SDR) nga FMN-ja.

Ekonomia e Kosovës, me fondet e saj të investuara jashtë vendit (mjetet e privatizimit, mjetet e TKPK), është mjaft aktive në tregjet financiare ndërkombëtare andaj përveç borxhit të jashtëm bruto, për vlerësimin e qëndrueshmërisë së pozicionit të jashtëm është me rëndësi që të analizohet edhe borxhi i jashtëm neto. Kosova në fund të vitit 2012 kishte një pozicion kreditor prej 875.5 milionë euro që d.m.th. se borxhi i sektorit të jashtëm ndaj ekonomisë së Kosovës (2.4 miliardë euro) është më i lartë sesa borxhi i ekonomisë së Kosovës ndaj sektorit të jashtëm (1.5 miliardë euro).

Të gjithë sektorët kanë pozicion kreditor ndaj sektorit të jashtëm me përjashtim të qeverisë dhe huave ndër-kompani (Figura 100). ‘Sektorët tjerë’ kanë pozicionin më të lartë kreditor prej 831.9 milionë euro pasuar nga Banka Qendrore me 511.8 milionë euro dhe bankat komerciale me 458.0 milionë euro. Ndërsa pozicioni debitor i qeverisë dhe huave ndër-kompani prej 336.5 përkatësisht 589.7 milionë euro është i njëjtë me borxhin bruto të tyre pasi që këta dy sektorë nuk kanë mjete të investuara jashtë.

Figura 100. Borxhi i jashtëm neto sipas sektorëve, në milion euro



Burimi: BQK (2013)

## 4. Mbikëqyrja e Institucioneve Financiare

### 4.1. Licencimi dhe Rregullativa

#### 4.1.1 Licencimi

Kriteret dhe kushtet për të marrë licencë për kryerjen e veprimtarive bankare dhe veprimtarive tjera financiare në Republikën e Kosovës janë të përcaktuara në Ligjin për BQK-në (Ligji Nr. 03/L-209) dhe në aktet tjera nënligjore të nxjerra nga BQK-ja.

Kriteret e licencimit të përcaktuara me legjislacion, synojnë sigurimin e një tregu financiar të drejtë dhe të rregulluar nëpërmjet një procesi të ndërtuar mbi bazën e parimit të drejtësisë, ndershmërisë dhe barazisë. Kushtet dhe kriteret e licencimit janë të karakterit mbikëqyrës dhe nuk kanë për qëllim vendosjen e barrierave ndaj investitorëve qofshin ata të brendshëm apo të jashtëm.

Strategjia e BQK-së në fushën e licencimit të institucioneve financiare përqendrohet në tërheqjen e investitorëve të cilët kanë gjendje të mirë financiare, përmbushin kriteret etike dhe profesionale të nevojshme dhe të përshtatshme për aksionarë dhe menaxhment, janë të aftë të drejtojnë një qasje në zhvillimin e matur të biznesit për të mbrojtur interesat e klientëve, duke ndihmuar në këtë mënyrë forcimin e sektorit financiar dhe rritjen e besueshmërisë ndaj tij.

Departamenti i Licencimit dhe Rregullimit ka për detyrë që të kontribuojë në kompletimin e kornizës ligjore për mbikëqyrje financiare në përputhje me Direktivat e Bashkimit Evropian dhe praktikat më të mira ndërkombëtare ashtu siq janë të prezentuara në “Principet Themelore të Mbikëqyrjes Efektive Bankare” të publikuara nga Banka për Rregullim Ndërkombëtar (anglisht: Bank for International Settlement-BIS), si dhe “Principet Themelore të Mbikëqyrjes Efektive të Sigurimeve” të publikuara nga Asociacioni Ndërkombëtar i Mbikëqyrësve të Sigurimeve (anglisht: International Association of Insurance Supervisors - IAIS). Në kryerjen e këtij misioni Departamenti i licencimit është përgjegjës për pranimin, shqyrtimin dhe rekomandimin për aplikacione të institucioneve që kërkojnë licencim respektivisht regjistrim për të operuar në Kosovë, siç janë bankat komerciale, kompanitë e sigurimit dhe ndërmjetësuesit e sigurimeve, fondet pensionale dhe të gjitha institucionet tjera financiare jo bankare.

Aktiviteti i licencimit të mbikëqyrjes financiare gjatë vitit 2012 kryesisht ka përfshirë:

- Aprovimin e licencimit të një dege të bankës së huaj;
- Aprovimin e dy (2) kërkesave të bankës në ndryshimin e aktit të themelimit dhe statutit;
- Aprovimin e dy (2) kërkesave për shpërndarje të dividendës;
- Aprovimin e një kërkesë të kompanisë së sigurimit për tu transferuar nga dega në shoqëri të pavarur;
- Aprovimin e tridhjetë e shtatë (37) kërkesave për emërimet e administratorëve, menaxhmentit të lartë dhe auditorëve të brendshëm të bankave dhe institucioneve mikrofinanciare si dhe të kompanive të sigurimeve;
- Aprovimin e tetëdhjetë e pesë (85) kërkesave për hapje të degëve të reja dhe zhvendosje të degëve të bankave, të kompanive të sigurimit, si dhe institucioneve tjera financiare në Kosovë;
- Aprovimin e katër (4) kërkesave në shtimin e veprimtarive dhe të produkteve të sigurimeve;

- Aprovimin e gjashtëdhjetë e tetë (68) kërkesave të agjentëve të kompanive të sigurimit;
- Aprovimin e regjistrimit të një zyre të këmbimit;
- Revokimin e regjistrimit të dy (2) institucioneve mikro financiare;
- Refuzimin e dy (2) kërkesave të anëtarëve të bordit drejtues të kompanisë dhe ndërmjetësuesit të sigurimeve;
- Refuzimin e nëntë (9) kërkesave të agjentëve të kompanive të sigurimit.
- Pezullimin e licensës së një vlerësuesi të dëmeve.

Në rastet e miratuara të administratorëve të bankave, njëzet e një (21) prej tyre janë për anëtarë të bordit drejtues të bankës, një (1) për anëtarë të komitetit të auditimit, dhe tetë (8) raste janë për drejtor dhe zëvendës drejtor të përgjithshëm të bankave dhe institucioneve mikrofinanciare, si dhe shtatë (7) për menaxhment të lartë të bankave. Ndërsa, tek sigurimet, tetë (8) prej tyre janë për anëtarë të bordeve drejtuese të kompanive dhe ndërmjetësuesve të sigurimit, pesë (5) raste janë për drejtor dhe zëvendësdrejtor të përgjithshëm të kompanive dhe ndërmjetësuesve të sigurimit, katër (4) raste për auditorë të brendshëm , gjashtëmbëdhjetë (16) raste janë të menaxhmentit të mesëm të kompanive dhe ndërmjetësuesve të sigurimi .

Bankat dhe kompanitë e sigurimeve kanë punuar vazhdimisht në zgjerimin e aktivitetit të tyre në drejtim të diversifikimit të produkteve bankare dhe siguruese duke ofruar më shumë mundësi investimi dhe zgjedhje të shumta për klientët e tyre. Gjatë vitit 2012 është pranuar vetëm një aplikacion për themelim të bankës, mirëpo ka pasur edhe interesim nga investitorë të jashtëm për të aplikuar për bankë ose degë bankare.

Në tregun bankar gjatë vitit 2012 kishim nëntë (9) banka me 310 degë dhe nëndegë bankare, ndërsa në tregun e sigurimeve trembëdhjetë (13) kompani të sigurimeve - dhjetë (10) kompani të sigurimit jo jetë dhe tre (3) kompani të sigurimit të jetës. Gjatë vitit 2012 është pranuar një aplikacion për themelim të ndërmjetësuesit të sigurimeve.

Bordi Ekzekutiv i BQK-së gjatë vitit 2012 ka aprovuar licencën përfundimtare të degës së bankës së huaj, Turkiye Is Bankasi, nga Turqia .

Në fushën e pensioneve kanë vazhduar së operuari dy fonde pensionale: fondi pensional i detyrueshëm – Trusti i Kursimeve Pensionale të Kosovës (“Trusti”) dhe fondi i pensioneve individuale - Fondi Slloveno Kosovar.

**Tabela 10. Numri i bankave, kompanive të sigurimit dhe fondeve pensionale 2010-2012**

Përshkrimi	2010	2011	2012
Banka	8	8	9
Kompani te sigurimit	12	13	13
Fondet pensionale te detyrueshme dhe individuale	2	2	2

Burimi: BQK (2013)

**Institucionet mikro financiare dhe jo bankare financiare.** Në fund të vitit 2012, në Kosovë, kanë operuar katërmëdhjetë (14) institucione mikro financiare dhe katër (4) institucione jo bankare financiare me aktivitet të kredidhënies. Në pajtueshmëri me kërkesat e kornizës ligjore për arsye të mos fillimit të operimit të institucionit financiar Bordi Ekzekutiv ka revokuar regjistrimin e

dy institucioneve mikrofinanciare : “Agro Invest” (Krushë e Vogël, Prizren) dhe “Fundway Mortgage” (Prishtinë).

**Ndërmjetësuesit e sigurimeve.** Në fund të vitit 2012 kanë operuar tre (3) ndërmjetësues të sigurimeve.

**Zyret e Këmbimit të Valutave dhe Zyret e Transferit të Parave.** Gjatë vitit 2012 Bordi Ekzekutiv i BQK-së aprovoi aktivitetin shtesë të transferit të parave për institucionin financiar jo bankar “DMTH sh.p.k” , si dhe regjistrimin e institucionit financiar jo bankar “ Capital” (Prishtinë) për kryerjen e aktivitetit të transferit dhe shërbimit të pagesave; si dhe regjistrimin e zyrës së këmbimit: “Te Bernardi” ( Klinë). Në fund të vitit 2012 , në Kosovë kanë operuar tridhjetë e një (31) zyre të këmbimit të valutave dhe pesë (5) zyre të transferit të parave.

**Tabela 11. Numri institucioneve mikrofinanciare, jobankare financiare, zyreve të transferit të parave dhe zyreve të këmbimit të valutave 2010-2012**

Përshkrimi	2010	2011	2012
Institucionet Mikro Financiare	13	15	14
Institucionet Financiare jo Bankare -kredidhenje	4	5	4
Zyret e Transferit te Parave	2	4	5
Zyret e Këmbimit te Valutave	26	30	31

Burimi: BQK (2013)

**Tabela 12. Numri i ndërmjetësuesëve të sigurimit 2010-2012**

Përshkrimi	2010	2011	2012
Agjentët/operatorët	679	744	631
Brokerët e Sigurimit	3	2	2
Trajtuesit e dëmeve	1	1	1

Burimi: BQK (2013)

#### 4.1.2 Rregullativa

##### a) Kuadri ligjor

Korniza ligjore në fushën e licensimit dhe rregullimit të mbikëqyrjes financiare është rishikuar dhe freskuar gjatë vitit 2012, për të siguruar një mbikëqyrje efektive financiare në përputhje të plotë me praktikat më të mira ndërkombëtare, standardet dhe direktivat e BE-së. Në vazhden e zhvillimeve domethënëse që e karakterizuan vitin 2012 vlen të përmendet aprovimi i Ligjit Nr.04 /L-093 për bankat, institucionet mikrofinanciare dhe institucionet financiare jobankare.

Gjithashtu, në bashkëpunim me asistencën teknike të Departamentit të Thesarit Amerikan ka vazhduar procesi i rishikimit dhe plotësimi të draft ligjit të përgjithshëm të sigurimeve. Ky draft ligj përfshin një avancim më të lartë të bazës ligjore për rregullimin dhe mbikëqyrjen e sektorit të sigurimeve në Kosovë.

Si rezultat i hyrjes ne fuqi të Ligjit Nr. 04/L-018 mbi “Sigurimin e Detyrueshëm te autopërgjegjësise”, në vitin 2011, BQK-ja ne bashkëpunim me industrinë e sigurimeve dhe akteret tjerë relevant, ka themeluar Byronë Kosovare te Sigurimeve (BKS) si dhe ka dorëzuar aplikacionin për anëtarësimin e Kosovës ne Sistemin Ndërkombëtar te Kartonit Jeshil. Ndërsa gjate vitit 2012 kanë vazhduar përpjekjet e Industrisë se Sigurimeve te Kosovës ne gjetjen e nje modaliteti përfaqësimi ne Sistemin Ndërkombëtar te Kartonit Jeshil.

### **Rregulloret e mbikëqyrjes bankare**

Qëllimi i plotësimit të rregulloreve përkatëse për mbikëqyrje financiare është sigurimi dhe krijimi i një mjedisi të rregulluar mirë, pa vendosur ngarkesa të panevojshme për përdoruesit e shërbimeve financiare.

Në pajtueshmëri me ligjin e ri për bankat, institucionet mikrofinanciare dhe institucionet financiare jobankare, gjatë vitit 2012, vazhdoi puna për plotësimin dhe finalizimin e rregulloreve të mbikëqyrjes bankare në përputhje me standardet e Komitetit të Bazelit dhe direktivat e BE-së:

Viti 2012 u karakterizua me finalizimin e njëzet e një (21) rregulloreve të reja bankare të aprovuara nga Bordi Ekzekutiv dhe Bordi i BQK-së, si vijon:

- Rregullore për Licencimin e Bankave dhe Degeve të Bankave të Huaja,
- Rregullore për Drejtorët dhe Menaxheret e Lartë të Bankave ,
- Rregullore për Hapjen e Zyrave Përfaqësuese Brenda dhe Jashtë Republikës së Kosovës ,
- Rregullore për Hapjen dhe Mbylljen Brenda dhe Jashtë Republikës së Kosovës të Degëve dhe Subjekteve të Varura të Bankave ,
- Rregullore për Adekuatshmërinë e Kapitalit të Bankave ,
- Rregullore për Depozitën Ekuivalente të Kapitalit për Degët e Bankave të Huaja
- Rregullore për Ndryshimet në Llogaritë e Kapitalit ,
- Rregullore për Ekspozimet e Mëdha ,
- Rregullore për Transaksionet me Personat e Ndërlidhur dhe Ekspozimet ndaj Puntorëve ,
- Rregullore për Kufizimet në Mbajtjen e Pasurisë së Paluajtshme dhe të Luajtshme ,
- Rregullore për Rrezikun nga Aktiviteti me Valuta të Huaja ,
- Rregullore për Menaxhimin e Rrezikut Kreditor ,
- Rregullore për Menaxhimin e Rrezikut të Likuiditetit,
- Rregullore për Menaxhimin e Rrezikut Operacional ,
- Rregullore për Mbikëqyrjen e Konsoliduar të Grupeve Bankare ,
- Rregullore për Bashkimet dhe Përvetesimet e Bankave ,
- Rregullore për Raportimin e Bankave në BQK ,
- Rregullore për Publikimin e Informacionit nga Bankat ,
- Rregullore për Auditimin e Jashtëm të Bankave,
- Rregullore për Kontrollat e Brendshme dhe Auditimin e Brendshëm , si dhe

- Rregullore për Normën Efektive të Interesit dhe Kërkesat për Shpalosje.

Komisioni përkatës i themeluar për rishikimin e kornizës rregullative dhe përgaditjen e rregulloreve të reja mbikëqyrëse është duke punuar edhe në draftimin e rregulloreve për institucionet mikrofinanciare dhe institucionet financiare jobankare, si dhe për finalizimin e draftimit të ligjit për sigurime të përgjithshme dhe rregulloret përkatëse për sigurime.

Viti 2013 do të jetë vit i vazhdimësisë së konsolidimit të kornizës ligjore për mbikëqyrjen e bankave, IMF, IFJB, kompanive të sigurimit dhe fondeve pensionale, në përputhje me ligjet e reja dhe njëkohësisht për krijimin e një kornize rregullative që reflekton në nevojat dhe kërkesat e identifikuara gjatë një periudhe trembëdhjetëvjeçare të ekzistimit të mbikëqyrjes financiare në Kosovë.

### Rregulloret e mbikëqyrjes së sigurimeve

Gjatë vitit 2012 është vazhduar puna në përgatitjen e akteve tjera nënligjore të parapara me Ligjin Nr. 04/L-018 mbi Sigurimin e Detyrueshëm të Autopërgjegjësisë. Bordi Ekzekutiv dhe mëpastaj edhe Bordi i BQK kanë aprovuar rregulloret në vijim;

- Rregullore mbi implementimin e sistemit *Bonus Malus*,
- Rregullore mbi kushtet e përgjithshme të polices së sigurimit të autopërgjegjësisë,
- Rregullore mbi procedurat e trajtimit të kërkesave mbi kompensimin e dëmeve,
- Rregullore për mënyrën e mbajtjes dhe të përdorimit të aktives së fondit të kompensimit të Byrosë Kosovare të Sigurimeve,
- Rregullore për përcaktimin e standardeve të raportimit dhe mbikëqyrjes së Byrosë Kosovare të Sigurimeve, si dhe
- Rregullore për përcaktimin e standardeve dhe formave të raportimit të Byrosë Kosovare të Sigurimeve dhe Kompanive të Sigurimeve.

### c) Lista e institucioneve financiare dhe numri i degëve/nëndegëve të tyre, fundi i vitit 2012

Tabela 13. Bankat komerciale

Bankat komerciale		
Nr.	Emri	Filialat/degët ekzistuese
1	ProCredit Bank	68
2	Raiffeisen Bank Kosovo J.S.C.	50
3	NLB Prishtina sh.a	51
4	Banka për Biznes	41
5	Banka Ekonomike	44
6	TEB sh.a	23
7	Banka Kombetare Tregtare – Dega Kosovë	24
8	Komercijalna Banka – Dega Mitrovicë	8
9	Turkiye Is bankasi - Dega Prishtinë	1
	Gjithsej	310

Burimi: BQK (2013)

**Tabela 14. Kompanitë e sigurimeve**

Kompanitë e sigurimeve		
Nr.	Emri	Filialat/degët ekzistuese
1	Dardania	31
2	Illyria	48
3	Kosova e Re	34
4	Siguria	37
5	Insig	32
6	Sigma	39
7	Sigal	44
8	Croatia Sigurimi	23
9	Sigkos	25
10	Graw e Elsig	38
11	Illyria Life	1
12	Graw e Kosova	1
13	Sigal Life Uniq Group Austria	1
	Gjithsej	354

Burimi: BQK (2013)

**Tabela 15. Institucionet mikrofinanciare**

Institucionet mikrofinanciare		
Nr.	Emri	Filialat/degët ekzistuese
1	Finca	21
2	KEP	34
3	KGAMMF-Grameen	4
4	AFK	12
5	Besëlidhja	11
6	KRK	15
7	Mështekna	1
8	Qelim Kosovë	1
9	KosInvest	6
10	Start	2
11	Perspektiva 4	1
12	KAD	1
13	ACP	1
14	Timi Invest	1
15	Gjithsej	111

Burimi: BQK (2013)

**Tabela 16. Institucionet financiare jobankare**

Institucionet financiare jobankare		
Nr.	Emri	Filialat/degët ekzistuese
1	Crimson Finance Fund	1
2	Lesna	9
3	Raiffeisen Leasing	1
4	Factor Leasing	1
5	Gjithsej	12

Burimi: BQK (2013)

**Tabela 17. Zyrat për transferin e parave**

Zyrat për transferin e parave		
Nr.	Emri	Filialat/degët ekzistuese
1	UFP (nën-agjentët)	175
2	DMTH (nën-agjentët)	113
3	Vllesa Co	23
4	KLM Enterprise	1
5	Capital	1
	Gjithsej	313

Burimi: BQK (2013)

**Tabela 18. Ndërmjetësuesit e sigurimeve**

Ndërmjetësuesit e sigurimeve		
Nr.	Emri	Filialat/degët ekzistuese
1	WVP Sh.p.k	1
2	Risk Sh.p.k	1
3	Ansia Sh.p.k	1
	Gjithsej	3

Burimi: BQK (2013)

Tabela 19. Zyrat e këmbimit të valutave

Zyrat e këmbimit të valutave		
Nr.	Emri	Filialat/degët ekzistuese
1	Euro Cufa	1
2	NBS	1
3	Monedha	1
4	Euro	1
5	Euro Këmbimi	1
6	Euro Eki	1
7	Gipa	1
8	Xeni	1
9	Agimi	1
10	Indriti	1
11	Agoni	1
12	Ximi	1
13	Beni	1
14	Prizreni	1
15	Valuta	1
16	Edona	1
17	Ebani	1
18	Te Gazi	1
19	Hamza	1
20	Veli	1
21	Mena	1
22	Sara	1
23	Kujtimi	1
24	Adis	1
25	Aral	1
26	Ismeti	1
27	Kemi	1
28	Safeti	1
29	Yllka	1
30	Mani	1
31	Bernardi	1
	Gjithsej	31

Burimi: BQK (2013)

## 4.2. Mbikëqyrja Bankare

### 4.2.1 Sektori Bankar – Karaktersistika e përgjithëshme

Gjatë vitit 2012, sektori bankar i Kosovës vazhdoi të rritet si dhe të ruaj qëndrueshmërinë e komponentëve përbërës të likuiditetit, profitabilitetit dhe kapitalit. Gjithsej mjetet e sektorit bankar arritën vlerën prej 2.641 miliardë euro të cilat shënuan një rritje vjetore me rreth 138.6 milion euro ose 5.5 për qind, çka dëshmon një ritëm më të ulët krahasuar me vitin e kaluar, gjatë të cilit gjithsej mjetet u rritën me rreth 176.0 milion euro ose 7.6 për qind. Njëkohësisht, portofoli kreditor ka shfaqur një rritje ndjeshëm më të ulët krahasuar me një vit më parë, konkretisht me 66.1 milion euro ose me 3.9 për qind krahasuar me rritjen me 240.2 milion euro ose 16.7 për qind, të shënuar gjatë vitit 2011. Struktura e mjeteve vazhdon të financohet kryesisht nga depozitat dhe të jetë e përqendruar në aktivitetin e kredidhënies.

Dinamika e rritjes u karakterizua me konsolidimin e vazhduar të sektorit, përkatësisht rritjes së peshës së bankave të vogla dhe degëve të bankave të huaja dhe rënies së peshës së bankave të mëdha. Në vitin 2012 Turkiye Is Bank është licencuar nga BQK për të operuar si degë e huaj e Turkiye Is Bankasi nga Turqia, e cila ka filluar me aktivitetet operativ bankar në fund të Dhjetorit 2012.

Grupi i bankave të vogla (G2)<sup>33</sup> kanë dhënë kontributin kryesorë në rritjen e gjithsej mjeteve të sektorit me rreth 91.5 milion euro ose 3.7 për qind, pasuar nga grupi i degëve të bankave të huaja (G3)<sup>34</sup> me rreth 51.9 milion euro ose 2.0 për qind, përderisa grupi i bankave të mëdha (G1)<sup>35</sup> shënuan rënie të gjithsej mjeteve me rreth 4.8 milion euro ose 0.2 për qind. Pas këtyre ndryshimeve, pjesëmarrja e bankave të vogla (G2) në kuadër të sektorit bankar është rritur në 22.0 për qind në vitin 2012 nga 19.5 për qind sa ishte në vitin 2011. Ngjashëm, pjesëmarrja e degëve të bankave të huaja (G3) është rritur në 8.7 për qind nga 7.2 për qind. Në të kundërt, pjesëmarrja e bankave të mëdha ka rënë në 69.3 për qind nga 73.3 për qind.

Ndryshimet e lartpërmendura në kuadër të sektorit bankar nxisin konkurrencën ndër-bankare duke shtuar peshën e bankave të vogla dhe degëve të bankave të huaja që veprojnë në Kosovë. Rritja e vazhdueshme e aktivitetit të bankave të vogla dhe degëve të bankave të huaja është reflektuar në trendin rënës të shkallës së koncentrimit e cila vlerësohet të jetë relativisht e lartë. Tri bankat më të mëdha në sektorin bankar të Kosovës menaxhojnë rreth 69.3 për qind të gjithsej mjeteve të sektorit, të cilat në vitin e kaluar operonin me rreth 73.3 për qind. Ndryshimeve të lartpërmendura të ndodhura gjatë vitit ka vazhduar t'i adaptohet edhe aktiviteti mbikëqyrës duke shtuar fokusin e monitorimit të performancës financiare dhe ekzaminimeve më të shpeshta në grup-bankat me normë më të lartë të rritjes dhe profilizimin më gjithëpërfshirës të bankave të mëdha duke u bazuar edhe në analizën e qëndrueshmërisë së konsoliduar financiare të grupit të cilit i takojnë.

### Mjetet dhe depozitat - trendi dhe zhvillimet

Gjatë vitit 2012, sektori bankar u karakterizua me normë më të ulët të rritjes së gjithsej mjeteve me 5.5 për qind kundrejt rritjes me 7.6 për qind gjatë vitit 2011.

Struktura e mjeteve të sektorit bankar krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar shfaq këto zhvillime kryesore:

*“Paraja e gatshme dhe gjendja me BQK”* shënoi rritje me rreth 87.2 milion euro ose 26.3 për qind, përkatësisht paraja e gatshme u rrit për 13.1 milion euro ose 11.7 për qind, ndërsa gjendja me BQK për 74.1 milion euro ose 33.7 për qind. Njëherit, pozicioni *“Paraja e gatshme dhe gjendja me BQK”* karakterizohet me rritjen më të lartë krahasuar me pozicionet tjera në kuadër të gjithsej mjeteve të sektorit bankar, duke rritur pjesëmarrjen e tij në gjithsej mjetet në 15.8 për qind nga 13.2 për qind sa ishte në vitin e kaluar. Kjo si rezultat i ndjekjes së një politike më të kujdesshme nga ana e bankave në akordimin e kredive të reja duke forcuar kështu pozitën e likuiditetit.

*“Kërkesat ndaj bankave/plasmanët”* regjistruan rënie me rreth 41.6 milion euro ose 12.6 për qind krahasuar me vitin e mëparshëm, e cila është reflektuar në rënien e peshës së tyre në kuadër të gjithsej mjeteve nga 13.2 për qind në 10.9 për qind në vitin 2012. Zvogëlimi i plasmanëve është drejtuar kryesisht në rritjen e pozicionit më likuid të bankave *“Paraja e gatshme dhe gjendja me BQK”*. BQK, ka vazhduar edhe gjatë këtij viti të ndjekë qasje më të matur për sa i takon limiteve ekzistuese të ekspozimeve të bankave në institucionet financiare jashtë vendit. Nga ky aspekt, është mbajtur niveli rregullator në ekspozimet me rrezik kreditor karshi kapitalit të klasit të

<sup>33</sup> Bankat me pjesëmarrje në treg prej <10% të gjithsej mjeteve.

<sup>34</sup> Përfshin degët e bankave të huaja që veprojnë në Kosovë.

<sup>35</sup> Bankat me pjesëmarrje në treg prej >10% të gjithsej mjeteve.

parë. Kjo çasje është diktuar në masë të madhe nga paqëndrueshmëria e tregjeve financiare globale dhe fluktuimet në tregjet rajonale.

“Investimet në letrat me vlerë” janë rritur për 55.9 milion euro ose për 27.7 për qind, të cilat karakterizohen me një normë më të lartë të rritjes krahasuar me një vit më parë, gjatë të cilit këto investime u rritën me rreth 28.5 milion euro ose 16.4 për qind. Prirja e rritjes më të shpejtë të letrave me vlerë është ndikuar nga strategjia e bankave për të rritur investimet në mjetet të cilat sjellin normë më të lartë të kthimit krahasuar me plasmanët në bankat tjera. Duhet theksuar faktin se rreth 60.0 milion euro bankat komerciale i kanë investuar në bonot e thesarit të Qeverisë së Kosovës, të cilat përmbajnë shkallë zero të rrezikut. Kjo mundësi e re investimi për bankat u mundësua pasi që në vitin 2012 në Kosovë filloj të funksionoj për herë të parë tregu i bonove të thesarit. Pjesëmarrja e letrave me vlerë në kuadër të gjithsej mjeteve është rritur në 9.8 për qind nga 8.1 për qind, përderisa kualiteti është i mirë duke qenë kryesisht letra me vlerë të qeverive qendrore të shteteve me klasifikim të favorshëm, përkatësisht aftësi të lartë paguese.

“Kreditë (Bruto) dhe lizingjet” janë rritur për 66.1 milion euro ose për 3.9 për qind gjatë vitit 2012, krahasuar me rritjen prej rreth 240.2 milion euro ose 16.7 për qind, gjatë vitit paraardhës. Sektori bankar vazhdoj të kreditojë ekonominë e vendit, me një ritëm rritjeje të portofolit të kredisë ndjeshëm më të ulët krahasuar me një vit më parë, e cila u reflektua në rënien e pjesëmarrjes së kredive në kuadër të gjithsej mjeteve nga 62.4 për qind në 60.4 për qind. Kjo ka ardhur si pasojë e një sjelljeje më të kujdesshme nga ana e bankave në akordimin e kredive ndikuar nga zhvillimet e përgjithshme ekonomike në vend si dhe nga rritja e kredive jopërformuese, çka i ka bërë bankat të drejtohen në kreditim më kualitativ e jo vetëm në rritje të vëllimit. Ndërmjetësimi financiar nga sektori bankar, në veçanti aktiviteti kreditues, është një komponent i rëndësishëm në mbështetjen e aktivitetit ekonomik. Gjithsesi, likuiditeti i mjaftueshëm dhe gjendja e mirë financiare e bankave kanë mundësuar aftësinë e bankave për të rritur nivelin e kredidhënies.

Në një analizë të gjithsej kredive sipas sektorëve të ekonomisë vërehet që aktiviteti kreditues vazhdon të jetë i orientuar drejt kreditimit të tregtisë i cili ka peshën më të madhe në gjithsej kreditë dhe zë rreth 35.7 për qind në fund të vitit 2012 nga 36.2 për qind në vitin 2011. Për sa i përket kredive akorduar individëve (kreditë individuale-konsumuese), në dhjetor 2012, ato zënë 29.1 për qind të portofolit ose 0.2 pikë përqindjeje më shumë krahasuar me vitin 2011. Po ashtu, rritje të pjesëmarrjes në gjithsej kreditë e sektorit bankar kanë shënuar kreditë e dhëna për pasuri të patundshme, pjesëmarrja e të cilave është rritur në 8.8 për qind nga 8.1 për qind.

Në të kundërt, rënie të pjesëmarrjes në gjithsej kreditë kanë shënuar kreditë për miniera në 0.9 për qind nga 1.0 për qind, ato për prodhimtari në 7.0 për qind nga 7.1 për qind, kreditë për shërbime, turizëm, hotelieri në 7.4 për qind nga 7.5 për qind. Kreditë për bujqësi edhe pse krahasuar me vitin e kaluar kanë shtuar lehtësisht pjesëmarrjen për 0.1 pikë përqindje, pjesëmarrja e tyre vazhdon të jetë mjaft e vogël në gjithsej kreditë ndaj ekonomisë së vendit me 2.5 për qind.

Edhe pse është evidente rënia e cilësisë së kredive gjatë vitit 2012, kreditë jopërformuese vazhdojnë të jenë të menaxhueshme dhe të mbuluara në nivel të kënaqshëm me provizione për humbjet nga kreditë. Në vijim janë të përshkruara ndryshimet e kategorive të cilësisë së portofolit kreditor.

- “kreditë me vonesa<sup>36</sup> ndaj gjithsej kredive” u rritën nga 10.3 për qind sa ishin në vitin e kaluar në 13.0 për qind në vitin aktual,
- “kreditë me probleme<sup>37</sup> ndaj gjithsej kredive” nga 8.5 për qind në 10.0 për qind si dhe

<sup>36</sup> Kreditë me vonesa përfshijnë kreditë e klasifikuara : vrojtuese, nënstandard, të dyshimta dhe kreditë humbje.

<sup>37</sup> Kreditë me probleme përfshijnë kreditë e klasifikuara : nënstandard, të dyshimta dhe kreditë humbje.

- “kreditë jopërformuese<sup>38</sup> ndaj gjithsej kredive” evidentuan rritje nga 5.9 për qind në 7.5 për qind. Këto zhvillime në cilësinë e kredive kanë ndikuar në rritjen e rezervës për humbjet nga kreditë krahasuar me vitin e kaluar për 32.4 milion euro ose për 28.3 për qind.

**Tabela 20. Kreditë sipas sektorëve të ekonomisë**

Përshkrimi	2011		2012	
	Mijëra euro	Pjesëmarrja (%)	Mijëra euro	Pjesëmarrja (%)
Kreditë për bujqësi	40,489.3	2.4%	43,508.7	2.5%
Miniera	17,227.1	1.0%	16,004.6	0.9%
Prodhimtari	119,594.9	7.1%	122,020.5	7.0%
Energji	23,675.3	1.4%	24,712.0	1.4%
Shërbim, turizëm, hoteleri, restorante	125,239.4	7.5%	128,301.3	7.4%
Komunikim	2,467.8	0.1%	3,725.4	0.2%
Tregti	606,972.1	36.2%	622,510.1	35.7%
Shërbime financiare (të tjera nga kërkesat ndaj bankave)	5,065.9	0.3%	17,907.4	1.0%
Pasuri e patundshme.-ndertimi i pasurisë së patundshme	135,649.5	8.1%	153,278.4	8.8%
Kreditë individuale për amvisri, familje & shpenzime tjera personale (kreditë konsumuese)	484,929.9	28.9%	507,583.6	29.1%
Kreditë tjera	114,269.9	6.8%	102,083.1	5.9%
Lizingjet	0.0	0.0%	0.0	0.0%
Gjithsej kreditë dhe lizingjet	1,675,581	100%	1,741,635	100%

Burimi: BQK (2013)

Struktura e burimeve të financimit të sektorit bankar krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar shfaq këto zhvillime kryesore:

“Gjithsej Depozitat” shënuan rritje vjetore me rreth 170.1 milion euro ose 8.1 për qind. Depozitat pa interes u rritën për 49.2 milion euro ose 9.6 për qind, ndërsa depozitat me interes u rritën për 120.8 milion euro ose për 7.6 për qind krahasuar me vitin e kaluar.

Në kuadër të strukturës së depozitave pa interes janë shënuar këto ndryshime: depozitat nga bankat u rritën për 432.0 mijë euro ose 29.1 për qind, ato nga individët për 30.0 milion euro ose 9.2 për qind si dhe depozitat nga ndërmarrjet evidentuan rritje me rreth 18.8 milion euro ose 10.1 për qind.

Ndërsa, në kuadër të strukturës së depozitave me interes janë shënuar këto ndryshime: depozitat nga bankat u zvogëluan me rreth 6.0 milion euro ose 71.9 për qind, ato nga individët u rritën me rreth 130.9 milion euro ose 10.8 për qind, ndërsa depozitat nga ndërmarrjet u zvogëluan me 4.1 milion euro ose me 1.1 për qind.

Burimi më i rëndësishëm dhe i qëndrueshëm i financimit për sistemin bankar të Kosovës vazhdojnë të jenë depozitat e klientëve. Në fund të vitit 2012, depozitat e klientëve në sektorë arrijnë nivelin prej 2.269 miliardë euro. Gjatë këtij viti, këto depozita janë rritur, megjithëse vërehet një rënie e lehtë e ritmit të rritjes së tyre – konkretisht 8.1 për qind krahasuar me 8.7 për qind sa ishte rritja një vit më parë. Depozitat e klientëve vazhdojnë të ruajnë peshën e lartë që pozicioni i tyre ka në kuadër të gjithsej detyrimeve dhe ekuitetit të aksionarëve. Në vitin

<sup>38</sup> Kreditë jopërformuese përfshijnë kreditë e klasifikuara: të dyshimta dhe kreditë humbje.

aktual kjo pjesëmarrje evidentohet rreth 85.9 për qind. Depozitat e individëve vazhdojnë të përbëjnë pjesën dërrmuese të depozitave të klientëve të sistemit bankar me rreth 74.6 për qind, duke përbërë gjithashtu pjesën kryesore të rritjes së gjithsej depozitave.

Përsa i përket përqendrimit në sektorë, rreth 67.7 për qind të depozitave të klientëve janë përqendruar në 3 bankat më të mëdha të sektorit, shifër kjo 5.3 pikë përqindje më e vogël se një vit më parë, çka dëshmon për një përmirësim të raportit të përqendrimit të depozitave në 3 bankat më të mëdha.

“*Ekuiteti i aksionarëve*” shënoi rritje vjetore me rreth 11.0 milion euro ose 4.3 për qind, megjithatë norma e rritjes ishte më e ngadaltë krahasuar me një vit më parë gjatë të cilit “*Ekuiteti i aksionarëve*” evidentoi rritje vjetore me rreth 22.4 milion euro ose me 9.7 për qind. Rritja më e ngadaltë e këtij zëri është ndikuar kryesisht nga shpërndarja e dividendës nga dy banka të sektorit gjatë vitit 2012 si dhe nga rritja e fitimeve me një normë më të ulët gjatë vitit 2012 krahasuar me vitin 2011. Shuma e shpërndarë e dividendës në sektorin bankar në vitin 2012 ishte në vlerë prej 32.0 milion euro, nga e cila 15.0 milion euro janë rikapitalizuar. Rrjedhimisht, pjesëmarrja e zërit “*Ekuiteti i aksionarëve*” në gjithsej mjetet e sektorit bankar në fund të vitit 2012 ka rënë në 10.0 për qind nga 10.1 për qind sa ishte në fund të vitit 2011. Megjithatë, ky tregues vazhdon të evidentoj normë ndjeshëm më të lartë krahasuar me kërkesën rregullative të BQK-së, e cila kërkon që bankat të mirëmbajnë raportin minimal të levës<sup>39</sup> prej 7.0 për qind.

### **Kapitali rregullator-mjaftueshmëria dhe trendi**

Gjithsej kapitali rregullator<sup>40</sup> në sektorin bankar në vitin 2012 për dallim nga viti 2011 u karakterizua me trend të rënies. Vlera e gjithsej kapitalit rregullator raportohet rreth 277.1 milion euro, që paraqet një rënie vjetore në shumë prej 20.8 milion euro ose 7.0 për qind. Në këtë ndryshim të kapitalit rregullator posaqërisht pati ndikim implementimi i Ligjit për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare (këtu e tutje: Ligji për bankat) si dhe ndryshimet rregullative bankare. Po ashtu, në vitin 2012 dy nga bankat e sektorit shpërndanë dividendë nga fitimet e tyre të mbajtura në vlerë prej 32.0 milion euro nga të cilat 15.0 milion euro u rikapitalizuan. Megjithatë, në sektorin bankar ishte evidente edhe shtimi i kapitalit të freskët nga aksionarët e bankave me rreth 8.5 milion euro gjatë vitit 2012. Rëndësia e këtij zhvillimi, është tregues i gatishmërisë së aksionarëve për të mbështetur aktivitetin bankar.

Ashtu sikurse paraqitet në tabelën e mëposhtme, kapitali aksionar (i paguar) vazhdon të jetë elementi më i rëndësishëm i ekuitetit të aksionarëve, i cili në vitin 2012 shënoi rritje për 23.5 milion euro ose 13.3 për qind. Fitimi neto i sektorit shënon nivel prej 18.6 milion euro, i cili duket të jetë më i ulët se ai i vitit të kaluar për 15.9 milion euro ose për 46.0 për qind.

Kapitali i klasit të parë të sektorit bankar përbën komponentin kryesor të kapitalit rregullator me një peshë prej 81.9 për qind, çka tregon për një kapital rregullator cilësisht të mirë dhe të qëndrueshëm. Megjithatë, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, në fund të vitit 2012 pesha e tij ka shënuar një rënie të lehtë prej 2.0 pikë përqindjeje.

<sup>39</sup> Raporti i levarazhit është i barabartë me gjithsej ekuitetin ndaj gjithsej mjeteve

<sup>40</sup> Kapitali rregullator = kapitali i klasit të parë + kapitali i klasit të dytë

**Tabela 21. Struktura e kapitalit rregullator dhe ecuria e komponentëve të tij**

Përshkrimi	2011		2012	
	Mjëra euro	Pjesëmarrja (%)	Mjëra euro	Pjesëmarrja (%)
Kapitali (Kapitali aksionar, teprica, akc. e pref)	176,574	59.3%	200,074	72.2%
Fondet rezervë	606	0.2%	853	0.3%
Fitimi (humbja) për vitin e aktual	34,555	11.6%	18,649	6.7%
Fitimi i pashpërndarë nga vitet paraprake	41,933	14.1%	44,366	16.0%
Mjetet jo materiale dhe vlera e emrit të mirë	3,821	1.3%	5,059	1.8%
Investimet në ekuitetin e bankave tjera apo institucione kreditore	0	0.0%	333	0.1%
Huazimet e personave të ndërlidhur me bankën	0	0.0%	31,584	11.4%
Gjithsej kapitali i klasit të I-rë (I)	249,848	83.9%	226,967	81.9%
Provizioni i përgjithshëm për kreditë *	16,520	5.5%	19,063	6.9%
Aksionet preferenciale të zakonshme	0	0.0%	0	0.0%
Aksionet preferenciale me afat	0	0.0%	0	0.0%
Borxhet e varura	31,045	10.4%	31,045	11.2%
Instrumente tjera	442	0.1%	0	0.0%
Gjithsej kapitali i klasit të dytë (II)	48,007	16.1%	50,109	18.1%
Gjithsej kapitali (I+II)	297,855	100.0%	277,076	100.0%

\* (Standard dhe Vrojtuese) Limituar deri në 125% të mjeteve të rrezikuara

Burimi: BQK (2013)

Kapitali i klasit të dytë, i cili përbëhet nga provizionet e përgjithshme për kreditë dhe borxhi i varur, llogaritet në nivelin prej 50.1 milion euro, kundrejt 48.0 milion euro në fund të vitit 2011, duke përfaqësuar rreth 18.1 për qind të kapitalit rregullator. Numri i bankave me borxh të varur mbetet dy, njësoj sikurse në fund të vitit 2011.

**Tabela 22. Treguesit e kapitalizimit, në përqindje**

Përshkrimi	Dhjetor 2011	Mars 2012	Qershor 2012	Shtator 2012	Dhjetor 2012
Gjithsej kapitali/ Gjithsej mjetet e rrezikuara	17.5	18.0	17.2	17.7	14.2
Ekuiteti i aksionarëve / Gjithsej mjetet	10.1	10.6	10.3	10.1	10.0
Kreditë me probleme (neto) / Kapitali i kl.I-rë	17.7	17.3	20.5	18.9	19.8

Burimi: (2013)

Treguesi i kapitalit të bazuar në rrezik “gjithsej kapitali ndaj gjithsej mjeteve të rrezikuara”, si tregues thelbësor mbikëqyrës, në vitin 2012 shënoi rënie të ndjeshme krahasuar me vitin 2011, respektivisht nga 17.5 për qind në 14.2 për qind. Rënia e këtij treguesi është ndikuar kryesisht nga rënia e gjithsej kapitalit me rreth 20.8 milion euro ose 7.0 për qind si dhe nga rritja e gjithsej mjeteve të rrezikuara me rreth 243.9 milion euro ose 14.3 për qind. Në zbatim të Ligjit për Bankat dhe ndryshimeve rregullative, kapitali rregullator është zvogëluar për shumën e kredive të dhëna personave të ndërlidhur me bankën si dhe kërkesat e tjera të lidhura me peshimin e mjeteve të rrezikuara për rrezikun operacional. Shuma e kredive të dhënave personave të ndërlidhur me bankën në fund të vitit 2012 evidenton nivel prej 31.6 milion euro, ndërsa shuma e peshuar e mjeteve për rrezikun operacional është rreth 179.5 milion euro. Megjithatë, raporti i kapitalit të bazuar në rrezik tejkalon ndjeshëm nivelin minimal rregullator prej 12.0 për qind.

Pesha e kredisë neto me probleme ndaj kapitalit të klasit të parë përlogaritet 19.8 për qind nga 17.7 për qind sa ishte në fund të vitit të kaluar. Rritja e këtij treguesi është rrjedhojë e rënies së kapitalit të klasit të parë, në njërën anë si dhe në anën tjetër rritjes së kredisë neto me probleme. Ashtu sikurse është potencuar edhe më lartë, rënia e kapitalit të klasit të parë është rezultat i zbatimit të Ligjit për Bankat dhe ndryshimeve rregullative ndaj bankave.

Raporti "ekuiteti i aksionarëve ndaj gjithsej mjeteve" si indikator i nivelit të mbështetjes së mjeteve nga ekuiteti i aksionarëve ka shënuar trend të lehtë të rënies. Rënia e këtij treguesi nga 10.1 për qind në 10.0 për qind do të thotë se sektori për financimin e mjeteve edhe këtë vit vazhdon të mbështetet më shumë në borxh. Rrjedhimisht, sektori bankar u karakterizua edhe me rritjen e gjithsej detyrimeve me një ritëm më të shpejtë, përkatësisht rritje për 127.7 milion euro ose 5.7 për qind krahasuar me ritmin e rritjes së ekuitetit të aksionarëve me rreth 11.5 milion euro ose 4.5 për qind krahasuar me vitin e kaluar. Megjithatë, ky tregues vazhdon të jetë ndjeshëm mbi normën e kërkuar rregullative prej 7.0 për qind.


### Cilësia e kredive

Në vitin 2012 gjithsej kreditë e sektorit bankar shënuan rritje me rreth 66.1 milion euro ose 3.9 për qind, të cilat karakterizohen me një normë më të ulët të rritjes krahasuar me vitin 2011, gjatë të cilit gjithsej kreditë evidentuan rritje me rreth 240.2 milion euro ose 16.7 për qind. Rritja më e lartë e kredive konstatohet në tremujorin e dytë të vitit 2012 me 59.5 milion euro, ndërsa rritja më e ulët rezulton në tremujorin e parë 2012 me një rënie prej 21.7 milion euro. Rritja e nivelit të kredisë u ndikua kryesisht nga grupi i bankave të vogla (G2), pasuar nga grupi i bankave të mëdha të grupit G1, me përkatësisht 58.4 milion euro (3.5 për qind) dhe 8.6 milion euro (0.5 për qind), ndërsa grupi i degëve të bankave të huaja evidentuan rënie të lehtë me 923 mijë euro (0.1 për qind).

Rritja mujore e gjithsej kredive karakterizohet me një ecuri të luhatshme nga muaji në muaj gjatë vitit 2012. Rritja mesatare mujore e kredive gjatë vitit 2012 është në vlerën e 0.3 për qind. Rritja mujore më e lartë e kredive evidentohet në mars 2012 prej 1.5 për qind, ndjekur nga muaji prill dhe qershor me rreth 1.4 për qind, respektivisht 1.2 për qind. Ndërsa muaji që ka pasur rënien më të lartë të kredive rezulton muaji janar 2012 me një rënie prej 0.9 për qind.

Zhvillimet tregojnë për një rritje të ekspozimit të sektorit bankar ndaj rrezikut kreditor. "Kreditë me probleme ndaj gjithsej kredive" dhe "kreditë jopërformuese ndaj gjithsej kredive" evidentuan rritje nga 8.5 për qind dhe 5.9 për qind sa ishin në vitin 2011, në 10.0 për qind dhe 7.5 për qind në vitin 2012. Rënia e cilësisë së kredive është rezultat i rritjes së kredive të "Dyshimta" dhe kredive "Humbje" për 8.1 milion euro ose 22.2 për qind dhe 23.6 milion euro ose 37.9 për qind, në njërën anë si dhe në anën tjetër rritjes së gjithsej kredive me një trend më të ulët rritës gjatë vitit 2012. Megjithatë, rezervat për humbjet nga kreditë mbulojnë në nivel të kënaqshëm kreditë jopërformuese prej 112.4 për qind. Kjo nënkupton që sektori bankar vazhdon t'i trajtoj me kujdes të duhur kreditë jopërformuese përmes ndarjes adekuate të rezervave për humbjet nga kreditë.

Figura 101. Norma e rritjes (zvogëlimit) mujore të kredive gjatë vitit 2012



Burimi: BQK (2013)

**Tabela 23. Treguesit e cilësisë së kredive, në përqindje**

Treguesit	Dhjetor 2011	Mars 2012	Qershor 2012	Shtator 2012	Dhjetor 2012
Kreditë me vonesa / Gjithsej kreditë	10.3	10.8	11.5	12.1	13.0
Kreditë me probleme / Gjithsej kreditë	8.5	8.8	9.5	9.8	10.0
Kreditë joperformuese / Gjithsej kreditë	5.9	5.9	6.5	7.0	7.5
Rezervat për humbjet nga kreditë / Kreditë joperformuese	115.6	119.6	117.3	115.0	112.4

Burimi: BQK (2013)

Në analizën e cilësisë së kredive sipas sektorëve të kredituar të ekonomisë nuk është shënuar ndonjë ndryshim i madh në fund të vitit 2012 krahasuar me fundin e vitit 2011. Niveli më i lartë i kredive joperformuese vazhdon të shfaqet tek kreditë për tregti, pjesëmarrja e të cilëve në gjithsej kreditë e sektorit bankar është rritur në 3.7 për qind nga 3.1 për qind sa ishte në vitin e kaluar. Ngjashëm, kreditë joperformuese për kreditë e akorduara individëve (kreditë konsumuese) evidentuan rritje në 0.7 për qind në fund të vitit 2012, nga 0.4 për qind sa ishin në fund të vitit 2011.

**Tabela 24. Kreditë joperformuese sipas sektorëve të ekonomisë**

Përshkrimi	2011	2012
	Pjesëmarrja (%)	Pjesëmarrja (%)
Kreditë për bujqësi	0.06	0.09
Miniera	0.02	0.02
Prodhimtari	0.94	0.78
Energji	0.03	0.16
Shërbim, turizëm, hotelleri, restorante	0.74	0.77
Komunikim	0.00	0.01
Tregti	3.15	3.75
Shërbime financiare (të tjera nga kërkesat ndaj bankave)	0.01	0.00
Pasuri e patundshme.-ndertimi i pasurise së patundshme	0.29	1.03
Kreditë individuale për amvisri, familje & shpenzime tjera personale (kreditë konsumuese)	0.43	0.66
Kreditë tjera	0.24	0.23
Lizingjet	0.00	0.00
Gjithsej kreditë dhe lizingjet	5.91	7.50

Burimi: BQK (2013)

### Profitabiliteti i sektorit bankar

Performanca e sektorit bankar gjatë vitit 2012, në këndvështrimin e fitimit neto prezantohet me ritme më të ulëta rritjeje krahasuar me vitin 2011. Fitimi neto i realizuar gjatë vitit 2012 në vlerë prej 18.6 milion euro ka qenë rreth 15.9 milion euro ose 46.0 për qind më i ulët, ku përcaktues në këtë rezultat ishte rritja e ndjeshme e provizioneve për humbjet nga kreditë, si rezultat i dobësimit të cilësisë së kredive. Në fund të vitit 2012 provizionet për humbjet nga kreditë evidentojnë një nivel prej 49.2 milion euro, të cilat janë më të larta krahasuar me fundin e vitit 2011 për 14.1 milion euro ose 40.1 për qind. Treguesit kryesorë të profitabilitetit, respektivisht kthimi nga mjetet mesatare - ROAA (Angl: Return On Average Assets) dhe kthimi nga ekuiteti mesatar – ROAE (Angl: Return on Average Equity) regjistruan rënie nga 1.4 për qind dhe 14.3 për qind sa ishin në vitin e kaluar, në 0.7 për qind dhe 7.2 për qind në vitin aktual.

**Tabela 25. Treguesit e profitabilitetit (të përvitësuar), në përqindje**

Treguesit	Dhjetor 2011	Mars 2012	Qershor 2012	Shtator 2012	Dhjetor 2012
Kthimi nga mjetet mesatare (ROAA)	1.4	1.4	0.9	0.9	0.7
Kthimi nga ekuiteti mesatar (ROAE)	14.3	13.2	9.0	8.9	7.2
Margjina neto e interesit (MNI)	6.4	6.3	6.4	6.2	6.1
Të ardhurat neto nga interesi / Shpenzimet e përgjithshme	140.7	141.0	142.1	138.2	134.2

Burimi: BQK (2013)

Analiza e treguesit të ROAA-së sipas grup-bankave, tregon një rentabilitet dukshëm më të lartë të grupit të bankave të mëdha (G1) në raport me dy grupet e tjera (G2 & G3). Treguesi i ROAA-së për G1 përlllogaritet rreth 1.4 për qind duke shënuar një rënie krahasuar me atë të periudhës paraprake 1.8 për qind. Për bankat e G2 dhe G3 ROAA prezantohet në nivelet negative, respektivisht minus 0.1 për qind (nga 0.6 për qind) dhe minus 2.5 për qind (nga 0.2 për qind). Marzha neto nga interesat (MNI)<sup>41</sup> evidentoi rënie të lehtë prej 0.3 pikë përqindje, duke regjistruar një normë prej 6.1 për qind. Niveli i lartë i treguesit të efikasitetit<sup>42</sup> prej 134.2 për qind tregon për efikasitet të lartë në mbulimin e shpenzimeve të përgjithshme nga të hyrat neto nga interesi. Profitabiliteti i bankave vazhdon të siguroj mbështetjen kryesore dhe qëndrueshmërinë e kapitalit.

#### Likuiditeti i sektorit bankar

Sektori bankar edhe gjatë vitit 2012 u karakterizua me likuiditet të kënaqshëm ndonëse treguesit kryesorë të likuiditetit reflektuan tendencë rënëse krahasuar me vitin 2011. “Mjetet likuide ndaj gjithsej mjeteve” dhe “mjetet likuide ndaj gjithsej depozitave” përlllogariten 30.5 për qind dhe 35.5 për qind nga nivelet 32.3 për qind dhe 38.5 për qind sa ishin në vitin e kaluar. Prirja rënëse e këtyre treguesve është ndikuar kryesisht nga ndryshimet rregullative, të cilat kanë hyrë në fuqi në dhjetor të vitit 2012. Burimi kryesorë i financimit të mjeteve – depozitat kanë vazhduar trendin e rritjes duke regjistruar rritje vjetore me rreth 170.1 milion euro ose 8.1 për qind. Në financimin e aktivitetit bankar (në detyrimet e bilancit të gjendjes), vërehet se kontributi në gjenerimin e fondeve ka ardhur tërësisht nga aktiviteti depozitues.

**Tabela 26. Treguesit e likuiditetit, në përqindje**

Treguesit	Dhjetor 2011	Mars 2012	Qershor 2012	Shtator 2012	Dhjetor 2012
Kredi / Depozita	79.8	81.3	83.3	78.7	76.7
Mjete likuide / Gjithsej mjete	32.3	31.2	29.4	33.7	30.5
Mjete likuide / Gjithsej depozita	38.5	37.1	34.7	39.6	35.5
Mjete likuide / Gjithsej detyrime	36.2	34.9	32.8	37.5	33.9

Burimi: BQK (2013)

Rritja e depozitave gjatë vitit 2012 u shoqërua me një rritje ndjeshëm më të ulët të gjithsej kredive. Kjo rezultoi në një rënie të treguesit kredi ndaj depozita, i cili ka pasur një trend të qëndrueshëm gjatë vitit 2012, duke shënuar normën prej 76.7 për qind nga 79.8 për qind sa ishte në vitin 2011. Sipas grup-bankave evidentohet rritje e depozitave në të tre grupet, përkatësisht me rreth 92.3 milion euro në G2, 74.2 milion euro në G3 si dhe 3.6 milion euro në G1. Gjatë vitit

<sup>41</sup> MNI = Neto të hyrat nga interesi / Mjetet mesatare fitimprurëse

<sup>42</sup> Treguesi i efikasitetit = Të ardhurat neto nga interesi / Shpenzimet e përgjithshme

2012, të gjitha bankat kanë qenë në përputhje të plotë me rregulloren e BQK-s, që përcakton kërkesën mbi minimumin e rezervave të bankës.

### Ekzaminimet në vend

Me qëllim të përmbushjes së objektivave të përcaktuara ligjore, gjatë ekzaminimeve të bankave fokusi ka qenë kryesisht në vlerësimin e rreziqeve bankare me të cilat janë ballafaquar bankat, në veçanti rreziku kreditor.

Edhe përkundër angazhimit të personelit të Departamentit për Mbikqyrje Bankare në kuadër të grupeve punuese në përpilimit e rregulloreve bankare si pjesë e legjislacionit dytësor, të dalë nga ligji për bankat, IMF dhe IFJB në vitin 2012, është vazhduar me implementimin e planit vjetor i aprovuar i ekzaminimeve të bankave.

Gjatë vitit 2012, janë realizuar gjithsej gjashtë (6) ekzaminime të bankave, prej të cilave dy (2) ekzaminime të plota dhe katër (4) ekzaminime të fokusuar.

Ekzaminimet e plota kanë pasur qëllim vlerësimin e gjendjes së përgjithshme të bankës, duke përfshirë kontrollet e brendshme, pajtueshmërinë me rregullat dhe rregulloret e BQK-së, praktikat bankare, vlerësimin e kapitalit, kualitetin e mjeteve, vlerësimin e politikave dhe procedurave, menaxhmentin, fitimet, likuiditetin dhe ndjeshmërinë ndaj rrezikut të tregut. Gjithashtu ekzaminimi i plotë ka përfshirë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së funksionit të parandalimit të pastrimit të parasë si dhe vlerësimin e teknologjisë informative. Në raste të caktuara, kur nga rezultatet e ekzaminimit është vlerësuar që bankës ti lëshohet një memorandum i mirëkuptimit nga BQK-ja, gjatë ekzaminimit ishte përcjellë edhe implementimi i memorandumit të mirëkuptimit nga banka sipas afateve të përcaktuara kohore.

Ndërsa, ekzaminimet e fokusuar kanë pasur qëllim përcjelljen e përmbushjes së rekomandimeve nga ekzaminimet e kaluar të BQK-së si dhe në raste të caktuara edhe përcjelljen e implementimit të "Vendimit" të BQK-së si rezultat nga ekzaminimi i kaluar i BQK-së. Është vlerësuar procesi i lejimit dhe administrimit të kredive, trendi i kualiteti të kredive, adekuatshmëria e provizioneve për humbje nga kreditë, zërat jashtëbilancor, kredit ndaj personave të brendshëm. Gjithashtu, është ekzaminuar edhe burimi i prejardhjes së fondeve të deponuara të klientëve në bankë.

### Spektori mikrofinanciar dhe jobankar<sup>43</sup>

Institucionet mikrofinanciare dhe jobankare të kreditimit edhe përgjatë vitit 2012 kanë shfaqur ritëm rënës të gjithsej mjeteve. Shuma e gjithsej mjeteve të këtij sektori ishte në shumë prej 108.9 milion euro, duke shënuar rënie vjetore prej 13.1 milion euro ose 10.8 për qind për dallim nga niveli i rënies vjetore prej 2.1 për qind në vitin 2011. Rënia e gjithsej mjeteve i referohet kryesisht vazhdimin të zvogëlimin të mjeteve të në dy institucionet më të mëdha mikrofinanciare e që kjo ka rrjedhë nga zvogëlimi huamarrjeve të tyre karshi kreditorëve përkatës.

Ky sektor vazhdon të karakterizohet me shkallë të lartë të përqendrimit ku rreth 55.2 për qind e gjithsej mjeteve menaxhohen nga katër institucione. Megjithatë, në vitin 2012 evidentohet rënie e shkallës së përqendrimit krahasuar me vitet paraprake prej 57.7 për qind në 2011, përkatësisht 67.4% në 2010.

Mjetet në këtë sektor financohen kryesisht nga huamarrjet të cilat përbëjnë rreth 65.7 për qind dhe ekuiteti prej 34.3 për qind të gjithsej mjeteve. Krahasuar me vitin 2012 detyrimet në raport

<sup>43</sup> Përfshinë: Institucionet jo-bankare të cilat aktivitet kanë kreditimin - përfshirë edhe lizingun financiar, Agjencionet për transfer të parave, Zyrat për këmbimin e valutave.

me gjithsej mjetet kanë rënë për 1.9 pikë përqindje, respektivisht për të njëjtën pikë përqindje është ngritur pjesëmarrja e ekuitetit. Detyrimet gjatë vitit 2012 shënuan rënie vjetore rreth 11.0 milion euro ose 13.3 për qind, përderisa ekuiteti edhe përkundër rritjes në raport me gjithsej mjetet nga viti paraprak ka shënuar një rënie vjetore prej 2.1 për qind, respektivisht rënie për 2.1 milion euro, zvogëlim ky i reflektuar nga humbjet e vitit 2012.

Aktiviteti i këtyre institucioneve vazhdon të jetë i përqendruar në kreditimin e bizneseve të vogla dhe ekonomive familjare. Portofoli i kredive në fund të vitit 2012 është në shumë prej 98.2 milion euro, që paraqet një rënie vjetor prej 6.4 milion euro ose 6.3 për qind, megjithatë në vitin paraprak ka patur rënje vjetore prej 12.4 milion euro apo 10.6 pikë përqindje. Gjithashtu, nga vitit 2011 në 2012 kreditë bruto kanë shtuar peshën e tyre në kuadër të gjithsej mjeteve për 4.4 pikë përqindje. Në strukturën e gjithsej mjeteve kreditë neto në shumë prej 91.6 milion euro marrin pjesë me 84.1 për qind.

### Cilësia e kredive

Treguesit e cilësisë së portofolit kreditor kanë pasur ecuri të përkeqësimit të vogël krahasuar me vitin paraprak. Raporti i kredive me probleme ndaj gjithsej kredive dhe raporti i kredive jopërfomuese ndaj gjithsej kredive pasqyrohet në nivelet prej 7.3 për qind dhe 5.3 për qind, përderisa në fund të vitit 2011 ishte 4.8 për qind, përkatësisht 3.8 për qind. Rezervat për humbjet nga kreditë në raport me gjithsej kreditë sillen në nivele prej 6.8 për qind, që paraqet rritje prej 1.4 pikë përqindje nga viti 2011. Në dhjetor 2012 shkalla e mbulueshmërisë së kredive jopërfomuese me rezerva për humbjet nga kreditë është në nivel 128.8 për qind nga 139.3 për qind sa ishte vitin e kaluar. Niveli i tillë megjithatë paraqet raport të kënaqshëm të mbulueshmërisë dhe nënkupton që ky sektor vazhdon t'i trajtoj me kujdes kreditë jopërfomuese përmes ndarjes adekuate të rezervave për humbjet nga kreditë.

**Tabela 27. Ecuria e treguesit të cilësisë së kredisë për periudhën 2011 – 2012, në përqindje**

Treguesit	Dhjetor 2011	Mars 2011	Qershor 2012	Shtator 2012	Dhjetor 2012
Kreditë me probleme / Gjithsej kreditë	4.8	6.1	7.6	8.5	7.3
Kreditë jopërfomuese / Gjithsej kreditë	3.8	4.8	6.4	7.0	5.3
Rezervat për humbjet nga kreditë / Kreditë jopërfomuese	139.3	135.1	119.2	113.7	128.8

Burimi: BQK (2013)

### Profitabiliteti i sistemit mikrofinanciar

Sektori mikrofinanciar dhe jo-bankar kreditues gjatë vitit 2012 ka gjeneruar humbje neto në shumë prej 4,454 mijë euro, përderisa në fund vitin 2011 performanca e këtij sektori në këndvështrimin e fitimit prezantonte fitime modeste prej 704 mijë euro.

Shpenzimet e përgjithshme në vitin 2012 kanë shfaqur nivele të ngjashme me ato të vitit 2011, që do të thotë se profitabiliteti i sektorit konsiston kryesisht nga zvogëlimi i të ardhurave neto nga interesi si dhe rritja rritja e provizioneve për humbjet nga kreditë, si rezultat i dobësimit të cilësisë së kredive.

Treguesit kryesor të profitabilitetit evidentojnë përkeqësim të theksuar krahasuar me vitin 2011. Kthimi nga mjetet mesatare (ROAA) dhe kthimi nga ekuiteti mesatar (ROAE) shënojnë nivele negative prej minus 0.4 për qind dhe minus 11.8 për qind nga 0.6 për qind, respektivisht 1.8 për qind sa ishin në vitin 2011.

**Tabela 28. Ecuria treguesit të profitabilitetit për periudhën dhjetor 2011 – dhjetor 2012, në përqindje**

Treguesit	Dhjetor 2011	Mars 2011	Qershor 2012	Shtator 2012	Dhjetor 2012
Kthimi nga rjetet mesatare (ROAA)	0.6	-4.4	-4.6	-4.5	-4.0
Kthimi nga ekuiteti mesatar (ROAE)	1.8	-13.8	-13.9	-13.5	-11.8
Margjina neto e interesit (MNI)	15.5	12.3	12.9	12.9	13.6
Të ardhurat neto nga interesi / Shpenzimet e përgjithshme	107.3	88.7	88.3	85.5	86.8

Burimi: BQK (2013)

Marzha neto nga interesi (MNI)<sup>44</sup> historikisht ka qenë mjaft e lartë në këtë sektor, megjithatë përgjatë vitit 2012 ka një mesatare prej 12.9 për qind për dallim nga mesatarja e vitit paraprak prej 14.5 për qind. Niveli i ulët i treguesit të efikasitetit<sup>45</sup> prej 133.8 për qind tregon për mos efikasitet në mbulimin e shpenzimeve të përgjithshme nga të hyrat neto nga interesi.

### Ekzaminimet në vend

Gjatë vitit 2012 janë kryer tri (3) ekzaminime të plota në institucione mikrofinanciare dhe një ekzaminim i fokusuar në një nga institucionet financiare jo-bankare kredidhëse, si dhe është vazhduar me përcjelljen e përmbushjes së rekomandimeve mbikëqyrëse për institucionet përkatëse mikrofinanciare dhe jobankare. BQK në raste të mos-transparencës apo mos-zbatimit të kërkesave përkatëse ka ndërmarr masa korrektuese ndaj institucioneve në fjalë .

### Parandalimi i pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit

Komform objektivave përkatëse edhe gjatë vitit 2012 mbikëqyrja bankare është fokusuar në vetëdijesimin e sektorit privat dhe publik mbi parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit PPP/PFT, përmirësimin e infrastrukturës ligjore dhe strukturave raportuese në funksion të PPP/PFT.

BQK-ja gjatë vitit 2012 ka vazhduar të kontriboj në vetëdijesimin e sektorit privat dhe publik mbi PPP/FT me anë prezantimeve të ndryshme nga stafi profesional i Departamentit të Mbikëqyrjes Bankare në tryeza diskutimi dhe organizime të shumta në bashkëpunim me Policinë e Republikës së Kosovës, Shoqatën e Bankave, Departamentin e Thesarit Amerikan, Organizatën për Siguri dhe Bashkëpunim Evropian dhe palë tjera të interesit.

Sa i përket infrastrukturës ligjore BQK-ja në bashkëpunim me Ministrinë e Financave, Njësinë për Inteligjencë Financiare të Republikës së Kosovës, EULEX-in dhe përmes Asistencës Teknike të Departamentit të Thesarit Amerikan ka luajtur rol thelbësor në identifikimin e zbrazëtirave dhe gabimeve në Ligjin Për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit të dekretuar në vitin 2008. Si rezultat, ligji me ndryshimet dhe plotësimet e propozuara është miratuar në Kuvend në fillim të vitit 2012. Komform këtyre ndryshimeve dhe plotësimeve BQK-ja gjithashtu është në proces të ri-hartimit të legjislacionit sekondar në fushën e PPP/PFT.

Gjithashtu gjatë vitit BQK-ja ka luajtur rol të rëndësishëm në luftimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit në Kosovë duke kontribuar në implementimin e Projektit kundër Krimin

<sup>44</sup> MNI = Neto të hyrat nga interesi / Mjetet mesatare fitimprurëse

<sup>45</sup> Treguesi i efikasitetit = Të ardhurat neto nga interesi / Shpenzimet e përgjithshme

Ekonomik në Kosovë të iniciuar nga Bashkimi Evropian dhe Këshilli i Evropës. Synimi i këtij Projekti është forcimi i kapaciteteve institucionale në bashkëpunim me Këshillin e Evropës në fushën e PPP/PFT.

Mbikëqyrja bankare, gjatë vitit 2012 ka kryer ekzaminime të përgjithshme periodike në banka, institucione mikrofinanciare dhe institucione financiare jo-bankare me fokus në pajtueshmërinë me legjislacionin për PPP/FT. Nga këto ekzaminime është evidentuar se institucionet e lartpërmendura kanë avancuar infrastrukturën e nevojshme në funksion të PPP/FT; si politikat, procedurat dhe sistemet në identifikimin, njohjen dhe raportimin e transaksioneve të dyshimta dhe përgjithësisht në adresimin e kësaj fushe të ndjeshme si në rrafshin vendorë e gjithashtu edhe në atë ndërkombëtarë.

Megjithatë, si rezultat i ndryshimeve të fundit të kornizës ligjore të gjitha institucionet që mbeten subjekt monitorimi i vazhdueshëm nga BQK në kursin e rregullt të mbikëqyrjes në vend dhe monitorimit nga jashtë janë në proces të harmonizimit të pajtueshmërisë me kornizën ligjore të re.

### **Pajtueshmëria me kornizën rregullative ligjore-veprimet detyruese**

Sistemi bankar përgjithësisht ka vepruar në përputhje me kërkesat e kuadrit ligjor dhe rregullativ mbikëqyrës. Megjithatë, gjatë ekzaminimeve në vend të bankave janë evidentuar disa mangësi në drejtim të praktikave të qeverisjes, administrimit të rrezikut të kredisë, tejkalimin e kufizimeve të ekspozimeve kreditor, mjaftueshmërinë e kapitalit të peshuar në rrezik si dhe saktësinë e raportimit.

Gjatë ekzaminimeve të bankave janë evidentuar mos pajtueshmëri me kornizën rregullative dhe ligjore të BQK-së si në vijim:

- Bordi i drejtorëve nuk ka mbikëqyrur në masë të duhur zbatimin e politikave vijuese:
  - o Politikës së menaxhimit të rrezikut kreditor;
  - o Politikës së rrezikut operacional dhe
  - o Politikës së menaxhimit të rrezikut të normës së interesit;
- Komiteti i menaxhimit të rrezikut kreditor nuk ka monitoruar në masë të duhur:
  - o Zbatimin e politikave dhe procedurave për dhënien e kredive;
  - o Administrimin e kredive si dhe nuk ka monitoruar pajtueshmërinë me Rregulloren 1999/21 dhe Rregullën IX-të të BQK-së;
    - o Shuma e zëvendësuesve të kredive, përkatësisht garancionet për pjesëmarrje në tender në shumë të caktuar ishin peshuar me faktorë të rrezikut prej 0%, përderisa sipas rregullores së BQK-së për mjaftueshmëri e kapitalit kërkohet që zëvendësuesit direkt të kredive të peshohen me 20%;
    - o Tejkalimi i limitit të ekspozimeve të huamarrësve mbi limitet e përcaktuara me rregulloren mbi ekspozimet e mëdha;
    - o Mos klasifikimi i kredive në pajtueshmëri me rregullën e IX-të të BQK-së;
    - o Nënvlërësimi i provizioneve për humbje nga kreditë sipas kërkesës së rregullës së IX-të të BQK-së

Si rezultat i evidentimit të mos pajtueshmërisë së disa bankave me kornizën rregullative dhe ligjore, BQK-ja ka ndërmarr masa detyruese ndaj disa bankave dhe ka listuar fushat që kërkojnë vëmendjen e bordit të drejtorëve si në vijim:

- Masat përmirësuese, në formë të “Vendimeve”;
- Shqiptimi i dënimeve me gjoba monetare;
- Vërejtje me shkrim për mos ushtrimin me përgjegjësi të funksioneve përkatëse, të personave përgjegjës:
  - - Kërkesë për ripublikim të pasqyrave financiare, duke u bazuar në korrigjimet e pozicioneve financiare nga rezultat e ekzaminimit të BQK-së;
- Zëvendësimi i anëtarëve aktual të bordit të drejtorëve me anëtar të rinjë profesionist, dhe në pajtueshmëri me kërkesat e ligjit për bankat, IMF-et dhe IFJB-et;
- Rritja e kapitalit aksionar, në mënyrë që të plotësojë kapitalin e bazuar në rrezik në nivelet e kërkuara me rregulloren e BQK-së për mjaftueshmërin e kapitalit;
- Ekzekutimin e depozitave të bllokuara për kredit të cilat janë në vonesa në pagesa, siç specifikohet me politikat e bankës;
- Sjellja e të gjitha ekspozimeve kreditorë të huamarrësve në kufirin e përcaktuar rregullativ dhe ligjor të BQK-së;
- Sjellja në nivelin rregullator, e kredive të personave të lidhur me bankën në kufirin prej 100% të kapitalit të klasit të I-rë, të përcaktuar me rregullën e XX-të të BQK-së;
- Sjellja e raportit mes ekuitetit dhe gjithsej mjeteve në nivelin prej minimum prej 10%;
- Përmirësimi i sistemit të informimit të menaxhimit dhe praktikat e menaxhimit të rrezikut kreditor;
- Përpilimi i planit për përmirësimin e fitimeve, duke analizuar racionalizimin e shpenzimeve të kostove tjera që ngarkojnë pozitën financiare;
- Përpilimi i planit për zvogëlimin e përqendrimit të portofolit kreditor në ekspozimet e mëdha;
- Sigurimi i adekuatshmërisë së kapitalit pas korrigjimeve për ekspozimeve ndaj personave të ndërlidhur me bankën;
- Sigurimi i adekuatshmërisë së kapitalit duke peshuar humbjet nga rreziku operacional;
- Sigurojë pajtueshmëri me kuadrin rregullativ në fuqi, duke eliminuar të gjitha shkeljet e evidentura;
- Aprovimi nga bordi i drejtorëve i të gjitha politikave të bankës, si organ i vetëm politikës bërës i bankës;
- Sigurimi i një sistemi të shëndosh të kontrollit të brendshëm;
- Përpilimi i politikave të rrezikut operacional, duke përshtatur specifikave të tregut vendor;
- Aprovimi i strategjisë kreditor dhe sigurimi i një plani për përmirësimin e kualitetit të mjeteve;
- Sigurimi i kredive të riprogramuara të behet në pajtueshmëri me rregulloren për menaxhimin e rrezikut kreditor.

## Ecuria e procesit të likuidimit të Bankës Kreditore të Prishtinës

Procesi i likuidimit të Bankës Kreditore ka vazhduar edhe gjatë vitit 2012 dhe deri në fund të këtij viti janë rimbursuar gjithsej 54.10% e shumës së depozitave, përkatësisht 99.82% e numrit të llogarive të depozitave. Procesi i likuidimit është mundësuar nga arkëtimet e kredive. Gjatë vitit 2012 nga kreditë janë arkëtuar gjithsej 501,856 euro.

Perspektiva e procesit të likuidimit është e lidhur ngushtë me efikasitetin e arkëtimeve nga kreditë, arkëtimeve sekondare nga kolateralët si dhe nga blerës potencial të portofolit kreditorë të mbetur.

**Tabela 29. Kreditë – trendi i arkëtimeve**

Përshkrimi	Nr.Llogarive	Shuma	Ndryshimi në llogari		Ndryshimi në shumë	
			Nr.	Përqind	Nr.	Përqind
Kredit me 13.03.2006		28,438,587				
Kredit me 01.01.2012		22,497,072			5,941,515	20.89
Kredit me 31.12.2012		21,789,058			6,649,529	23.38
Arkëtimet gjatë 2012		501,856			501,856	1.76

Burimi: BQK (2013)

**Tabela 30. Depozitat – trendi i rimbursimeve**

Përshkrimi	Nr.Llogarive	Shuma	Ndryshimi në llogari		Ndryshimi në shumë	
			Nr.	Përqind	Nr.	Përqind
Depozitat me 13.03.2006	35,529	33,454,222				
Depozitat me 01.01.2012	76	15,649,497	35,453	99.79	17,804,725	53.22
Depozitat me 31.12.2012	65	15,355,734	35,464	99.82	18,098,488	54.1

Burimi: BQK (2013)

Edhe gjatë vitit 2012 procesi i likuidimit ka qenë i ndikuar nga gjendja aktuale e kualitetit të kredive, pagesat dhe procedurat përmbareme shumë të ngadalta nëpër gjykata. Zyra e likuidatorit në vazhdimësi ka qenë në funksion të marrjes së të gjitha masave dhe veprimeve të mundshme me qëllim që gjatë procesit të likuidimit të merret parasysh parimi kryesor që procesi i likuidimit në të gjithat fazat e tij të shoqërohet me maksimizimin e mjeteve likuide në dispozicion me qëllim të maksimizimit të kompensimit të depozitarëve dhe të gjithë kreditorëve tjerë.

Sfidat për të ardhmen në procesin e likuidimit, me qëllim të krijimit të mjeteve likuide, përmes shitjes së kolateraleve pas përfundimit të procedurave përmbareme gjyqësore dhe përmes ristrukturimit të kredive (duke u bazuar në faktin se nuk ka ndonjë rrugëdalje tjetër meqenëse nuk ka asnjë palë potenciale të interesuar për blerje të aktives së bankës), si dhe me qëllim të rimbursimit të depozitorëve të bankës, vlerësohen të nevojshme ndërmarrja e masave vijuese:

- Ristrukturimi i kredive;
- Përfundimi i procedurave përmbareme;
- Finalizimi i procesit gjyqësor ndaj ish-drejtuesve të bankës dhe grupeve të ndërlidhura;

- Objekti kapital: marrja në dispozicion e objektit ( kompensimi në emër të qirasë i cili aktualisht është duke u shfrytëzuar nga institucionet vendore) dhe shitja e këtij objekti i cili është vlerësuar nga ekspert nderkombetar te jete mbi 2 milionë Euro;
- Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim Evropian (OSBE) . Përfundimi i kontestit me OSBE në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë lidhur me pretendimin e BKP-së për tu kompensuar për vlerën mbi 800 mijë euro për shfrytëzimin e objektit nga OSBE.

### 4.3. Mbikëqyrja e sigurimeve

#### Kompanitë e sigurimeve, struktura e pronësisë

Tregu i sigurimeve gjatë vitit 2012 vazhdoi të njohë rritje, megjithëse me një ritëm më të ulët se viti paraprak. Numri dhe struktura e kompanive të sigurimit të cilat ushtruan aktivitet në Kosovë mbeti e pandryshuar. Gjatë këtij viti (2012), numri i kompanive të sigurimit ishte trembëdhjetë (13), ku dhjetë (10) prej tyre vazhduan të ofrojnë produkte të sigurimit jo-jetë, ndërsa tri (3) tjera ofruan produkte të sigurimit të jetës.

Nëse marrim në konsideratë strukturën e kompanive të sigurimit sipas pronësisë shohim se gjatë vitit 2012 nuk ka pasur ndonjë ndryshim në krahasim me vitin paraprak, çka do të thotë se numri i kompanive të sigurimit si dhe struktura e pronësisë së tyre mbeti po e njëjta me vitin paraprak (2011). Nga gjithsej numri i kompanive të cilat operuan në tregun e sigurimeve, shtatë (7) kompani ishin me pronësi të huaj, dy (2) kompani me pronësi të përzier, tri (3) prej tyre ishin me pronësi vendore dhe një (1) kompani ishte vartëse.

#### Struktura e portofolit të primeve, numër dhe vlerë

Gjatë vitit 2012, numri i kontratave të shkruara në tregun e sigurimeve është rritur për 20,2% krahasuar me vitin paraprak (2011). Nga gjithsej numri i kontratave të shkruara sa ishte në vitin 2012, afro 99,8% prej tyre përbëhej nga produktet e sigurimit jo-jetë dhe vetëm 0,2% përbëhet nga sigurimi jetë.

**Tabela 31. Vlera e Primeve të Shkruara 2010-2012**

Aktiviteti	Vitet (miliona)			Ndryshimi në %	
	2010	2011	2012	2011/2010	2012/2011
Prime të Shkruara Bruto (Jo-jetë)	61,8	67,6	69,8	9,3%	3,2%
Prime të Shkruara Bruto (Jetë)	0,7	1,0	1,5	47,6%	42,5%
Gjithsej	62,5	68,6	71,2	9,7%	3,8%

Burimi: BQK (2013)

Vlera e primeve të shkruara bruto u karakterizua me një rritje afro 3,8% krahasuar kjo me një vit më parë (shih Tabelën 1). Primet e shkruara bruto për vitin 2012 kapën shifrën rreth 71,2 mln. euro. Nga gjithsej bruto primet e shkruara, afro 97,9% e primeve përbëhej nga produktet e sigurimit Jo-Jetë, ndërsa vetëm 2,1% e primeve përbëhej nga sigurimet Jetë.

Rritja e tregut të sigurimeve gjatë vitit 2012 është nxitur kryesisht nga dinamika e rritjes së sigurimeve Jo-Jetë. Tregu i sigurimeve Jo-Jetë gjatë vitit 2012 kapi shifrën rreth 69,8 mln. euro apo 3,2 % më shumë në krahasim me vitin paraprak (2011). Rritje të theksuar në kuadër të sigurimeve Jo-Jetë shënuan sigurimet kufitare si rezultat si rezultat i aplikimit të tarifave të sigurimit kufitar me dy shtete fqinje (Serbi dhe Mali i Zi), dhe se për herë të parë gjatë vitit 2012 u arrit që të gjitha automjeteve të cilat kaluan në drejtim të pikave kufitare në Kosovë iu nënshtruan pagesës së tarifave për sigurimet kufitare.

Primet e shkruara bruto në sigurimin e Jetës gjatë vitit 2012 kapën shifrën rreth 1,5 mln. euro, duke shënuar një rritje prej afro 0,5 mln. euro në krahasim me vitin paraprak (2011). Rritja e sigurimeve të Jetës gjatë vitit 2012 ishte i lidhur kryesisht me hyrjen e dy kompanive të reja gjatë fund vitit paraprak, me ç' rast është rritur edhe portofoli i produkteve të ofruara nga këto kompani.

### Dendësia e Sigurimeve<sup>46</sup>

Viti 2012 karakterizohet me një rritje të lehtë në tregun e sigurimeve në Kosovë. Primi për kokë banori ishte mesatarisht 39,24 euro në krahasim me 37,79 euro sa ishte në vitin 2011. Nga kjo shumë, 38,42 euro ishte shpenzuar për sigurimin Jo-Jetë ndërsa vetëm 0,82 euro ishte shpenzuar për sigurimin Jetë.

Gjatë këtij viti, pjesëmarrja e primeve të shkruara bruto në raport me PBB-në mbetet akoma e ulët si rezultat i rritjes së ngadalësuar të primeve të shkruara në raport me vitin paraprak si dhe në raport me normën e rritjes së PBB-së.


### Primet e Sigurimit Jo-Jetë

Primet e shkruara bruto nga sigurimet Jo-Jetë vazhduan me një trend rritjeje edhe gjatë vitit 2012 por me një ritëm më të ngadalësuar. Numri i kontratave të sigurimit Jo-Jetë kapi shifrën rreth 0,7 mln. apo 20,1% më shumë se vitin paraprak 2011. Nga gjithsej numri i kontratave të shkruara rreth 84,4% përbëhej nga sigurimet e detyrueshme ndërsa vetëm 15,6% përbëhej nga sigurimet vullnetare.

Primet e shkruara bruto nga sigurimet Jo-Jetë kapën shifrën rreth 69,8 mln. euro


apo 3,2% më shumë se në vitin paraprak 2011 (Figura 103). Nga gjithsej vlera e primeve të shkruara bruto të sigurimeve Jo-Jetë, rreth 72,7% përbëhej nga sigurimet e detyrueshme, ndërsa vetëm 27,3% përbëhej nga sigurimet vullnetare (2011: 70,1% me 29,9%). Rritja e pjesëmarrjes së

Figura 102. Prime të shkruara dhe deme të paguara



Burimi: BQK (2013)

Figura 103. Prime të shkruara jo jetë



Burimi: BQK (2013)

<sup>46</sup>Popullsia, Dhjetor 2012: esk.rks-gov.net

sigurimeve të detyrueshme krahas sigurimeve vullnetare vije si rezultat i rritjes së të hyrave nga sigurimet kufitare në njërën anë dhe rënies së kërkesës për produktet vullnetare në anën tjetër (shih Tabelën 2).

Vlen të theksohet se në kuadër të sigurimeve të detyrueshme, në vitin 2012, shihet një rënie e lehtë e sigurimeve nga auto përgjegjësia<sup>47</sup> e brendshme si rezultat i mos-ripërtëritjes së kontratave nga ana e polic-mbajtësve në krahasim me vitin paraprak. Ky nivel i rënies së primeve nga auto përgjegjësia e brendshme dhe produkteve vullnetare ndikoi në mënyrë të ndjeshme në rënien e normës së rritjes së primeve të shkruara në krahasim me vitet paraprake (shih Fig. 103).

**Tabela 32. Prime të shkruara bruto, Sigurimet jo jetë**

Aktiviteti	2011 (mln)	2012 (mln)	Ndryshimi ne %	Pjesëmarrja 2011	Pjesëmarrja 2012
Sigurime te Detyrueshme	47,4	50,7	7.1%	70,1%	72,7%
Sigurime Vullnetare	20,2	19,0	-5.7%	29,9%	27,3%
Gjithsej sigurime jo jetë	67,6	69,8	3,2%	100%	100%

Burimi: BQK (2013)

### Sigurimet e detyrueshme


Gjatë vitit 2012, sigurimet e detyrueshme vazhduan dominim e tyre krahas sigurimet vullnetare, duke sjellë rreth 73,3% të të ardhurave nga primet e shkruara bruto të tregut të sigurimeve (shih Fig. 104). Kjo rritje e pjesëmarrjes së sigurimeve të detyrueshme u ndikua nga dinamika e rritjes së sigurimeve kufitare të cilat gjatë vitit 2012 shënuan rritjen më të lartë (shih Tabelën 32).

Primet e shkruara bruto të sigurimit auto përgjegjësia e brendshme, gjatë vitit 2012 shënuan rënie duke arritur në 37,0 mln. euro ose rreth 3,1% më pak se në vitin paraprak 2011 (shih Fig. 105). Mund të thuhet se ky ishte viti i parë në të cilin sigurimet nga Auto përgjegjësia shënojnë rënie.

Në vitin 2012, primet e shkruara bruto nga sigurimi TPL+48 ishin rreth 1,2 mln. euro ose rreth 1,1% më shumë në krahasim me vitin paraprak (shih Tabelën 33).


Primet e shkruara bruto nga sigurimet

**Figura 104. Portofolio e sigurimeve jo jetë**



Burimi: BQK (2013)

**Figura 105. Prime te shkruara nga MTPL e brendshme**



Burimi: BQK (2013)

<sup>47</sup> MTPL (angli: Motor Third Party Liability)

<sup>48</sup> TPL+. Nga marrëveshja e mirëkuptimit me Maqedoninë.

kufitare të shpërndara në kompani kapën vlerën rreth 12,6 mln. euro ose rreth 56,4% më shumë në krahasim me vitin paraprak.

**Tabela 33. Sigurime të detyrueshme**

Përshkrimi	2011 (mln)	2012 (mln)	Ndryshimi ne %	Pjesëmarrja 2011	Pjesëmarrja 2012
5. TPL	38,2	37,0	3,1%	80,6%	72,9%
6. TPL +	1,1	1,2	1,3%	2,4%	2,3%
7. Sigurimet kufitare	8,0	12,6	56,4%	17,0%	24,8%
Total	47,4	50,7	7,1%	100,0%	100,0%

Burimi: BQK (2013)

### Sigurimet vullnetare

Gjatë vitit 2012, sigurimet vullnetare kapën shifrën rreth 19,0 mln. euro ose 5,7% më pak në krahasim me vitin paraprak 2011 (shih Tabelën 34). Rënia e sigurimeve vullnetare në krahasim me vitin paraprak, njëherazi tregon edhe rënien e pjesëmarrjes së këtyre produkteve në total portofolin e primeve të shkruara gjatë vitit 2012.

**Tabela 34. Sigurime Vullnetare**


Përshkrimi	2011	2012	Ndryshimi ne %	Pjesëmarrja 2011	Pjesëmarrja 2012
Aksident dhe shendet	9,9	9,2	-7,1%	49,0%	48,1%
Sigurimet Motorrike	2,8	3,0	4,8%	14,1%	15,6%
Zjarr & Demtime ne prone	3,0	3,7	24,6%	14,6%	19,3%
Pergjegjesi te pergjithshme	2,0	1,1	44,2%	10,0%	5,9%
Kredi dhe Garancione	1,5	1,5	0,9%	7,6%	8,1%
Humbje Financiare	1,0	0,5	43,4%	4,7%	2,8%
Gjithsej	20,2	19,0	-5,7%	100,0%	100,0%

Burimi: BQK (2013)

Rënia e primeve nga sigurimet vullnetare kryesisht u ndikua nga klasët e sigurimit “Përgjegjësi e përgjithshme” ku në krahasim me vitin paraprak shënoi rënie për 44,2%, pastaj klasët e sigurimit “Humbje financiare” duke shënuar rënie për 43,4% si dhe klasët e sigurimit “Aksident dhe Shëndet” me një rënie prej afro 7,4%.

Mund të vlerësohen si tregues të mirë rritja e primeve nga klasët e sigurimit “Zjarr dhe dëmtime tjera në pronë” kur në krahasim me vitin paraprak shënuan rritje prej 24,6%, klasa e sigurimit “Motoristike” është rritur për 4,8% kryesisht për shkak të rritjes së sigurimit “Kasko”, ndërsa klasa e sigurimit “Kredi dhe Garancione” ka mbetur e njëjtë.

**Figura 106. Produktet Vullnetare, pjesëmarrja ne % 2011 - 2012**



Burimi: BQK (2013)

Nga gjithsej primet e shkruara të sigurimeve vullnetare, peshën më të lartë specifike e përbën grupi i klasëve të sigurimit “Aksident dhe shëndet” me 48,1%, pastaj sigurimet “Zjarr dhe dëmtime tjera në pronë” me 19,3%, sigurimet “Motorike” me 15,6%, “Kredi dhe Garancione” me 8,1%, “Përgjegjësi të përgjithshme me 5,9% dhe “Humbje financiare” me 2,8% (Figura 106).

### Primet e Sigurimit të Jetës

Primet e shkruara bruto në sigurimin e jetës në vitin 2012, krahasuar me një vit më parë patën një rritje prej 42,5%, duke arritur një vlerë prej 1,5 mln. euro (Figura 107). Po ashtu rritje u shënuar edhe në numrin e kontratave të shkruara për 81% në krahasim me vitin paraprak. Rritja e primeve të shkruara bruto në sektorin e jetës u ndikua kryesisht nga hyrja e dy kompanive të reja në fund të vitit 2011, duke rritur portofolin e produkteve të ofruara në tregun e sigurimeve të jetës.

Në këtë mënyrë, rritja më e lartë në vlerë u shënuar tek produkti Sigurimi Miks i Jetës i cili gjatë vitit 2012 kapi shifrën 1,1 mln. euro, me një pjesëmarrje prej 76,4% në primet e shkruara bruto të jetës. Më pas vijoi produkti “Sigurimi i Kredive për hua” i cili ishte i lidhur ngushtë me nivelin e kredi dhënies, me një pjesëmarrje prej 7,1% në primet e shkruara bruto të jetës (shih Tabelën 5).


Sigurimet e jetës akoma mbeten të ulëta krahas produkteve tjera të sigurimeve jo-jetë. Ky treg edhe pse ka shënuar një ngritje të theksuar në vlerën e primeve të shkruara bruto të jetës, pjesëmarrja e tyre vlerësohet si pjesëmarrje e vogël dhe në gjithsej bruto primin e shkruar përbën vetëm 2,1% në vitin 2012 (2011: 1,5%).

**Tabela 35. Sigurime jetë, mijëra**

Përshkrimi	2011	2012	Ndryshimi ne %	Pjesëmarrja 2011	Pjesëmarrja 2012
Sigurimi Miks i Jetës	921.6	1,133.2	23.0%	88.6%	76.4%
Sigurimi në grup i jetës	38.2	16.7	-56.2%	3.7%	1.1%
Aksidentet Personale	75.7	86.6	14.4%	7.3%	5.8%
*Endow ment	5.0	40.8	716.8%	0.5%	2.8%
Term Life	-	41.8		0.0%	2.8%
Sigurimi i kreditorëve për hua	-	105.4		0.0%	7.1%
Tjera	0.2	58.4	30778.4%	0.0%	3.9%
Gjithsej	1,040.7	1,483.0	42.5%	100.0%	100.0%

\*Endowment, kontratë e sigurimit të jetës e cila paguan shumën e siguruar në rastin e vdekjes së personit të siguruar dhe në rastin e maturimit të kontratës.  
Burimi: BQK (2013)

Figura 107. Prime të shkruara nga sigurimi Jetë 2009-2012



Burimi: BQK (2013)

## Dëmet

Gjatë vitit 2012, nga kompanitë e sigurimeve në Kosovë u paguan rreth 25,9 mln. euro dëme bruto<sup>49</sup> ose 13,7% më shumë në krahasim me vitin paraprak 2011 (Figura 107 dhe 108). Vlen të theksohet së në kuadër të dëmeve të paguara, nuk janë përfshirë dëmet e paguara nga BKS<sup>50</sup> të cilat për vitin 2012 kapin vlerën rreth 4,8 mln. euro ose 13,2% më shumë së në vitin paraprak 2011.

Numri i dëmeve të paguara gjatë vitit 2012 ishte rreth 78,3 mijë ose 6,4% më shumë së në vitin paraprak. Nga ky numër i dëmeve të paguara, rreth 75,3 mijë dëme u paguan nga kompanitë e sigurimeve dhe 3,0 mijë u paguan nga BKS.

Rritja e nivelit të dëmeve të paguara gjatë vitit 2012 u ndikua kryesisht nga pagesa e dëmeve në emër të produkteve vullnetare të cilat kapën shifrën rreth 10,5 mln. euro ose 32,6% më shumë në krahasim me vitin paraprak. Faktorët kryesor të cilët ndikuan në rritjen e nivelit të dëmeve të paguara tek produktet vullnetare ishin kryesisht dëmet me frekuencë të ulët dhe ashpërsi të lartë, ku në vitin 2012 një pjesë e madhe e tyre u mbulua nga kompania ri-siguruese.

Vlen të ceket se në kuadër të produkteve vullnetare gjatë vitit 2012, rreth 51,6% e dëmeve të paguara përbëhej nga sigurimi “Aksident dhe Shëndet”, 21,5% përbëhej nga sigurimi Kasko në kuadër të sigurimeve “Motorike”, 23,3% nga sigurimi “Zjarr dhe dëmtime tjera në pronë” dhe 3,6% sigurime tjera vullnetare.

Krahas dëmeve të paguar tek sigurimet vullnetare, gjatë vitit 2012 rritje u shënuar edhe në dëmet e paguara tek sigurimet e detyrueshme duke kapur shifrën rreth 15,3 mln. euro ose 3,4% më shumë së në vitin paraprak. Në kuadër të sigurimeve të detyrueshme pjesëmarrjen më të lartë të dëmeve të paguara e përbente sigurimi auto përgjegjësia e brendshme me 99,4% ndërsa TPL+ vetëm 0,6%.


Gjatë vitit 2012, vlera e dëmeve të paguara nga sigurimet jete kapi shifrën 63,683, përderisa kjo vlerë në vitin 2011 ishte 30,666 euro duke shënuar një rritje të theksuar.

## Byroja Kosovare e Sigurimit

Byroja Kosovare e Sigurimit është themeluar me 07.09.2011 nga 10 kompanitë e sigurimit të licencuara të cilat operojnë në Republikën e Kosovës, bazuar në Ligjin Nr.04/L-018 mbi Sigurimin e Detyrueshëm nga Auto përgjegjësia.

Byroja Kosovare e Sigurimit është organizatë profesionale në cilësinë e personit juridik e themeluar për qëllime jofitimprurëse. Qeveria e Republikës së Kosovës e njeh statusin e Byrosë Nacionale të Sigurimit me të drejta të pakufizuara, në cilësi të byrosë paguese dhe byrosë trajtuese, që garanton përmbushjen e të gjitha detyrimeve nga sistemi i kartonit ndërkombëtar të sigurimit.

Figura 108. Dëme të paguara bruto 2008-2012



Burimi: BQK (2013)

<sup>49</sup> Në dëmet bruto është përfshirë edhe pjesa e ri-siguruesit.

<sup>50</sup> BKS – Byroja Kosovare e Sigurimeve.

Byroja financohet nga anëtarët e saj dhe veprimtaria e së cilës mbikëqyret nga Banka Qendrore e Kosovës. Në kuadër të Byrosë Kosovare të Sigurimit funksionon Fondi i Kompensimit, Sigurimi Kufitar, Qendra Informativë e Sigurimit dhe Kartoni i Gjellbër.

**Tabela 36. Dëmet e paguara**

Aktiviteti	2010 (mln)	2011 (mln)	*2012 mln euro
BKS	4.5	4.3	4.8
Fondi i Kompensimit	3.3	3.3	3.5
Sigurimet Kufitare	1.1	1.0	1.4
% Rritjes/Zvogëlimit	0%	4%	13%

\*Te dhënat për vitin 2012 i përkasin Byrosë Kosovare të Sigurimeve (BKS), ndërsa te dhënat e dy viteve paraqite, 2011 dhe 2010 i përkasin SHSK (Shoqatës së sigurimeve të Kosovës)

Burimi: BQK (2013)

## Risigurimi

Duke u bazuar në kërkesat ligjore të BQK-së ndaj industrisë së sigurimeve, nga kompanitë e sigurimeve që gjatë veprimtarisë së vet kërkohet që të transferojnë rreziqet përmes kontratave risiguruese.

Gjatë vitit 2012, kompanitë e sigurimeve kanë marrë përsipër rreziqe të cilat i përkasin klasëve të ndryshme të biznesit duke filluar nga sigurimi i aksidentit dhe shëndetit, sigurimi motorik, sigurimi i zjarrit dhe dëmtimeve në pronë, sigurimi i mallrave në transport, sigurimi i garancive, sigurimi i përgjegjësive publike si dhe ndaj palëve të treta nga auto përgjegjësia.

Gjatë vitit 2012, kompanitë e sigurimeve në Kosovë, kanë ceduar prime tek risiguruesi rreth 5,9 mln. euro ose rreth 8,5% të primeve të shkruara bruto.

Më shumë se 78,0% e kontratave risiguruese të kompanive të sigurimit kanë klasifikim nga A+ deri në AA- vlerësuar nga Standard & Poor's, dhe vetëm 22,0% kanë klasifikim BBB-. Ndër pjesëmarrësit kryesorë në këto programe ri-sigurimi mund të përmendim Munich Re, Hannover Re, Swiss Re etj. Kontratat ri siguruese i plotësojnë kërkesat ligjore të BQK-se

BQK ka ushtruar mbikëqyrje të vazhdueshme duke monitoruar mënyrën e menaxhimit të rreziqeve nga ana e kompanive të sigurimit si dhe respektimin e limiteve të rreziqeve sipas ligjeve dhe rregulloreve të BQK-së.

## Pozicioni financiar i kompanive të sigurimit

### Asetet e Industrisë së sigurimeve

Në vitin 2012 asetet e tregut të sigurimeve arritën në 122,1 mln. euro apo 8,2% më shumë se në vitin paraprak (shih Tabelën 6). Asetet rrjedhëse kanë vazhduar dominimin e tyre në krahasim me asetet tjera në kuadër të total aseteve me 66,4% ndërsa asetet fikse përbënin 16,4% të totalit të aseteve. Kërkesat dhe të arkëtueshmet kanë shënuar rritje të lehtë në krahasim me vitin e kaluar, gjithashtu rritje kanë shënuar edhe asetet teknike të cilat përbëhen nga kostot e shtyra të parapaguara dhe asetet e risigurimit. Në qoftë se bëjmë një krahasim me vitin paraprak 2011 kur asetet rrjedhëse përbënin 65,8% dhe asetet fikse me 15,3% atëherë shohim se nuk ka ndonjë ndryshim të theksuar në strukturën e aseteve të tregut të sigurimeve. Rritja e parasë si aset në njërin anë është rezultat i shtimit të parasë për mbulimin e likuiditetit dhe deficitit, ndërsa rritja e aseteve fikse në anën tjetër është rezultat i rivlerësimit të pronave investuese të bëra gjatë këtij vitit nga ana e kompanive të sigurimit.

## Detyrimet dhe Ekuiteti

Në vitin 2012 detyrimet e tregut të sigurimeve arritën në 76,7 mln. euro ose 14,8% më shumë se në vitin paraprak. Rezervat teknike përbënin 50,1% të total detyrimeve, detyrimet tjera përbënin 12,8 % ndërsa kapitali dhe rezervat tjera 37,2%. Gjatë vitit 2012, shihet një vazhdimësi e rritjes së trendit të alokimit të fondeve në rezerva teknike. Si rezultat i kësaj, rezervat teknike shënuan rritje për 12,3% ndërsa kapitali shënoi rënie për 1,4%. Në kuadër të rezervave teknike, rritja më e madhe është shënuar tek rezervat për dëmet e ndodhura por të raportuara (anglisht: IBNR – Incurred But Not Reported) në masën prej 32,0%, Rezerva për dëmet e njohura por jo të rregulluara në masën prej 20,0% si dhe rezerva tjera për dëme në masën prej 47,0% por të cilat në vlera monetare paraqiten më të ulëta.

Rritja e rezervave teknike gjatë vitit 2012 në raport me shtimin e rreziqeve të marra në sigurim nga ana e kompanive, është rezultat i një monitorimi të vazhdueshëm të alokimit të rezervave nga ana e BQK-së. Ky monitorim i vazhdueshëm është bere ne baze te ligjeve dhe rregullave ne fuqi lidhur me kalkulimin e provizioneve teknike, me c'rast jane marre masa te nevojshme. Vlen te teksohet se gjate ketij viti, eshte kerkuar nga auditori i jashtem nje vleresim lidhur me adekuatshmerine e provizioneve teknike.

## Treguesit e Performancës Financiare

Në vitin 2012, industria e sigurimeve në Kosovë shënoi rënie në treguesit e performancës financiare në krahasim me vitin paraprak 2011. Rezultati financiar neto i tregut të sigurimeve për vitin 2012 shënoi humbje në vlerë prej 3,0 mln. euro, krahasuar me 0,5 mln. euro neto të hyra në vitin paraprak 2011. Tregu i sigurimeve të jetës vazhdoi të ketë rezultat financiar pozitiv në vlerë prej 0,3 mln. euro, ndërsa tregu i jo-jetës shënoi humbje në vlerë prej 3,4 mln. euro.

Ky rezultat negativ për vitin 2012 u ndikua në masë të madhe nga raporti i kombinuar i cili për këtë vit kapi normën rreth 115,0%. Nga ky tregues shohim se industria e sigurimeve për këtë vit, për çdo 1 euro të arkëtuar, ka shpenzuar 1.15 euro.

## Profitabiliteti i tregut të sigurimeve

Në qoftë se bazohemi në dy treguesit e profitabilitetit, Kthimi mesatar në Asete (angl: ROAA) dhe Kthimi mesatar në Ekuitet (angl: ROAE), shihet se industria e sigurimeve në Kosovë gjatë vitit 2012 shënoi rënie të theksuar në këta indikator në krahasim me vitin paraprak. Kthimi mesatar në Asete (ROAA) në tregun e sigurimeve shënoi një trend rënie nga 0,5% sa ishte në vitin 2011 në -2,6% në vitin 2012. Gjithashtu një rënie ka pasur edhe raporti i kthimit mesatar në Ekuitet (ROAE) nga 1,1% sa ishte në vitin 2011 në -6,7% në vitin 2012. Këto raporte shënuan rënie si rezultat i humbjes financiare të shënuar gjatë vitit 2012.

## Niveli i Solvencës në Industrinë e Sigurimeve

Aftësia paguese (anglisht: Solvency) e ka kuptimin e aftësisë së një kompanie për mbulimin e detyrimeve të saj afatgjata. Aftësia paguese dallon në krahasim me likuiditetin e cila në vete tregon aftësinë e organizatës për mbulimin e detyrimeve të saj afatshkurtra. Aftësia paguese (Solvencia) në industrinë e sigurimeve në Kosovë është e rregulluar me anë të rregullores mbi “Depozitimin e aseteve si garancë, mjaftueshmërisë së kapitalit, raportimin financiar, menaxhimin e riskut, investimeve dhe likuiditetin” të BQK-së e cila në kalkulimin e Solvencës nuk i njuh si asete: a) 100% e debitorëve të primeve mbi 90 ditë, b) 100% të parapagimeve dhe aseteve tjera të paprekshme si dhe 25% të shpenzimeve të shtyra e të parapaguara. Si rrjedhojë e kësaj kur prej aseteve neto zbresim detyrimet atëherë fitojmë rezultatin e Solvencës e cila duhet

të jetë mbi 0,6 mln euro për secilën kompani ashtu siç është përcaktuar me rregulloren e sipër cekur të BQK-së.

Bazuar në raportet financiare të vitit 2012, solvenca totale e kalkuluar e industrisë së sigurimeve ishte 13,7 mln. euro duke shënuar rënie prej 25 % krahasuar me vitin paraprak 2011.

**Tabela 37. Kalkulimi i margjinës minimale të Solvencës (kompanitë jo-jetë)**

Aktiviteti	2012	2012
Total Asetet	102.1	110.4
Minus:Asetet e papranueshme	-12.5	-15.5
=Neto Asetet	89.6	94.9
Minus:Detyrimet përjashtuar pasurinë neto	-65.2	-75.2
Niveli i margjinë minimale të solvencës	6.0	6.0
Niveli i Solvencës	18.4	13.7
Pozicioni i Solvencës	Solvent	Solvent

Burimi: BQK (2013)

Rënia e nivelit të solvencës në krahasim me vitin paraprak vije si rezultat i rritjes së aseteve të papranueshme sipas rregullatives ne fuqi në njërin anë dhe rritjes së detyrimeve në anën tjetër.

### Treguesit e Likuiditet

Gjatë vitit 2012 industria e sigurimeve në përgjithësi rezultoi me tregues të qëndrueshëm likuiditeti por më një rënie të lehtë në krahasim me vitin paraprak. Paraja e gatshme dhe ekuivalentët e saj në raport me rezerva teknike ishte 132,6% (2011: 136,4%), ndërsa në raport me gjithsej detyrimet ishte 105,7% (2011: 111,1%) (shih Tabelën 7). Ngushtimi i likuiditetit për vitin 2012 ka rezultuar si pasojë e trendit të rritjes së shpejtë të totalit të rezervave teknike në krahasim me vitin paraprak 2011.

**Tabela 38. Tregues likuiditeti**

Aktiviteti	2011	2012
Mjetet Likuide Keshi/Provizionet Teknike	136.4%	134.9%
Mjetet Likuide Keshi/Total Detyrimet	111.1%	111.2%
Kërkesat/ Total Asetet	6.8%	6.0%
NPSH/Ekuiteti	1.30	1.36
Ekuiteti/Detyrimet	68.8%	59.1%

Burimi: BQK (2013)

### Roli i DMS

Objektivi kryesorë i BQK është mbrojtja e policë mbajtëseve duke vepruar gjithnjë në zbatim të Ligjeve dhe Rregulloreve të BQK-se, brenda të cilave industria e sigurimeve e zhvillon aktivitetin e saj sigurues duke i kompensuar me rregull dëmet për klientët e saj.

BQK nëpërmjet Departamentit për Mbikëqyrje të Sigurimeve luan rol të rëndësishëm në ndërtimin e një tregu stabil dhe eficientë, për ndërtimin e një mjedisi adekuat për aksionaret, investitorët potencial si dhe në zhvillimin e konkurrencës së drejtë dhe të lirë.

Në përputhje me këtë, janë ndërmarrë masat e duhura në zbatimin të mbikëqyrjes së vazhdueshme të sigurimeve dhe krijimin e kushteve për zhvillimin e mëtejshëm të industrisë së sigurimeve.

Krahas kësaj, BQK edhe gjate vitit 2012 ka qenë e angazhuar në adaptimin e praktikave më të mira bazuar në parimet e Asociacionit Ndërkombëtar të Mbikëqyrësve të Sigurimeve (International Association of Insurance Supervisors – IAIS) si dhe mbikëqyrjen e bazuar në risk, duke kontribuar kështu në rritjen e transparencës së operacioneve ndaj industrisë së sigurimeve dhe njëkohësisht rritjes së transparencës së kompanive të sigurimit ndaj publikut.

Gjithashtu, gjate vitit 2012, BQK ka vazhduar punën në implementimin e rekomandimeve të bëra në raportin e Bankës Botërore lidhur me aplikimin e Parimeve Themelore të Sigurimeve, ku gjatë vitit 2011 ishte bërë vlerësimi i aplikimit të parimeve themelore të sigurimeve (ICP) nga ekspertet të jashtëm të Bankës Botërore.

### **Zhvillimi i Kornizës Ligjore**

Për krijimin e një tregu të qëndrueshëm dhe konkurrues pa dyshim se korniza ligjore është esenciale. Nuk mund të paramendohet një mbikëqyrja efektive e sigurimeve pa një rregullativë të qëndrueshme ligjore e cila është esenciale për stabilitetin e industrisë së sigurimeve dhe të berit atë me konkurrues në rajon.

Ne këtë drejtim BQK-ja në bashkëpunim të ngushtë me asistencën teknike të ofruar nga Banka Botërore, USAID, FMN dhe Asistencën Teknike nga Departamenti i Thesarit të SHBA-ve etj, kanë shënuar progres të rëndësishëm në zhvillimin e kornizës ligjore, respektivisht zëvendësimin e Rregulloreve të UNMIK-ut me ligjet e Republikës së Kosovës.

Gjatë vitit 2012 kanë vazhduar përpjekjet e përbashkëta dhe akterët tjerë në vend dhe jashtë vendit si dhe me Industrinë e Sigurimeve të Kosovës në gjetjen e një modaliteti përfaqësimi në Sistemin Ndërkombëtar të Kartonit Jeshil.

Në vijimësi gjatë vitit 2013 DMS ka vazhduar punën me draftimin e akteve tjera nënligjore të parapara me Ligjin mbi Sigurimin e Detyrueshëm të Auto përgjegjësisë të cilat pastaj janë proceduar në Bordin Ekzekutiv dhe Bordin e BQK-s për aprovim. Si rrjedhojë, janë aprovuar rregullore si në vijim (i) implementimin e sistemit Bonus Malus, (ii) kushtet e përgjithshme të Policës së sigurimit të auto përgjegjësisë, (iii) procedurat e trajtimit të kërkesave mbi kompensimin e dëmeve, (iv) mënyrën e mbajtjes dhe të përdorimit të aktives së fondit të kompensimit të BKS, (v) përcaktimin e standardeve të raportimit dhe mbikëqyrjes së Byrosë Kosovare të Sigurimeve dhe (vi) përcaktimin e standardeve dhe formave të raportimit të Byrosë Kosovare të Sigurimeve dhe Kompanive të Sigurimeve.

### **Proceset në zhvillim**

BQK në bashkëpunim me industrinë e sigurimeve është duke punuar në hartimin e Ligjit të Përgjithshëm të Sigurimeve, Ligj ky i cili është në proces të rishikimit respektivisht finalizimit të tij i cili është edhe një hap me tutje drejt avancimit në drejtim të Direktivave Evropiane.

### **Struktura organizative e Departamentit të Mbikëqyrjes së Sigurimeve (DMS)**

Departamenti të mbikëqyrjes së sigurimeve përbëhet nga dy divizione; a) Divizioni për Raportim dhe Analiza dhe b) Divizioni për Mbikëqyrje në Vend (DMV).

### **Divizioni për Raportim dhe Analiza (DRA)**

Monitorimi i kompanive të sigurimit bëhet përmes “Divizionit për Raportim dhe Analiza” (DRA) i cili në mënyrë sistematike dhe në forma të standardizuara nxjerrë analiza të rregullta mujore, tremujore dhe vjetore sipas Rregulloreve të brendshme të BQK-së, bazuar në parimet e IFRS dhe praktikave të IAIS. DRA në baza të rregullta mujore, tremujore dhe vjetore monitoron performancën financiare të industrisë së sigurimeve dhe përgatitë raporte të rregullta për organet drejtuese të BQK-së.

Ne kuadër të performancës financiare përfshihen edhe indikatorë tjerë si:

- Kalkulimi i marginës minimale të Solvences,
- Kalkulimi i Kapitalit dhe Ekuitetit
- Kalkulimi mbi mjaftueshmërinë e kapitalit variabël
- Kalkulimi i raportit të dëmeve të paguara, dëmeve të ndodhura, raportin e shpenzimeve dhe raportin e kombinuar etj.

Gjatë vitit 2012, DRA ka vazhduar të zbatoj sistemin e paralajmërimit të hershëm (Early Warning Test). Kështu, në analizën e gjendjes financiare të industrisë së sigurimeve si dhe në vlerësimin individual të kompanive të sigurimeve, përdoren treguesit e sistemit IRIS (Sistemi Informativ Rregullativ i Sigurimeve) të përshtatura për kompanitë e sigurimeve Jo Jetë në Kosovë. Këta tregues financiarë i shërbejnë evidentimit në kohën e duhur të problemeve që mund të çojnë në përkeqësimin e një ose disa parametrave të sigurueseve në Industri.

Po ashtu në kuadër të performancës financiare (IRIS) përfshihen edhe 20 parametra – indikator tjerë të rrezikut dhe performancës financiare të industrisë.

Si rezultat i monitorimit të vazhdueshëm, DRA ka nxjerre tri urdhëresa për mungesë të kapitalit variabël (riskut sigurues) si dhe një urdhëresë për mungesë të kapitalit – Ekuitetit. Me qëllim të mbajtjes së likuiditetit, DRA ju ka rekomanduar kompanive të sigurimeve që të ngritin nivelin e asetëve likuide në raport me asetet tjera. Po ashtu me Rekomandimin e DRA, BQK ka ndërmarrë veprime tjera të nevojshme ndaj kompanive të sigurimeve për shkeljet e ndryshme që kanë bërë ndaj rregullave dhe ligjeve tjera të BQK-së në fuqi.

Bazuar në treguesit e performancës financiare, DRA ka rekomanduar për veprime ndaj kompanive të sigurimeve me theks të veçantë në ato kompani të cilat janë të ekspozuara ndaj rrezikut të lartë apo në drejtim të mbrojtjes së interesave të konsumatorëve.

### **Divizioni për Mbikëqyrje në Vend (DMV)**

Divizioni për Mbikëqyrje në Vend është një proces i rëndësishëm i mbikëqyrjes përmes secilit sigurohen informacione mbi ushtrimin e aktivitetit sigurues si dhe shpalosen informacione mbi politikën procedurat e hartuara si dhe informacione mbi aplikimin e tyre nga bartësit përkatës. Mbikëqyrja në vend kryhet sipas një plani të ekzaminimeve paraprakisht të aprovuara nga Menaxhmenti për ekzaminime të plota dhe të fokusuara në kompanitë e sigurimeve dhe ndërmjetësuesit e sigurimeve.

Mbikëqyrja në vend realizohet nëpërmjet verifikimit në vend të aktivitetit të siguruesve dhe entiteteve të tjera të cilat merren me aktivitetin e sigurimeve. Është proces i rëndësishëm i mbikëqyrjes sepse siguron informacione burimore mbi ushtrimin e aktivitetit si dhe shpalos informacion mbi politikën dhe procedurat e hartuara si dhe informacione mbi aplikimin e tyre nga bartësit përkatës.

Ekzaminimet e kryera gjate vitit 2012 kryesisht kanë qenë të orientuara në bazë të vlerësimeve mbi riskun në entitetet e ekzaminuara, por edhe me prioritet në kompanitë – entitetet e sigurimeve në raport me ciklin kohor të ekzaminimit nga ekzaminimi paraprak.

Janë kryer shtatë ekzaminime të plota - (për gjithë aktivitetin) në gjashtë kompani të sigurimeve, prej tyre tri kompani të sigurimeve jo-jetë dhe tri kompani të sigurimeve jetë si dhe një ekzaminim i plotë në BKS, i cili ka përfshirë aktivitetin edhe të Shoqatës së sigurimeve të Kosovës (SHSK)/Njësinë e sigurimeve të detyruara (NJSD) deri në themelimin Byrosë Kosovare të Sigurimit (BKS). Ekzaminime të plota janë kryer edhe në entitete tjera siç janë profesionistët e sigurimeve. Janë kryer gjithsej katër ekzaminime, prej tyre një ndërmjetësues i sigurimeve, një broker dhe dy trajtues të dëmeve.

Janë zhvilluar tridhjetë e dy ekzaminime të fokusuar (për një fushë të caktuar të aktivitetit), të cilat janë kryer si rezultat i zhvillimeve në industrinë e sigurimeve, në saje të mbikëqyrjes dhe monitorimit të vazhdueshëm. Ekzaminime të tilla janë bërë për të përcjellë përmbushjen e rekomandimeve dhe masave të shqiptuara, ekzaminimi në fushën e procesimit dhe pagesës së dëmeve etj.

Në kuadër të mbikëqyrjes në vend janë mbajtur takimet përmbyllëse, janë përgatitur raportet e ekzaminimeve, janë shqyrtuar dhe analizuar komentet e pranuar nga kompanitë-ndërmjetësuesit dhe entitetet tjera dhe janë rekomanduar masat në pajtueshmëri me rregullativën.

Gjate ekzaminimeve të zhvilluara janë konstatuar gjetjet: Mungesë e politikave dhe procedurave të qarta, mungesë e kontrolleve të brendshme të mirëfillta, mos ushtrim i mjaftueshëm i kompetencave nga bordi, parregullsi në trajtimin dhe rregullimin e dëmeve, mos përmbushje e duhur e kërkesave të policë mbajtëseve, vonesa në rregullimin dhe pagesën e dëmeve, mos zbatueshmëri e kërkesave të Rregullativës - (shkelje të Rregullativës), mos përfillje e kërkesave të autoritetit mbikëqyrës nga zyrtar të kompanisë, dukuri e dhënies së Shpërblimeve, bonuseve dhe donacioneve pa mbulesë (pa rezultate të balancuara në raport me benefitin e kompanisë), raste të trajtuara të lëndëve me përmbajtje të falsifikuar, mos përmbushje e duhur e rekomandimeve.


Në raport me gjendjen e konstatuar, BQK ka ndërmarr masa në pajtueshmëri me rregullativën.

Rekomandim për përmbushje të çështjeve të konstatuara, shqiptim i vërejtjes me shkrim bordit, menaxhmentit dhe auditorit të brendshëm, ndëshkim me gjobë kompanisë, individëve, largim nga menaxhimi i kompanisë, pezullim licence etj.

#### 4.4. Mbikëqyrja e Pensioneve

Sistemi pensional i Kosovës gjatë vitit 2012 nuk ka pasur ndonjë ndryshim të theksuar edhe pse lëvizja e çmimit të njësive në tregjet financiare ndikon drejtpërsëdrejti në mjetet e fondeve pensionale të investuara jashtë Kosovës. Qëllimi i mbikëqyrjes së divizionit të pensioneve mbetet mbikëqyrja dhe rregullimi i fondeve pensionale, siguruesve të pensioneve, menaxhuesve të mjeteve, investimeve dhe ruajtja e mjeteve të kontribuesve.

Figura 109. Çmimi i njësive janar-dhjetor 2012



Burimi: TKPK (2013)

Në mars të vitit 2012 është miratuar ligji për mbikëqyrjen e Fondeve Pensionale, kështuqë sistemi pensional në Kosovë funksionon në bazë të Ligjit 04/L-101 cili ka hyre në fuqi me 30 mars të vitit 2012. Ligji në fjalë përcakton dhe rregullon tri (3) shtylla të sigurimit pensional:

- Pensionin bazë të moshës së vjetër për të gjithë të moshuarit mbi 65 vjeç, dhe financohet nga të hyrat e Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës (e njohur si shtylla e I-rë);
- Pensionet e kursimeve individuale që i siguron Fondi i Kursimeve Pensionale i Kosovës (FKPK) – të financuara nga kontributet e obligueshme të punëdhënësve dhe punëtorëve për të punësuarit (shtylla e II-të) dhe;
- Pensionete plotsuese individuale Vullnetare, të financuara nga kontributet vullnetare të individëve dhe punëdhënësve (shtylla e III-të).

Në bazë të Ligjit 04/L-101 për Pensionet në Kosovë, shtylla e dytë financohet nga kontributet mujore të detyrueshme të cilat janë të përcaktuara me Ligj ku 5% kontribuojnë të punësuarit në bruto pagën e tyre dhe 5% kontribuojnë punëdhënësit. Çdo pagesë transferohet në llogaritë individuale të kontribusve në Fondin e Kursimeve Pensionale të Kosovës (FKPK).

Gjatë vitit 2012 janë kryer inspektime të plota dhe të fokusuara në Fondin e Kursimeve Pensionale të Kosovës si dhe një inspektim i plote në Fondin Sllloveno Kosovar të Pensioneve.

Gjatë vitit 2012 divizioni i mbikëqyrjes së Fondeve Pensionale ka filluar rishikimin dhe përshtatjen e legjislacionit sekondar të Pensioneve për të harmonizuar me ligjin dhe rregullativën e Bashkimit Evropian. Po ashtu është edhe duke u përgatitur manuali për Mbikëqyrjen e bazuar në rrezik – Off-site dhe rregullativën e nevojshme.

### Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës (FKPK)


FKPK është themeluar për të administruar dhe menaxhuar shtyllën e dytë dhe përderisa nuk liberalizohet tregu i pensioneve FKPK është i vetmi institucion i cili merret me menaxhimin dhe administrimin e shtyllës së dytë ashtu siç është përcaktuar me Ligjin mbi pensionet 04/L-101.

Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës (më tutje "FKPK" ose "Fondi") është themeluar me Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2001/35 më 22 dhjetor 2001, e amendamentuar me Rregulloren 2005/20,

dhe e amendamentuar me Ligjin për pensione Nr. 04/L-101 të Republikës së Kosovës, si entitet ligjor jo-profitabil me qëllimin e vetëm dhe ekskluziv të administrimit dhe menaxhimit të llogarive individuale të kursimeve pensionale, duke siguruar investim të kujdesshëm dhe mbrojtje të aseteve pensionale dhe duke paguar rrjedhjet nga llogaritë individuale për blerjen e anuiteteve për kursimet pensionale, si i besuar për menaxhim duke vepruar në të mirë të pjesëmarrësit dhe përfituesve të tij/saj.

Numri i kontribuesve deri me 31 dhjetor 2012 ishte 418,064 ndërsa në vitin 2011 ishte 384,574 kontribues. Gjatë vitit 2012 vlera e mjeteve në menaxhim të Fondit u rrit për 151,721,906.50€ ku 113,038,605.25€ janë kontribute të pranuar gjatë vitit 2012. Gjithsej vlera e mjeteve në menaxhim të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës me 31 dhjetor 2012 ishte 740,125,122.47€ ndërsa në vitin 2011 ishte 588,403,215.97€.

Figura 110. Çmimi i njësisë nga viti 2002-2012




Burimi: TKPK (2013)

Gjatë vitit 2012 FKPK ka investuar mjete në tregjet e huaja në vlerë prej 145,000,000.00€, ku kjo ka pasur një kthim pozitiv. Fondi i kursimeve pensionale në bazë të ligjit Nr. 04/L-101 ka investuar në letrat me vlerë të Qeverisë së Kosovës në shumë prej 13,752,252.00€. Fondi i Kursimeve Pensionale gjatë vitit 2012 ka pasur një kthim pozitiv ku kthimi bruto ishte në vlerë prej 53,654,123.00€ apo 7.18% ndërsa në vitin 2011 ishte në vlerë prej 3,314,530.00€ apo 0.56%. Në fund të vitit 2012 vlera e njësisë e Fondit të Kursimeve Pensionale i Kosovës ishte 1.117€ ndërsa në vitin 2011 ishte 1.0346€, një rritje të çmimit të njësisë për 7.34%.

Në tabelën në vijim shihet pjesëmarrja e Asset menaxherve në investimin e mjeteve pensionale sipas klasve të aseteve në total mjetet e të TKPK-së për vitin 2012.

Figura 111. Vlera e njesisë së fondit Slloveno Kosovar të pensioneve 2007-2012



Burimi: Fondi i Pensioneve Slloveno-Kosovar(2013)

Tabela 39. Struktura e investimit të mjeteve pensionale deri me 31 dhjetor 2012

Institucionet ku janë të investuara mjetet pensionale	Klasa e Asetit	Mjetet	Pjesëmarrja në përqindje
Vanguard	Ekuitete	272,937,642	36.88
Schroders	Bono	64,758,425	8.75
European Credit Managment	Treg i Kredive	22,086,565	2.98
Aquila	Diversified	73,938,085	9.99
AXA GILB	Bono të lidhura me inflacionin	115,609,533	15.62
BNY Mellon	Të ndryshme	83,960,682	11.34
State Street	Aksione	33,028,458	4.46
Letrat me Vlere te Qeversis se Kosoves		13,928,911	1.88
Raiffeisen Bank	Certifikata Depozitash Bankare	16,120,085	2.18
NLB Prishtina	Certifikata Depozitash Bankare	16,428,599	2.22
BQK	Të painvestuara	27,328,138	3.69
Gjithsej		740,125,122	100

Burimi: BQK (2013)

Fondi Slloveno Kosovar i Pensioneve (FSKP)FSKP është themeluar si shoqëri aksionare “Prva Group” nga Ljubljana dhe Korporata “Dukagjini” nga Peja, më 4 shtator 2006, në bazë të Ligjit 04/L-101. FSKP-ja është licencuar si Fond Pensional Suplementar.

Me 31 dhjetor 2012 mjetet e Fondit Slloveno Kosovar të Pensioneve arritën vlerën 4,467,722.66€ € ndërsa kjo vlerë me 31 dhjetor 2011 ishte në vlerën prej 4,079,674.97€.Vlera e njësi me 31 dhjetor 2012 ishte 129.9732€ ndërsa me 31.12.2011 ishte në vlerë prej 125.6594€.

Numri i kontribuesve për vitin 2012 arrin në 3,590 anëtarë ndërsa në vitin 2011 ishte 3,515. Ngjashëm me institucionet tjera financiare edhe operatorët e sistemit të pensioneve si Fondi ashtu edhe FSKP-ja u janë nënshtruar ekzaminimeve “on-site” dhe “off-site”.

**Tabela 40. Struktura e investimit të mjeteve pensionale nga FSKP-ja deri me 31 dhjetor 2012**

Përshkrimi	Mjetet në Euro	Përqindja
Aksione	176,283	3.95
Obligacione dhe letra të tjera fikse me vlerë	3,143,127	70.35
Depozita	962,600	21.55
Keshi	101,059	2.26
Asetet tjera	84,654	1.89
Total asetet e Fondit	4,467,723	100


Burimi: FSKP (2013)

## 5. Shërbimet e siguruar për autoritetet, komunitetin financiar dhe publikun

BQK u siguron institucioneve shtetërore, institucioneve financiare dhe publikut të gjerë shërbimet e rëndomta që ofrojnë bankat qendrore. Në përgjithësi këto shërbime kanë të bëjnë me qarkullimin e parave të gatshme, transaksionet e llogarive, menaxhimin e mjeteve financiare, sistemet ndërbankare të pagesave, regjistrin e kredive dhe statistikave dhe analizat ekonomike.


### 5.1. Operacionet dhe menaxhimi i parave të gatshme

Figura 112. Furnizimi me para të gatshme (vlera), në milionë euro



Burimi: BQK (2013)

Figura 113. Pranimi i parave të gatshme (vlera), në milionë euro



Burimi: BQK (2013)


Funksioni dhe qëllimi strategjik i BQK-së për sigurimin e një furnizimi të duhur me kartëmonedha dhe monedha për kryerjen e transaksioneve me para të gatshme në ekonomi gjatë vitit 2012 është kryer në mënyrë të suksesshme. Meqë euroja është valuta që përdoret zyrtarisht në Kosovë, përgjegjësitë e BQK-së lidhur me operacionet dhe menaxhimin e parave të gatshme kishin të bëjnë në radhë të parë me euron.

Në vitin 2012, vlera e përgjithshme e parave të gatshme të furnizuara shënoi një rritje prej 30.65 përqind krahasuar me vitin 2011. Struktura e parave të gatshme të furnizuara sipas denominimeve, që në radhë të parë përcaktohet nga kërkesat e sektorit bankar, patën një ndryshim të dukshëm nga viti 2011 në vitin 2012. Te kartëmonedhat euro vazhduan të dominojnë furnizimet me denominimet e ulëta – 5, 10, 20 dhe 50 euro, ndërsa vëllimet e denominimeve prej 100, 200 dhe 500 euro mbeten dukshëm më të ulëta.

Gjatë vitit 2012 vëllimet e denominimeve të ulëta në vlerë prej 20 dhe 10 euro patën rritje të konsiderueshme krahasuar me një vit më parë.


Siç është paraqitur në figurat e mëposhtme, gjatë vitit 2012, BQK-ja i furnizoi bankat komerciale dhe institucionet e tjera me afër 11.5 milionë copë kartëmonedha euro (në shumë prej mbi 293.4 milionë euro) dhe mbi 1.52 milion copë monedha euro (në shumë rreth 0.42 milion euro).

Figura 114. Furnizimi me kartëmonedha euro sipas denominimeve (numri i copëve)



Burimi: BQK (2013)


Figura 115. Furnizimi me monedha euro sipas denominimeve (numri i copëve)



Burimi: BQK (2013)


Njëjtte sikurse gjatë vitit 2011 furnizimi me monedha euro kryesisht u dominua nga monedhat me vlerë të vogël nga 1 eurocent deri në 5 eurocent. Gjatë vitit 2012 vëllimet e denominimeve të ulëta në vlerë prej 2 eurocent dhe 1 eurocent patën rritje të konsiderueshme krahasuar me një vit më parë kurse vëllimi i denominimit prej 5 eurocent shënoi rënie.

Figura 116. Kartëmonedha euro të pranuar sipas denominimeve (numri i copëve)



Burimi: BQK (2013)

Figura 117. Monedha euro të pranuar sipas denominimeve (numri i copëve)



Burimi: BQK (2013)


Në vitin 2012, vlera e përgjithshme e parave të gatshme të pranuar si depozita shënoi një rritje të lehtë prej 0.33 përqind krahasuar me vitin paraprak. BQK-ja pranoi afër 15.9 milionë copë kartëmonedha euro (mesatarisht rreth 64,000 copë kartëmonedha në ditë) dhe afër 3.67 milionë copë monedha euro (mesatarisht rreth 14,000 copë monedha në ditë) si depozita në para të gatshme nga bankat komerciale dhe institucionet e tjera. Të shprehura në vlerë, këto depozita arritën përafërsisht shumat prej 759.7 milionë euro dhe 2.8 milionë euro, përkatësisht. Struktura e kartëmonedhave dhe monedhave euro të pranuar nuk dallon shumë nga viti paraprak.

Ngjashëm me vitet e kaluara, në vitin 2012, paratë e gatshme neto<sup>51</sup> të depozituara ishin në një vlerë më të lartë se sa paratë e gatshme të furnizuara. Në fakt, duke arritur në rreth 469.2 milionë euro, ndryshimi i tillë ishte në një masë të konsiderueshme më i ulët se sa në vitin e mëhershëm që ishte rreth 535.5 milionë euro. Kjo ulje ishte kryesisht si rezultat i rritjes së furnizimit të kartëmonedhave në vlerë prej 10 dhe 20 euro.

<sup>51</sup> Depozitat minus Terheqjet


Meqë BQK-ja mban vetëm nivelin minimal të nevojshëm të parave të gatshme, tepriat janë dërguar në eurozonë, ku më pastaj kthehen në mjete interes-prurëse dhe përdoren edhe për kryerjen e pagesave ndërkombëtare dhe investime. Neto dërgesat jashtë vendit të parave të gatshme në vitin 2012 arritën shumën prej 465.5 milionë eurove duke qenë më e ulët se sa një vit më herët kur ishin 581.9 milionë euro. Ecuritë e eksporteve dhe importeve të parave të gatshme gjatë viteve të fundit janë të paraqitura në dy figurat në vijim. Ky zvogëlim i neto dërgesave erdhi si rrjedhojë e gjendjes fillestare me te ulet te parave te gatshme ne trezorët e BQK-se ne fillim te vitit ne njëren ane dhe rritjes se kërkesave për para te gatshme nga bankat komerciale ne anën tjetër.

Figura 118. Eksporti i parave të gatshme (vlera) në milionë euro



Burimi: BQK (2013)


Figura 119. Importi i parave të gatshme (vlera), në milionë euro



Burimi: BQK (2013)


Ashtu sikurse ne vitet e kaluara, operacionet me para të gatshme vijuan të kryhen përmes pajisjeve moderne të procesimit dhe në përputhje me rregullat dhe procedurat standarde te BQK-se. Të gjitha paratë e gatshme të pranuar nga bankat komerciale dhe institucionet e tjera u procesuan (afër 15.9 milionë copë kartëmonedha euro dhe 3.67 milionë copë monedha euro) dhe u klasifikuan sipas shkallës së vjetërsimit.

Figura 120. Numri i kartëmonedhave të vjetërsuara të tërhequra nga qarkullimi (numri i copëve)



Burimi: BQK (2013)

Figura 121. Proporcioni i kartëmonedhave të tërhequra nga qarkullimi nga gjithsej të pranuar



Burimi: BQK (2013)

Gjatë vitit 2012, rreth 6.9 milionë copë kartëmonedha euro (43.4 për qind e numrit të kartëmonedhave euro të depozituara) u klasifikuan si tejet të vjetërsuara dhe u hoqën nga qarkullimi duke u dërguar në bankat qendrore të eurozonës. Një vëllim i këtillë i konsiderueshëm i kartëmonedhave euro tejet të vjetërsuara të hequra nga qarkullimi kontribuoi në mënyrë të dukshme në përmirësimin e cilësisë së parave të gatshme në qarkullim në Republikën e Kosovës. Kartëmonedhat që më së shumti u klasifikuan si tejet të vjetërsuara dhe u hoqën nga qarkullimi ishin ato të denominimeve 50, 20, 10 dhe 5 euro, për shkak të qarkullimit më të madh të tyre në ekonomi.

Cilësia e parave të gatshme në qarkullim u përmirësua gjithashtu përmes furnizimit të kartëmonedhave plotësisht të reja euro, të cilat u sollën nga eurozona. Gjatë vitit 2012, BQK-ja furnizoi sektorin bankar me afër 4 milionë copë kartëmonedha të reja euro (34.85 për qind e të gjithë numrit të kartëmonedhave euro të furnizuara).

Figura 122. Furnizimi me kartëmonedha të reja (numri i copëve)






Figura 123. Proporcioni i kartëmonedhave të reja të futura në qarkullim nga gjithsej të furnizuara



Shumica e kartëmonedhave të reja të furnizuara ishin kartëmonedha të denominimeve më të ulëta (20, 10 dhe 5 euro), me të cilat kryesisht u furnizuan bankat komerciale për qëllim të pajisjes së bankomatëve të tyre. Mandej, edhe të gjitha kartëmonedhat e përdorura euro që u furnizuan ishin të një cilësie standarde të lartë (cilësia adekuate për bankomatë).

Për sa u përket masave kundër falsifikimit, BQK-ja vazhdoi të përcjellë rastet e parave të falsifikuara gjatë vitit 2012. Në veçanti, vazhdoi të bashkëpunojë me autoritetet për avancimin e raportimit të parave të gatshme të dyshuara si false dhe organizimin e trajnimeve mbi paratë e falsifikuara të dizajnuar për stafin e zgjedhur të institucioneve financiare që ofrojnë shërbime me para të gatshme. Vlen të theksohet mbajtja e rregullt e takimeve të Komitetit Qendror të Analizave të Parave të Falsifikuara<sup>52</sup>. Me tutje në vitin 2012 BQK së bashku me Policinë e Kosovës dhe Laboratorin e Forenzikës vazhdoi të publikoj në ueb<sup>53</sup> faqen e saj statistikën mbi paratë e falsifikuara në nivel të Republikës së Kosovës. Materialet e publikuara kanë si qëllim informimin e publikut të gjere mbi kartëmonedhat dhe monedhat e falsifikuara.

Figura 124. Parate euro te falsifikuara te konfiskuara ne nivel te Kosoves (numri i copëve)



## 5.2. Mirëmbajtja dhe transaksionet e llogarive

BQK-ja ofron shërbime bankare për Thesarin dhe institucionet e tjera të Qeverisë së Republikës së Kosovës, Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP) dhe institucione të tjera sic janë bankat dhe institucionet të tjera financiare, subjektet publike, bankat e huaja, bankat qendrore, institucionet financiare ndërkombëtare (FMN, BB), dhe organizatat ndërkombëtare, sic është specifikuar në nenin 9 të ligjit Nr. 03/L-209 të BQK-se.

<sup>52</sup> Komiteti është i përbërë nga tre përfaqësues të lartë të PK-së dhe tre përfaqësues të lartë të BQK-së

<sup>53</sup> <http://ëëë.bqk-kos.org/?cid=1,141>

Në vitin 2012, sikurse edhe viteve të mëparshme, këto shërbime përbëheshin kryesisht nga mirëmbajtjet e llogarive dhe kryerja e pagesave, duke përfshirë çfarëdo forme të kreditimit.

Gjatë vitit 2012, BQK-ja vazhdoi të mbështesë avancimin e proceseve të kryerjes së transaksioneve dhe akordimeve të Thesarit dhe të AKP-së. Format e pagesave dhe mënyrat e komunikimit u janë përshtatur kërkesave të tyre. Vlen të veçohet elektronizimi i plote i urdhërtransfereve ndërkombëtarë të Thesarit.

**Tabela 41. Shuma e transaksioneve sipas llojeve kryesore të pagesave (në mijëra euro)**

Llojet e transaksioneve	2008	2009	2010	2011	2012
<b>Transaksionet me para te gatshme</b>	<b>385113</b>	<b>411055</b>	<b>423658</b>	<b>535190</b>	<b>468755</b>
Depozita ne para te gatshme	524346	601207	648911	760082	762596
Terheqje te parave te gatshme	139233	190152	225253	224892	293841
<b>Transferet vendor</b>	<b>78078</b>	<b>41169</b>	<b>392587</b>	<b>462867</b>	<b>335267</b>
Transferet vendor ardhës	1076145	1225527	1568021	1615232	1568574
Transferet vendor dales	998067	1184358	1175434	1152365	1233308
<b>Transferet nderkombetar</b>	<b>-364795</b>	<b>-463816</b>	<b>-408689</b>	<b>-558778</b>	<b>-366873</b>
Transferet nderkombetar ardhës	203113	202755	326319	266706	372967
Transferet nderkombetar dales	567908	666571	735008	825483	739840

Burimi: BQK (2013)


Në pjesën e parë të vitit 2012 u bë përmbyllja e të gjitha fazave të planifikuara të projektit të elektronizimi i plote i urdhërtransfereve ndërkombëtarë të Thesarit. BQK gjatë tërë vitit 2012 ka procesuar në mënyrë elektronike urdhërtransferet ndërkombëtar të Thesarit dhe shumica e këtyre urdhërtransfereve janë kryer me date të plotfuqishme në të njëjtën ditë përkundër periudhës plus dy dite sa ishte me parë. Me qëllim të avancimit të validimit të urdhërtransfereve ndërkombëtar dhe në mungesë të SWIFT – BIC kodit BQK gjatë vitit 2012 vazhdoi me përdorimin e licencës së BIC-SWIFT kodeve të marre nga kompania SWIFT që u përdor nga moduli i pagesave ndërkombëtare për validimin e BIC kodeve të urdhërtransfereve ndërkombëtar të klientëve të BQK-së dhe Thesarit në veçanti.

Përderisa pjesa më e madhe e operacioneve me para të gatshme të BQK-së gjatë vitit 2012 u kryen në emër të dhe për llogari të bankave komerciale, pjesa më e madhe e pagesave vendore të BQK-së janë kryer në emër të dhe për llogari të Thesarit<sup>54</sup>.

Si pjesëmarrëse e drejtpërdrejtë në Sistemin Elektronik të Kliringut Ndërbankar (SEKN) BQK-ja ka dërguar dhe ka pranuar urdhërpagesat vendore në emër të dhe për llogari të llogarimbajtësve të saj. Gjatë vitit 2012, përmes SEKN-së BQK-ja ka dërguar në emër të klientëve të saj afër 287 mijë urdhërpagesa shkuarëse (një rritje prej 15.1 për qind krahasuar me vitin paraprak), dhe ka pranuar për llogari të tyre afër 96.6 mijë urdhërpagesa ardhëse (një rritje prej 3 për qind krahasuar me vitin paraprak).


<sup>54</sup> Thesari – Ministria e Ekonomisë dhe Financave

Figura 125. Vëllimi i transaksioneve vendore shkuarëse, numri



Burimi: BQK (2013)


Figura 126. Vlera e transaksioneve vendore shkuarëse, në milionë euro



Burimi: BQK (2013)


Shprehur në vlerë, urdhërpagesat shkuarëse në vitin 2012 arritën mbi 1.23 miliardë euro (një rritje prej 7 përqind krahasuar me vitin paraprak) dhe urdhërpagesat ardhëse arritën mbi 1.57 miliardë euro (një zvogëlim prej 2.9 përqind krahasuar me vitin paraprak). BQK-ja ka mbetur, sa i përket si vlerës ashtu edhe vëllimit të transaksioneve, pjesëmarrësi më i madh në SEKN.

Figura 127. Vëllimi i transaksioneve vendore ardhëse, numri



Burimi: BQK (2013)

Figura 128. Vlera e transaksioneve vendore ardhëse, në milionë euro




Burimi: BQK (2013)

Kur flitet për transaksionet e pagesave vendore, duhet theksuar se të gjitha bankat komerciale i gjenerojnë vetë ato si pjesëmarrëse në SEKN, kurse institucionet e sigurimit numrin më të madh të pagesave të tyre e kryejnë nëpërmes bankave komerciale. Në të vërtetë, të gjithë llogarimbajtësit e tjerë të BQK-së i shfrytëzojnë shërbimet e pagesave të ofruara nga BQK-ja në mënyrë të kufizuar, pasi që të gjithë ata kanë llogari në banka komerciale.


Sa u përket transaksioneve ndërkombëtare, në vitin 2012, numri më i madh i tyre u krye nga BQK-ja me urdhër të Thesarit. Në anën tjetër, duke marrë për bazë vlerën e tyre, pjesa më e madhe e transaksioneve ndërkombëtare të kryera nga BQK-ja kanë të bëjnë me transferet e fondeve të bankave komerciale. Të dhënat vjetore për pesë vitet e fundit mbi transaksionet ndërkombëtare janë të paraqitura në katër figurat në vijim.

Figura 129. Vëllimi i transaksioneve ndërkombëtare ardhëse, numri



Burimi: BQK (2013)


Figura 130. Vlera e transaksioneve ndërkombëtare ardhëse, në milionë euro



Burimi: BQK (2013)


Sa i përket shumës së depozitave, Institucionet e Qeverisë së Republikës së Kosovës së bashku me depozitat e Agjencisë Kosovare të Privatizimit përbënin pjesën më të madhe të depozitave të gjithmbarshme të mbajtura në BQK në fund vitin 2012 (61.07 për qind). Më 31 dhjetor 2012, depozitat e institucioneve të Qeverisë së Republikës së Kosovës arritën shumën prej 271.7 milionë euro, ndërsa ato të AKP-së arritën shumën prej 549.4 milionë euro.

Figura 131. Vëllimi i transaksioneve ndërkombëtare shkuarëse, numri



Burimi: BQK (2013)

Figura 132. Vlera e transaksioneve ndërkombëtare shkuarëse, në milionë euro




Burimi: BQK (2013)

Në mesin e llogarimbajtësve të tjerë, bankat komerciale dhe institucionet e sigurimit janë më të rëndësishmit sa i përket nivelit të depozitave që mbahen në llogaritë në BQK. Depozitat e bankave komerciale dhe institucioneve të sigurimeve që mbahen në BQK, kryesisht kanë të bëjnë me obligimet e tyre rregullatore. Ato përbënin 22.8 për qind të depozitave të gjithsejta që u mbajtën në BQK gjatë vitit 2012. Më 31 dhjetor 2012, depozitat e bankave komerciale dhe institucioneve të sigurimit ishin në shumën prej 307.13 milionë euro.

Niveli i depozitave të Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës (TKPK) të mbajtura në BQK u rrit gjatë vitit 2012. Ato përbënë rreth 2 për qind të depozitave të gjithsejta që u mbajtën në BQK gjatë vitit 2012 dhe në fund të vitit arritën shumën prej 27.3 milionë euro.

Figura 133. Evoluimi i depozitave të klientëve kryesorë të BQK-së, milionë euro



Burimi: BQK (2013)

### 5.3. Sistemi i Pagesave

#### 5.3.1 Operimi i Sistemit Elektronik të Kliringut Ndërbankar

Zhvillimi i një sistemi efikas, të sigurt dhe të qëndrueshëm të pagesave kombëtare, si shtyllë kyçe e infrastrukturës financiare, është një prej funksioneve parësore të BQK-së. BQK-ja operon Sistemin Elektronik të Kliringut Ndërbankar (SEKN), i cili është sistem i vetëm ndër bankar i pagesave në vend. SEKN-ja, funksionon si një sistem hibrid i cili mundëson kanalizimin ndër bankar të një sërë instrumentesh të pagesave.

Gjatë vitit 2012 u shënuan rritje në vëllim dhe vlerë të transaksioneve të SEKN-së dhe u bë avancim i mëtejshëm i sistemit.

Figura 134. Numri i transaksioneve në SEKN





Figura 135. Vlera e transaksioneve në SEKN



Nga zhvillimet me rëndësi të veçantë ishte automatizimi i ndërfaqeve (ndërlidhjeve) të Sistemit Elektronik të Kliringut Ndërbankar (SEKN) me Sistemin Qendror të Letrave me Vlerë (DEPO/x) dhe poashtu implementimi dhe funksionalizimi i Regjistrimit të Poseduesve të Llogarive Bankare për herë të parë në Kosovë, si dhe fillimi i zbatimit të disa nga projektet e planifikuara zhvillimore<sup>55</sup> në kuadër të Strategjisë për Zhvillim të Sistemit Kombëtar të Pagesave.

Figura 136. Mesatarja ditore e numrit të transaksioneve në SEKN





Figura 137. Mesatarja ditore e vlerës së transaksioneve në SEKN




Rritja e vazhdueshme në vëllim dhe vlerë të transaksioneve ndërbankare të SEKN-së pasqyrojnë rritjen relative të pagesave pa para të gatshme dhe rritjen e besueshmërisë në sistemin bankar. Sikurse viteve të mëparshme, në vitin 2012, rritja vjetore si e vëllimit ashtu edhe e vlerës së transaksioneve të SEKN-së ishte e dukshme. Rreth 4.3 milionë transaksione me një vlerë të përgjithshme prej 5.7 miliardë euro u kanalizuan përmes SEKN-së gjatë vitit 2012.

<sup>55</sup> Sigurimi i shërbimeve web të pagesave elektronike ndërbankare për kompani e institucione qeveritare dhe publike (shtylla IV); Projekti i pagave dhe pesnioneve (shtylla IV); Dërgesat nga jashtë (shtylla VIII-të), hartimi dhe publikimi i studimit për "dërgesa nga jashtë" fokusuar nga këndi i lehtësimit të qarkullimit të pagesave

Krahasuar me transaksionet e SEKN-së në vitin paraprak, vëllimi i transaksioneve u rrit për 3.34 për qind dhe vlera e transaksioneve u rrit për 11.69 për qind. Rritja e transaksioneve të SEKN-së mund të shihet edhe nga të dhënat mesatare ditore. Vlera ditore e transaksioneve të SEKN-së në vitin 2012 ishte 22.9 milionë euro, krahasuar me rreth 20.5 milionë euro në vitin 2011. Mandej, vëllimi ditor i transaksioneve të SEKN-së në vitin 2012 ishte afro 17.5 mijë, krahasuar me rreth 16.9 mijë në vitin 2011. Një ndër faktorët që ka ndikuar në rritjen e vlerës së transaksioneve të SEKN-së ishin transaksionet fiskale nga Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës si dhe emetimi i letrave me vlerë nga ana e qeverisë së Republikës së Kosovës. Ndërkaq rritja në numër të pagesave ndërbankare gjatë këtij viti nuk ishte aq e ndjeshme në krahasim me vitet paraprake.


Janë disa lloje të veçanta të transaksioneve të SEKN-së: të rregullta (individuale dhe masive), prioritare (individuale dhe masive), Kos-Giro, Debitimi Direkt dhe Letrat me Vlerë. Nivelet e vëllimeve dhe vlerave të tyre për vitet 2011 dhe 2012 janë të paraqitura në figurat në vijim.

Figura 138. Vëllimi vjetor i transaksioneve të SEKN-së sipas llojeve të tyre



Burimi: BQK (2013)

Figura 139. Vlera vjetore e transaksioneve të SEKN-së sipas llojeve të tyre



Burimi: BQK (2013)

Pagesat e rregullta (individuale dhe masive) përbëjnë rreth 86.6 për qind të vëllimit dhe rreth 63.9 për qind të vlerës së transaksioneve të SEKN-së. Ato kanalizohen përmes SEKN-së ose si transaksione individuale (një-deri te-një) ose si transaksione masive (një-deri te-shumë ose shumë-deri te-një). Ato procesohen përmes 4 sesioneve të rregullta të kliringut dhe shlyhen në baza neto.

Transaksionet Kos-Giro përfaqësojnë një lloj të veçantë të transaksioneve të rregullta që po ashtu procesohen përmes sesioneve të kliringut dhe shlyhen në baza neto. Ato kanalizohen përmes SEKN-së si transaksione masive (shumë-deri te-një). Përderisa transaksionet e rregullta individuale janë të destinuara për pagesat në përgjithësi dhe pagesat e rregullta masive janë të destinuara për pagesat dhe arkëtimet e ndërmarrjeve dhe institucioneve të ndryshme, transaksionet Kos-Giro janë të destinuara për arkëtimet e standardizuara dhe të automatizuara të entiteteve të mëdha faturuese. Gjatë vitit 2012 u shënuar një rritje si e vëllimit ashtu edhe e vlerës së tyre.

Transaksionet prioritare (urgjente) procesohen dhe shlyhen menjëherë gjatë orarit të punës në baza bruto. Ngjashëm me transaksionet e rregullta, transaksionet prioritare kanalizohen përmes SEKN-së ose si transaksione individuale ose si transaksione masive. Ato ende përfaqësojnë një pjesë të vogël të transaksioneve të gjithmbarshme të SEKN-së. Në vitin 2012, sa i përket vëllimit, ato përfaqësuan më pak se 1 për qind të transaksioneve, ndërsa sa i përket vlerës, ato arritën të përfaqësojnë mbi 15.7 për qind të transaksioneve. Ky lloj vazhdon të përdoret kryesisht për kryerjen e pagesave urgjente dhe të atyre me vlera më të mëdha.

Debitimi Direkt si instrument dhe skemë e re e pagesave në Kosovë e lansuar në nëntor 2009 ofron një mundësi më të avancuar të kryerjes automatike të pagesave periodike (pa para të gatshme) nga llogaria bankare që kanë të bëjnë, në radhë të parë, me shpenzime mujore për energji elektrike, furnizimi me ujë, telefoni, ngrohje, mirëmbajtje etj. Si lloj i ri transaksioneve të SEKN-së, Debitimi Direkt, ende nuk përdoret në atë masë sa llojet e tjera të pagesave, kështu që, gjatë vitit 2012, përfaqësonte vetëm 1 për qind të vëllimit dhe vlerës së transaksioneve të SEKN-së. Gjatë vitit 2012, dy kompani të reja iu bashkuan skemës së Debitimit Direkt.

Një pasqyrë e detajuar e treguesve të përqendrimit të pjesëmarrjes së institucioneve më aktive në SEKN gjatë vitit 2012, kundrejt totalit të aktivitetit në këtë sistem, është paraqitur në vijim.

**Tabela 42. Treguesit e përqendrimit për transaksionet e iniciuara/dërguara në SEKN**

Sistemi SEKN	Vëllimi	Vlera
Tri banka	51.15%	67.26%
Pesë bankat tjera	48.85%	32.74%
Totali (vlerë absolute)	4,329,681	5,680,977,737

Burimi: BQK (2013)

Referuar vlerës së përgjithshme të transaksioneve të shlyera në SEKN, gjatë vitit 2012 vlera e përgjithshme ka qenë 5,680,957,532 €, ku tri institucionet e para me vlerë më të madhe të transfereve të iniciuara zënë 67.26 për qind të vlerës absolute ndërsa të gjitha institucionet tjera 32.74 për qind. Sa i përket numrit të transfereve të iniciuara, nga numri i përgjithshëm i tyre 4,329,678, tri institucionet e para me numër më të madh të transfereve të iniciuara zënë 51.15 për qind të numrit të përgjithshëm, ndërsa të gjithë institucionet tjera zënë 48.85 për qind.

**Tabela 43. Treguesit e përqendrimit për transaksionet e pranuar/hyrëse në SEKN**

Sistemi SEKN	Vëllimi	Vlera
Tri banka	75.71%	69.97%
Pesë bankat tjera	24.29%	30.03%
Totali (vlerë absolute)	4,329,681	5,680,977,737

Burimi: BQK (2013)

Sa i përket transfereve të pranuar, tri institucionet me vlera më të mëdha të transfereve të pranuar zënë 69.97 për qind të shumës së përgjithshme, ndërsa gjithë institucionet tjera zënë 30.03 për qind.

Ndërsa nga numri i përgjithshëm i transfereve të pranuar, tri institucionet e para zënë 75.71 për qind të numrit të përgjithshëm, ndërsa të gjithë institucionet tjera 24.29 për qind.

### 5.3.2 Zhvillimet e përgjithshme, analiza dhe mbikëqyrja e sistemeve të pagesave

Në kuadër të implementimit të Strategjisë së Zhvillimit të Sistemit Kombëtar të Pagesave, gjatë vitit 2012 u zhvilluan aktivitete pothuaj në të gjitha shtyllat përkatëse të saj si: i) korniza ligjore, ii) pagesat me vlera të mëdha dhe ato urgjente, iii) pagesat me vlera të vogla, iv) transaksionet qeveritare, v) letrat me vlerë, vi) tregu monetar, VII) dërgesat nga jashtë, VIII) mbikëqyrja e sistemit të pagesave, dhe IX) bashkëpunimi dhe koordinimi mes akterëve të pagesave.

Në kuadër të nismave për implementim të strategjisë janë themeluar grupet punuese për të gjitha shtyllat e parapara në strategji dhe janë ndërmarrë një mori aktivitete të përkatëse.

Konkretisht, janë përgatitur termat e referencës për sistemet e reja të pagesave (shtylla ii, iv dhe vi) si dhe është finalizuar drafti i ligjit për sistemin e pagesave, ka kaluar për herë të parë në procedurat e Kuvendit të Kosovës, është shqyrtuar nga komisioni për buxhet dhe financa dhe është në procedim për tu miratuar. Po ashtu në kuadër të shtyllës së parë (baza ligjore e sistemit të pagesave), janë plotësuar, përshtatur dhe miratuar këto rregullore: a) Rregullore mbi minimumin e rezervave të bankës, b) Rregullore për regjistrin e poseduesve të llogarive bankare, si dhe c) Rregullore dhe udhëzim për pagesat ndërkombëtare.

Në kuadër të shtyllës së fundit (IX), Këshillit Kombëtar i Pagesave (KKP), të themeluar për të mbështetë zhvillimin dhe rritjen e sistemeve të qëndrueshme dhe efikase për kliringun dhe shlyerjen e pagesave dhe letrave me vlerë në Kosovë. Gjatë këtij viti, nën ombrellën e këtij këshilli ka vepruar me sukses edhe grupi për menaxhimin e projektit për reduktimin e pagesave me para të gatshme në Kosovë. Në këtë fushë, janë realizuar analiza të veçanta rreth përdorimit të instrumenteve elektronike në vend dhe krahasimet me vende në regjion dhe më gjerë si dhe analiza lidhur me pagesat jo në para të gatshme – hulumtime mbi klientin dhe tregtarin, etj. Njëkohësisht në kuadër të aktiviteteve të kësaj ekipe, u nisën dhe zhvilluan kontaktet e para me përfaqësues të kompanive “MasterCard” dhe “Visa”, për shkëmbim të ideve dhe bashkëpunim lidhur me promovimin e mënyrave elektronike të pagesave, etj.

Në kuadër të fushës së mbikëqyrjes së sistemit të pagesave (shtylla vii), BQK ka themeluar dhe zhvilluar funksionin përkatës në linjë me parimet dhe standardet ndërkombëtare, janë bërë publikime të rregullta të treguesve analitikë për instrumente të pagesave në Kosovë.


Po ashtu, gjatë vitit 2012 u rishikua dhe plotësua Metodologjia për Raportimin e Instrumenteve të Pagesave, duke pas për synim:

- Grumbullimin dhe përsosjen e përpunimit të të dhënave periodike si dhe mirëmbajtjen efikase të bazës së të dhënave mbi përdorimin e instrumenteve të pagesave në Kosovë.
- Monitorimin e zhvillimeve në fushën e sistemeve të pagesave në mënyrë që të vlerësohet shkalla e rreziqeve që përmbajnë këto dhe të sigurohet transparenca në marrëveshjet që kanë të bëjnë me instrumentet dhe shërbimet e pagesave.
- Përmirësimin e cilësisë së raporteve, analizave dhe publikimeve mbi instrumentet e pagesave në pajtim me raportet nga Banka Qendrore Evropiane, duke synuar kështu publikimin e të dhënave për Kosovë në botim përkatës në të ardhmen e afërt<sup>56</sup>.
- Analizimin e zhvillimeve në sferën e instrumenteve të pagesave në Kosovë karshi shteteve në Evropën Juglindore dhe Qendrore.<sup>57</sup>
- Nga të dhënat e mbledhura dhe të analizuar gjatë vitit 2012 është krijuar një pasqyrë e gjerë mbi nivelin e zhvillimit të sistemit kombëtar të pagesave. Në përgjithësi, vërehet se infrastruktura dhe instrumentet e pagesave po zhvillohen me një ritëm të shpejtë.

<sup>56</sup> Burimi: <http://www.bqk-kos.org/?cid=1,59,54>


<sup>57</sup> Burimi: <http://www.bqk-kos.org/?cid=1,59,55>

Figura 140. Numri i kartelave të debitit sipas llojit



Burimi: BQK (2013)

Figura 141. Numri i kartelave të kreditit sipas llojit




Burimi: BQK (2013)

Në vazhdimësi, numri i kartelave me funksion pagese është rritur. Rrjeti i terminaleve të bankave në Kosovë po ashtu është në rritje. Në dhjetor të vitit 2012, janë raportuar 599,651 kartela me funksion debiti, 95,942 kartela me funksion krediti dhe 13,081 kartela me parapagim. Këto kartela kanë mundur të përdoren në 483 terminale ATM (bankomatë) dhe 8,592 terminale POS (pika të shitjes) të vendosura nëpër Kosovë.


Në krahasim me vitin paraprak, numri i terminaleve ATM është rritur për 5 për qind dhe numri i terminaleve POS me 14.04 për qind.

Figura 142. Numri i terminaleve ATM



Burimi: BQK (2013)

Figura 143. Numri i terminaleve POS



Burimi: BQK (2013)

Nga raportimet e bankave rezulton se në fund të vitit 2012, numri i përgjithshëm i llogarive bankare të klientëve është rreth 1.8 milion, me një rënie prej 11,4 % krahasuar me fundin e vitit 2011. Rreth 98.4% e llogarive janë të rezidentëve, ndërsa rreth 1.6% të jo rezidentëve.

Nga totali i llogarive në fund të vitit 2012, rreth 97 mijë llogari kanë qasje “online” nga internet për të kryer pagesa apo për të kontrolluar gjendjen e llogarisë, duke shënuar një rritje prej 41 për qind në krahasim me vitin 2011. Pavarësisht rritjes së ndjeshme të këtij treguesi gjatë vitit 2012, niveli i shfrytëzimit të llogarive bankare me “e-banking” vazhdon të mbetet në nivele të ulëta. Në krahasim me shtetet e tjera në Evropën Qendrore dhe Juglindore, Kosova ka edhe shumë punë për të bërë. Sa i përket numrit të terminaleve për 1 milion banorë, Kosova vazhdon të qëndrojë ndër vendet e fundit në rajon.

Tabela 44. Numri i llogarive

Përshkrimi i llogarisë	Totali i llogarive të klientëve			Të aksesueshme nga interneti		
	2010	2011	2012	2010	2011	2012
Llogaritë e klientëve (1+2)	1,857,608	2,059,878	1,824,266	50,274	68,990	97,089
1-llogari të rezidentëve (a+b)(%)	98.40%	98.34%	98.40%	94.20%	94.80%	97.00%
a-individuele (%)	94.30%	94.36%	93.20%	83.60%	80.00%	78.70%
b-kompani (%)	5.70%	5.63%	6.80%	16.40%	20.00%	21.30%
2-llogari të jo-rezidentëve (c+d)	1.60%	1.66%	1.60%	5.80%	5.20%	3.00%
c-individuele (%)	96.10%	96.60%	96.50%	94.30%	90.80%	94.90%
d-kompani (%)	3.90%	3.40%	3.50%	5.70%	9.20%	5.10%

Burimi: BQK, Raportimet e bankave sipas "Metodologjisë për raportimin e instrumenteve të pagesave"

Mirëpo, shenjë pozitive në këtë drejtim është ritmi më i shpejtë i zhvillimit të infrastrukturës sesa mesatarja e zhvillimit në vendet e regjionit. Situata e ngjashme është edhe tek kartelat bankare. Numri i kartelave me funksion pagese vazhdon të rritet.

Tabela 45. Tabela krahasuese e instrumenteve dhe terminaleve të pagesave<sup>58</sup>

Përshkrimi	Banorë	Sipërfaqja (km <sup>2</sup> )	Densiteti (për km <sup>2</sup> )	ATM	për 1 milion banorë	për 100 km <sup>2</sup>	POS	për 1 milion banorë	për 100 km <sup>2</sup>	Kredit Kartelat	për 1 milion banorë	Debit Kartelat	për 1 milion banorë	E-Banking
Kosova	2.1	10,887	193	460	219	4	7,534	3,588	69	74,873	35,654	548,253	261,073	68,990
Shqipëria	3.19	28,748	111	805	252	3	5,126	1,607	18	37,893	11,879	693,958	217,542	37,138
Republika Çeke	10.54	78,865	134	4,082	387	5	77,651	7,367	98	2,858,390	271,194	7,455,017	707,307	-
Turqia	73.73	783,562	94	32,462	440	4	1,976,843	26,812	252	51,360,809	696,607	81,879,926	1,110,537	-
Slovenia	2.05	20,273	101	1,845	900	9	34,167	16,667	169	1,544,161	753,249	2,502,526	1,220,744	701,311
Bullgaria	7.54	110,879	68	5,792	768	5	64,425	8,544	58	978,546	129,781	7,007,157	929,331	-
Hungaria	9.74	93,028	105	4,907	504	5	84,678	8,694	91	1,230,544	126,339	7,680,693	788,572	-
Bosnia	3.77	51,197	74	1,202	319	2	18,589	4,931	36	180,453	47,866	1,480,855	392,800	94,339
Mali i Zi	0.62	13,812	45	311	502	2	10,131	16,340	73	50,897	82,092	303,630	489,726	27,230
Kroacia	4.42	56,594	78	3,975	899	7	100,012	22,627	177	1,983,188	448,685	7,062,580	1,597,869	1,253,171
Maqedonia	2.06	25,713	80	876	425	3	33,435	16,231	130	290,638	141,086	1,098,800	533,398	306,981

Burimi: BQK (2013) dhe bankat qendrore apo autoritetet mbikëqyrëse të shteteve përkatëse


## 5.4. Menaxhimi i Mjeteve

### 5.4.1 Menaxhimi i Mjeteve dhe Politika e Investimeve të BQK-së

Bazuar në Ligjin Nr. 03/L-209 (Neni 1 paragrafi 1.6), Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK) është e autorizuar të veprojë si agjent fiskal i Qeverisë. Kjo formë e investimeve financiare ka mundësuar kthimin nga investimet e mjeteve financiare mjete këto që derdhen në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Mjetet e depozituara ju takojnë kryesisht

Figura 144. Raporti i shpërndarjes së investimeve të portofolit të BQK-së



Burimi: BQK (2013)

<sup>58</sup> Të dhënat në tabelë janë nga viti 2011 pasi që shumica e vendeve në rajon të dhënat për vitin 2012 nuk i kanë publikuar ende

Institucioneve Qeveritare; Ministrisë së Financave, Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP)-së si dhe institucioneve financiare (rezervat e obligueshme për likuiditet).

Politika e Investimeve e aprovuar nga Bordi Ekzekutiv, implementohet nga ana e Departamentit të Menaxhimit të Mjeteve, respektivisht Divizionit të Investimeve. Për shkak se një pjesë e madhe e mjeteve që menaxhohen janë mjete të institucioneve publike, të cilat sipas Politikës së Investimeve mund edhe të kthehen për një afat të shkurtër kohor, pasi që objektivat kryesore të përcaktuara në këtë politikë janë siguria, likuiditeti dhe kthimi në investime.


#### 5.4.2 Menaxhimi i Investimeve për vitin 2012

Në pajtim me Politikën e Investimeve të BQK-së përgjatë vitit 2012 të gjitha mjetet janë investuar në instrumente financiare që hyjnë në kategorinë e instrumenteve financiare më të sigurta dhe më likuide.

Respektivisht, kategoritë e instrumenteve financiare në të cilat janë investuar mjetet nën menaxhimin e portfolios së BQK-së janë:

- depozitat e afatizuara bankare me afat maturimi të përcaktuar sipas Politikës së Investimeve të BQK-së në institucione financiare me rangim/vlerësim kreditor superior, përkatësisht euro-depozita bankare të afatizuara me banka komerciale dhe qendrore të shteteve më kredibile të Bashkimit Evropian dhe shteteve të Eurozonës, dhe
- bonot e thesarit të shteteve më të zhvilluara të Eurozonës me maturitet maksimal deri në një vit të emetuara në valutën euro.


Figura 145a. Shuma e përgjithshme e mjeteve në portfolion e investimeve e shprehur në milion euro në çdo fundvit



Burimi: BQK(2013)

Figura nr.145a e cila paraqet raportin e shpërndarjes të portfoliit të BQK-së në letra me vlerë dhe depozita me banka qendrore e komerciale tregon që lakorja e letrave me vlerë shënon rritje të përqindjes së investimit në këtë kategori të investimit të mjeteve sidomos pas muajit qershor kur investimet në depozita bankare bëhen më pak të favorshme për shkak të gjendjes në tregun e Eurozonës<sup>59</sup>. Përveç muajit janar 2012 gjatë pjesës tjetër të këtij viti, ekspozimi i depozitave të afatizuara me banka komerciale ka shënuar ngritje kundrejt bonove të thesarit të shteteve më të zhvilluara të Eurozonës.

Figura 145b. Shpërndarja e portfolios investuese në çdo fundvit



Burimi: BQK(2013)


<sup>59</sup> Pika më e lartë e pjesëmarrjes është arritur në muajin Nëntor.

Viti 2012 u karakterizua si vit i rritjes së mjeteve të përgjithshme në portfolion e investimeve të BQK-së. Figura 145a dhe 145b, tregojnë rritjen e mjeteve të investuara nga ana e BQK –së sipas gjendjes së tyre me 31 dhjetor të viteve 2009, 2010, 2011 dhe 2012.

**5.4.2.1 Performanca e portfolios për vitin 2012**

146a. Ndikimet nga kriza e borxheve në Eurozonë të shoqëruara me masat e Bankës Qendrore Evropiane (BQE) u ndjenë dukshëm përgjatë vitit në kthimet e realizuara për portfolin e BQK-së. Në veçanti pas uljes së normave kryesore të interesit nga BQE me datën 11 korrik 2012, normat në tregun ndër-bankar u zvogëluan si rrjedhojë e zvogëlimit të normës në depozita në nivel 0%. Figura 146a paraqet lëvizjen e kthimeve nga investimet në portfolion e BQK-së në raport me tregun ndër-bankar të Euros, respektivisht EURIBOR-in 1-mujor (Norma mesatare e huadhënies ndërbankare për valutën Euro).


Figura 146a. Lëvizja e normave në tregun ndër-bankar të Eurzonës dhe lëvizja e normave në depozita të investuara nga BQK



Burimi: BQK (2013)

146b. Për të reflektuar qartë mbi ndikimin e gjendjes së Eurozonës në kthimet nga investimi i mjeteve, në figurën 146b janë paraqitur dy kategori në dy periudha: kthimet nga investimet në raport me rrezikun e ndryshimit të normës së kthimit të shprehur si varianca e normës së interesit të fituar.


Figura 146b. Norma e kthimit të investimeve në portfolio dhe rreziku për dy periudhat gjashtëmujore të vitit 2012



Burimi: BQK(2013)

Horizonti kohor i investimeve: investimet në letra me vlerë përkatësisht bono të thesarit, gjatë vitit 2012 janë realizuar në periudha më të gjata kohore në krahasim me horizontin mesatar kohor të depozitave, përveç muajit shtator dhe muajit dhjetor. Investimi në periudha më të gjata kohore në bono të thesarit është bërë për shkak të sigurisë dhe rritjes së likuiditetit të mjeteve financiare pasi që këto instrumente mund të tregtohen.

Figura 146c. Horizonti kohor mesatar i investimeve të mjeteve financiare




Burimi: BQK (2013)

Si rrjedhojë, normat e kthimit nga letrat me vlerë kanë qenë më të larta se normat e interesit nga depozitat e afatizuara. Horizonti kohor mesatar i portfoliut total është 23,16 ditë.

Figura nr. 146d paraqet performancën e portfolios së BQK-së përgjatë dy periudhave gjashtëmujore të vitit 2012 të shprehur në përqindjen e normës së kthimit nga investimet dhe krahasueshmëria e këtyre

normave kundrejt performancës së treguesve kryesor monetar. Secili indikator ka shënuar rënie drastike performuese midis dy periudhave gjashtëmujore, si pasojë e vendimit të BQE-së për të zvogëluar normën e interesit në depozita bankare. Gjithashtu mund të vërehet që vetëm treguesi i normës së kthimit nga investimi në letra me vlerë ka arritur të qëndrojë më stabil në gjashtëmujorin e dytë, dhe kjo si rrjedhojë e blerjes së bonove të thesarit për periudha më të gjata kohore si dhe e rritjes së ekspozimit të portfolios së investimeve në këtë lloj të instrumentit financiar.

Figura 146d. Performanca e portfolios së investimeve krahas treguesve monetar të shprehur në përqindje



#### 5.4.2 Menaxhimi i Rrezikut të Investimeve

BQK investon në fonde të institucioneve financiare në shtete me klasifikim të lartë kreditor i bazuar në vlerësimet e kreditorëve nga agjencitë e mëdha të njohura ndërkombëtarisht si: Standard & Poor's dhe Moody's si dhe indikatorët tjerë të tregut financiar. Rreziqet aktuale janë rreziqet financiare si: rreziku kreditor, rreziku i interesit, rreziku likuiditetit si dhe rreziku operacional.

##### 5.4.2.1 Rreziku kreditor

Të gjitha investimet janë bërë në raport me kriteret e përcaktuara në Politikën e Investimeve kufizohet me nivelin më të ulët P-2/A-2 (Moody's/S&P) për investimet me afat të shkurtër.

BQK-ja menaxhon rrezikun kreditor përmes diversifikimit të investimeve i cili është i përcaktuar me kufijtë sasior (limite) për shtete dhe institucione financiare. Si shkak i krizës së borxhit në eurozonë janë marrë dhe vendime mbi kufizimin e investimeve si dhe ndalimin e investimeve në banka të cilat nuk janë vlerësuar me potencial që ofrojnë sigurinë e mjeteve të investuara.

Figura 147. Shpërndarja e portfolios sipas rangimit kreditor afatshkurtër (S&P)



Burimi: BQK (2013)

##### 5.4.2.2 Rreziku i normës interesit

Matjen relative të rrezikut të normës së interesit mund ta bëjmë duke krahasuar normën e realizuar të interesit në portfolio me normën e interesit të një pike referuese apo krahasuese. Pikat referuese me të cilat janë krahasuar kthimet në portfolion e investimeve janë EONIA (Norma mesatare një-ditore e huadhënies ndër-bankare për Euro) dhe EURIBOR 1 mujor (Norma mesatare e huadhënies ndër-bankare për valutën Euro) dhe duke me indikatorin statistikor si divijimin standard të normave të interesit. Devijimi standard nga norma e interesit për vitin 2012 është 0.139%, që nënkupton që norma mesatare e interesit mund të varijon për +/- 0.139%.

Norma mesatare e realizuar e kthimit nga investimi i mjeteve në portfolion e BQK-së është 0.144% dhe rezulton një kthim më të vogël për 5 pikë bazë në krahasim me pikën referuese EONIA e cila për vitin 2012 ishte 0.20% kurse si pikë referuese nëse marrim EURIBOR 1 mujor i cili ishte 0.326% që paraqet një kthim më i ulët për 18 pikë bazë. Figura 147 paraqet shpërndarjen e portfolios së rangimeve kreditore afatshkurtra (S&P).

#### 5.4.2.3 Rreziku i likuiditetit

Investimet kryesisht janë bërë në bono të thesarit dhe depozita bankare afatshkurtra në raport me Politikën e Investimeve të BQK-së, që nënkupton që banka ka mbajtur nivelin e likuiditetit për portfolion e investimeve.

Rreziku i likuiditetit është monitoruar vazhdimisht dhe gjatë tërë vitit 2012 nuk ka pasur raste të mungesës së fondeve për të realizuar nevojat e pagesës për depozitorët e BQK-së.

#### 5.4.2.4 Rreziku operacional


Ky rrezik ekziston në të gjitha aktivitetet dhe mund të rezultojë deri në humbje si pasojë e gabimeve të personelit apo sistemit teknologjik të informacionit gjatë procesit të realizimit të investimeve. Gjatë vitit 2012 nuk ka pasur asnjë rast të paraqitjes së këtij rreziku gjatë Investimit të mjeteve financiare.

#### 5.4.3 Letrat me vlerë

Bazuar në Ligjin për Borxhet Publike Nr. 03/L-175 (Neni 2, paragrafi 1.1. dhe 1.2.) dhe Rregulloren për Tregun Primar dhe Sekondar të Letrave me Vlerë të Qeverisë të aprovuar nga Ministria e Financave (MeF) dhe Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, BQK vepron si agjent i Ministrisë së Financave për emetimin e Letrave me Vlerë Më datën 17 Janar 2012 është mbajtur ankandi i parë për emetimin e Letrave me Vlerë të Qeverisë së Republikës së Kosovës, Bono të Thesarit me afat maturimi 3 muaj në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës. Ky ankand ka shënuar fillimin e funksionimit të tregut primar për emetimin e Letrave me Vlerë të Qeverisë së Republikës së Kosovës. BQK-ja gjatë vitit 2012 ka mbajtur të gjitha ankandet në pajtim me Kalendarin për Emetimin e Letrave me Vlerë të Qeverisë së Republikës së Kosovës përmes platformës elektronike për Tregtimin e Letrave me Vlerë. Në pajtim me Rregulloren për Tregun Primar dhe Sekondar të Letrave me Vlerë të Qeverisë, Neni 1 paragrafi 1.26 dhe Neni 7, të gjitha ankandet janë realizuar përmes Bankave Komerciale të cilat veprojnë si Akterë Primar.

Përveç Akterëve Primar, pjesëmarrës në tregun e Letrave me Vlerë të Qeverisë së Republikës së Kosovës kanë qenë edhe institucionet tjera jo-bankare dhe personat fizik, të cilët kanë dorëzuar ofertat e tyre në ankand përmes Akterëve Primar. Në pajtim me Rregulloren për Tregun Primar dhe Sekondar të Letrave me Vlerë të Qeverisë, ofertat nga pjesëmarrësit kanë qenë konkurruese dhe jo konkurruese. Për ofertat konkurruese pjesëmarrësit kanë ofertuar shumën dhe normën vjetore të kthimit, ndërsa për ofertat jo konkurruese pjesëmarrësit kanë ofertuar vetëm shumën

Figura 148. Struktura e Letrave me Vlerë të Qeverisë sipas afatit të maturimit



dhe kanë pranuar normën vjetore të kthimit të përcaktuar nga ofertat konkurruese të suksesshme.

Në pajtim me Kalendarin për Emetimin e Letrave me Vlerë të Qeverisë së Republikës së Kosovës, në vitin 2012 janë mbajtur katërmbëdhjetë ankande.


Në dymbëdhjetë nga këto ankande janë emetuar Letra me Vlerë me afat maturimi 91 ditë në shumën prej 10 milionë euro të emetuar në secilin ankand dhe në dy ankande tjera janë emetuar Letra me Vlerë me afat maturimi 182 ditë në shumën prej 20 milionë euro në korrik 2012 dhe 24 milion euro në shtator 2012, në figurën 148 paraqitet struktura e Letrave me Vlerë të Qeverisë sipas afatit të maturimit.

Të gjitha ankandet e Letrave me Vlerë të Qeverisë së Republikës së Kosovës janë zhvilluar me sukses pasi që në ankande kanë marrë pjesë të gjithë Akterët Primar dhe shuma e ofertuar për blerjen e Letrave me Vlerë vazhdimisht ka tejkaluar shumën e emetuar nga MeF. Si rezultat i kësaj, shuma e ofertuar për vitin 2012 ishte 407.8 milion euro duke qenë për 2.49 herë më e lartë se shuma e kërkuar nga Ministria e Financave (Thesari) të Republikës së Kosovës për ankandet e Letrave me Vlerë me afat maturimi prej 91 dhe 182 ditë. Kërkesa më e lartë për ankandet e Letrave me Vlerë me afat maturimi 91 ditë ishte në qershor 2012 ku për vlerën e emetuar prej 10 milionë euro oferta e pjesëmarrësve ishte 35.75 milionë euro. Kërkesa më e ulët për ankandet e Letrave me Vlerë me afat maturimi 91 ditë ishte në tetor 2012 ku për vlerën e emetuar prej 10 milionë euro oferta e pjesëmarrësve ishte 14.65 milionë euro. Në figurën 152 paraqitet struktura e ankandeve të Letrave me Vlerë të Qeverisë me afat maturimi 91 ditë.

Kërkesa në ankandet e Letrave me Vlerë të Qeverisë me afat maturimi 182 ditë ishte 55.35 milion euro në korrik 2012 për vlerën e emetuar prej 20 milionë euro dhe 39.35 milion euro në shtator 2012


Në figurën 149 paraqitet struktura e

Figura 149. Ankandet e Letrave me Vlerë të Qeverisë me afat maturim 182 ditë



Burimi: BQK (2013)


Figura 150. Struktura e pjesëmarrësve sipas shumave të alokuara



Burimi: BQK (2013)

me afat maturimi 91 ditë ishte në qershor 2012 ku për vlerën e emetuar prej 10 milionë euro oferta e pjesëmarrësve ishte 35.75 milionë euro.

Figura 151. Levizja e normës vjetore të kthimit për Letrat me Vlerë të Qeverisë




Burimi: BQK (2013)

ankandeve të Letrave me Vlerë të Qeverisë me afat maturimi 182 ditë. Pjesëmarrës në ankande përmes Akterëve Primar kanë qenë edhe institucionet jo-bankare si Trusti i Kursimeve Pensionale të Kosovës dhe Fondi Slloveno-Kosovar i Pensioneve.

Trusti i Kursimeve Pensionale të Kosovës ka marrë pjesë në ankandet e mbajtura në korrik 2012 dhe shtator 2012 ndërsa Fondi Slloveno Kosovar i Pensioneve ka marrë pjesë në ankandin e mbajtur në maj 2012. Rrjedhimisht këto dy institucione jo-bankare përbëjnë 8.57% të vlerës nominale të alokuar pjesëmarrësve të suksesshëm gjatë vitit 2012.

Në figurën 150 paraqitet struktura e pjesëmarrësve sipas shumave të alokuara. Normat e vjetore të kthimit të Letrave me Vlerë të Qeverisë me afat maturimi 91 ditë gjatë vitit 2012 kanë shënuar trend të rënies, duke filluar me normën vjetore të kthimit prej 3.5 përqind në janar 2012 deri në 1.08 përqind e arritur në dhjetor 2012, kjo si rezultat i rritjes së kërkesës për pjesëmarrje në tregun e Letrave me Vlerë të Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Figura 152. Ankandet e Letrave me Vlerë të Qeverisë me afat maturimi 91 ditë



Burimi: BQK (2013)

Norma mesatare vjetore e kthimit në të

gjitha ankandet për Letrat me Vlerë me afat maturimi 91 ditë ishte 2.52 përqind. Për emetimet e Letrave me Vlerë me afat maturimi 91 ditë, norma më e lartë vjetore e kthimit ishte në ankandin e muajit mars 2012 (4.0 përqind), ndërsa norma më e ulët vjetore e kthimit ishte në ankandin e muajit dhjetor 2012 (1.08 përqind). Në figurën 151 paraqitet lëvizja e normës vjetore e të kthimit për Letrat me Vlerë të Qeverisë. Ndërsa, për emetimet e Letrave me Vlerë me afat maturimi 182 ditë, norma vjetore e kthimit ishte 3.05 përqind në ankandin e korrikut 2012 dhe 2.36 përqind në ankandin muajit shtator 2012.

Norma mesatare vjetore e kthimit në të gjitha ankandet për Letrat me Vlerë me afat 182 ditë ka qenë 2.71 përqind.

Fillimi i emetimit të Letrave me Vlerë të Qeverisë përmes ankandeve ka treguar një interesim të shtuar nga ana e Akterëve Primar për blerjen e tyre, ku në të gjitha ankandet e mbajtura në vitin 2012 ofertat e dorëzuara për blerjen e Letrave me Vlerë të Qeverisë kanë qenë më të mëdha se shumata e emetuar. Në figurën numër 152 janë paraqitur të gjitha ankandet e mbajtura në vitin 2012.


Gjatë vitit 2012, BQK-ja ka bërë poashtu të gjitha përgatitjet e duhura për zhvillimin e Tregut Sekondar të Letrave me Vlerë të Qeverisë së Republikës së Kosovës. Tregtimi i Letrave me Vlerë konsiderohet si faktor me rëndësi për sektorin financiar dhe fiskal në Kosovë.

Ky treg promovon rritjen e efikasitetit në procesin e ndërmjetësimit financiar dhe konsiderohet bazë e rëndësishme për zhvillimin e tregut të kapitalit në vend.

## 5.5. Regjistri i Kredive të Kosovës


Furnizimi i institucioneve kredidhënëse dhe kredimarrësve me informacionet e nevojshme kreditore individuale përmes sistemit të Regjistrimit të Kredive të Kosovës (RKK) është një shërbim me rëndësi i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës (BQK).

Figura 153. Numri i qertifikatave



Burimi: BQK (2013)


Figura 154. Numri i hulumtimeve



Burimi: BQK (2013)


RKK-ja është dizajnuar si një aplikacion i bazuar në internet dhe mund të qaset drejtpërdrejte në kohë reale nga institucionet financiare anëtare të sistemit të RKK-së.

Figura 155. Numri i kredive te reja



Burimi: BQK (2013)

Figura 156. Numri i kredive me klasifikim standard




Burimi: BQK (2013)

Në bazë të rregullores së regjistrimit të kredive, anëtare janë të gjitha institucionet financiare të përcaktuara nga Banka Qendrore për të qenë ofrues të kredive, duke përfshirë të gjitha bankat dhe institucionet mikro-financiare të licencuara si dhe ato institucione financiare jo-bankare dhe kompani të sigurimeve të licencuara për t'u marrë me aktivitete të veçanta kreditore. Institucionet anëtare autorizojnë zyrtarët e tyre për të qenë përdorues të sistemit të RKK-së. Aktualisht janë mbi 1300 përdorues aktiv në sistemin e regjistrimit të kredive të cilët janë të paisur me qertifikata autorizuese nga regjistri i kredive. Gjatë vitit 2012, regjistri i kredive ka gjeneruar 427 qertifikata të reja si rrjedhojë e kërkesave të paraqitura nga institucionet anëtare. Numri i qertifikatave, për vitin 2009, 2010, 2011 dhe 2012 si në figurën 153.

Përdoruesit e sistemit të regjistrimit të kredive, të cilët janë të autorizuar nga

Figura 157. Numri i kredive me klasifikim vrojtues




Burimi: BQK (2013)

institucionet kredithënëse, i qasen sistemit me qëllim të hulumtimit mbi obligimet dhe historitë kreditore të aplikantëve kreditor. Sipas statistikave që dalin nga sistemi i regjistrimit të kredive, numri i hulumtimeve gjatë vitit 2012 ka kaluar shifrën prej 700,000 hulumtimeve.


Një pasqyrë mbi këtë aktivitet, në baza vjetore, për vitet 2009, 2010, 2011 dhe 2012 është paraqitur në vijim në figurën 157.

Figura 158. Numri i kredive aktive dhe klasifikimet



Burimi: BQK (2013)

Figura 159. Produktet kreditore



Burimi: BQK (2013)

Kreditë e raportuara nga institucionet anëtare në sistemin e RKK-së klasifikohen në bazë të Rregullores për Menaxhimin e Rrishtit Kreditor të cilat raportohen në baza mujore në sistemin e RKK-së. Në sistemin e regjistrimit të kredive raportohen të gjitha produktet kreditore të cilat aprovohen dhe shpërndahen nga institucionet kredithënëse për aplikantë kreditor.

Subjektet e të dhënave të Regjistrimit të Kredive të Kosovës janë personat fizikë dhe juridik, të cilët paraqiten si kredimarrës. Regjistrimi i të gjitha të dhënave që kanë të bëjë me kreditë e kredimarrësve është shumë i rëndësishëm sepse kjo ndikon në marrjen e vendimeve të drejta nga kredithënësit.

Bazuar në Rregulloren e Regjistrimit të Kredive si dhe në Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, me qëllim të kontrollimit të informacioneve vetanake, çdo kredimarrës mund të marrë raportin e tij/saj kreditor. Kjo mundësohet nga secila bankë apo edhe drejtpërdrejtë nga Banka Qendrore e Kosovës. Figura në vazhdim paraqet raportet e marrura nga kredimarrësit për vitet 2009; 2010; 2011 dhe 2012.

Me ndihmën e USAID të financuar përmes projektit trevjeçar BEEP, për përmirësimin e ambientit biznesor në Kosovë, një komponente është e përqëndruar edhe në fushën e raportimit dhe informacionit kreditor, konkretisht në regjistrin e kredive. Bazuar në identifikimin e segmenteve të nevojshme për avansim, është punuar në avansimin e rregullativës për regjistrin të kredive dhe sistemit të RKK-së.

Kësisoj është aprovuar Rregullorja për Regjistrin e Kredive, Udhëzimi për Regjistrin e Kredive, është implementuar me sukses ngritja teknike e sistemit të RKK-së si dhe është zhvilluar dhe implementuar portali Raporti Kreditor.org cili u mundëson të gjithë personave fizik dhe juridik që përmes internetit të furnizohen me raporte kreditore.

Nga aspekti i përkrahjes së resurseve njerëzore përmes trajnimeve, për institucionet anëtarë të sistemit të RKK-së, Divizioni i Regjistrimit të Kredive (DRK) në bashkëpunim me projektin BEEP-USAID ka mbajtur trajnime dhe certifikuar afro 500 përdorues të sistemit të RKK-së.

Divizioni i Regjistrimit të Kredive të Kosovës ka prezantuar në Panairin Financiar 2012, të organizuar nga Shoqata e Bankave me ç'rast janë shpërndarë broshurat informative në lidhje me Regjistrin e Kredive për qytetarët dhe bizneset pjesëmarrëse.

Me qëllim të njoftimit të publikut të gjerë për Regjistrin e Kredive dhe Raportin Kreditor, DRK ka përgatitur tri broshura informative: për Regjistrin e Kredive, Përshkrimi i Raporti Kreditor dhe për Raportin Kreditor përmes Internetit. Këto broshura janë përgatitur në gjuhën shqipe, serbe dhe angleze. Shpërndarja e tyre është bërë në të gjithë Kosovën, tek klientët e institucioneve financiare përmes rrjetit të degëve të Bankave, Institucioneve Mikrofinanciare dhe atyre Jo-Bankare.

Për të promovuar rëndësinë e kredisë, me përkrahjen e USAID|BEEP është përgatitur edhe kampanja mediale në TV, gazeta dhe portale e cila ka arritur një audiencë prej rreth 380.000 vetave.

Nga fusha e studimeve, vlen të përmendet studimi i dytë mbi mbingarkesën e kredi marrësve Kosovarë, të iniciuar dhe të realizuar nga EFSE në bashkëpunim me Rexhistrin e Kredive të Kosovës në dhe nëntë institucione kredidhënëse (pesë banka dhe katër institucione mikrofinanciare). Në studim janë marrur në konsideratë 2200 mostra (raste-klientë) për dy nivele të lartësive të kredive dhe atë: kreditë në vlerë prej 10001 Eur deri 25000 Eur dhe kreditë në vlerë prej 25001 Eur deri 50000 Eur.

Rezultatet e studimit vërtetuan edhe njëherë rëndësinë dhe ndikimin e sistemit të RKK-së në mbrojtjen e institucioneve kredidhënëse si dhe në mbrojtjen e kredimarrësve nga mbingarkesa financiare.

Edhe në vitin 2012, regjistri i kredive ka kontribuar drejtpërdrejtë në të dhënat e mbledhura nga Banka Botërore(BB) me qëllim të raportit 2013. Sipas raportit të publikuar , nga BB, fusha “getting credit” gjatë katër viteve në vazhdimësi pasqyron përmirësim, duke u radhitur në pozitën e 23-të në vitin 2012 dhe duke shënuar indikatorin “getting credit” më pozitiv nga të gjithë të indikatorët tjerë të raportit “Doing Bussines 2013” për Republikën e Kosovës.

Përcjellja e trendeve zhvillimore(globale dhe rajonale) në fushën e raportimeve kreditore, është pjesë e pandashme e punëve dhe aktiviteteve të cilat zhvillohen në Divizionin e Regjistrin të Kredive. Si anëtare e plotë në Asociacionin e Evropian mbi raportimet kreditore - ACCIS , edukimi profesional dhe përcjellja e zhvillimeve në segmentin raportues dhe informativ kreditor, ka qenë më efektive, më konkrete dhe në hap me zhvillimet e bëra sipas praktikave më të mira në këtë fushë.

## **5.6. Aktiviteti në fushën e analizave ekonomike dhe stabilitetit financiar**

Departamenti i Stabilitetit Financiar dhe Analizave Ekonomike edhe gjatë vitit 2012 ka vazhduar të ketë rol të rëndësishëm në vlerësimin e zhvillimeve ekonomike në vend, me theks të veçantë në sektorin financiar, duke mundësuar kështu identifikimin e brishtësive të mundshme dhe rekomandimin e masave preventive për të siguruar stabilitetin financiar në vend.

Gjatë këtij viti, DSFAE ka vazhduar të avancojë cilësinë e publikimeve të saj periodike, duke bërë të mundur një pasqyrim më qartë të zhvillimeve në ekonominë e vendit. Në këtë periudhë është publikuar numri i tretë i Raportit të Stabilitetit Financiar, i cili përveç që ka ofruar një analizë më gjithëpërfshirëse të gjendjes së këtij sektori, ka prezantuar edhe dy materiale të karakterit kërkimorë: “Relacioni në mes të Konkurrencës së Sistemit Bankar dhe Provizioneve të Humbjeve nga Kreditë” dhe “Identifikimi i Bankave me Rëndësi Sistematike në Kosovë”. Progres është shënuar edhe në hartimin e Raportit të Bilancit të Pagesave, i cili prezanton një analizë të hollësishme të zhvillimeve në bilancin e pagesave të Kosovës dhe, për më tepër, përmbanë edhe analiza të karakterit kërkimor që trajtojnë aspekte të ndryshme të zhvillimeve në ekonominë e vendit. Numri i fundit i këtij raporti prezantori artikullin kërkimor me temë “Shfrytëzimi i Kapaciteteve Prodhuese në Vendet e Ballkanit Perëndimor: Analizë bazuar në BEEPS 2009”. Në kuadër të publikimeve të tjera, DSFAE ka vazhduar të publikojë vlerësimin tremujor të

ekonomisë që është pjesë përbërëse e Buletinit Mujor Statistikor, ndërsa janë bërë përgaditjet që kjo analizë të publikohet si material i vaçantë në baza tre-mujore që nga viti 2013.

Në kuadër të aktiviteteve të tjera, është shënuar progres në përpilimin e 'stres-testit' për sistemin bankar konform rekomandimeve nga i misioni i përbashkët i Fondit Monetar Ndërkombëtar dhe Bankës Botërore për Programin e Vlerësimit të Stabilitetit Financiar (angl. Financial Stability Assessment Program: FSAP). DSFAE ka vazhduar me përpilimin e Indikatorëve të Paralajmërimit të Hershëm në baza mujore, duke përparuar drejtë identifikimit me kohë të brishtësive të mundshme në ekonominë e vendit, e veçanërisht në sistemin bankar. Poashtu, përpilimi në baza të rregullta i indikatorëve të shëndetit financiar ka ofruar një vegël të mirë për vlerësimin e qëndrueshmërisë së sistemit bankar.

Gjatë vitit 2012, DSFAE ka vazhduar të realizojë anketën tremujore me bankat që operojnë në Kosovë, e cila ka për qëllim ofrimin e një pasqyre më të qartë lidhur me zhvillimet rreth aktivitetit kredidhënës në vend, duke përfshirë zhvillimet e ndërlidhura me standardet e bankave për aprovimin e kërkesave për kredi, ndryshimin e rregullave dhe kushteve kreditore, perceptimin e bankave për rrezikun, gatishmërinë e bankave për të zgjeruar kreditimin si dhe perceptimet e bankave për ndryshimin në faktorët që ndikojnë kërkesën për kredi. Rezultatet nga kjo anketë ka shërbyer si inpute të rëndësishme në përpilimin e analizave rreth zhvillimeve në sistemin bankar, përfshirë Raportin e Stabilitetit Financiar.

Një kontribut i posaqëm nga DSFAE ishte edhe organizimi i konferencës së parë ndërkombëtare të BQK-së me karakter kërkimor në temën "Konkurrenca kundruall Marrjes së Rrezikut në Sektorët Bankar të Vendeve të Evropës Qendrore dhe Lindore", ku përveç pjesëmarrjes së një numri Guvernatorësh nga Bankat Qendrore të Rajonit e më gjerë, me prezantime të materialeve hulumtuese u paraqitën ekonomistë nga bankat qendrore të Kosovës, Austrisë, Turqisë, Bullgarisë, Polonisë, Kroacisë, Shqipërisë, dhe Maqedonisë. Për më tepër, në rolin e udhëheqësit të njërit nga sesionet hulumtuese mori pjesë edhe Zëvendës-Kryesuesi i Divizionit për Vlerësim Financiar në Bankën Qendrore Evropiane. Gjatë vitit 2012, stafi i DSFAE-së u paraqit me prezantime të materialeve hulumtuese edhe në konferenca të tjera ndërkombëtare, përfshirë konferencat e organizuara nga Banka e Shqipërisë dhe Banka Kombëtare e Austrisë.

Një fushë tjetër mjaft intenzive e aktiviteteve të DSFAE-së kanë qenë angazhimet rreth procesit të integritit evropian të Kosovës, ku janë mbuluar kryesisht qështjet rreth zhvillimeve në sistemin bankar. Poashtu, stafi i DSFAE-së ka qenë vazhdimisht i angazhuar edhe në fushën e komunikimit me publikun, duke i shërbyer kështu ngritjes së transparencës rreth zhvillimeve në sektorin financiar dhe në ekonominë e vendit në përgjithësi.

### 5.7. Aktivitetet në fushën e statistikave

Funksioni statistikor i BQK-së gjatë vitit 2012 është karakterizuar me zgjerim të gamës së statistikave të publikuara si dhe avancim të mëtutjeshëm në kontekst të kualitetit dhe metodikës së statistikave të sektorit financiar dhe atij të jashtëm. Ndër të arriturat kryesore veçohen: publikimi i statistikave mbi pozicionin e investimeve ndërkombëtare, borxhit të jashtëm, si dhe publikimi i statistikave të institucioneve jo bankare. Gjatë vitit të kaluar është bërë zhvillimi (ngritja teknike) i softuerit edhe për statistikat e sektorit të jashtëm. Në rrafshin ndërkombëtar, stafi i Departamentit të Statistikës së BQK-së ka vazhduar me ofrimin e ekspertizës profesionale në vendet tjera, në kuadër të Fondit Monetar Ndërkombëtar.

Fillimi i publikimit të statistikave të pozicionit të investimeve ndërkombëtare (PIN), borxhit të jashtëm (BJ), raportit të harmonizuar mbi investimet e jashtme (CDIS) dhe raportit të harmonizuar mbi investimet portfolio (CPIS) konsiderohen të jenë arritjet kryesore statistikore në fushën e statistikave të sektorit të jashtëm gjatë vitit 2012. Që nga muaji mars 2012 është

filluar me publikimin e statistikave të PIN-it edhe në Fondin Monetar Ndërkombëtar (FMN).<sup>60</sup> Në qershor 2012, Kosova është pjesë e projektit statistikor të FMN-së të quajtur CDIS dhe CPIS që ka të bëjë me publikimin e të dhënave për investimet e huaja direkte dhe investimet në letra me vlerë.<sup>61</sup>

Viti 2012 paraqet periudhën e dërgimit (testues) të statistikave të bilancit të pagesave (BP), shërbimeve dhe investimeve të huaja direkte në Eurostat. Kjo është bërë në kuadër të projektit IPA, ku objektivi kryesor është që Kosova dhe vendet e tjera të Ballkanit të harmonizojnë metodikën statistikore konform kërkesave të Eurostatit (në harmoni me metodikën që zbatojnë vendet e Bashkimit Evropian). BQK është afër përbushjes së këtyre kërkesave dhe së shpejti pritet fillimi i raportimit të rregullt edhe në Eurostat.

Publikimi i statistikave të sektorit të jashtëm bëhet konform standardeve statistikore ndërkombëtare, kryesisht atyre të Fondit Monetar Ndërkombëtar, Bankës Botërore, Eurostatit dhe institucioneve tjera relevante. Që nga viti 2012 janë bërë hapat e nevojshëm për të filluar me implementimin e standardeve të reja për përpilimin e statistikave të sektorit të jashtëm bazuar në manualin e ri të FMN-së (anglisht: Balance of Payments and International Investment Position Manual, 6th Edition - BPM6). Janë bërë përgatitjet që implementimi i plotë i këtij standardi të ndodhë gjatë vitit 2013, edhe pse vendet e Bashkimit Evropian do fillojnë implementimin në vitin 2014.

Në kontekst të rritjes së mbulueshmërisë, rrjedhimisht edhe të cilësisë së statistikave të prodhuara nga BQK-ja, kjo e fundit ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me institucione të ndryshme ku me këtë rast do të veçoheshin marrëveshja me Doganat e Kosovës dhe Policinë e Kosovës.

Duke filluar që nga janari 2012, BQK zgjeroi gamën e statistikave të prodhuara lidhur me institucionet financiare. Përmes projekteve statistikore që tashmë janë shndërruar në standarde statistikore të BQK-së, janë përfshirë institucionet mikrofinanciare, institucionet që merren me lizing dhe agjencitë për transferimin e parave. Është fjala për Raportin Statistikor mbi Institucionet Mikrofinanciare, Raportin mbi Normat e Kamatës së Institucioneve Mikrofinanciare si dhe Raportin mbi Agjencitë për Transferimin e Parave. Prodhimi i këtyre statistikave nënkupton përpilimin dhe publikimin e tyre në harmoni me standardet statistikore ndërkombëtare të Fondit Monetar Ndërkombëtar, Bankës Qendrore Evropiane, Eurostatit, etj.

Statistikat mbi institucionet mikrofinanciare dhe institucionet që merren me lizing përfshijnë: bilancin e gjendjes, kreditë sipas sektorëve institucional, kreditë sipas sektorëve ekonomik, lizingun, kreditë e reja të lëshuara, normat efektive e interesit në kredi dhe bilancin e suksesit. Ndërsa, statistikat mbi agjencitë për transferimin e parave përfshijnë: bilancin e gjendjes, transferet ndërkombëtare sipas shteteve, bilancin e suksesit. Përveç zhvillimeve në industrinë jo bankare, viti 2012 karakterizohet edhe me avancimin e mëtutjeshëm dhe të vazhdueshëm të cilësisë së statistikave të industrisë bankare.

Me qëllim të avancimit të mëtutjeshëm në kontekst të përpilimit dhe validimit teknik të statistikave, gjatë vitit 2012 është filluar me ngritjen teknike të softuerit ekzistues statistikor. Është fjala për softuerin i cili përdoret për statistikat e sektorit financiar që nga viti 2004 e që tashmë përfshinë edhe futjen e të dhënave, përpilimin, validimin teknik dhe nxjerrjen e raporteve të statistikave të sektorit të jashtëm. Kjo, do të shërbejë si përkrahje e konsiderueshme dhe rritë sigurinë e punës me numra duke pasur parasysh volumin gjithnjë në rritje të statistikave të prodhuara karshi resurseve të limituara dhe afateve të publikimit.

<sup>60</sup> Numri i shteteve që raportojnë të dhënat për PIN është 133 (tetor 2012).

<sup>61</sup> Për më shumë, shih Kumbesën për Shtyp të FMN-së lidhur me CDIS, CPIS dhe letrat me vlerë: <http://www.imf.org/external/np/sec/pr/2012/pr12219.htm>; <http://elibrary-data.imf.org/NewsItem.aspx?id=111>; <http://www.imf.org/external/np/sec/pr/2012/pr12438.htm>

Publikimi i rregullt, periodik dhe me kohë i statistikave paraqet një atribut të veçantë të Departamentit të Statistikës të BQK-së. Përkundër rritjes së gamës së statistikave të prodhuara në njërën anë dhe numrit të njëjtë resurseve të anën tjetër, është arritur që publikimi i statistikave të bëhet konform afateve të specifikuara në ueb faqen e BQK-së. Seritë Kohore dhe Buletini Mujor Statistikor (ku edicioni i dhjetorit 2012 paraqet edicionin numër 136) paraqesin publikimet statistikore kryesore të BQK-së. Përveç tyre, statistikave të prodhuara nga Departamenti i Statistikës së BQK-së shërbejnë si informata kyçe edhe për publikimet tjera të BQK-së si: Raporti Vjetor, Raporti i Stabilitetit Financiar dhe Buletini i Bilancit të Pagesave.

Që nga marsi 2012, BQK ka filluar publikimin e statistikave të borxhit të jashtëm në Bankë Botërore dhe Fondit Monetar Ndërkombëtar (anglisht: *Quarterly External Debt Database - QEDS*)<sup>62</sup> duke i hapur Republikës së Kosovës një faqe të re në Bankën Botërore. BQK është koordinatore në nivel vendi për Sistemin e Shpërndarjes së të Dhënave të Përgjithshme në FMN (anglisht: GDDS). Rrjedhimisht, Faqja Përmbledhëse e të Dhënave Kombëtare (anglisht: National Summary Data Page) e publikuar në ueb faqen e FMN-së që paraqet informata të caktuara për Kosovën. Përveç atyre që u cek më lartë, është vazhduar me diseminimin në baza të rregullta në Fondin Monetar Ndërkombëtar, Bankë Botërore, Eurostat, dhe institucionet tjera me rëndësi të statistikave ekzistuese periodike mbi sektorin financiar dhe të jashtëm.<sup>63</sup>

Që nga muaji maj i vitit 2012, BQK udhëheq me Këshillin Statistikor të Republikës së Kosovës. Për më shumë, Drejtori i Departamentit të Statistikës së BQK-së është emëruar Kryetar i Këshillit Statistikor që funksionon në bazë të Ligjit mbi Statistikat Zyrtare të Republikës së Kosovës. E arritur e veçantë në këtë drejtim është miratimi nga Parlamenti i Kosovës i Programit të Statistikave Zyrtare 2013 – 2017 që paraqet një ndër përgjegjësitë kryesore të Këshillit Statistikor.

Edhe gjatë vitit 2012, stafi i BQK-së ka vazhduar me ofrimin ekspertizës profesionale në bankat qendrore të vendeve tjera të botës. Drejtori i Departamentit të Statistikës dhe Udhëheqësi i Divizionit të Statistikave të Bilancit të Pagesave kanë kryer në mënyrë të suksesshme tri misione ndërkombëtare, dhe atë në: Bankën Qendrore e Trinidadit dhe Tobagos (mars dhe qershor 2012) respektivisht në Bankën Qendrore të Botsvanës (gusht 2012).

## 6. Zhvillimet e brendshme

### 6.1. Kontrolli i Brendshëm

#### Shefi i Auditimit të Brendshëm

Detyrat dhe përgjegjësitë si dhe kompetencat e Shefit të Auditimit të Brendshëm (ShAB) janë të definuara dhe të përcaktuara me Ligjin e BQK-së nr. 03/L-209 (nenet 60 dhe 61).

#### Roli dhe objektivat e Auditimit të Brendshëm

Departamenti i Auditimit të Brendshëm në BQK ka përgatitur Universin e Auditimit për periudhën trevjeçare 2012-2014. Nga Universi i Auditimit është nxjerr dhe përpiluar Plani Vjetor i Auditimit të Brendshëm për vitin 2012 duke marr për bazë metodologjinë e bazuar në risk, ku prioriteti më i lartë i është dhënë zonave të universit të auditimit tek të cilat gjatë përpilimit të

<sup>62</sup> QEDS – është një bazë e të dhënave e për vendet anëtare në SDDS dhe GDDS lidhur me statistikave të borxhit të jashtëm. Aktualisht 118 shtete nga e gjithë bota dërgojnë të dhënat për borxhin e jashtëm në data bazën QEDS.

<sup>63</sup> Është fjala për publikimet: Statistikat Financiare Ndërkombëtare (anglisht: International Financial Statistics), Vjetari Statistikor i Bilancit të Pagesave të FMN-së (anglisht: Balance of Payments Statistical Yearbook), Anketa mbi Qasjen Financiare (anglisht: Financial Access Survey), dhe Raporti mbi Stabilitetin Financiar Global (anglisht: Global Financial Stability Report).

matricës së riskut është vlerësuar risku më i lartë. Poashtu janë marë për bazë dhe dy parime: ruajtja e aseteve të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës dhe ruajtja e reputacionit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës.

Bazë për përgatitjen e Planit Vjetor të Punës së Departamentit të Auditimit të Brendshëm është marrë standardi i Institutit të Auditimit Intern IIA 2010 (planifikim), i cili drejton Departamentin e Auditimit të Brendshëm në krijimin e planit të punës të bazuar në risk dhe përcakton prioritetet e aktiviteteve që do të zhvillohen konform objektivave dhe qëllimeve të institucionit. Shefi i Auditimit të Brendshëm konform standardit IIA 2020 (komunikimi dhe aprovimi) dhe Statusit të Auditorit të Brendshëm në BQK (anglisht: Audit charter) ka prezantuar Planin e Punës së Auditimit të Brendshëm për vitin 2012 para Komitetit të Auditimit. Komiteti i Auditimit ka aprovuar Planin e Punës së DAB për 2012 dhe më pas ky Plan është miratuar edhe nga Bordi i BQK-së .

Plani i Punës së Auditimit të Brendshëm për 2012 është realizuar ashtu siç është planifikuar , duke arrit që të përmbush në tërësi edhe rekomandimet e dala nga Raporti mbi vlerësimin e proceseve dhe procedurave në BQK (anglisht: “Safeguards Assesments”) i Fondit Monetar Ndërkombëtar ku janë audituar proceset dhe janë përformuar auditimet sistemore (gjithëpërfshirëse) të planifikuara.

Përveç auditimeve të planifikuara, Departamenti i Auditimit të Brendshëm ka performuar shtatë auditime rasti “Ad Hock” me kërkesën e Menaxhmentit të lartë të BQK-së.

Për përcjelljen e Portofolios së Investimeve në Bankat Korrespondente të BQK-së, Auditimi i Brendshëm gjatë vitit 2012 ka përgatitur 52 raporte speciale në baza javore, për periudhën Janar-Dhjetor 2012.

Bazuar në Memorandumin Teknik të Mirëkuptimit në mes të 2012-13 SBA Arrangement me IMF pika 5 e paragrafit I është azhurnuar Procedura “Auditimi i pavarur i rekonsilimit të llogarive të Qeverisë” dhe është përpiluar verisoni 2.0 te kësaj proceduare . Gjithsej deri më tani janë performuar dhjetë (10) auditime të pavarura të barazimit të llogarive të Qeverisë si vijon: në baza kuartale për vitin 2010 janë performuar dy (2) auditime të pavarura , për vitin 2011 janë performuar katër (4) auditime të pavarura dhe katër (4) auditime të pavarura për vitin 2012.

Konform Ligjit nr.03/l-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, neni 61 “detyrat e Shefit të Auditimit të Brendshëm” , Shefi i Auditimit të Brendshëm ka raportuar tek Komiteti i Auditimit në baza tremujore. Në këto raporte është prezantuar puna e auditorëve të brendshëm të cilët kanë ofruar opinionet e tyre të pavarura dhe objektive lidhur me menaxhimin e riskut, qeverisjen dhe vlerësimin efektiv në arritjen e objektivave të institucionit bazuar në standardin e IIA 1100(pavarësia dhe objektiviteti).

Përcjellja e implementimi të rekomandimeve duke bazuar në standardin e IIA 2500 (monitorimi i progresit), gjatë vitit 2012 është bërë në baza kuartale ku për secilin kuartal është përgatitur raport i veçantë lidhur me statusin e rekomandimeve. Këto raporte kuartale janë përmbledhur në raportin përmbledhës Vjetor për periudhën Janar-Dhjetor 2012 ku janë përfshirë të gjitha gjetjet, rekomandimet, komentet e menaxhmentit dhe statusi i rekomandimit. Këtë vit është bërë kategorizimi më i detajuar i statusit të rekomandimeve me ç ‘rast janë definuar pesë kategori dhe kjo ka bërë që të raportojmë më lehtë dhe më saktë gjate përcjelljes se implementimit (follow up) te rekomandimeve ne raportet përcjellës.

Krahas avancimeve të bëra në Departamentin e Auditimit të Brendshëm, Departamenti i Auditimit të Brendshëm gjate vitit 2012 ka rishikuar Manualin e Auditimit të Brendshëm verzionin 1.2. Manuali i Auditimit të Brendshëm është dokument shumë i rëndësishëm dhe udhërrëfyes i veprimtarisë së Auditimit të Brendshëm.

**Tabela 46. Përcaktimi i fushave të auditimit në bazë të riskut për periudhën 2009-2012**

Departamenti	VM			
	2009	2010	2011	2012
Teknologjia Informative	4.20%	10.00%	10.30%	21.80%
Menaxhimi i Mjeteve	16.90%	11.00%	16.00%	14.80%
Administrimi i Përgjithshëm	18.70%	18.30%	22.20%	12.60%
Kontabiliteti	15.60%	9.90%	11.20%	9.60%
Resurset Humane	9.40%	8.80%	6.10%	7.30%
Mbikqyrja Financiare		6.40%	5.00%	7.30%
Arka dhe Trezori	16.50%	17.80%	7.30%	6.50%

Burimi: BQK (2013)

Edhe gjatë vitit 2012 ka vazhduar bashkëpunimi në mes të Departamentit të Auditimit të Brendshëm të BQK-së me Departamentin e Kontrollit të Bankës së Shqipërisë me ç' rast është zhvilluar një vizitë e DAB të BQK-së në Tiranë dhe një vizitë e Departamentit të Kontrollit të BSH-së në Prishtinë. Përveç vizitave, edhe gjatë vitit 2012 auditorët e brendshëm kanë pas mundësinë e vijimit të trajnimeve për të zgjeruar edhe më tutje njohuritë lidhur me auditimin e brendshëm.

Gjatë vitit 2012 janë bërë parapërgatitjet

për implementimin e softuerit për nevojat e departamentit të Auditimit të Brendshëm i cili do të ndihmonte në rritjen e kualitetit të punës së auditorëve të brendshëm gjatë mbledhjes dhe analizës së të dhënave.


Objektivat kryesore të auditorëve të brendshëm të BQK-së kanë qenë të fokusuar në auditimin e respektimit të ligjit dhe rregullave në fuqi (objektivi i legjitimitetit), në auditimin e prezantimit të informacionit të plote financiar dhe menaxherial (objektivi i informimit) dhe në auditimin e efikasitetit dhe efektivitetit të shfrytëzimit të aseteve dhe burimeve të tjera të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës (objektivi i biznesit).

Gjatë vitit 2012 është përgatitur Plani Vjetor i punës së Auditimit të Brendshëm për vitin 2013 i cili është koncentruar në avancimin e kualitetit të raporteve karshi kuantitetit, së këndejmi është zvogëluar numri i raporteve në krahasim me vitin e kaluar. Megjithatë do të përfshihet i tërë Universi i auditimit por në disa Departamente kemi planifikuar të jenë auditimet gjithpërfshirëse sistemore.

Fushat e identifikuar të auditimit sipas shkallës së riskut për periudhën 2008-2012 janë paraqitur në formë tabelare dhe grafike si më poshtë:

## 6.2. Burimet njerëzore

Në dhjetor të vitit 2012 numri i të punësuarve në Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës gjithsej ka qenë 180 veta, që është m'i madh për 2.2% në krahasim me vitin paraprak. BQK-a është punëdhënëse me mundësi të barabartë dhe trajtim korrekt, të paanshëm, të barabartë dhe jo diskriminues gjatë punësimit. Në bazë të përzgjedhjes nga konkurset e jashtme (15 konkurse)

**Figure 160. Përcaktimi i fushave të auditimit në bazë të riskut për periudhën**

Burimi: BQK (2013)

BQK-a ka plotësuar 11 (njëmbëdhjetë ) pozita. Ndërsa, konkurse të brendshëm kanë qenë 11, prej tyre 10 pozita janë plotësuar .

Nga numri total i të punësuarve(180) , 88 janë femra dhe 92 meshkuj.

Në strukturën e përgjithshme të kualifikimit të të punësuarve në BQK , 50% e tyre janë me shkollim universitar , 26% pasuniversitar, 21% të mesëm , 1% të lartë dhe 2% me edukim bazik.

Në strukturën e pozitave menaxheriale 55% marrin pjesë meshkujt, ndërsa 45% femrat.

Mosha mesatare e të punësuarve në fund të muajit dhjetor 2012 ka qenë përafërsisht 40 vjeç. Banka Qendrore e Republikës së Kosovës vazhdimisht rrikrah edukimin e të punësuarve të saj përmes; kurseve, seminareve, punishteve, konferencave të rëndësishme si dhe programeve akademike relevante për BQK-në me qëllim të përmbushjes së kërkesave të punës me standarde më të larta dhe përmbushjes së objektivave të BQK-së.

Gjatë vitit 2012, 72 punëtorë të BQK-së kanë marrë pjesë në trajnime profesionale të përkrahura nga institucionet si më poshtë:

Pjesa më e madhe e trajnimeve gjatë vitit 2012, përkatësisht 91% janë ndjekur nga të punësuarit e departamenteve si më poshtë:

Me qëllim të përmbushjes së objektivave të BQK-së dhe zhvillimit permanent të divizionit të resurseve njerëzore në fund të vitit 2012 divizioni i resurseve njerëzore u përkrah nga asistenca teknike profesionale, financuar nga Banka Botërore.


BQK-a vazhdimisht përkrah studentët për kryerjen e praktikës të cilëve u mundëson lidhjen midis njohurive teorike të fituara gjatë studimeve dhe punës praktike në institucionet publike të pavarura,

Në vitin 2012, 20 studentë nga universitete/ kolegje në vend dhe jashtë vendit, kryen praktikën studentore në BQK.

### 6.3. Aktiviteti ligjor i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës gjatë vitit 2012


Në funksion të përmbushjes së objektivave dhe detyrave përkatëse, gjatë vitit 2012, aktiviteti ligjor i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës është fokusuar në forcimin e dhe implementimin e kornizës ligjore për sektorin financiar përmes miratimit të ligjeve të reja si dhe nxjerrjes së legjislacionit sekondar. Arritje të dukshme janë shënuar në drejtim të finalizimit dhe fuqizimit të bazës ligjore dhe rregullative për mbikëqyrje dhe rregullim të bankave, institucioneve mikrofinanciare dhe institucioneve financiare jobankare, për sistem të pagesave,

Figura 161. Struktura kualifikuese e të punësuarve të BQK-së



Burimi: BQK (2013)

Figura 162. Organizatorët e trajnimeve dhe numri i pjesëmarrësve



Burimi: BQK (2013)

fondet pensionale, sigurim të depozitave, duke plotësuar në këtë drejtim kuadrin ligjor dhe rregullativ me qëllim të harmonizimit me legjislacionin e ri dhe atë ekzistues.

Për më tepër, gjatë vitit 2012, korniza ligjore e BQK-së është plotësuar me hyrjen në fuqi të ligjeve që mbulojnë sektorë të ndryshëm financiar. Kështu, gjatë këtij viti, Kuvendi i Kosovës me qëllim të rregullimit të mëtutjeshëm të sektorit financiar ka miratuar ligjet si në vijim: Ligji për Fondet Pensionale të Kosovës, Ligji për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare, si dhe Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit mbi themelimin e sistemit për sigurimin e depozitave për institucionet financiare në Kosovë.

Në vazhden e plotësimit të kornizës ligjore, në bashkëpunim me asistencën teknike të ekspertëve të Bankës Botërore, gjatë këtij viti është hartuar edhe projektligji për “Sistemin e Pagesave” i cili projektligji është dorëzuar për procedim të miratimit tek organet kompetente. Projektligji në fjalë synon të përcaktojë një kuadër ligjor të domosdoshëm për funksionimin e sigurt dhe shëndoshë të sistemit kombëtar të pagesave, rolin dhe detyrat e Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës në lidhje me licencimin, rregullimin dhe mbikëqyrjen e sistemeve të pagesave dhe të shlyerjeve në Republikën e Kosovës.

Me qëllim të avancimit dhe kompletimit të infrastrukturës së sigurimeve në Kosovë, është hartuar draftligji për “Sigurimet e Përgjithshme” i cili ndodhet në proces të shqyrtimit final në Bankën Qendrore. Ky draftligj synon të avancoi bazën ligjore për mbikëqyrjen, rregullimin dhe licencimin e siguruesve, risiguruesve, ndërmjetësuesve të sigurimeve dhe subjekteve tjera të parapara me këtë ligj, në mënyrë që industria e sigurimeve në Republikën e Kosovës të operoj në mënyrë të sigurt, të qëndrueshëm dhe transparent në mbrojtje të të drejtave dhe interesave të policëmbjatësve. Ky draftligj është hartuar në pajtim me standardet dhe parimet themelore ndërkombëtare të mbikëqyrjes së sigurimeve.

Po ashtu, gjatë vitit 2012, aktiviteti ligjor rezultoi edhe në amandamentimin e rregullativës për letrat me vlerë gjegjësisht Rregullores për tregun primar dhe sekondar të letrave me vlerë të Qeverisë, si dhe rishikimin e kornizës ligjore ekzistuese lidhur me mbrojtjen e konsumatorit në bashkëpunim me ekspertët nga Banka Botërore, me qëllim të avancimit të kornizës ligjore dhe rregullative, edukimit financiar dhe vetëdijesimit të konsumatorëve, fuqizimin e mekanizmit të trajtimit të ankesave dhe rregullave të qarta të institucioneve financiare, si dhe fuqizimin e rolit dhe mandatit të Bankës Qendrore në kuadër të ligjeve dhe dispozitave relevante për mbrojtjen e konsumatorit.

Në vijueshmëri të aktivitetit ligjor, edhe gjatë këtij viti nuk ka munguar bashkëpunimi dhe asistencë teknike e ofruar nga Fondi Monetar Ndërkombëtar si dhe Banka Botërore.

Në përgjithësi, korniza ligjore dhe rregullative e Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës parasheh një bazë të përkryer për sigurimin e stabilitetit financiar dhe zhvillimin e një sistemi të shëndoshë financiar në drejtim të implementimit të standardeve dhe praktikave më të mira ndërkombëtare në fushën financiare.

Prandaj, në funksion të përmbushjes së objektivave dhe detyrave të saj, aktiviteti ligjor i Bankës Qendrore në vazhdimësi është i orientuar në mbarëvajtjen e zbatimit të ligjeve dhe akteve nënligjore, duke garantuar një kornizë ligjore të shëndoshë dhe bashkëkohore të rishikuar dhe rifreskuar në vazhdimësi në pajtim me standardet dhe kriteret e kërkuara, për avancim dhe stabilitet në fushën e rregullimit, mbikëqyrjes dhe zhvillimit të sistemit financiar në Kosovë.

#### **6.4. Teknologjia Informative**

Gjate vitit 2012 ne Departamentin per Menaxhim te Informacionit eshte ndryshuar skema organizative e cila eshte riorganizuar me qellim te ndarjes me te mire te pergjegjesive, pra jane

formuar dy njesi, ajo e teknologjise se informacionit dhe njesia e vazhdimesise se punes dhe sigurise se informacionit.

Nje projekt mjaft me rendesi eshte edhe avancimi i postes elektronike ne nje sistem me te avancuar, me te sigurte dhe me fleksibil qe nenkupton edhe fleksibilitet dhe kolaborim me te mire ne mes punetoreve te BQK-se.

Gjithashtu me rendesi te ceket eshte edhe funksionalizimi i sistemit te Letrave me Vlere per vazhdimesi te punes i cili eshte vendosur ne nje vend tjetër nga ndertesa e BQK-se.

Ne vazhden e avancimit te sistemeve eshte riorganizuar edhe sistemi baze i informacionit ne nje sistem me te sigurte dhe me te fuqishem.

Nje projekt mjaft me rendesi edhe edhe ridizajnimi komplet i regjistrimit te kredive duke filluar nga hardueri, softueri dhe menyra e komunikimit mes pjesemarresve dhe sistemit qe gjeneron te dhena e qe gjendet ne BQK.

Në fushën e Sigurisë së Informacionit, DMI gjatë vitit 2012 ka rishikuar Rregullën e Sigurisë së Informacionit, duke aprovuar kështu edhe Udhëzimin mbi Sigurinë e Informacionit. Në këtë mënyrë, është vendosur një bazë për zhvillime të mëturjeshme të mbajtjes së sigurisë së informacionit në nivelin e duhur. Po ashtu, në fushën e Vazhdimit të Punës, DMI gjatë vitit 2012 ka rishikuar Rregullën për Vazhdimin e Punës, si dhe Planin e Vazhdimit të Punës. Po ashtu, ka filluar zbatimi i projektit për funksionalizimin e Qendrës për Vazhdimin e Punës së BQK-së. Gjatë vitit 2012, përveç sigurimit të fondeve, është bërë shpallja e interesit për konsulentin që do të përgatis planin arkitektonik të ndërtesës që do të shërbejë si qendër e vazhdimit të punës së BQK-së.

## 7. Bashkëpunimi rajonal dhe ndërkombëtar

### 7.1. Marrëveshjet, promovimi dhe përfaqësimi ndërkombëtar

BQK ka vazhduar bashkëpunimin e ngushtë me institucione të rëndësishme ndërkombëtare duke përfshirë Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe Bankën Botërore në kuadrin e forcimit të gjithanshëm të kapaciteteve mbikëqyrëse për t'iu përgjigjur me fleksibilitet efekteve që burojnë nga zhvillimet e viteve të fundit në tregjet financiare globale.

Kështu që, një nga ngjarjet me rëndësi ndërkombëtare gjatë vitit 2012 vlen të përmendet vizita e misionit vlerësues të sektorit financiar të ashtuquajtur “ The Financial Sector Assessment Program (FSAP)”. FSAP si përgjegjësi e përbashkët e Fondit Monetar Ndërkombëtar dhe Bankës Botërore ka pasur për qëllim vlerësimin e dy komponentëve kryesore : stabilitetin financiar ( shëndetshmërinë dhe sigurinë e sektorit financiar), si dhe zhvillimin financiar ( kualiteti i kornizës ligjore) . Ky program ka paraqitur një analizë të thellë dhe gjithëpërfshirëse të sektorit financiar. Krahas ekzaminimit të stabilitetit të sektorit financiar, ky vlerësim është fokusuar edhe në aspektet zhvillimore të këtij sektori duke marrë parasysh specifikat individuale të vendit tone. Gjate këtij vlerësimi, fokusi , midis tjerash, i është dhënë fushës se stres testit dhe kornizës makroprudenciale për sistemin bankar, parandalimin e jo stabilitetit financiar, sigurimin e depozitave, qasjen në financim dhe një vlerësimi teknik mbi sistemin e sigurimeve në vend. Rezultatet e këtij vlerësimi do të kontribuojnë dukshëm në drejtim të avancimit të mëtejshëm të sektorit financiar të vendit tone.

Vlerësimet, sugjerimet dhe rekomandimet e misionit kanë qenë shumë të vlefshme dhe të mirëpritura për BQK, kështu që të njëjtat janë inkorporuar në kuadër të Planit strategjik të

BQK-së 2013 – 2015, pastaj me operacionalizimin e këtyre veprimeve me plan konkret veprimi me qëllim të adaptimit dhe forcimit të kornizës ligjore sipas standardeve të kërkuara ndërkombëtare dhe në harmoni me ambientin e vendit.

Një bashkëpunim mjaft i suksesshëm është realizuar në fushën e këmbimit të informacionit mbikëqyrës me institucionet më të cilat BQK ka marrëveshje bashkëpunimi. Një bashkëpunim i tillë mjaft më rëndësi gjatë vitit 2012 është realizuar në mes BQK-së dhe Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare (FMA) në Austri dhe atë në baza tremujore, në mes BQK-së dhe Bankës së Sllovenisë, BQK-së dhe Autoritetit Rregullativ dhe të Mbikëqyrjes së Turqisë (BRSA).

## 7.2. Asistenca teknike

BQK-ja ka vazhduar të përfitoj nga asistenca teknike e ofruar nga institucionet financiare ndërkombëtare dhe donatorët e ndryshëm si me projektet ekzistuese, po ashtu edhe me iniciativa të reja. Gjate vitit 2012 ka vazhduar implementimi i projektit *Asistence Teknike për Sektorin Financiarë* të financuar nga Banka Botërore (Agjencia Ndërkombëtare për Zhvillim-IDA). Ky projekt ka ndihmuar në nivel të avancimit të kornizës ligjore dhe përfarimit të saj me direktivat evropiane dhe standardet ndërkombëtare si dhe ngritjen e kapaciteteve të brendshme për mbikëqyrje me efektivë të sektori financiar në Kosovë. **Gjithashtu edhe** projekti *Fuqizimi i sektorit financiar dhe infrastrukturës së tregut* financuar nga kredia e dakorduar në mes të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Agjencisë Ndërkombëtare për Zhvillim (IDA) vazhdon të implementohet me dinamikën e planifikuar. Ky projekt fokus të veçantë ka: (i) financimin e kostos që ndërlidhet me Implementimin e strategjisë së BQK-së për Zhvillimin e Sistemit Kombëtar të Pagesave dhe krijimin e sistemit për *Barazim të Pagesave në Kohe Reale* bazuar në Strategjinë e Sistemit Kombëtar të Pagesave, (ii) Ndërtimi i Qendrës së Vazhdimësinë e Biznesit për BQK-ne me qëllim të sigurimit të vazhdimësisë së punës kur ndodhin rastet e katastrofave (nga faktor të pakontrollueshëm) me qëllim të rimëkëmbjes së operacioneve të teknologjisë informative që siguron të dhënat e azhurnuara nga të gjitha sistemet kritike të BQK-se, si dhe (iii) Sigurimin e financimit të kapitalit fillestar për Fondin për Sigurim të Depozitave të Kosovës (DIFK) me qëllim të grumbullimit të rezervës në formë të kapitalit fillestar.

BQK-ja e konsideron mbrojtjen e konsumatorëve si element thelbësor për ndërtimin dhe ruajtjen e një sektori financiar eficient, konkurrues dhe të drejtë, prandaj me qëllim të avancimit të këtij funksioni në Nëntor të vitit 2012 i është nënshtruar Vlerësimi Diagnostik të Mbrojtjes së Konsumatorëve dhe të Edukimit Financiar. Vlerësimi është fokusuar në sistemin bankar, industrinë e sigurimeve dhe institucionet mikrofinanciare. Ky vlerësim ka përfshirë fushat vijuese: 1) ligjet, rregulloret dhe praktikatat, 2) transparencën dhe shpalosjen e informacionit, 3) praktikatat e biznesit të institucioneve financiare 3) mekanizmat e ankesave dhe të zgjidhjes së kontesteve, 4) vetëdijesimin dhe edukimin e konsumatorëve. Implementimi i planit të veprimit që rezulton nga ky vlerësim do të ndihmojë në avancimin edhe më të madh të të drejtave të konsumatorëve të sektorit financiar për të disponuar me informacion të qartë, të plotë, të saktë dhe gjithëpërfshirës në të gjitha rolet e tyre si shfrytëzues të shërbimeve financiare, përfshirë këtu edhe zgjerimin e edukimit financiar në bashkëpunim me institucionet përkatëse vendore dhe ndërkombëtare. Projektet e lartcekura do të kontribuojnë në thellimin e mëtejshëm të bashkëpunimit efektiv dhe efikas ndër-institucional.



## 8. Pasqyrat financiare të BQK-së





**Banka Qendrore e Republikës së Kosovës**  
**Raporti i Auditorit të Pavarur dhe Pasqyrat Financiare**  
**më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2012**

## **Banka Qendrore e Republikës së Kosovës**

Përmbajtja	Faqe
Raporti i Auditorit të Pavarur	1
Pasqyra e gjendjes financiare	3
Pasqyra e përmbledhur e të ardhrave	4
Pasqyra e ndryshimeve në kapital dhe rezerva (ekuitet)	5
Pasqyra e rrjedhjes së parasë	6
Shënime për pasqyrat financiare	7 - 40

## Raporti i Auditorit të Pavarur

Grant Thornton LLC  
Rr. Rexhep Mala 18  
10 000 Pristina  
Kosovo

T +381 38 247 771  
+381 38 247 801  
F +381 38 247 802  
[www.grant-thornton.com.mk](http://www.grant-thornton.com.mk)

Për Bordin e

Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të bashkëngjitura të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës (“Banka”), të cilat përbëhen nga pasqyra e gjendjes financiar më 31 dhjetor 2012, pasqyra e përmbledhur e të ardhurave, pasqyra e ndryshimeve në ekuitet dhe pasqyra e rrjedhjes së parasë për vitin e mbyllur në atë datë, dhe një përmbledhje të politikave të rëndësishme kontabël dhe informatat tjera shpjeguese.

### *Përgjegjësia e menaxhmentit për pasqyrat financiare*

Manaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar, dhe për kontrollet e brendshme aq sa manaxhmenti i konsideron të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale të shkaktuara nga mashtrimi apo gabimi.

### *Përgjegjësia e auditorit*

Përgjegjësia jonë është të shprehim një opinion mbi këto pasqyra financiare bazuar në auditimin tonë. Auditimi ynë u krye në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarde kërkojnë që ne të respektojmë kërkesat e etikes dhe të planifikojmë dhe kryejmë auditimin me qëllim që të marrim një siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare nuk përmbajnë anomali materiale.

Auditimi ka të bëjë me kryerjen e procedurave për të marrë evidencë auditimi rreth shumave dhe informacioneve të dhëna në pasqyrat financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, përfshirë këtu edhe vlerësimin e rreziqeve të anomalive materiale në pasqyrat financiare, si pasojë e mashtrimit apo gabimit. Kur vlerëson këto rreziqe, auditori merr në konsideratë kontrollet e brendshme të lidhura me përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në mënyrë që të planifikojë procedura të përshtatshme auditimi në rrethanat e Bankës, por jo me qëllim për të shprehur një opinion mbi efektshmërinë e kontrolleve të brendshme të saj. Një auditim gjithashtu përfshin vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të përgjithshme të pasqyrave financiare.

Ne besojmë që evidenca e auditimit që ne kemi marrë është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë bazat për opinionin tonë të auditimit.



*Opinion*

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës më 31 dhjetor 2012, rezultatin e saj financiar dhe rrjedhjen e parasë për vitin e mbyllur në atë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.

*Grant Thornton LLC*  
**Grant Thornton LLC**

Prishtinë, Kosovë  
10 maj 2013

# Banka Qendrore e Republikës së Kosovës


## Pasqyra e gjendjes financiare


Më 31 dhjetor

<i>Në mijë Euro</i>	<b>Shënimi</b>	<b>2012</b>	<b>2011</b>
<b>Aktivët</b>			
Paraja e gatshme	7	16,761	13,456
Llogaritë rrjedhëse me bankat e huaja	8	99,549	31,513
Bono thesari	9	285,983	24,988
Depozita me bankat e huaja	10	821,590	1,009,046
Mjete të ndërlidhura me FMN	11	245,401	155,687
Prona dhe pajisjet	12	1,450	1,576
Mjete të paprekshme	13	1,425	1,506
Mjete tjera	14	462	446
<b>Gjithsej aktivët</b>		<b>1,472,621</b>	<b>1,238,218</b>
<b>Detyrimet</b>			
Detyrime ndaj bankave vendase	15	302,147	209,700
Detyrime ndaj llogarive të ndërlidhura me FMN	16	246,890	156,509
Detyrime ndaj institucioneve qeveritare	17	821,509	782,178
Detyrime ndaj entiteteve tregtare dhe publike	18	49,023	37,059
Detyrime të tjera vendase	19	3,289	3,337
<b>Gjithsej detyrimet</b>		<b>1,422,858</b>	<b>1,188,783</b>
<b>Kapitali dhe rezervat (Equiteti)</b>			
Kapitali	20	30,000	30,000
Rezerva të përgjithshme	21	19,435	17,980
Fitimet e mbajtura		328	1,455
<b>Gjithsej kapitali dhe rezervat</b>		<b>49,763</b>	<b>49,435</b>
<b>Gjithsej detyrimet, kapitali dhe rezervat</b>		<b>1,472,621</b>	<b>1,238,218</b>

Shënimet nga 1 deri 32 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Këto pasqyra financiare u miratuan nga menaxhmenti i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës në 10 Maj 2013 dhe u nënshkruan në emër të tij nga:

  
Bedri Hamza  
Guvernator

  
Faton Ahmetaj  
Drejtore për Planifikim dhe Raportim  
Financiar

# Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

## Pasqyra e përmbledhur e të ardhurave

Më 31 dhjetor

<i>Në mijë Euro</i>	<b>Shënim</b>	<b>2012</b>	<b>2011</b>
Të ardhura nga interesi		2,786	10,079
Shpenzime për interes		(1,770)	(7,585)
<b>Të ardhura nga interesi, neto</b>	<b>22</b>	<b>1,016</b>	<b>2,494</b>
Të ardhura nga tarifa dhe komisione		1,914	2,651
Shpenzime për tarifa dhe komisione		(388)	(290)
<b>Të ardhura nga tarifa dhe komisione, neto</b>	<b>23</b>	<b>1,526</b>	<b>2,361</b>
Të ardhura nga grantet	24	55	44
Të ardhura operative të tjera	25	1,729	1,620
Fitimi / (humbja) nga kursi i këmbimit	28	32	(1,139)
<b>Të ardhura operative</b>		<b>4,358</b>	<b>5,380</b>
Shpenzime personeli	26	(2,566)	(2,249)
Shpenzime zhvlerësimi dhe amortizimi	12,13	(482)	(625)
Shpenzime të përgjithshme dhe administrative	27	(982)	(1,051)
<b>Shpenzimet operative</b>		<b>(4,030)</b>	<b>(3,925)</b>
<b>Fitimi për vitin</b>		<b>328</b>	<b>1,455</b>
<b>Të ardhurat tjera të përmbledhura</b>			
<b>Gjithsej të ardhurat e përmbledhura</b>		<b>328</b>	<b>1,455</b>

Shënimet nga 1 deri 32 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare

**Banka Qendrore e Republikës së Kosovës**  
**Pasqyra e ndryshimeve në ekuitet**  
**Më 31 dhjetor**

<i>Në mijë Euro</i>	<b>Kapitali i autorizuar</b>	<b>Rezerva të përgjithshme</b>	<b>Fitim i pashpërndarë</b>	<b>Gjithsej</b>
<b>Gjendja më 1 janar 2012</b>	<b>30,000</b>	<b>17,980</b>	<b>1,455</b>	<b>49,435</b>
Transferime në rezervën e përgjithshme	-	1,455	(1,455)	-
Gjithsej transaksionet e kërkuara me ligj	-	1,455	(1,455)	-
Fitimi për vitin	-	-	328	328
Të ardhura tjera të permbledhura	-	-	-	-
Të ardhura tjera të permbledhura për vitin	-	-	328	328
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2012</b>	<b>30,000</b>	<b>19,435</b>	<b>328</b>	<b>49,763</b>
<b>Gjendja më 1 janar 2011</b>	<b>30,000</b>	<b>14,923</b>	<b>3,057</b>	<b>47,980</b>
Transferime në rezervën e përgjithshme	-	3,057	(3,057)	-
Gjithsej transaksionet e kërkuara me ligj	-	3,057	(3,057)	-
Fitimi për vitin	-	-	1,455	1,455
Të ardhura tjera të permbledhura	-	-	-	-
Të ardhura tjera të permbledhura për vitin	-	-	1,455	1,455
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2011</b>	<b>30,000</b>	<b>17,980</b>	<b>1,455</b>	<b>49,435</b>

Shënimet nga 1 deri 32 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare

# Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Pasqyra e rrjedhjes së parasë

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2012

<i>Në mijë Euro</i>	<b>Shënim</b>	<b>2012</b>	<b>2011</b>
<b>Rrjedhja parave nga aktivitetet operacionale</b>			
Fitimi për periudhën		328	1,455
<i>Rregullime për:</i>			
Zhvlerësimi	12	300	484
Amortizimi	13	182	141
Të ardhura nga grantet	24	(55)	(44)
Të ardhurat nga aktiveve afatgjata materiale		(13)	-
Të ardhura nga interesi	22	(2,786)	(10,079)
Shpenzime për interes	22	1,770	7,585
		<b>(274)</b>	<b>(458)</b>
Ndryshime në bono thesari		(221,043)	104,122
Ndryshime në depozita me bankat e huaja		(508)	(40,989)
Ndryshime në aktive me FMN		(89,571)	(1,112)
Ndryshime në aktive të tjera		(17)	30
Ndryshime në detyrimet ndaj bankave vendase		92,447	6,128
Ndryshime në detyrimet ndaj llogarive të ndërlidhura me FMN		90,240	2,678
Ndryshime në detyrimet ndaj institucioneve qeveritare		40,683	(17,212)
Ndryshime në detyrimet ndaj entiteve tregtare dhe publike		11,965	(6,170)
Ndryshime në detyrimet e tjera vendase		(44)	77
		<b>(76,122)</b>	<b>47,094</b>
Interesa të marra		4,319	9,147
Interesa të paguara		(2,979)	(6,895)
		<b>(74,782)</b>	<b>49,346</b>
<b>Paraja e gjeneruar nga aktivitetet operacionale, neto</b>			
<b>Rrjedhja e parave nga aktivitetet investuese</b>			
Të ardhurat nga aktiveve afatgjata materiale		13	-
Blerja e aktiveve afatgjata materiale	12	(174)	(334)
Blerja e aktiveve afatgjata jo-materiale	13	(101)	(738)
		<b>(262)</b>	<b>(1,072)</b>
<b>Paraja e gjeneruar nga aktivitetet investuese, neto</b>			
<b>Rrjedhja e parave nga aktivitetet investuese</b>			
Të ardhurat nga grantet		50	634
		<b>50</b>	<b>634</b>
<b>Paraja e gjeneruar nga aktivitetet financuese, neto</b>			
		<b>(74,994)</b>	<b>48,908</b>
<b>(Zvogëlimi)/rritja e parasë dhe ekuivalentëve të saj</b>			
Efekti i normë së këmbimit		-	-
Paraja dhe ekuivalentët e saj më 1 janar		<b>772,213</b>	<b>723,305</b>
		<b>772,213</b>	<b>723,305</b>
<b>Paraja dhe ekuivalentët e saj më 31 dhjetor</b>			
	29	<b>697,219</b>	<b>772,213</b>
		<b>697,219</b>	<b>772,213</b>

Shënimet nga 1 deri 32 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare

# Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

## Shënime mbi pasqyrat financiare

(në mijë Euro, nëse nuk është shënuar ndryshe)

### 1. Subjekti raportues

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (nga këtu e tutje "BQK" ose "Banka"), pasardhëse e Autoritetit Qendror Bankar të Kosovës, është një subjekt i pavarur juridik me kompetenca të plota si një person juridik sipas ligjit të aplikueshëm në Republikën e Kosovës. BQK është një subjekt publik i veçantë i cili ka autoritetin për të licencuar, mbikëqyrur dhe rregulluar institucionet financiare në Republikën e Kosovës. Banka vepron në përputhje me Ligjin nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës të cilit tash e tutje i referohemi si "Ligji për BQK-në". Sipas këtij ligji objektivat kryesore të BQK-së janë si vijon:

- të nxisë sigurinë, aftësinë e pagimit dhe funksionimin efikas të sistemit financiar.
- të kontribuojë në arritjen dhe mbajtjen e stabilitetit të brendshëm të çmimeve.
- të mbështes rregullat e përgjithshme ekonomike të qeverisë.

Siç është përshkruar në ligj, BQK duhet të veprojë në përputhje me parimet e një tregu të hapur me një konkurrencë të lirë, duke favorizuar ndarjen efektive të resurseve.

BQK ushtron veprimtarinë e saj nga zyrat e saj qendrore në Prishtinë. Adresa zyrtare e BQK-së është si më poshtë:

Garibaldi nr. 33

Prishtinë, Kosovë.

### Bordi i Bankës Qendrore, Bordi Ekzekutiv dhe Guvernatori

Organet vendimmarrëse të BQK-së janë Bordi i Bankës Qendrore, Bordi Ekzekutiv dhe Guvernatori. Sipas nenit 79, paragrafit 2 të Ligjit për BQK-në, Bordi i Bankës Qendrore përbëhet nga Guvernatori, Drejtori Gjeneral i Thesarit dhe tre anëtar jo-ekzekutiv që janë përgjegjës për mbikëqyrjen e implementimit të politikave, të administratës dhe operacioneve të BQK-së.

Më 31 dhjetor 2012, Bordi i Bankës Qendrore përbëhej nga këta anëtarë:

- Sejdi Rexhepi – Kryetar i Bordit
- Gani Gerguri – Guvernator
- Fatmir Plakiqi – Anëtar, Drejtor i Thesarit në Ministrinë e Financave
- Mejd Bektashi – Anëtar

Bordi Ekzekutiv përbëhet nga Guvernatori, i cili është Kryesues dhe dy Zëvendësguvernatorët dhe është përgjegjës për implementimin e politikave të BQK-së dhe të operacioneve të saj.

### 2. Baza e përgatitjes

#### a) Deklarata e përputhshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("SNRF").

#### b) Baza e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur mbi bazën e vlerësimeve specifike për secilin lloj të aktives, detyrimeve, të hyrave dhe shpenzimeve në përputhje me SNRF. Baza e matjeve në formë më të plotë është shpalosur në politikat kontabël me poshtë.

# Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

## Shënime mbi pasqyrat financiare

(në mijë Euro, nëse nuk është shënuar ndryshe)

### 2. Baza e përgatitjes (në vazhdim)

#### c) Monedha funksionale dhe e prezantimit

Këto pasqyra financiare prezantohen në Euro ("EUR"), e cila është monedha funksionale e BQK-së. Nëse nuk është shënuar ndryshe, informacioni financiar i prezantuar në Euro është rumbullakosur në mijëshen më të afërt.

#### d) Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon nga menaxhmenti i Bankës që të bëjë gjykime, vlerësime dhe supozime që ndikojnë në zbatimin e politikave kontabël dhe shumat e raportuara të aktiveve dhe detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet faktike mund të ndryshojnë nga ato të vlerësuara.

Vlerësimet dhe supozimet shqyrtohen në bazë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël njihen në periudhën në të cilën vlerësimi rishikohet dhe në periudhat e ardhshme nëse ato ndikohen. Në veçanti, në shënimin 5 jepet informacion mbi elementë të rëndësishëm në vlerësimin e pasigurive dhe mbi gjykime kritike për aplikimin e politikave kontabël të cilat kanë efekt të konsiderueshëm në vlerat kontabël në pasqyrat financiare.

Politikat kontabël të paraqitura më poshtë janë zbatuar në mënyrë të qëndrueshme në të gjitha periudhat e prezantuara në këto pasqyra financiare.

### 3. Politika të rëndësishme kontabël

#### a) Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj vlerësohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datat e kryerjes së veprimeve. Pasuritë dhe detyrimet monetare të shprehura në monedhë të huaj rivlerësohen me kursin zyrtar të këmbimit në datën e raportimit. Fitimi apo humbja nga kursi i këmbimit për zërat monetarë është diferenca ndërmjet kostove të amortizuara në monedhën funksionale në fillim të periudhës, e rregulluar me interesin efektiv dhe pagesat gjatë periudhës, dhe kostove të amortizuara në monedhë të huaj të rivlerësuara me kursin e këmbimit në fund të periudhës. Pasuritë (mjetet) dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj që maten me vlerë të tregut rivlerësohen në monedhë funksionale me kursin e këmbimit në datën kur është përcaktuar vlera e tregut. Diferencat nga kursi i këmbimit që rrjedhin nga rivlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave si fitim ose humbje.

#### b) Interesat

Të hyrat dhe shpenzimet nga interesi njihen në pasqyrën e të ardhurave bazuar në metodën e interesit efektiv. Norma e interesit efektiv është norma që skanton pagesat dhe arkëtimet e pritshme në të ardhmen gjatë jetëgjatësisë së aktivitetit ose detyrimit financiar (ose një periudhë më e shkurtër kur është e përshtatshme) deri në vlerën kontabël të aktivitetit ose detyrimit financiar. Norma efektive e interesit përcaktohet në njohjen fillestare të aktivitetit ose detyrimit financiar dhe nuk rishikohet më pas.

# Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

## Shënime mbi pasqyrat financiare

(në mijë Euro, nëse nuk është shënuar ndryshe)

### 3. Politika të rëndësishme kontabël (në vazhdim)

#### b) Interesat (në vazhdim)

Llogaritja e normës së interesit efektiv përfshin të gjitha komisionet a paguara apo të arkëtuara, kostot e transaksioneve, dhe zbritjet apo primet që janë pjesë përbërëse e normës efektive të interesit.

Kostot e transaksioneve përfshijnë kosto shtesë të ngarkueshme drejtpërdrejt për blerjen apo emetimin e një aktivi apo detyrimi financiar.

Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesi të paraqitura në pasqyrën e të ardhurave përfshijnë interesat nga aktivet ose detyrimet financiare me kosto të amortizuar mbi bazën e interesit efektiv.

#### c) Tarifa dhe komisione (ngarkesa)

Të hyrat dhe shpenzimet nga tarifat dhe komisionet të cilat janë pjesë përbërëse e normës së interesit efektiv për një pasuri apo detyrim financiar, përfshihen në matjen e normës së interesit efektiv.

Të hyrat tjera nga komisionet dhe tarifat, përfshirë tarifat e transaksioneve për llogaritë operative, transferimet e fondeve dhe tarifat e licencimit njihen në momentin e kryerjes së shërbimeve të lidhura me to.

Shpenzime të tjera për komisione dhe tarifa lidhen kryesisht me tarifa transaksionesh ose shërbimesh të cilat shpenzohen në momentin që shërbimet përfitohen.

#### d) Përfitimet e punonjësve

BQK paguan kontributet për sigurimet shoqërore të detyrueshme që përcaktojnë përfitimet e punonjësve kur dalin në pension. Këto kontribute klasifikohen sipas planeve të kontributit të paracaktuara, bazuar në legjislacionin e Kosovës. Kontributet e BQK-së njihen si shpenzim në pasqyrën e të ardhurave kur ato ndodhin.

BQK-ja paguan kontributet e pensionit sikurse lejohet nga legjislacioni i Kosovës, ku shteti siguron përfitime pensioni për punonjësit më rastin e daljes së tyre në pension. Kontributet e BQK-së për planet e pensionit i ngarkohen si shpenzim fitimit ose humbjes në momentin kur ndodhin.

#### e) Tatimi dhe shpërndarja e fitimit

BQK-ja është e përjashtuar nga tatimi mbi fitimin sipas Ligjit nr. 03/L-209 të miratuar më 22 korrik 2010. Shih shënimin 4 (f) se si BQK-ja shpërndan fitimin saj.

# Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

## Shënime mbi pasqyrat financiare

(në mijë Euro, nëse nuk është shënuar ndryshe)

### 3. Politika të rëndësishme kontabël (në vazhdim)

#### f) Pasuritë dhe detyrimet financiare

Banka klasifikon investimet e saja në këto kategori: Pasuri (mjete) financiare me vlerë reale përmes fitimit apo humbjes, kreditë dhe detyrimet, aktivet financiare të mbajtura deri në maturim dhe pasuri financiare të gatshme për tregtim. Ky klasifikim varet nga qëllimi për të cilin investimet janë siguruar. Menaxhmenti përcakton klasifikimin e investimeve të tij sipas njohjes fillestare dhe e rivlerëson këtë gjatë çdo date të raportimit.

#### Pasuritë (Mjetet) financiare në vlerë reale përmes fitimit apo humbjes

Kjo kategori ka dy nënkategori: mjetet financiare të mbajtura për tregtim dhe ato të përcaktuara sipas vlerës reale të fitimit apo humbjes së pësuar. Një pasuri financiare klasifikohet në "aktivet financiare me vlerë reale sipas kategorisë së fitimit apo humbjes së pësuar nëse parimisht sigurohet me qëllim të shitjes afatshkurtër, nëse formon një pjesë të portofolit të aktiveve financiare në të cilat ka dëshmi të përfitimit afatshkurtër, apo nëse përcaktohet kështu nga menaxhmenti.

#### Kreditë dhe të arkëtueshmet

Kreditë dhe detyrimet janë mjete financiare jo-derivative me pagesa fikse apo të përcaktueshme dhe që nuk citohen në një treg aktiv përveç atyre që Banka ka për qëllim t'i shesë në afat të shkurtër apo që i ka përcaktuar në vlerën reale sipas fitimit apo humbjes apo vënë në dispozicion për shitje. Fillimisht kreditë dhe detyrimet njihen në vlerë reale dhe më pas maten në vlerën e amortizuar duke shfrytëzuar metodën e interesit efektiv, minus provizionin për efekt zhvlerësimi. Provizioni për dëmin e kredive dhe detyrimeve përcaktohet kur ka prova objektive se Banka nuk do të jetë në gjendje që të arkëtojë të gjitha shumat e detyrueshme sipas kushteve fillestare.

#### Mjetet financiare të mbajtura deri në maturim

Mjetet financiare të mbajtura deri në maturim janë pasuri financiare jo-derivative me pagesa fikse apo të përcaktueshme përveç atyre që plotësojnë përcaktimin e kreditorëve dhe detyrimeve që menaxhmenti i Bankës ka qëllim dhe mundësi pozitive që të mbaj sipas maturitetit. Fillimisht aktivet njihen në vlerë reale dhe më pas maten në vlerën e amortizuar duke shfrytëzuar metodën e interesit efektiv, minus provizionin për efekt zhvlerësimi, Provizioni për dëmin e shumave të mbajtura në maturim përcaktohet kur ka prova objektive se Banka nuk do të jetë në gjendje që të arkëtojë të gjitha shumat e detyrueshme sipas kushteve fillestare.

#### Mjetet financiare të gatshme për tregtim

Mjetet financiare të gatshme për tregtim janë pasuri financiare jo-derivative të cilat ose përcaktohen në këtë kategori ose klasifikohen në ndonjërin nga kategoritë tjera. Banka nuk ka aktive të klasifikuara në këtë kategori.

#### i. Njohja

BQK-ja fillimisht njeh depozitat në datën kur ato krijohen. Të gjitha mjetet dhe detyrimet e tjera financiare njihen fillimisht në datën e tregtimit në të cilën BQK bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit.

Mjetet financiare apo detyrimet financiare fillimisht maten me vlerën e drejtë, të cilës i shtohen, për artikujt jo me vlerën e drejtë përmes fitimit apo humbjes, kostot e transaksionit që i atribuohen direkt blerjes apo emetimit të tyre.

# Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

## Shënime mbi pasqyrat financiare

(në mijë Euro, nëse nuk është shënuar ndryshe)

### 3. Politika të rëndësishme kontabël (në vazhdim)

#### f) Mjetet dhe detyrimet financiare (në vazhdim)

##### ii. Çregjistrimi (Shlyrja)

BQK-ja çregjistron një pasuri financiar kur mbarojnë të drejtat kontraktuale të rrjedhjeve të parasë që vijnë nga mjeti financiar, ose kur transferon të drejtat për të marrë rrjedhjet e kontraktuara të parasë mbi mjetin financiar përmes një transaksion në të cilin transferohen në thelb të gjitha rreziqet dhe përfitimet nga pronësia e mjetit financiar. Interesat në aktivin financiar të transferuar të cilat janë krijuar apo mbajtur nga BQK-ja njihen si një pasuri apo detyrim i veçantë. Në çregjistrimin e një mjeti (aseti) financiar, ndryshimi në mes të vlerës kontabël të tij (ose vlerës kontabël të ndarë në pjesën e tij të transferuar), dhe shumën e (i) vlerës së marrë (duke përfshirë çdo aset të ri që ka marrë minus çdo detyrim të ri të supozuar) dhe (ii) çdo fitim apo humbje kumulative që është njohur në të ardhurat e tjera të përmbledhura, njihet si fitim ose humbje.

BQK-ja çregjistron një detyrim financiar kur detyrimet kontraktuale janë përmbushur, ndërprerë apo përfunduar.

##### iii. Netimi

Mjetet dhe detyrimet financiare netohen me njëra-tjetrën dhe shuma paraqitet neto në pasqyrën e gjendjes financiare atëherë dhe vetëm atëherë kur BQK-ja ka të drejtën ligjore për të netuar këto shuma dhe ka si qëllim ose t'i shlyejë neto ose të realizojë pasurinë dhe të shlyejë detyrimin njëkohësisht.

Të ardhurat dhe shpenzimet paraqiten në bazë neto vetëm atëherë kur lejohet nga standardet kontabël, ose për fitimet dhe humbjet e krijuara nga një grup transaksionesh të ngjashme.

##### iv. Matja e kostos së amortizuar

Kostoja e amortizuar e një mjeti ose detyrimi financiar është vlera me të cilën mjeti ose detyrimi financiar matet në momentin e njohjes fillestare, duke i zbritur pagesat e principalit, plus ose minus amortizimin e akumuluar duke përdorur metodën e interesit efektiv të çdo difference ndërmjet vlerës fillestare të njohur dhe vlerës në maturim, minus çdo zbritje për efekt zhvlerësi.

##### v. Matja e vlerës së drejtë

Vlera e drejtë është shuma me të cilën një pasuri (aset) mund të këmbehet, ose një detyrim të shlyhet, në mes të palëve të në një transaksion të vullnetshëm midis palëve në datën e matjes.

Kur është e disponueshme, BQK-ja mat vlerën e drejtë e një instrumenti duke përdorur çmimet e kuotuar në një treg aktiv për këtë instrument. Një treg konsiderohet si aktiv, nëse çmimet e kuotuar janë të disponueshme në mënyrë të shpejtë dhe të përfaqësojnë transaksionet që ndodhin aktualisht në treg në bazë të vullnetshme midis palëve.

Nëse tregu për instrumentin financiar nuk është aktiv, BQK krijon vlerën e drejtë duke përdorur një teknikë vlerësi. Teknikat e vlerësimit përfshijnë përdorimin e transaksioneve më të fundit të midis palëve të mirë informuara dhe ne formë të vullnetshme, (nëse janë të disponueshme), referimin në vlerën e drejtë aktuale të instrumenteve tjera që në thelb janë të njëjta, analizat e skontimit të rrjedhave të parasë dhe modelet e vlerësimit të çmimit. Teknika vlerësuese e zgjedhur, përdor maksimalisht të dhënat e tregut, mbështetet sa më pak të jetë e mundur në vlerësimet specifike të BQK-së, përfshin të gjithë faktorët që pjesëmarrësit në treg do t'i marrin parasysh në vendosjen e çmimit dhe janë në përputhje me metodologjitë e pranuar ekonomike për vendosjen e çmimit të instrumenteve financiare. Të dhënat përmes teknikave vlerësuese paraqesin në mënyrë të arsyeshme pritjet e tregut dhe matjet e faktorëve të rrezikut që ekzistojnë në instrumentin financiar. BQK-ja kalibron teknikat vlerësuese dhe i teston ato për vlefshmërinë e tyre duke shfrytëzuar çmimet nga transaksionet aktuale të dallueshme të tregut në të njëjtin instrument apo në bazë të të dhënave tjera të dallueshme dhe të disponueshme në treg.

# Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

## Shënime mbi pasqyrat financiare

(në mijë Euro, nëse nuk është shënuar ndryshe)

### 3. Politika të rëndësishme kontabël (në vazhdim)

#### f) Mjetet dhe detyrimet financiare (në vazhdim)

##### vi. Identifikimi dhe matja e zhvlerësimit (humbjes në vlerë)

Në çdo datë raportimi, BQK vlerëson nëse ka evidencë objektive që mjetet financiare të cilat nuk mbahen me vlerën e tregut përmes pasqyrës së të ardhurave ose humbjes janë zhvlerësuar. Mjetet financiare zhvlerësohen kur evidenca objektive paraqet që një ngjarje që sjell humbje ka ndodhur pas njohjes fillestare të mjetit (pasurisë), dhe që ngjarja që sjell humbje ka një ndikim në rrjedhjet e ardhshme të parasë së mjetit, të cilat mund të maten me besueshmëri.

Evidenca objektive që mjetet financiare janë të zhvlerësuar mund të përfshijë mospagesa ose vështirësi financiare të huamarrësit, ristrukturimin e një depozite apo paradhënie nga BQK-ja me kushte dhe afate të cilat BQK-ja nuk do t'i kishte konsideruar, të dhëna që një huamarrës ose emetues i letrave me vlerë po falimenton, zhdukja e një tregu aktiv për një letër me vlerë, ose të dhëna të tjera të dukshme lidhur me një grup aktivesh si p.sh ndryshime të pafavorshme në aftësinë paguese të një huamarrësi ose emetuesi të letrave me vlerë, ose kushte ekonomike që lidhen me sjelljen e vështirësive financiare në BQK.

Humbja në vlerë (zhvlerësimi) i një aktivi financiar të matur me koston e amortizuar llogaritet si diferencë ndërmjet vlerës kontabël dhe vlerës aktuale të rrjedhjeve të ardhshme të vlerësuar të parave që skontohen me normën fillestare të interesit efektiv të aktivitetit financiar. Humbjet njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe pasqyrohen në një llogari provizioni përkundrejt huave dhe paradhënies. Interesat mbi aktivet e zhvlerësuar vazhdojnë të njihen nëpërmjet skontimeve të pandryshueshme. Kur një ngjarje pas datës së bilancit tregon për zvogëlim të zhvlerësimit, zhvlerësimi anulohet nëpërmjet të ardhurës ose humbjeve

#### g) Paraja dhe ekuivalentët e saj

Për qëllimin e pasqyrës së rrjedhjes së parasë, paraja dhe ekuivalentët e saj përfshijnë kartëmonedha dhe monedha në arkë, llogari rrjedhëse me bankat dhe të tjera mjete financiare afatshkurtra me maturitet origjinal tre muaj ose më pak, të cilat janë objekt i një rreziku jo-domethënës të ndryshimeve në vlerën e drejtë, dhe përdoren nga BQK-ja në administrimin e detyrimeve afatshkurtra.

Paraja dhe ekuivalentët e saj mbahen në pasqyrën e gjendjes financiar me kosto të amortizuar.

#### h) Letra me vlerë të investimit

Letrat me vlerë që mbahen për investim, që janë Bonot e Thesarit, njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus kosto të tjera direkte të transaksionit, dhe në vijim trajtohen si investime që mbahen deri në maturim.

Letrat me vlerë që mbahen deri në maturim janë mjete (pasuri) financiare jo-derivative me pagesa fikse ose të përcaktueshme dhe maturitet fiks, të cilat BQK-ja ka synimin e qartë dhe aftësinë t'i mbajë deri në maturim, dhe të cilat nuk janë përcaktuar me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes. Letrat me vlerë që mbahen deri në maturim përfshijnë bonot e thesarit.

Letrat me vlerë që mbahen deri në maturim mbahen me kosto të amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv. Në raste të shitjes ose ri-klasifikimit përpara maturimit të një sasive të konsiderueshme të letrave me vlerë që mbahen deri në maturim, larg kohës së maturimit të tyre, do të rezultojë në një riklasifikim të të gjitha letrave me vlerë që mbahen deri në maturim si të disponueshme për shitje, dhe do të parandalonte BQK-në të klasifikonte letrat me vlerë për qëllime investimi si të mbajtura deri në maturim gjatë periudhës aktuale dhe gjatë dy viteve financiare pasuese.

# Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

## Shënime mbi pasqyrat financiare

(në mijë Euro, nëse nuk është shënuar ndryshe)

### 3. Politika të rëndësishme kontabël (në vazhdim)

#### i) Prona dh pajisjet

##### i. Njohja dhe matja

Zërat e pronës dhe pajisjeve paraqiten me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe humbjet e akumuluar nga ndryshimi në vlerë.

Kosto përfshin shpenzime që janë drejtpërdrejt të lidhura me blerjen e mjetit. Kosto e mjeteve të ndërtuara nga vetë BQK-ja përfshin koston e materialeve dhe të fuqisë punëtore të drejtpërdrejtë, kosto të tjera që lidhen drejtpërdrejt me sjelljen e mjetit në gjendjen funksionale që ai të jetë i përdorshëm në mënyrën e synuar, dhe kostot e çmontimit dhe lëvizjes së pajisjeve dhe restaurimin e ambientit ku ato janë vendosur.

Programe kompjuterike të blera që janë thelbësore për funksionimin e pajisjes përkatëse kapitalizohen si pjesë e asaj pajisjeje.

Kur pjesë të një elementi të pronës dhe pajisjeve kanë jetëgjatësinë e dobishme të ndryshme, ato kontabilizohen si elemente të veçanta (komponentë kryesor) të aktiveve afatgjata materiale.

##### ii. Kostot vijuese

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një elementi të pronës dhe pajisjeve njihet në vlerën e mbartur të elementit nëse është e mundur që përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i atij mjeti të rrjedhin në BQK, dhe kostoja e tij mund të matet me besueshmëri. Kostot e servisimit të përditshëm të pronës dhe pajisjeve (aktiveve afatgjata materiale) njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve në momentin kur ndodhin.

##### iii. Zhvlerësimi

Zhvlerësimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën lineare përgjatë jetëgjatësisë të secilës pjese të një elementi të aktiveve afatgjata materiale.

Vlerësimi i jetëgjatësisë për periudhën e tashme dhe krahasuese është si më poshtë:

	2012	2011
Investimet në objektet me qira	20 vite	20 vite
Pajisje	5 vite	5 vite
Kompjuterë	3 vite	3 vite
Automjete	5 vite	5 vite

Jetëgjatësia e pajisjeve tjera vlerësohet rast pas rasti. Metoda e zhvlerësimit, jetëgjatësia dhe vlera e mbetur rivlerësohen në datën e raportimit.

#### j) Mjetet e paprekshme

Programet kompjuterike të blera nga BQK-ja njihen me koston historike të zvogëluar për zhvlerësimin e akumuluar dhe humbjet e akumuluar nga ndryshimi në vlerë.

Shpenzimet e mëvonshme për programet kompjuterike kapitalizohen vetëm kur këto shpenzime rrisin përfitimin e ardhshëm ekonomik prej këtij aktivi. Të gjitha shpenzimet e tjera njihen në periudhën që ndodhin.

Shpenzimi i amortizimit njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve, bazuar mbi metodën lineare të amortizimit gjatë jetës së dobishme ekonomike të programit kompjuterik, prej datës në të cilën ky program është i gatshëm për përdorim. Jeta e dobishme ekonomike e programeve kompjuterike bazohet në vlerësimin për shfrytëzimin e atij programi pa qenë nevoja për ndonjë përmirësim të madh, aktualisht nga 3 deri në 10 vite.

# Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

## Shënime mbi pasqyrat financiare

(në mijë Euro, nëse nuk është shënuar ndryshe)

### 3. Politika të rëndësishme kontabël (në vazhdim)

#### k) Rënia në vlerë i mjeteve jo-financiare

Vlera kontabël e mjeteve jo-financiare të BQK-së, rishikohet në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka evidenca për ndryshim në vlerë. Nëse ka evidenca të tilla atëherë vlerësohet vlera e rikuperueshme e mjetit.

Humbje nga rënia në vlerë njihet nëse vlera kontabël e një aseti ose e njësisë gjeneruese të parasë tejkalon vlerën e rikuperueshme. Njësia gjeneruese e mjeteve monetare është grupi më i vogël i identifikueshëm i aseteve që gjeneron rrjedhë të parasë që janë të pavarura nga mjetet dhe grupet e tjera. Humbjet nga rënia në vlerë njihen në pasqyrën e të ardhurave. Humbjet nga rënia në vlerë e njësisë gjeneruese të parasë shpërndahen në mënyrë proporcionale midis aseteve të tjera të njësisë (grupi të njësisë) për të zvogëluar vlerën kontabël të tyre.

Vlera e rikuperueshme e një aktivi ose e njësisë gjeneruese të parasë është më e madhja ndërmjet vlerës së tij në përdorim dhe vlerës së drejtë minus kostot e shitjes. Në vlerësimin e vlerës në përdorim, rrjedhjet e ardhshme të vlerësuara të mjeteve monetare skontojnë në vlerën e tyre aktuale duke përdorur një normë skontimi para taksave që reflekton vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe rreziqet specifike për aktivin.

Humbjet nga rënia në vlerë të njohura në periudhat e mëparshme vlerësohen në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse rënia në vlerë është zbutur ose nuk ekziston më. Një humbje nga rënia në vlerë anulohet nëse ka pasur ndryshim në vlerësimet e përdorura për përcaktimin e vlerës së rikuperueshme. Humbja nga rënia në vlerë anulohet deri në atë masë sa vlera kontabël e aktivit nuk tejkalon vlerën kontabël që do të përcaktohej duke i zbritur amortizimin dhe zhvlerësimin, dhe sikur të mos ishte njohur ndonjë humbje nga rënia në vlerë.

#### l) Detyrimet financiare

Burimet e financimit të BQK-së janë depozitat nga institucionet ndërkombëtare, qeveritare, publike, bankare dhe institucione të tjera financiare. Detyrimet financiare maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e normës efektive të interesit.

#### m) Të ardhurat nga grantet

Grantet qeveritare njihen fillimisht si të ardhura të shtyra kur ekziston një siguri e arsyeshme se ato do të merren dhe se BQK-ja do t'i përmbahet kushteve lidhur me grantin. Grantet që BQK-ja përfiton për shpenzime njihen si fitim ose humbje në baza sistematike në të njëjtat periudha në të cilat njihen shpenzimet. Grantet që BQK-ja përfiton për koston e një aseti njihen në fitim ose humbje në baza sistematike përgjatë jetës së përdorimit të asetit.

#### n) Pagat e financuara nga donatorët

Individë të caktuar të angazhuar në BQK janë ekspertë ndërkombëtar të caktuar dhe financiar për një afat të shkurtër nga organizatat ndërkombëtare. Financimi nga këto organizata ndërkombëtare ndër të tjera përfshin, por nuk kufizohet në pagesën e pagave të këtyre ekspertëve ndërkombëtar. Duke qenë se kjo ndihmë i paguhet personave të caktuar drejtpërdrejt nga organizatat ndërkombëtare, nivelet e pagesës nuk janë të njohura dhe as nuk janë të përfshira në këto pasqyrat financiare.

#### o) Provizionet

Provizionet njihen nëse, si rezultat i ngjarjeve që kanë ndodhur në të kaluarën, BQK-ja ka detyrime aktuale ligjore ose konstruktive që mund të vlerësohen në mënyrë të besueshme, dhe është e mundshme që një dalje e parave apo të mirave ekonomike do të kërkohet për të shlyer detyrimin. Provizionet përcaktohen duke e skontuar rrjedhjen e ardhshme të parasë me një normë para tatimit e cila reflekton vlerësimin aktual të tregut për vlerën kohore të parasë dhe kur është e përshtatshme, rrezikun specifike për detyrimet.

Provizioni për kontrata të ngarkuara njihet kur përfitimet e pritura për t'u nxjerrë nga BQK-ja nga kontrata janë më të vogla se kostoja e pashmangshme e realizimit të detyrimeve sipas kontratës. Provizionin matet në vlerën aktuale me më të voglën midis koston së pritshme të ndërprerjes së kontratës dhe koston së pritshme neto të vazhdimit të kontratës. Përpara se të njihet një provizion, BQK njeh çdo humbje nga rënia në vlerë e asetit të lidhur me atë kontratë.

# Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

## Shënime mbi pasqyrat financiare

(në mijë Euro, nëse nuk është shënuar ndryshe)

### 3. Politika të rëndësishme kontabël (në vazhdim)

#### p) Ndryshimet në politikat dhe shpalosjet kontabël

##### (i) Miratimi i 'Prezantimit të zërave të të ardhurave tjera gjithëpërfshirësve' (Ndryshimet në SNK 1)

Banka ka miratuar 'Prezantimin e zërave të të ardhurave tjera gjithëpërfshirëse' (Ndryshimet në SNK 1). Ndryshimet në SNK 1 vlejné për periudhat vjetore që fillojnë më apo pas 1 korrikut 2012 dhe kërkojnë nga subjektet që t'i veçojnë zërat e paraqitur në të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse (ATGJ) nga ato, të cilat në përputhje me SNRF-të tjera, nuk do të riklasifikohen pas fitimit apo humbjes dhe nga ato që do të riklasifikohen pas fitimit apo humbjes kur plotësohen kushtet specifike. Opsioni ekzistues për të paraqitur zërat e ATGJ-ve qoftë para taksave apo netos së taksave mbetet i pandryshuar; megjithatë, nëse zërat paraqiten para tatimit, atëherë Ndryshimet në SNK 1 kërkon që ndërlihet me secilin nga dy grupet e ATGJ-ve të paraqitet veçmas.

##### (ii) Standardet, ndryshimet dhe interpretimet në standardet ekzistuese që nuk janë ende në fuqi dhe që nuk janë miratuar më parë nga Banka

Në datën e autorizimit të këtyre pasqyrave financiare, standarde të reja, ndryshime dhe interpretime të standardeve ekzistuese janë publikuar nga BSNK-ja por që ende nuk janë në fuqi dhe nuk janë miratuar më parë nga Banka (përveç Ndryshimeve në SNK 1 të cekur më lartë).

Menaxhmenti pret që të gjithat shpalljet relevante do të miratohen në politikat kontabël të Bankës për periudhën e parë që fillon pas datës së hyrjes në fuqi të shpalljes së tyre. Informacionet rreth standardeve të reja, ndryshimeve dhe interpretimeve që priten të jenë relevante për pasqyrat financiare të Bankës janë dhënë më poshtë. Janë nxjerrë edhe standarde dhe interpretime të caktuara tjera të reja por ato nuk priten që të kenë ndonjë ndikim material në pasqyrat financiare të Bankës.

#### SNRF 9 Instrumentet financiare (SNRF 9)

BSNK-ja ka për qëllim që të zëvendësojë në tërësi SNK 39 'Instrumentet Financiare: Njohja dhe Matja' me SNRF 9. Deri me tani, janë nxjerrë kapitujt që kanë të bëjnë me njohjen, klasifikimin, matjen dhe çregjistrimin e asetëve dhe detyrimeve financiare. Këta kapituj janë efektive për periudhat vjetore që fillojnë më 1 janar 2015. Kapitujt tjerë që kanë të bëjnë me metodologjinë e zhvlerësimit dhe llogaritjen kufizuese janë ende në zhvillim e sipër. Për më tepër, në nëntor të vitit 2011, BSNK-ja mbase kishte vendosur që të bëjë modifikime të kufizuara në modelin e klasifikimit të aktiveve financiare të SNRF 9 me qëllim të adresimit çështjeve të zbatimit. Menaxhmenti të Bankës i duhet të vlerësojë ndikimin e këtij standardi të ri në pasqyrat financiare të Bankës. Megjithatë, menaxhmenti nuk pret që implementojë SNRF 9 përderisa të jenë publikuar të gjithë kapitujt e tij dhe që ata të mund të vlerësojnë në mënyrë gjithëpërfshirëse ndikimin e të gjitha ndryshimeve.

#### Standardet e konsolidimit

Një pako standarde të reja të konsolidimit është efektive për periudhën që fillon më 1 janar 2013. Informacionet rreth këtyre standardeve të reja janë paraqitur më poshtë. Menaxhmenti i kompanisë duhet të vlerësojë ndikimin e këtyre standardeve të reja dhe të rishikuara në pasqyrat financiare të Bankës.

#### SNRF 10 'Pasqyrat e Konsoliduara Financiare' (SNRF 10)

SNRF 10 zëvendëson SNK 27 'Pasqyrat e Konsoliduara dhe të Veçanta Financiare' (SNK 27) dhe KSI 12 Konsolidimi – Subjektet më Qëllim të Posaçëm. SNRF 10 rishikon përkufizimin e kontrollit dhe siguron udhëzime të reja të vazhdueshme rreth aplikimit të tij. Këto kërkesa të reja kanë potencial për të ndikuar se cilët nga investuesit e grupit konsiderohen të jenë degë dhe në këtë mënyrë ndryshojnë fushëveprimin e konsolidimit.

Megjithatë, kërkesat dhe procedurat e konsolidimit dhe kontabilitetit për interesat dhe ndryshmet jo-kontrolluese në kontroll mbesin të njëjta.

# Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

## Shënime mbi pasqyrat financiare

(në mijë Euro, nëse nuk është shënuar ndryshe)

### 3. Politika të rëndësishme kontabël (në vazhdim)

#### p) Ndryshimet në politikat dhe shpalosjet kontabël (në vazhdim)

#### (iii) Standardet, ndryshimet dhe interpretimet në standardet ekzistuese që nuk janë ende në fuqi dhe që nuk janë miratuar më parë nga Banka (në vazhdim)

##### SNRF 11 'Aranzhimet e Përbashkëta' (SNRF 11)

SNRF 11 zëvendëson SNK 31 'Interesat në kompanitë "Jonit Venture"' (SNK 31). Llogaritjen nga investitorët e sjell më afër me të drejtat dhe obligimet e tyre lidhur me aranzhimin e përbashkët. Përveç kësaj, opsioni i SNFR 11 për të shfrytëzuar konsolidimin proporcional për sipërmarrjet e përbashkëta është eliminuar. SNFR 11 tani kërkon shfrytëzimin e metodës së llogaritjes së kapitalit, e cila aktualisht shfrytëzohet për investimet në shoqëri.

##### SNRF 12 'Shpalosja e Interesave në Entitetet Tjera' (SNFR 12)

SNFR 12 integron dhe e bën të qëndrueshme kërkesën për shpalosje për llojet e ndryshme të investimeve duke përfshirë entitetet me strukturë të pakonsoliduar. Paraqet kërkesat e reja për shpalosje lidhur me rreziqet ndaj të cilave ekspozohet një entitet nga përfshirja e tij me entitete e strukturuar.

##### Udhëzimit kalimtar për SNRF 10, 11, 12

Pas nxjerrjes së standardeve të reja, the BSNK-ja ka bërë disa ndryshime në dispozitat kalimtare në SNRF 10, SNRF 11 dhe SNRF 12. Ky udhëzim konfirmon se nuk kërkohet nga entiteti që të aplikojë SNRF 10 në mënyrë retrospektive në rrethana të caktuara dhe sqaron kërkesat për paraqitjen e krahasuesve të rregulluar. Udhëzimi po ashtu bën ndryshime në SNRF 11 dhe SNRF 12 që siguron një lehtësim të ngjashëm nga paraqitja apo rregullimi i të dhënave krahasuese për periudhat para periudhës së menjëhershme paraprijëse. Për më tepër, ai siguron një lehtësim shtesë duke hequr kërkesën për paraqitjen e krahasuesve për shpalosjet që kanë të bëjnë me entitetet me strukturë të pakonsoliduar për çdo periudhë para periudhës së parë vjetor për të cilën aplikohet SNRF 12. Udhëzimi i ri është gjithashtu efektiv për periudhat vjetor më apo pas 1 janarit 2013.

Ndryshimet pasuese në SNK 27 'Pasqyrat e Veçanta Financiare' (SNK 27) dhe SNK 28 'Investimet në Shoqëri dhe Sipërmarrje të Përbashkëta' (SNK 28). SNK 27 tani merret vetëm me pasqyrat e veçanta financiare. SNK 28 sjell në fushëveprimin e saj investimet në sipërmarrje të përbashkëta. Megjithatë, metodologjia për llogaritjen e kapitalit sipas SNK 28 mbetet e njëjtë.

##### **SNFR 13 'Matja e Vlerës së Drejtë' (SNRF 13)**

SNFR 13 sqaron përcaktimin e vlerës së drejtë dhe ofron udhëzime përkatëse dhe shpalosje të shtuar rreth matjeve të vlerës së drejtë. Nuk përcakton se cilët zëra kërkohen që të vlerësohen drejtë. SNRF 13 është i zbatueshëm për periudhat vjetor që fillojnë më apo pas 1 janarit 2013.

Menaxhmenti është në proces të rishikimit të metodologjive vlerësuese të tij për përputhshmëri me kërkesat e reja dhe duhet të bëjë vlerësimin rreth ndikimit të tyre në pasqyrat financiare të Bankës.

# Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

## Shënime mbi pasqyrat financiare

(në mijë Euro, nëse nuk është shënuar ndryshe)

### 3. Politika të rëndësishme kontabël (në vazhdim)

#### p) Ndryshimet në politikat dhe shpalosjet kontabël (në vazhdim)

#### (iii) Standardet, ndryshimet dhe interpretimet në standardet ekzistuese që nuk janë ende në fuqi dhe që nuk janë miratuar më parë nga Banka (në vazhdim)

##### Ndryshimet në SNK 19 'Përfitimet e Punonjësve' (Ndryshimet SNK 19)

Ndryshimet në SNK 19 përfshijnë një numër të përmirësimeve të synuara nëpërmjet këtij standardi. Ndryshimet kryesore kanë të bëjnë me planet e definuara të përfitimit.

Ato:

- eliminojnë 'metodën e korridorit', që kërkon nga entitetet që të njohin të gjitha fitimet dhe humbjet që lindin në periudhën raportimit,
- ndryshojnë matjen dhe paraqitjen e komponentëve të caktuar të kostos së definuar të përfitimit,
- shtojnë kërkesat për shpalosje, duke përfshirë informacionet rreth karakteristikave të planeve të definuara të përfitimit dhe rrethqeve ndaj të cilave ekspozohen subjektet që marrin pjesë në to.

Ndryshimet SNK 19 janë efektive për periudhat vjetore që fillojnë më apo pas 1 janarit 2013 dhe aplikohen në mënyrë retrospektive.

##### Netimi i Aktiveve Financiare dhe Detyrimeve Financiare (Ndryshimet në SNK 32)

Ndryshimet në SNK 32 japin udhëzime rreth aplikimit me qëllim të adresimit të mospërputhjeve gjatë aplikimit të kriterëve të SNK 32 për netimin e aktiveve financiare dhe detyrimeve financiare në dy fushat si në vijim:

- kuptimin e 'aktualisht ka të drejtë të zbatueshme ligjore të netimit',
- se disa sisteme të zgjidhjes bruto mund të konsiderohen si ekuivalente zgjidhjes neto.

Ndryshimet janë efektive për periudhat vjetore që fillojnë më apo pas 1 janarit 2014 dhe kërkohen që të zbatohen në mënyrë retrospektive. Menaxhmenti nuk pret ndonjë ndikim material në pasqyrat financiare të Bankës nga këto Ndryshime.

##### Shpalosjet – Netimi i Aktiveve Financiare dhe Detyrimeve Financiare (Ndryshimet në SNRF 7)

Shpalosje kualitative dhe kuantitative i janë shtuar SNRF 7 'Instrumentet Financiare: Shpalosjet (SNRF 7) e që kanë të bëjnë me shumën bruto dhe neto të instrumenteve të njohura financiare që janë (a) netimi në pasqyrën e gjendjes financiare dhe (b) subjekt i aranzhimit kryesor të zbatueshme të netimit dhe aranzhimeve të ngjashme, madje edhe nëse në nuk është netuar në pasqyrën e gjendjes financiare Ndryshimet janë efektive për periudhat vjetore që fillojnë më apo pas 1 janarit 2014 dhe kërkohen që të zbatohen në mënyrë retrospektive. Menaxhmenti nuk pret ndonjë ndikim material në pasqyrat financiare të Bankës nga këto Ndryshime.

##### Përmirësimet Vjetore 2009-2011 (Përmirësimet Vjetore)

Përmirësimet Vjetore 2009-2011 (Përmirësimet Vjetore) kanë bërë disa ndryshime të vogla në një numër të SNRF0ve. Ndryshimet që janë relevante për Bankën janë përmbledhur si më poshtë:

Sqarimi i kërkesave për hapje të pasqyrës së gjendjes financiare:

- sqaron se data e duhur për hapje të pasqyrës së gjendjes financiare është fillimi i fillimi i periudhës paraprijëse (nuk kërkohet që edhe më tej të paraqiten shënimet e ndërlidhura)
- adreson kërkesat relative për hapje të pasqyrës së gjendjes financiare kur një entitet ndryshon politikat kontabël apo rikrijon pasqyra apo bën riklasifikime retrospektive në përputhje me SNK 8.

# Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

## Shënime mbi pasqyrat financiare

(në mijë Euro, nëse nuk është shënuar ndryshe)

### 3. Politika të rëndësishme kontabël (në vazhdim)

#### p) Ndryshimet në politikat dhe shpalosjet kontabël (në vazhdim)

#### (iii) Standardet, ndryshimet dhe interpretimet në standardet ekzistuese që nuk janë ende në fuqi dhe që nuk janë miratuar më parë nga Banka (në vazhdim)

Sqarimi i kërkesave për të dhënave krahasuese të siguruara përtej kërkesave minimale:

- sqaron se të dhënat shtesë rreth pasqyrës financiare nuk duhet të paraqiten në formën e një vargu komplet pasqyrash financiare për periudhat përtej kërkesave minimale.
- kërkon qëçdo e dhënë plotësuese shtesë e paraqitur duhet të paraqitet në përputhje me SNRF dhe entiteti duhet t'i paraqes të dhënat krahasuese në shënimet e ndërlidhura për atë të dhënë shtesë.

Efekti tatimor i shpërndarjes së instrumenteve të ekuitetit tek poseduesit:

- adreson mospërputhjen e perceptuar ndërmjet SNK 12 'Tatimi në të Ardhura' (SNK 12) dhe SNK 32 'Instrumentet Financiare: Paraqitja (SNK 32) në lidhje me njohjen e pasojave të tatimit në të ardhura lidhur me shpërndarjet e një instrumenti të ekuitetit tek poseduesit dhe me kostot e transaksionit të një transaksioni të ekuitetit;
- sqaron se qëllim i i SNK 32 është që të ndjek kërkesat në SNK 12 të llogaritjes së tatimit në të ardhura që ndërlidhet me shpërndarjet e një instrumenti të ekuitetit tek poseduesit dhe me kostot e transaksionit të një transaksioni të ekuitetit.

Të dhënat e segmetuara për gjithsej aktive dhe detyrime:

- sqaron se gjithsej aktivet dhe detyrimet për një segment të veçantë të raportueshëm janë të nevojshme për shpalosje nëse dhe vetëm nëse: (i) matja e gjithsej aktiveve apo e gjithsej detyrimeve (apo që të dyja) i sigurohet rregullisht vendimmarrësit kryesor të operacioneve; (ii) ka pasur një ndryshim material nga matjet e shpalosura në pasqyrat e fundit vjetor financiare për atë segment të raportueshëm.

Përmirësimet vjetore të cekura më lartë janë efektive për periudhat vjetore që fillojnë më apo pas 1 janarit 2013. Menaxhmenti nuk pret ndonjë ndikim material në pasqyrat financiare të Bankës nga këto Ndryshime.

# Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

## Shënime mbi pasqyrat financiare

(në mijë Euro, nëse nuk është shënuar ndryshe)

### 4. Menaxhimi i rrezikut financiar

#### a) Prezantim dhe të përgjithshme

BQK është ekspozuar ndaj rreziqeve të mëposhtme nga përdorimi i instrumenteve financiare:

- Rreziku i kreditor
- Rreziku operacional
- Rreziku i likuiditetit
- Rreziku i tregut

Ky shënim paraqet informacion lidhur me ekspozimin e BQK-së ndaj rreziqeve të mësipërme si dhe objektivat, politikat dhe procedurat për matjen dhe administrimin e tyre si dhe për administrimin e kapitalit të BQK-së. Shënime të tjera sasiore janë përfshirë përgjatë këtyre pasqyrave financiare.

#### *Struktura e menaxhimit të rrezikut*

Krijimi dhe mbikëqyrja e strukturës së administrimit të rrezikut të BQK-së është përgjegjësi e Bordit të Bankës Qendrore. Menaxhmenti i BQK-së raporton rregullisht nëpërmjet Bordit Ekzekutiv të BQK-së tek Bordi i BQK mbi veprimet e lidhura me administrimin e rrezikut. Bordi Ekzekutiv dhe Komitetit i Investimeve janë të angazhuar në zhvillimin dhe monitorimin e politikave të administrimit të rrezikut të BQK-së. Këto politika implementohen më pas nga njësitë organizative përkatëse.

Politikat e administrimit të rrezikut të BQK-së janë krijuar për të identifikuar dhe analizuar rreziqet e ndeshura nga BQK-ja, për të vendosur limite dhe kontrole të përshtatshme, dhe për të monitoruar rreziqet dhe respektimin e limiteve të vendosura. Politikat dhe sistemet e administrimit të rrezikut rishikohen rregullisht në mënyrë që të reflektojnë ndryshimet në kushtet e tregut, produktet dhe shërbimet e ofruara. Me anë të trajnimeve, standardeve dhe procedurave të administrimit, BQK-ja synon të zhvillojë një mjedis kontrolli konstruktiv dhe të disiplinuar, në të cilin të gjithë punonjësit të jenë të vetëdijshëm për rolet dhe detyrimet e tyre.

Komiteti i Auditimit të BQK-së është përgjegjës për monitorimin e pajtueshmërisë me politikat dhe procedurat e administrimit të rrezikut, si dhe për rishikimin e mjaftueshmërisë së strukturës së administrimit të rrezikut lidhur me rreziqet që përballet BQK-ja. Komiteti i Auditimit të BQK-së ndihmohet në kryerjen e detyrave të tij nga Departamenti i Auditimit të Brendshëm. Auditimi i brendshëm ndërmerr auditime të kontroleve dhe të procedurave të administrimit të rrezikut në mënyrë të rregullt dhe rastësore, rezultatet e të cilave i raportohen Komitetit të Auditimit përmes Shefit të Auditimit të brendshëm.

#### b) Rreziku i kreditor

Rreziku i kreditor është rreziku i humbjes së mjeteve financiare për BQK-në nëse një palë kontraktuese e instrumenteve financiare dështon të përmbushë detyrimet kontraktuale të saj, dhe mund të rrjedh kryesisht nga investimet e BQK-së në letra me vlerë dhe depozitat (në tregjet e parasë apo llogari rrjedhëse) në banka të tjera.

#### *Menaxhimi i rrezikut të kreditimit*

##### *i. Investimet dhe ekspozimi në banka të tjera*

BQK-ja e kufizon ekspozimin e saj ndaj rrezikut të kreditimit duke investuar vetëm në letra me vlerë të emetuara nga qeveritë e vendeve të BE-së dhe duke pasur depozita pranë bankave të huaja, detyrimet afatshkurtra të të cilave janë të vlerësuara në një nga dy kategoritë më të larta nga agjencitë ndërkombëtare të njohura për vlerësimin e rrezikut të kreditimit. Duke pasur vlerësimet e larta kreditore, menaxhmenti nuk pret që ndonjë nga palët kontraktuese të dështojë në përmbushjen e detyrimeve të veta.

# Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

## Shënime mbi pasqyrat financiare

(në mijë Euro, nëse nuk është shënuar ndryshe)

### 4. Menaxhimi i rrezikut të kreditor (në vazhdim)

#### Menaxhimi i rrezikut të kreditor (në vazhdim)

##### ii. Ekspozimi ndaj rrezikut të kreditor

Ekspozimi maksimal ndaj rrezikut kreditor më 31 dhjetor 2012 dhe 31 dhjetor 2011 paraqitet nga vlera e mbartur: e llogarive rrjedhëse me bankat jo-rezidente, e bonove të thesarit dhe e depozitave me bankat jo-rezidente. Për detaje mbi ekspozimin referojuni shënimeve 8, 9 dhe 10

Asnjë nga ekspozimet e BQK-së nuk është me vonesë ose me rënie në vlerë. Nuk ka ndryshime në politikat e administrimit të rrezikut nga vitet e kaluara. BQK-ja nuk mban asnjë kolateral apo ndonjë element tjetër avancues kreditor kundrejt ekspozimit ndaj rrezikut të kreditimit.

##### c) Rreziku i likuiditetit

Rreziku i likuiditetit është rreziku që BQK-ja nuk do të jetë në gjendje të përmbushë në kohën e duhur obligimet e lidhura me detyrimet financiare.

#### Menaxhimi i rrezikut të likuiditetit

Qëndrimi i BQK-së në menaxhimin e likuiditetit është të sigurojë vazhdimisht likuiditet të mjaftueshëm për të përmbushur me kohë detyrimet si në kushte normale ashtu edhe në ato të papavorshme, pa pësuar humbje të papranueshme apo rrezikuar të dëmtojë reputacionin e BQK-së.

Politikat e monitorimit dhe adresimit të rrezikut të likuiditetit janë të vendosura nga Bordi Ekzekutiv i Bankës. BQK-ja menaxhon rrezikun e likuiditetit duke investuar në depozita afatshkurtra me bankat jorezidente dhe duke mbajtur shuma të mjaftueshme të mjeteve monetare. Politikat e menaxhimit të likuiditetit janë të vendosura në një mënyrë të tillë që edhe në kushte të përkeqësuar BQK-ja të jetë në gjendje të përmbushë detyrimet e saj.

Pozicioni ditor i likuiditetit monitorohet dhe testime të rregullta kryhen nën skenarë të ndryshëm si për kushte të tregut normale ashtu edhe për ato më të vështira. Të gjitha politikat dhe procedurat e likuiditetit janë pjesë e rishikimit dhe aprovimit të menaxhmentit të BQK-së. Raportet mujore që mbulojnë pozicionin e likuiditetit të BQK-së i paraqiten rregullisht anëtarëve të Komitetit të Investimeve nga Departamenti i Menaxhimit të Mjeteve.

#### Ekspozimi ndaj rrezikut të likuiditetit

**Maturiteti i mbetur kontraktual për detyrimet financiare, më përjashtim të pagesave të ardhshme të interesit:**

	Shënim	Vlera e mbartur	Më pak se 1 muaj	1-3 muaj	3 muaj deri në 1 vit	1 vjet deri në 5 vite
<b>31 dhjetor 2012</b>						
<i>Detyrimet jo-derivative</i>						
Detyrime ndaj bankave vendase	15	302,147	302,147	-	-	-
Detyrime ndaj llogarive të ndërlidhura	16	246,890	133,832	-	-	113,058
Detyrime ndaj institucioneve qeveritare	17	821,509	681,502	80,003	60,004	-
Detyrime ndaj entiteteve tregtare dhe publike	18	49,023	49,023	-	-	-
Detyrime të tjera vendase	19	2,428	2,428	-	-	-
		<b>1,421,997</b>	<b>1,168,932</b>	<b>80,003</b>	<b>60,004</b>	<b>113,058</b>
<b>31 dhjetor 2011</b>						
<i>Detyrimet jo-derivative</i>						
Detyrime ndaj bankave vendase	15	209,700	209,700	-	-	-
Detyrime ndaj llogarive të ndërlidhura	16	156,509	136,045	-	-	20,464
Detyrime ndaj institucioneve qeveritare	17	782,178	355,365	165,171	261,642	-
Detyrime ndaj entiteteve tregtare dhe publike	18	37,059	37,059	-	-	-
Detyrime të tjera vendase	19	2,427	2,427	-	-	-
		<b>1,187,873</b>	<b>740,596</b>	<b>165,171</b>	<b>261,642</b>	<b>20,464</b>

# Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

## Shënime mbi pasqyrat financiare

(në mijë Euro, nëse nuk është shënuar ndryshe)

### 4. Menaxhim i rrezikut financiar (në vazhdim)

#### c) Rreziku i likuiditetit (në vazhdim)

Tabela e mësipërme tregon rrjedhjet e parasë të paskontuara të detyrimeve financiare të BQK-së bazuar në mundësinë më të hershme të maturitetit të tyre kontraktual. Për administrimin e rrezikut të likuiditetit që rrjedh nga detyrimet financiare, BQK mban mjete likuide që përfshijnë para dhe ekuivalentë të saj dhe letra me vlerë për të cilat ekziston një treg aktiv dhe likuid.

#### *Paqëndrueshmëria në tregjet financiare botërore dhe të Kosovës*

Kriza ekonomike dhe financiare botërore ka rezultuar, përveç të tjerave, në një nivel më të ulët të financimit të tregut kapital, nivel më të ulët të likuiditetit në sektorin bankar, ulje të normave të interesit nga bankat qendrore për të ndihmuar huamarrësit, injektive të kapitalit nga qeveritë, norma më të larta ndërbankare interesi dhe paqëndrueshmëri në tregun e aksioneve. Zhvillimet e mëtejshme të pafavorshme që rezultojnë nga kriza mund të kenë ndikim në pozicionin financiar dhe të likuiditetit të BQK-së.

#### d) Rreziku i tregut

Rreziku i tregut është rreziku që ndryshimi në çmimet e tregut, si normat e interesit, çmimet e kapitalit, normat e kursit të këmbimit dhe normat kreditore (që nuk lidhen me ndryshimet në gjendjen kreditore të huamarrësit/emetuesit) do të ndikojë në të ardhurat e BQK-së apo vlerën e instrumenteve financiare të mbajtura nga ajo. Objektivi i administrimit të rrezikut të tregut është të menaxhojë dhe kontrollojë që ekspozimi ndaj rrezikut të tregut të jetë brenda parametrave të pranueshëm, ndërkohë që optimizon kthimin nga rreziku.

#### *Menaxhimi i rrezikut të tregut*

Operacionet e BQK-së i nënshtrohen rrezikut të luhatjes së normave të interesit në masën që aktivet dhe detyrimet që bartin interes maturohen ose riçmohen në kohë apo shuma të ndryshme. Mjetet dhe detyrimet me norma të ndryshueshme janë të ekspozuara ndaj rrezikut bazë, i cili është ndryshimi në karakteristikat e riçimit të indekseve të shumëllojshëm me norma të ndryshueshme.

Veprimtaritë e menaxhimit të rrezikut synojnë të optimizojnë të ardhurat neto nga interesi bazuar mbi nivelet e normave të interesit të tregut konsistente me strategjitë e veprimit të BQK-së. Ekspozimi i BQK-së ndaj rrezikut të tregut lidhet vetëm me portofolet jo të tregtueshme.

#### *Ekspozimi ndaj rrezikut të normës së interesit - portofolet jo të tregtueshme*

Rreziku kryesor ndaj të cilit portofolet jo të tregtueshme janë ekspozuar është rreziku i humbjes nga luhatja e rrjedhjeve të ardhshme të parasë apo e vlerave të drejta të instrumenteve financiare për shkak të një ndryshimi në normat e tregut. Rreziku i normës së interesit kryesisht menaxhohet duke monitoruar diferencat midis normave të interesit dhe duke pasur limite paraprakisht të miratuara për intervalet e rivlerësimit. Komiteti i investimeve është autoriteti që monitoron zbatimin e këtyre limiteve. Një përmbledhje e pozicionit të BQK-së lidhur me diferencën midis normave të interesit të portfolios jo të tregtueshme paraqitet si më poshtë:

# Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

## Shënime mbi pasqyrat financiare

(në mijë Euro, nëse nuk është shënuar ndryshe)

### 4. Menaxhimi i rrezikut financiar (në vazhdim)

#### (d) Rreziku i tregut (në vazhdim)

*Ekspozimi ndaj rrezikut të normës së interesit - portofolet jo të tregtueshme*

31 dhjetor 2012	S hë ni m	Vlera e mbartur	Më pak se 3 muaj	3-6 muaj	6-12 muaj	1-5 vite
Bono thesari	9	285,983	39,994	145,992	99,997	-
Depozita me bankat e huaja	10	821,590	540,922	280,668	-	-
Mjete ne llogarit e ndërlidhura me FMN	11	193,303	80,245	-	-	113,058
<b>Gjithsej</b>		<b>1,400,425</b>	<b>760,710</b>	<b>426,660</b>	<b>99,997</b>	<b>113,058</b>
Detyrime ndaj bankave vendase	15	(302,147)	(302,147)	-	-	-
Detyrime ndaj llogarive të ndërlidhura me FMN	16	(194,792)	(81,734)	-	-	(113,058)
Detyrime ndaj institucioneve qeveritare	17	(821,509)	(761,505)	(32,652)	(27,352)	-
Detyrime ndaj entiteteve tregtare dhe publike	18	(49,023)	(49,023)	-	-	-
Detyrime të tjera vendase	19	(2,428)	(2,428)	-	-	-
<b>Gjithsej</b>		<b>(1,369,899)</b>	<b>(1,196,837)</b>	<b>(32,652)</b>	<b>(27,352)</b>	<b>(113,058)</b>
<b>Ndryshimi</b>		<b>30,526</b>	<b>(436,127)</b>	<b>394,008</b>	<b>72,645</b>	<b>-</b>

31 dhjetor 2011	S hë ni m	Vlera e mbartur	Më pak se 3 muaj	3-6 muaj	6-12 muaj	1-5 vite
Bono thesari	9	24,988	-	24,988	-	-
Depozita me bankat e huaja	10	1,009,046	727,474	177,255	104,317	-
Mjete ne llogarit e ndërlidhura me FMN	11	155,687	135,223	-	-	20,464
<b>Gjithsej</b>		<b>1,221,234</b>	<b>894,210</b>	<b>202,243</b>	<b>104,317</b>	<b>20,464</b>
Detyrime ndaj bankave vendase	15	(209,700)	(209,700)	-	-	-
Detyrime ndaj llogarive të ndërlidhura me FMN	16	(156,509)	(136,045)	-	-	(20,464)
Detyrime ndaj institucioneve qeveritare	17	(782,178)	(520,536)	(221,545)	(40,097)	-
Detyrime ndaj entiteteve tregtare dhe publike	18	(37,059)	(37,059)	-	-	-
Detyrime të tjera vendase	19	(2,427)	(2,427)	-	-	-
<b>Gjithsej</b>		<b>(1,187,873)</b>	<b>(905,767)</b>	<b>(221,545)</b>	<b>(40,097)</b>	<b>(20,464)</b>
<b>Ndryshimi</b>		<b>33,361</b>	<b>(11,557)</b>	<b>(19,302)</b>	<b>64,220</b>	<b>-</b>

# Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

## Shënime mbi pasqyrat financiare

(në mijë Euro, nëse nuk është shënuar ndryshe)

Aktivitet dhe detyrimet financiare që nuk mbartin interes nuk janë përfshirë në tabelën më lartë.

### 4. Menaxhimi i rrezikut financiar (në vazhdim)

#### (d) Rreziku i tregut (në vazhdim)

Rreziku i përgjithshëm jo-tregtar i normave të interesit jo të tregtueshme menaxhohet nga Departamenti i Menaxhimit të Mjeteve, i cili përdor investimet në letra me vlerë dhe depozitat në banka për të menaxhuar rrezikun e përgjithshëm që lind nga aktivitetet jo tregtare të BQK-së.

Menaxhimi i rrezikut të normave të interesit kundrejt limitit të hendekut të normave të interesit, kompletohet duke vëzhguar ndjeshmërinë e mjeteve dhe detyrimeve të BQK-së ndaj skenarëve të ndryshëm standard dhe jo-standard të normave të interesit. Skenarët standard të cilët vlerësohen në mënyrë periodike, përfshijnë një rënie ose ngritje paralele në të gjitha kurbat e kthimit, prej 100 pikësh bazë ("pb"). Një analizë e ndjeshmërisë së BQK-së ndaj një rritje ose rënie të normave të interesit të tregut (duke supozuar që nuk ka lëvizje asimetrike të kurbave të kthimit si dhe një gjendje të pandryshueshme financiare) është si vijon:

#### 2012

	100 pb	100 pb
	Rritje	Rënie
Efekti i parashikuar në fitim (humbje)	305	(305)

#### 2011

	100 pb	100 pb
	Rritje	Rënie
Efekti i parashikuar në fitim (humbje)	376	(376)

### Ekspozimi ndaj rreziqeve të tjera të tregut/valutore të portofoleve jo të tregtueshme

BQK-ja CBK është e ekspozuar ndaj SDR lidhur me aktivitet dhe detyrimet e saj në FMN, të cilat i monitoron në vazhdueshmëri. Ekspozimi i BQK ndaj rrezikut të valutave të huaja është si vijon:

#### 2012

	100 pb	100 pb
	Rritje	Rënie
Efekti i parashikuar në fitim (humbje)	15	(15)

#### 2011

	100 pb	100 pb
	Rritje	Rënie
Efekti i parashikuar në fitim (humbje)	35	(35)

# Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

## Shënime mbi pasqyrat financiare

(në mijë Euro, nëse nuk është shënuar ndryshe)

### 4. Menaxhimi i rrezikut financiar (në vazhdim)

#### (d) Rreziku i tregut (në vazhdim)

31 dhjetor 2012	EUR	DVT (Ekuivalent i EUR)	Gjithsej
<b>Aktive</b>			
Paraja e gatshme	16,761	-	16,761
Llogaritë rrjedhëse me bankat e huaja	99,549	-	99,549
Bono thesari	285,983	-	285,983
Depozita me bankat e huaja	821,590	-	821,590
Mjete ne llogarit e ndërlidhura me FMN	113,058	132,343	245,401
Mjete të tjera	462	-	462
<b>Gjithsej</b>	<b>1,337,403</b>	<b>132,343</b>	<b>1,469,746</b>
<b>Detyrime</b>			
Detyrime ndaj bankave vendase	302,147	-	302,147
Detyrime ndaj llogarive të ndërlidhura me FMN	165,334	81,556	246,890
Detyrime ndaj institucioneve qeveritare	821,509	-	821,509
Detyrime ndaj entiteteve tregtare dhe publike	49,023	-	49,023
Detyrime të tjera vendase	3,289	-	3,289
<b>Gjithsej</b>	<b>1,341,302</b>	<b>81,556</b>	<b>1,422,858</b>
<b>Pozicioni neto për valuta të huaja</b>		<b>50,787</b>	
<hr/>			
31 dhjetor 2011	EUR	DVT (Ekuivalent i EUR)	Gjithsej
<b>Aktive</b>			
Paraja e gatshme	13,456	-	13,456
Llogaritë rrjedhëse me bankat e huaja	31,513	-	31,513
Bono thesari	24,988	-	24,988
Depozita me bankat e huaja	1,009,046	-	1,009,046
Mjete ne llogarit e ndërlidhura me FMN	20,464	135,223	155,687
Mjete të tjera	446	-	446
<b>Gjithsej</b>	<b>1,099,913</b>	<b>135,223</b>	<b>1,235,136</b>
<b>Detyrime</b>			
	209,700	-	209,700
	73,668	82,841	156,509
	782,178	-	782,178
	37,059	-	37,059
	3,337	-	3,337
<b>Gjithsej</b>	<b>1,105,942</b>	<b>82,841</b>	<b>1,188,783</b>
<b>Pozicioni neto për valuta të huaja</b>		<b>52,382</b>	

# Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

## Shënime mbi pasqyrat financiare

(në mijë Euro, nëse nuk është shënuar ndryshe)

### 4. Menaxhimi i rrezikut financiar (në vazhdim)

#### (d) Rreziku i tregut (në vazhdim)

BQK-ja kryesisht kryen veprime me Euro, ndërsa monedhat e huaja me të cilat merret BQK-ja janë kryesisht “Të Drejtat e Veçanta të Tërheqjes” (“DVT”). Kurset e këmbimit të përdorura për përkthimin më 31 Dhjetor 2012 dhe 2011 ishin si vijon:

	2012	2011
	EUR	EUR
1 DVT (SDR)	1.1658	1.1865

DVT-të janë aktive shitesë nga rezervat e kursit të këmbimit që përcaktohen dhe mbahen nga Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN). Edhe pse DVT-të nuk janë valutë në vete, ato përfaqësojnë një kërkesë potenciale në valuta të vendeve anëtare të FMN-së me të cilat mund të këmbehen. DVT-të janë krijuar në vitin 1969 si pasojë e mungesës së aktiveve në valutat e preferuara të kohës si dollari amerikan dhe ari, vlera e DVT-ve përcaktohet si mesatare e shportës së katër valutave kryesore, euro, dollari amerikan, funta britanike dhe jeni japonez.

#### (e) Rreziku operacional

Rreziku operacional është rreziku i humbjeve direkte apo indirekte që shkaktohen nga një shumëllojshmëri shkaqesh të lidhura me proceset e BQK-së, personelin, teknologjinë dhe infrastrukturën si dhe faktorët e tjerë të jashtëm përveç rrezikut kreditor, të tregut dhe likuiditetit siç janë kërkesat ligjore dhe rregullative si dhe standardet e pranuar gjerësisht të sjelljes korporative. Rreziku operacional rrjedh nga të gjitha operacionet e BQK-së dhe prek të gjitha njësitë organizative.

Objekti i BQK-së është të menaxhojë rrezikun operacional si dhe të balancojë evitimin e humbjeve financiare dhe dëmtimin e reputacionit të BQK-së me administrimin efektiv të kostove.

Përgjegjësia kryesore për zhvillimin dhe implementimin e kontrolleve për monitorimin e rrezikut operacional i përket stafit menaxhues të çdo njësie organizative. Kjo përgjegjësi shoqërohet me respektimin e të gjitha standardeve të BQK-së për menaxhimin e rrezikut operacional në fushat e mëposhtme:

- kërkesat për ndarjen e detyrave dhe përgjegjësi, duke përfshirë këtu edhe autorizimin e pavarur të transaksioneve;
- kërkesat për vlerësime dhe monitorime të transaksioneve;
- përshtatshmëria me kërkesat rregullative dhe ligjore;
- dokumentimi i kontrolleve dhe procedurave;
- kërkesat për vlerësimin periodik të rrezikut operacional dhe përshtatshmërisë së kontrolleve dhe procedurave për menaxhimin e këtij rreziku;
- kërkesat për raportimin e humbjeve operative dhe propozimit të veprimeve korigjuese;
- zhvillimin e planeve emergjente;
- trajnimin dhe zhvillimin profesional;
- standardet etike dhe të mirësjelljes;
- zvogëlimin të rrezikut, duke përfshirë dhe sigurimin kur kjo është efektive.

Përshtatshmëria me standardet e BQK-së mbështetet nga një program kontrollesh periodike të ndërmarra nga Auditimi i brendshëm. Gjetjet e kontrolleve të Auditimit të brendshëm diskutohen me menaxherët e njësisë organizative me të cilat ato janë të lidhura dhe konkluzionet i dërgohen Komitetit të Auditimit dhe menaxhmentit të BQK-së.

# Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

## Shënime mbi pasqyrat financiare

(në mijë Euro, nëse nuk është shënuar ndryshe)

### 4. Menaxhim i rrezikut financiar (në vazhdim)

#### (f) Menaxhimi i kapitalit

Ligji nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, i miratuar më datën 22 korrik 2010 nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, përcakton kërkesat e kapitalit të BQK-së. Sipas këtij ligji, kapitali i autorizuar i BQK-së është 30 milionë Euro. Kapitali mund të rritet me shuma të tilla siç propozohet nga BQK dhe aprovet nga Qeveria. Asnjë reduktim i kapitalit të BQK-së nuk do të lejohet në asnjë kohë

Sipas Ligjit nr. 03/L-209, të ardhurat neto ose humbja neto e BQK-së llogariten në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Nga të ardhurat neto duke hequr gjithsej shumën e fitimeve të perealizuara të rivlerësimit, nxirren fitimet e disponueshme për shpërndarje (sipas nenit 56 të ligjit të lartpërmendur).

Të ardhurat neto shpërndahen çdo vit në rezervën të përgjithshme derisa shuma totale e kapitalit fillestar dhe rezervat e përgjithshme barazohen me pesë përqind (5%) të detyrimeve monetare të Bankës Qendrore.

Pjesa prej 50% e bilancit neto të të ardhurave të realizuara që mbeten pas përmbushjes së kriterit të 5% të përmendur më lart, duhet t'i transferohet Ministrisë së Ekonomisë dhe Financës. Ndërsa 50% që mbetet nga të ardhurat e realizuar duhet t'i alokohet llogarisë së rezervës së përgjithshme të BQK-së.

### 5. Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve

Menaxhmenti diskuton me Bordin e Bankës Qendrore zhvillimin, zgjedhjen dhe paraqitjen e politikave dhe vlerësimeve kritike kontabël të BQK-së, dhe aplikimin e këtyre politikave dhe vlerësimeve. Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në eksperiencën historike dhe faktorë të tjerë, duke përfshirë pritshmëritë e ngjarjeve të ardhshme të cilat besohet të jenë të arsyeshme në rrethana të caktuara.

Këto shënime shpjeguese mbështesin komentet mbi menaxhimin e rrezikut financiar (shi shënimin 4).

### Burimet kryesore të pasigurisë në matje

#### Lejimet për humbjet kreditore

Mjetet e regjistruara me kosto të amortizuar vlerësohen për të identifikuar rënien në vlerë të aktivit, në bazë të politikave të përshkruara në 3(f)(vi). Përbërësi specifik në totalin e provizioneve për rënie në vlerë të mjeteve financiare të vlerësuara individualisht, bazohet në vlerësimin më të mirë të rrjedhjeve të pritshme të parasë. Për të llogaritur këto rrjedhje të parave menaxhmenti i BQK-së gjykon mbi situatën financiare të palës në transaksion dhe vlerës neto të realizueshme të çdo kolaterali të vendosur. Çdo aktiv me rënie në vlerë, matet bazuar mbi cilësitë e tij, dhe llogaritja e rrjedhjeve të parasë që konsiderohen të arkëtueshme aprovet në mënyrë të pavarur nga menaxhmenti.

#### Gjykime kritike kontabël në aplikimin e politikave kontabël të BQK-së

Gjykimet kritike kontabël të kryera gjatë aplikimit të politikave kontabël të BQK-së përfshijnë:

#### Klasifikimi i mjeteve dhe detyrimeve financiare

Politikat kontabël të BQK-së krijojnë mundësinë që aktivet dhe detyrimet të vendosen që në fillim në kategori të ndryshme kontabël sipas rrethanave të caktuara.

Në klasifikimin e aktiveve si të mbajtura deri në maturim, BQK-ja ka treguar se ka qëllimin pozitiv dhe aftësinë për ti mbajtur mjetet deri në datën e maturimit, siç kërkohet nga politikat kontabël 3 (h).

# Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

## Shënime mbi pasqyrat financiare

(në mijë Euro, nëse nuk është shënuar ndryshe)

### 6. Mjetet dhe detyrimet financiare (klasifikimet kontabël dhe vlerat e drejta)

Tabela më poshtë paraqet klasifikimin për çdo klasë të aktiveve dhe detyrimeve financiare të BQK-së, si dhe vlerat e drejta të tyre.

<i>Në mijë Euro</i>	Shënim	Kredi dhe llogari të arkëtueshme	Të mbajtura deri në maturim	Të tjera me kosto të amortizuar	Vlera totale e mbartur	Vlera e drejtë
<b>31 dhjetor 2012</b>						
Paraja e gatshme	7	16,761	-	-	16,761	16,761
Llogaritë rrjedhëse me bankat e huaja	8	99,549	-	-	99,549	99,549
Bono thesari	9	-	285,983	-	285,983	285,984
Depozita me bankat e huaja	10	821,590	-	-	821,590	821,590
Aktive me FMN	11	245,401	-	-	245,401	245,401
		<b>1,183,301</b>	<b>285,983</b>	<b>-</b>	<b>1,469,284</b>	<b>1,469,285</b>
Detyrime ndaj bankave vendase	15	-	-	302,147	302,147	302,147
Detyrime ndaj llogarive të ndërlidhura me FMN	16	-	-	246,890	246,890	246,890
Detyrime ndaj institucioneve qeveritare	17	-	-	821,509	821,509	821,509
Detyrime ndaj entiteteve tregtare dhe publike	18	-	-	49,023	49,023	49,023
Detyrime të tjera vendase	19	-	-	2,428	2,428	2,428
		-	-	<b>1,421,997</b>	<b>1,421,997</b>	<b>1,421,997</b>
<i>Në mijë Euro</i>						
<b>31 dhjetor 2011</b>						
Paraja e gatshme	7	13,456	-	-	13,456	13,456
Llogaritë rrjedhëse me bankat e huaja	8	31,513	-	-	31,513	31,513
Bono thesari	9	-	24,988	-	24,988	24,990
Depozita me bankat e huaja	10	1,009,046	-	-	1,009,046	1,009,046
	11	155,687	-	-	155,687	155,687
		<b>1,209,702</b>	<b>24,988</b>	<b>-</b>	<b>1,234,690</b>	<b>1,234,692</b>
Detyrime ndaj bankave vendase	15	-	-	209,700	209,700	209,700
Detyrime ndaj llogarive të ndërlidhura me FMN	16	-	-	156,509	156,509	156,509
Detyrime ndaj institucioneve qeveritare	17	-	-	782,178	782,178	782,178
Detyrime ndaj entiteteve tregtare dhe publike	18	-	-	37,059	37,059	37,059
Detyrime të tjera vendase	19	-	-	2,427	2,427	2,427
		-	-	<b>1,187,873</b>	<b>1,187,873</b>	<b>1,187,873</b>

# Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

## Shënime mbi pasqyrat financiare

(në mijë Euro, nëse nuk është shënuar ndryshe)

### 7. Paraja e gatshme

Paraja e gatshme shprehet e gjitha në Euro.

### 8. Llogaritë rrjedhëse me bankat e huaja

Këto llogari mbahen në bankat e mëposhtme:

	2012	2011
Deutsche Bundesbank	40,240	30,961
Raiffeisen Zentralbank	650	61
Commerzbank	-	481
Banque De France	1,050	-
Deutsche Bank	17,264	10
Banque centrale du Luxembourg	40,345	-
<b>Gjithsej</b>	<b>99,549</b>	<b>31,513</b>

Të gjitha llogaritë rrjedhëse kanë një vlerësim kreditor prej dhe mbi A-1/P-1, sipas vlerësimit të vitit 2012 të bërë më 31 dhjetor 2012 nga Standard & Poors/Moody's.

### 9. Bono thesari

Bonot e thesarit janë letra të borxhit qeveritar nga vendet e Bashkimit Evropian. Ato kanë maturitetet deri në dymbëdhjetë muaj dhe janë për t'u mbajtur deri në maturim. Të gjitha bonot janë në Euro dhe kanë norma efektive interesi nga 0.005% deri në 2.131% vjetore (2011: 0.35% deri në 1.20%).

Bonot e thesarit lëshohen nga qeveritë e vendeve të Bashkimit Evropian si më poshtë:

	2012	2011
Italia	39,994	-
Belgjika	245,989	24,988
<b>Gjithsej</b>	<b>285,983</b>	<b>24,988</b>

BQK-ja investon në bono thesari me një vlerësim minimal kreditor prej A-2u dhe P-2, sipas vlerësimit sipas Standard & Poor's / Moody's.

# Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

## Shënime mbi pasqyrat financiare

(në mijë Euro, nëse nuk është shënuar ndryshe)

### 10. Depozita me bankat huaja

Depozitat me bankat huaja janë të përbëra si më poshtë:

	2012	2011
<b>Depozitat e afatizuara</b>		
Raiffeisen Zentralbank	162,000	129,200
Svenska Handelsbanken	110,004	36,000
ING Bank	85,579	120,664
Deutsche Bundesbank	50,000	80,000
KBC	-	87,334
Rabobank	161,204	132,555
Danske Bank	-	98,534
Banque de France	-	165,755
Banque Centrale du Luxembourg	167,711	157,279
Deutsche Bank	85,000	-
	<b>821,498</b>	<b>1,007,321</b>
<b>Interesi i përlogaritur në depozitat e afatizuara</b>		
Raiffeisen Zentralbank	5	434
Svenska Handelsbanken	23	185
ING Bank	33	387
Deutsche Bundesbank	-	9
KBC	-	186
Rabobank	-	140
Danske Bank	-	1
Banque de France	-	354
Banque Centrale du Luxembourg	2	29
Deutsche Bank	29	-
	<b>92</b>	<b>1,725</b>
<b>Gjithsej</b>	<b>821,590</b>	<b>1,009,046</b>

### 11. Depozitat me bankat e huaja

Depozitat e vendosura me bankat e huaja janë të përcaktuara në Euro dhe fitojnë interes me normë efektive që varion nga 0.005% në 0.85% (2011: 0.05% në 1.68% vjetore) si dhe kanë maturitet fillestar nga 1 në 367 ditë (2011: nga 1 në 367 ditë). Të gjitha depozitat kanë një vlerësim kreditor prej A-1/P-1, sipas vlerësimit të bërë në dhjetor 2012 nga Standard & Poors/Moody's.

# Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

## Shënime mbi pasqyrat financiare

(në mijë Euro, nëse nuk është shënuar ndryshe)

### 12. Mjete ne llogarit e ndërlidhura me FMN

	2012	2011
Kuota e FMN-së	68,784	70,006
Titujt DVT	63,348	65,149
Interesi i përllogaritur	211	68
<b>FMN</b>	<b>132,343</b>	<b>135,223</b>
<b>Qeveria</b>		
Kërkesa nga Qeveria e Kosovës për shfrytëzimin e fondeve të FMN-së (SBA)	113,058	20,464
<b>Gjithsej</b>	<b>245,401</b>	<b>155,687</b>

Mjetet e listuara më sipër lidhen me pranimin e Kosovës në FMN në qershor të vitit 2009. Në lidhje me anëtarësimin e Kosovës në FMN, BQK-ja vepron si depozitues dhe agjent fiskal. Kjo është në përputhje me Ligjin nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës dhe Ligjin nr. 03-L-152 për Anëtarësimin e Republikës së Kosovës në Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe Organizatat e Grupit të Bankës Botërore.

Kuota në FMN përfaqëson kuotën e regjistrimit që është përcaktuar në kohën e pranimin dhe është e shprehur në DVT (e shpalosur më lartë në ekuivalent të Euros) dhe shuma përcaktohet në bazë të rregullave të FMN-së.

Titujt DVT përfaqësojnë aktive të aprovuara nga Bordi i Guvernatorëve të FMN-së sipas alokimeve DVT ndaj vendeve anëtare të FMN-së (vendime të marra më 28 gusht 2009 dhe 9 shtator 2009). Titujt DVT përfitojnë norma vjetore të interesit në vitin 2012 të cilat variojnë nga 0.06% në 0.16% vjetore (2011: 0.11% - 1.55% vjetore).

Kërkesa nga Qeveria për shfrytëzimin e fondeve të FMN-së përfaqësojnë si detyrime ndaj Qeverisë që rrjedhin nga nënshkrimi i Marrëveshjes së linjës në shfrytëzim (Stand-by Arrangement) ndërmjet Qeverisë së Kosovës dhe FMN-së në qershor të vitit 2010 dhe 2012, me anë të së cilës Qeveria e Kosovës ka përfituar nga FMN një linjë të shfrytëzimit të mjeteve në përputhje me marrëveshjen në fjalë në total prej 109.7 milion DVT (127.9 milion Euro). Norma e interesit të kësaj marrëveshje është e lidhur me normën e interesit sipas kushteve të tregut të normës bazë të interesit të vendosur nga FMN-ja, e cila vetë është e lidhur me normën e interesit të DVT-ve. Norma e interesit për vitin 2012 lëviz mesatarisht nga 1.06% deri në 1.16% vjetore (prej gushtit 2011 deri më 31 dhjetor 2011 ka lëvizur nga 1.11% deri në 1.55%).

Saldo e tërhequr nga Qeveria e Kosovës nga marrëveshja në fjalë (SBA) me FMN-në më 31 dhjetor 2011 dhe tri pjesët tjera gjatë vitit 2012 është rreth 97 milion DTV (113 milion Euro). BQK-ja vepron si institucion depozitues për Qeverinë e Kosovës. Për të rregulluar këtë marrëveshje me FMN-në, BQK-ja dhe Qeveria e Kosovës kanë arritur një marrëveshje në korrik 2010 dhe prill 2012 “mbi procedurat për kërkesë, pranim dhe ri-blerje të fondeve nga FMN-ja sipas kushteve të marrëveshjes (Stand-By Arrangement). Bazuar në këtë marrëveshje BQK-ja tërheq DVT-të nga FMN-ja në emër të Qeverisë dhe i krediton këto fonde në llogarinë e Qeverisë.

# Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

## Shënime mbi pasqyrat financiare

(në mijë Euro, nëse nuk është shënuar ndryshe)

### 12. Prona dhe pajisjet

Prona dhe pajisjet përbëhen si më poshtë:

	Investimet në objektet me qira	Pajisje	Kompjuterë	Automjet e	Aktivët në ndërtim	Gjithsej
<b>Kosto</b>						
<b>Gjendja më 1 janar 2011</b>	1,279	1,566	846	286	9	3,986
Blerje	-	31	119	-	184	334
Nxjerrje jashtë përdorimit	-	(279)	(162)	-	-	(441)
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2011</b>	<b>1,279</b>	<b>1,318</b>	<b>803</b>	<b>286</b>	<b>193</b>	<b>3,879</b>
<b>Gjendja më 1 janar 2012</b>	1,279	1,318	803	286	193	3,879
Blerje	106	41	27	-	-	174
Gjendja më 31 dhjetor	165	-	28	-	(193)	-
Gjendja më 31 dhjetor	-	-	-	(44)	-	(44)
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2012</b>	<b>1,550</b>	<b>1,359</b>	<b>858</b>	<b>242</b>	<b>-</b>	<b>4,010</b>
<b>Zhvlerësimi</b>						
<b>Gjendja më 1 janar 2011</b>	256	1,220	664	121	-	2,261
Zhvlerësimi i vitit	64	233	133	54	-	484
Nxjerrje jashtë përdorimit	-	(279)	(163)	-	-	(442)
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2011</b>	<b>320</b>	<b>1,174</b>	<b>634</b>	<b>175</b>	<b>-</b>	<b>2,303</b>
<b>Gjendja më 1 janar 2012</b>	320	1,174	634	175	-	2,303
Zhvlerësimi i vitit	71	66	117	46	-	300
Nxjerrje jashtë përdorimit	-	-	-	(44)	-	(44)
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2012</b>	<b>391</b>	<b>1,240</b>	<b>751</b>	<b>177</b>	<b>-</b>	<b>2,559</b>
<b>Vlera bartëse</b>						
<b>Gjendja më 1 janar 2011</b>	<b>1,023</b>	<b>346</b>	<b>182</b>	<b>165</b>	<b>9</b>	<b>1,725</b>
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2012</b>	<b>959</b>	<b>144</b>	<b>169</b>	<b>111</b>	<b>193</b>	<b>1,576</b>
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2012</b>	<b>1,159</b>	<b>119</b>	<b>107</b>	<b>65</b>	<b>-</b>	<b>1,450</b>

Nuk ka mjete të bllokuara si kolaterale më 31 dhjetor 2012 (31 dhjetor 2011: asnjë).

# Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

## Shënime mbi pasqyrat financiare

(në mijë Euro, nëse nuk është shënuar ndryshe)

### 13. Mjetet e paprekshme

Mjetet e paprekshme përbëhen si më poshtë:

	Programe kompjuterike në zhvillim	Programe kompjuterike	Gjithsej
<b>Kosto</b>			
<b>Gjendja më 1 janar 2011</b>	826	1,194	2,020
Blerje	620	118	738
Transfere (nga)/për	(800)	800	-
Nxjerrje jashtë përdorimit	-	(177)	(177)
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2011</b>	<b>646</b>	<b>1,935</b>	<b>2,581</b>
<b>Gjendja më 1 janar 2012</b>	646	1,935	2,581
Blerje	-	101	101
Transfere të programeve kompjuterike	(621)	621	-
Nxjerrje jashtë përdorimit	-	-	-
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2012</b>	<b>25</b>	<b>2,657</b>	<b>2,682</b>
<b>Amortizimi</b>			
<b>Gjendja më 1 janar 2011</b>	-	1,111	1,111
Amortizimi për vitin	-	141	141
Nxjerrje jashtë përdorimit	-	(177)	(177)
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2011</b>	-	<b>1,075</b>	<b>1,075</b>
<b>Gjendja më 1 janar 2012</b>	-	1,075	1,075
Amortizimi për vitin	-	182	182
Nxjerrje jashtë përdorimit	-	-	-
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2011</b>	-	<b>1,257</b>	<b>1,257</b>
<b>Shumat e bartura</b>			
<b>Gjendja më 1 janar 2011</b>	<b>826</b>	<b>83</b>	<b>909</b>
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2012</b>	<b>646</b>	<b>860</b>	<b>1,506</b>
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2012</b>	<b>25</b>	<b>1,400</b>	<b>1,425</b>

### 14. Mjete tjera

Mjetet e tjera përbëhen si më poshtë:

	2012	2011
Të ardhura të përlogaritura nga tarifat	390	371
Llogari të arkëtueshme dhe parapagime	72	75
<b>Gjithsej</b>	<b>462</b>	<b>446</b>

Të ardhura të përlogaritura nga tarifat paraqesin vlerësimet për tarifat nga ripërtëritja e licencave dhe tarifa të tjera nga institucionet financiare vendore për tremujorin e fundit.

# Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

## Shënime mbi pasqyrat financiare

(në mijë Euro, nëse nuk është shënuar ndryshe)

### 15. Detyrime ndaj bankave ne vendë

Sipas Rregullës XVII të BQK-së për mbikëqyrjen bankare, bankat komerciale që operojnë në Kosovë janë të detyruara të mbajnë rezerva të likuiditetit në shumën prej 10% të depozitave të kualifikuara të klientëve të tyre. Së paku gjysma e kësaj rezerve duhet të mbahet në llogari në BQK.

BQK paguan interes për mjetet e bankave komerciale që mbahen në llogari te ajo deri në shumën e përcaktuar me minimumin e rezervave të detyrueshme. Nuk paguhet interes nga BQK-ja ndaj bankave tregtare për shumat e mbajtura në BQK mbi minimumin e kërkuar të kapitalit. Norma vjetore e interesit gjate vitit që u mbyll më 31 dhjetor 2012 ishte 0.00% (31 dhjetor 2011: 0.10%).

### Detyrime ndaj bankave vendase

	2012	2011
ProCredit Bank Kosovë	29,605	29,255
Raiffeisen Bank Kosovë	25,332	28,314
NLB Prishtina	15,613	12,062
Banka Ekonomike e Prishtinës	5,887	5,356
Banka për Biznes	4,188	3,713
Banka Kombëtare Tregtare	8,465	4,674
Banka Ekonomike Turke - TEB	12,052	8,553
Komercijalna Banka – Dega Mitrovicë	1,955	1,774
<b>Gjithsej rezerva e kërkuar</b>	<b>103,097</b>	<b>93,701</b>

### Shuma shtesë mbi rezervën e kërkuar

ProCredit Bank Kosovë	65,204	35,547
Raiffeisen Bank Kosovë	11,078	9,775
NLB Prishtina	35,843	8,105
Banka Ekonomike e Prishtinës	18,770	21,220
Banka për Biznes	16,540	25,630
Banka Kombëtare Tregtare	28,092	4,900
Banka Ekonomike Turke	14,617	8,992
Komercijalna Banka – Dega Mitrovicë	1,872	1,816
Turkiye is Bankasi a.s.	6,999	-
Banka Kreditore e Prishtinës	35	14
<b>Gjithsej shtesa në llogaritë rrjedhëse</b>	<b>199,050</b>	<b>115,999</b>
<b>Gjithsej</b>	<b>302,147</b>	<b>209,700</b>

# Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

## Shënime mbi pasqyrat financiare

(në mijë Euro, nëse nuk është shënuar ndryshe)

### 16. Detyrime ndaj llogarive të ndërlidhura me FMN

	2012	2011
FMN Llogaria nr. 1	172	175
FMN Llogaria nr. 2	6	5
FMN Llogaria e letrave me vlerë	165,156	73,488
FMN DVT Shpërndarja	64,550	65,697
Interesi i përllogaritur	211	68
<b>Gjithsej detyrimi ndaj FMN</b>	<b>230,095</b>	<b>139,433</b>
<b>Detyrimi ndaj Qeverisë</b>		
FMN- Pjesa e kuotës e paguar nga Qeveria	16,795	17,076
<b>Gjithsej detyrimi ndaj Qeverisë</b>	<b>16,795</b>	<b>17,076</b>
<b>Gjithsej</b>	<b>246,890</b>	<b>156,509</b>

Vlerat e mësipërme lidhen me pranimin e Kosovës në FMN në qershor 2009.

Llogaritë nr.1 dhe nr.2 janë llogari të FMN-së në BQK që janë hapur sipas kërkesave të bazuara në rregullat dhe rregulloret e FMN-së.

Llogaria e letrave me vlerë të FMN-së paraqet një lloj dëftese të borxhit (note e pagueshme), të cilën Qeveria e Kosovës duhet ta paguaj, sipas kërkesës së FMN-së. Kjo shumë paraqet detyrimin BQK-së ndaj FMN-së dhe përputhet me kërkesën korresponduese të BQK-së tek Qeveria e Kosovës.

Pjesa e paguar në FMN e kuotës nga Qeveria e Kosovës, paraqet shumën që Qeveria e Kosovës ia ka paguar FMN-së në emër të kuotës së FMN-së.

Shpërndarja DVT-ve paraqet shpërndarjet e DVT-ve në shtetet anëtare të FMN-së, që është aprovuar nga Bordi i Guvernatorëve të FMN-së më 28 gusht 2009 dhe 9 shtator 2009.

Shpërndarjet e DVT-ve dhe pjesa e paguar e kuotës janë interese që përmbajnë norma vjetore interesi mesatar nga 0.06% - 0.16% për vitin 2012 (2010: 0.11% - 0.55% vjetore).

# Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

## Shënime mbi pasqyrat financiare

(në mijë Euro, nëse nuk është shënuar ndryshe)

### 17. Detyrimet ndaj institucioneve qeveritare

Detyrimet ndaj institucioneve qeveritare përfshijnë llogaritë rrjedhëse si më poshtë:

	2012	2011
<b>Llogaritë rrjedhëse</b>		
Thesari - Ministria e Financave	73,697	89,326
Agjencia Kosovare e Privatizimit	549,403	265,310
Institucionet e përkohshme administrative	407	729
<b>Gjithsej llogaritë rrjedhëse</b>	<b>623,507</b>	<b>355,365</b>
<b>Depozita me afat</b>		
Thesari - Ministria e Financave	152,007	105,042
Agjencia Kosovare e Privatizimit	-	321,771
<b>Gjithsej depozitat me afat</b>	<b>152,007</b>	<b>426,813</b>
<b>Letra me vlerë</b>		
Thesari - Ministria e Financave	45,995	-
<b>Gjithsej letra me vlerë</b>	<b>45,995</b>	<b>-</b>
<b>Gjithsej</b>	<b>821,509</b>	<b>782,178</b>

Norma efektive e interesit për llogaritë rrjedhëse për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2012 është 0.00% (për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2011: 0.10% vjetore). Për depozitat me afat normat e interesit efektiv për vitin 2012 lëvizin nga 0.01% - 0.85% (2011: 0.25% - 1.53% vjetore).

### 18. Detyrime ndaj entiteteve tregtare dhe publike

	2012	2011
<b>Llogaritë rrjedhëse</b>		
Kompanitë e sigurimeve	4,227	6,938
Institucionet tjera publike	44,725	30,050
Fondet e licencuara pensionale	68	68
Të tjera	3	3
	<b>49,023</b>	<b>37,059</b>

Norma efektive e interesit për llogaritë rrjedhëse më 31 dhjetor 2012 është 0.00% (31 dhjetor 2011: 0.10% vjetore).

### 19. Detyrime të tjera vendase

	2012	2011
Llogari në përkujdesje	2,428	2,427
Të ardhura të shtyra nga grantet	590	595
Të ardhurat tjera të shtyra	76	62
Kreditorë të ndryshëm	195	242
Të ardhura dhe detyrime tjera të shtyra	-	11
	<b>3,289</b>	<b>3,337</b>

# Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

## Shënime mbi pasqyrat financiare

(në mijë Euro, nëse nuk është shënuar ndryshe)

### 19. Detyrime të tjera vendase (në vazhdim)

Bilanci i llogarive në përkujdesje përbëhet nga këto lloje të llogarive dhe shumave.

Shuma prej 1,135 Euro paraqet shumat e qerasë të mbledhura nga BQK-ja deri më 5 janar 2004 në emër të Qeverisë së Kosovës për zyrat e ish-bankës kombëtare të Kosovës, të cilat i ishin lëshuar me qira subjekteve të ndryshme/individëve. Kjo shumë përfshinë edhe interesin e fituar nga këto pagesa të qirasë deri më 31 dhjetor 2012.

Të përfshira në llogaritë e sigurta të kujdestarisë janë edhe disa shuma parash, në monedha të ndryshme dhe aktive të tjera, që BQK-ja i ka trashëguar që nga krijimi, nga Banka Popullore Kosovës dhe interesin e fituar mbi to përgjatë viteve.

Po ashtu në kuadër të llogarive në përkujdesje janë të përfshira edhe 756 mijë Euro, që ndërlidhen me procesin e likuidimit të kompanisë së Sigurimeve Kosova e cila është likuiduar në prill të vitit 2010.

Lëvizjet në të hyrat nga grantet janë si vijon:

	<b>Ministria e Financave</b>	<b>Banka Botërore</b>	<b>ECB</b>	<b>Gjithsej</b>
Të hyrat e shtyra nga grantet më 1 janar 2011	5	-	-	5
Grante të pranuar gjatë vitit	606	11	17	634
Të ardhurat nga grantet për vitin	(16)	(11)	(17)	(44)
<b>Të hyrat e shtyra nga grantet më 31 dhjetor 2011</b>	<b>595</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>595</b>
Të hyrat e shtyra nga grantet më 1 janar 2012	595	-	-	595
Grante të pranuar gjatë vitit	12	36	2	50
Të ardhurat nga grantet për vitin	(52)	(1)	(2)	(55)
<b>Të hyrat e shtyra nga grantet më 31 dhjetor 2012</b>	<b>555</b>	<b>35</b>	<b>-</b>	<b>590</b>

### 20. Kapitali i autorizuar

Kapitali i Autorizuar i BQK-së më 31 Dhjetor 2012 dhe 2011 është 30,000 Euro sipas Ligjit nr. 03/L-209 të miratuar më 22 korrik 2010.

BQK i raporton direkt Kuvendit të Kosovës. Kapitali i BQK-së nuk i nënshtrohet ndonjë detyrimi.

### 21. Fondi rezervë

Niveli i rezervave të përgjithshme rregullohet me Ligjin nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës. Fitimi neto i çdo viti financiar, shpërndahet si përshkruhet në shënimin 4 (f) në përputhje me këtë ligj.

# Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

## Shënime mbi pasqyrat financiare

(në mijë Euro, nëse nuk është shënuar ndryshe)

### 22. Të ardhura nga interesi, neto

Të ardhurat nga interesi, neto përbëhen si më poshtë:

	2012	2011
<b>Të ardhura nga interesi</b>		
Nga plasmanët ne tregun e parasë	2,398	8,943
Nga bonot e thesarit	269	696
Nga llogaritë rrjedhëse	119	440
	<b>2,786</b>	<b>10,079</b>
<b>Shpenzimet e interesit</b>		
Në llogaritë rrjedhëse të entiteteve jo-bankare	255	870
Në llogaritë rrjedhëse të bankave	73	598
Në depozitat me afat	1,442	6,117
	<b>1,770</b>	<b>7,585</b>
<b>Të ardhura nga interesi, neto</b>	<b>1,016</b>	<b>2,494</b>

### 23. Të ardhura nga tarifa dhe komisione, neto

Të ardhurat nga tarifa dhe komisione (ndalesa), neto përbëhen si më poshtë:

	2012	2011
<b>Të ardhura nga tarifaf</b>		
Nga depozitime parash	463	372
Nga transfertat e jashtme hyrëse	32	68
Nga transfertat e jashtme dalëse	203	238
Nga sistemi kliringut ndërbankar	321	281
Nga sistemi i regjistrimit të kredive	135	158
Nga menaxhimi i fondeve të thesarit	721	1,500
Tarifaf e tjera	39	34
	<b>1,914</b>	<b>2,651</b>
<b>Shpenzimet nga tarifaf</b>		
Për transport parash	350	259
Për transaksione me bankat korrespondente	35	31
Ngarkesat për dënime	3	-
	<b>388</b>	<b>290</b>
<b>Të ardhura neto nga tarifaf dhe komisionet,</b>	<b>1,526</b>	<b>2,361</b>

Të ardhurat nga menaxhimi i fondit të thesarit rrjedhin nga shërbimet e menaxhimit të mjeteve të Thesarit të Ministrisë së Financave. Këto shërbime janë në përputhje me Ligjin për BQK-në.

# Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

## Shënime mbi pasqyrat financiare

(në mijë Euro, nëse nuk është shënuar ndryshe)

### 24. Të ardhura nga grantet

Të ardhurat nga grantet përbëhen si më poshtë:

	2012	2011
Banka Qendrore Evropiane ("BQE")	2	17
Banka Botërore	1	11
Ministria e Ekonomisë dhe e Financave	52	16
<b>Gjithsej</b>	<b>55</b>	<b>44</b>

### 25. Të ardhura operative të tjera

Të ardhurat të tjera operative përfshijnë kryesisht tarifa të vendosura ndaj institucioneve financiare në Kosovë si pjesë e lëshimit dhe ripërtëritjes së licencave, po ashtu edhe tarifa tjera të detyrueshme që kanë të bëjnë me aktivitetet e tyre.

Të ardhurat e tjera operative përbëhen si më poshtë

	2012	2011
Tarifa ngarkuar për kompanitë e sigurimit	1,017	938
Tarifa ngarkuar për bankat tregtare	599	611
Tarifa nga institucionet financiare jo-bankare	62	67
Tarifa nga ripërtëritja e pensioneve	27	-
Te ardhura tjera	24	4
<b>Gjithsej</b>	<b>1,729</b>	<b>1,620</b>

### 26. Shpenzimet e personeli

Shpenzimet e personelit përbëhen si më poshtë:

	2012	2011
Pagat dhe tatimet	1,927	1,639
Kontributet pensionale	303	261
Shpenzimet e sigurimit shëndetësor	97	97
Trajnimet e stafit	62	85
Shpenzimet e Bordit të BQK-së	128	132
Të tjera	49	35
<b>Gjithsej</b>	<b>2,566</b>	<b>2,249</b>

Numri i punonjësve në BQK në vitin 2012 ishte 178 (2011: 167).

# Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

## Shënime mbi pasqyrat financiare

(në mijë Euro, nëse nuk është shënuar ndryshe)

### 27. Shpenzime të përgjithshme dhe administrative

Shpenzimet e përgjithshme dhe administrative përbëhen si më poshtë:

	2012	2011
Shpenzimet e sigurimit	201	223
Mirëmbajtje dhe riparime	69	53
Mirëmbajtja e programeve kompjuterik	178	209
Shpenzimet e komunikimit (telefon, teleks, dhe internet)	57	79
Shërbime komunale	84	81
Shpenzimet e auditimit dhe këshillimit	14	20
Shpenzimet sigurisë dhe ruajtjes	78	79
Udhëtime dhe transport	88	95
Shpenzimet e funksionimit të veturave	25	22
Materiale zyre	26	32
Shpenzime për ushqim dhe reprezentacion	72	44
Shpenzimet për artikuj konsumues për kompjuterë dhe pajisje të tjera	41	50
Shpenzimet e publikimit dhe shpenzimet e literaturës	34	41
Të tjera	15	23
<b>Gjithsej</b>	<b>982</b>	<b>1,051</b>

### 28. Fitimi/(humbjet) neto nga këmbimi valutor

Fitimi neto nga kursi i këmbimi valutor është prej 32 mijë Euro për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2012 (2011: humbje prej nga 1,139 mijë) përbëhen nga fitimi / humbja si e ardhur e perealizuara nga kurset e këmbimit që vijnë nga diferencat në këmbimet valutore nga përkthimi i mjeteve dhe detyrimeve të DVT-ve të shprehura në librat e BQK-së

### 29. Paraja dhe ekuivalentët e saj

Paraja dhe ekuivalentët e saj përbëhen si më poshtë:

	Shënim	2012	2011
Paraja e gatshme	7	16,761	13,456
Llogaritë rrjedhëse me bankat e huaja	8	99,549	31,513
Bono thesari me maturitet deri në tre muaj		39,994	-
Depozita me bankat e huaja me maturitet me maturitet deri në tre muaj		540,915	727,244
<b>Gjithsej</b>		<b>697,219</b>	<b>772,213</b>

Paraja dhe ekuivalentët e saj mbahen për qëllim të përmbushjes së detyrimeve të likuiditetit kryesisht afatshkurtër, se sa për investime ose qëllime të tjera. Një investim kualifikohet si ekuivalent i parasë kur ai ka maturim afatshkurtër, më pak se tre muaj nga data e blerjes.

# Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

## Shënime mbi pasqyrat financiare

(në mijë Euro, nëse nuk është shënuar ndryshe)

### 30. Detyrime të kontraktuara dhe kontingjente

#### Ligjore

BQK-ja është e përfshirë në procedura ligjore rutinë që janë në kursin e zakonshëm të veprimitarisë. Është mendimi i menaxhmentit se rezultati përfundimtar i këtyre padive nuk do të ketë një efekt të rëndësishëm në pasqyrat financiare të BQK-së më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2012.

#### Detyrimet te kontraktuara kreditore

Më 31 dhjetor 2012, BQK-ja kishte për detyrim që të vendoste depozita (plasmanë) në shumën e përgjithshme prej 50 milion Euro (31 dhjetor 2011, BQK-ja kishte për detyrim që të vendoste depozita në shumën e përgjithshme prej zero Euro).

#### Detyrime të tjera

Detyrime e tjera përbëhen si vijon:

	2012	2011
Kontrata për pajisje	50	-
Kontrata për shërbime	44	-
<b>Gjithsej</b>	<b>94</b>	<b>-</b>

Në vitin 2009, Kosova u bë anëtare e organizatave të grupit të Bankës Botërore – Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (BNRZH), Shoqata Ndërkombëtare për Zhvillim (SHNZH), si dhe Agjencia për Garantimin e Investimeve Shumëpalëshe (AGISH). Në lidhje me anëtarësimin e Kosovës në Bankën Botërore, BQK-ja vepron si depozitar. Kjo është në përputhje me Ligjin nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës dhe Ligjin nr. 03-L-152 për Anëtarësimin e Republikës së Kosovës në Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe Organizatat e Grupit të Bankës Botërore.

Në qershor 2009, Qeveria e Kosovës lëshoi letra premtimi për të bërë pagesa lidhur me anëtarësimet në agjencitë e Bankës Botërore të lartpërmendura, sipas kërkesës dhe instruksioneve të pagesës së tyre. Shuma totale më 31 dhjetor 2012 dhe 2011 e këtyre letrave të premtimit është 4,007 mijë Euro.

### 31. Veprimet me palët e lidhura

Palët e lidhura përfshijnë menaxhmentin kyç dhe Bordin Bankës Qendrore. Kompensimet e tyre paraqiten më poshtë:

	2012	2011
Kompensimet për anëtarët e Bordit të Bankës Qendrore	120	130
Kompensimet për Komitetin e Auditimit	8	2
Kompensimi për menaxhmentin ekzekutiv	139	103
<b>Gjithsej</b>	<b>267</b>	<b>235</b>

### 32. Ngjarjet pas datës së mbylljes së bilancit

Nuk ka ngjarje të rëndësishme pasuese pas bilancit për të cilat të ketë nevojë për rregullime ose shënime shpjeguese në këto pasqyra financiare.

## 9. Shtojca Statistikore



## 1.1. Pasqyra e korporatave financiare - asetet e jashtme neto dhe kërkesat e brendshme

(Të dhëna kumulative, fundi i periudhës, në milionë euro)

Përshkrimi	Asetet e jashtme neto								Kërkesat e brendshme								
	Kërkesat ndaj jorezidentëve	prej të cilave:						Minus: detyrimet ndaj jorezidentëve	Kërkesat ndaj qeverisë qendrore				Kërkesat ndaj sektorëve tjerë	prej të cilave:			
		Ari monetar dhe DST-të	Depozita	Letrat me vlerë përveç aksioneve	Kuota në FMN	Asetet dhe ekuitetet tjera	Kërkesat ndaj qeverisë qendrore		Minus: detyrimet ndaj qeverisë	Depozita	Kreditë						
											Korp. tjera jofinan.	Ek. familjare					
2005 Dhjetor	827.3	890.9	—	422.6	242.4	—	145.3	63.6	348.9	-225.7	—	225.7	225.7	574.6	565.6	439.6	126.0
2006 Dhjetor	1,173.6	1,245.7	—	660.0	341.3	—	170.8	72.1	231.7	-475.0	—	475.0	475.0	706.6	694.3	548.2	146.1
2007 Dhjetor	1,622.4	1,704.6	—	955.0	408.9	—	175.4	82.3	124.5	-853.3	—	853.3	853.3	977.8	965.9	765.1	200.6
2009 Dhjetor	1,700.5	2,036.2	60.3	910.1	724.5	64.3	144.3	335.7	571.5	-846.3	—	846.3	846.3	1,417.8	1,396.1	1,052.3	343.5
2010 Dhjetor	1,957.5	2,387.7	64.0	1,257.8	525.2	68.5	269.3	430.2	766.8	-824.8	—	824.8	824.8	1,591.6	1,568.3	1,127.7	434.2
2011 Dhjetor	2,080.3	2,454.3	65.1	1,369.2	230.0	70.1	533.1	374.0	989.0	-798.4	—	798.4	798.4	1,787.4	1,761.7	1,244.1	514.6
2012 Dhjetor	2,337.3	2,773.6	63.3	1,260.7	486.0	68.8	666.5	436.3	1,082.4	-764.8	73.7	838.5	838.5	1,847.2	1,819.4	1,271.3	546.3

## 1.2. Pasqyra e korporatave financiare - detyrimet

(Të dhëna kumulative, fundi i periudhës, në milionë euro)

Përshkrimi	Depozitat									Kreditë	Rezerva teknike të sigurimit			Asetet dhe ekuitetet tjera	Zëra tjerë (neto)
	Dep. e transferueshme	prej të cilave:			Dep. tjera prej të cilave:			Ek. neto i ek. familjare ne fondet e pens.	Pagesa e premive dhe rezervave						
		Korp. publike jofinan.	Korp. tjera jofinan.	Ek. familjare	Korp. publike jofinan.	Korp. tjera jofinan.	Ek. familjare								
2005 Dhjetor	830.6	315.0	67.6	76.8	155.5	515.6	181.3	33.7	298.9	3.0	174.5	152.4	22.1	165.8	2.2
2006 Dhjetor	886.4	300.5	34.8	96.4	156.2	586.0	193.3	27.6	359.5	3.4	251.4	223.9	27.5	209.3	54.7
2007 Dhjetor	1,110.9	386.1	49.6	133.5	187.5	724.8	188.4	43.8	489.3	...	316.1	286.2	29.9	273.8	46.0
2008 Dhjetor	1,351.9	390.9	15.4	176.0	186.2	961.0	250.1	51.4	656.7	...	288.6	256.3	32.3	311.1	61.1
2009 Dhjetor	1,444.3	483.2	50.1	184.0	237.7	961.0	73.9	82.9	801.9	...	422.3	380.8	41.5	326.1	79.3
2010 Dhjetor	1,744.2	621.2	83.8	218.6	303.5	1,123.1	42.8	83.4	995.9	...	540.5	493.7	46.8	361.0	78.6
2011 Dhjetor	1,940.2	665.1	75.5	208.1	360.9	1,275.1	60.8	79.7	1,129.6	...	647.8	593.3	54.5	395.1	86.2
2012 Dhjetor	2,094.0	717.5	31.2	257.5	407.2	1,376.5	61.8	78.2	1,232.9	...	814.9	745.1	69.8	399.2	111.5

## 2.1. Pasqyra e korporatave depozituese - asetet e jashtme neto dhe kërkesat e brendshme

(Të dhëna kumulative, fundi i periudhës, në milionë euro)

Përshkrimi	Asetet e jashtme neto							Kërkesat e brendshme								
	Kërkesat ndaj jorez.	prej të cilave:					Minus: Detyrimet ndaj jorez.	Kërkesat neto ndaj qeverisë qendrore	Kërkesat ndaj qeverisë qendrore	Minus: Detyrimet ndaj qev. qendrore	Kërkesat ndaj sektorëve tjerë	prej të cilave:				
		Paraja e gatshme	Dep.	Letrat me vlerë përveç aksioneve	Kuota e FMN-së	Kreditë						Korp. publike financiare	Korp. tjera jofinan.	Ek.familjare		
2001 Dhjetor	583.3	604.8	239.2	358.1	7.5	---	21.5	-44.2	-70.3	---	70.3	26.1	25.9	...	25.9	---
2002 Dhjetor	649.5	674.1	53.1	621.0	...	---	24.6	-171.8	-258.6	---	258.6	86.8	86.5	...	80.8	5.7
2003 Dhjetor	695.8	727.0	73.2	533.6	119.6	---	31.2	-112.6	-346.4	---	346.4	233.8	232.8	...	193.5	39.0
2004 Dhjetor	648.7	687.9	55.3	384.0	236.7	---	39.2	156.9	-216.8	---	216.8	373.8	373.7	...	289.9	83.7
2005 Dhjetor	695.1	744.5	74.6	422.6	242.4	---	49.3	289.0	-225.7	---	225.7	514.6	513.9	...	387.9	126.0
2006 Dhjetor	975.4	1035.6	63.4	660.0	303.1	---	60.2	162.2	-475.0	---	475.0	637.1	636.6	...	490.5	146.1
2007 Dhjetor	1,377.5	1,426.1	145.3	955.0	308.2	---	48.6	39.1	-853.3	---	853.3	892.4	892.1	0.2	691.3	200.6
2008 Dhjetor	1,436.1	1,512.0	121.1	794.9	581.8	---	75.9	311.9	-871.8	---	871.8	1,183.8	1,183.4	0.1	901.7	281.0
2009 Dhjetor	1,531.6	1,782.2	111.4	910.0	626.4	64.3	250.6	442.9	-846.3	---	846.3	1,289.2	1,289.0	0.3	942.9	343.5
2010 Dhjetor	1,616.2	1,957.1	164.3	1,257.8	372.7	68.5	340.9	632.8	-824.8	---	824.8	1,457.5	1,457.1	6.3	1,010.8	434.2
2011 Dhjetor	1,603.8	1,900.3	124.9	1,359.3	227.0	70.1	296.6	867.7	-798.4	---	798.4	1,666.1	1,665.6	1.5	1,139.6	514.6
2012 Dhjetor	1,729.6	2,102.6	141.4	1,260.7	482.8	68.8	373.1	962.9	-778.7	59.9	838.5	1,741.6	1,740.9	1.4	1,172.9	546.3

## Tabela 2.2. Pasqyra e korporatave depozituese - detyrimet

(Të dhëna kumulative, fundi i periudhës, në milionë euro)

Përshkrimi	Dep. e përfshira në parantë e gjere										Dep. jashtë parantë së gjere	Asetet dhe ekuitete tjera	Zëra tjerë (neto)	
	Dep. e transferu ehisme	prej të cilave:				Dep. tjera	prej të cilave:							
		Korp. tjera financiare	Korp. publike jofinan.	Korp. tjera jofinan.	Ek. familjare		Korp. tjera financiare	Korp. publike jofinan.	Korp. tjera jofinan.	Ek. familjare				
2001 Dhjetor	486.8	361.5	.	7.0	135.3	219.2	125.2	.	.	31.3	93.9	12.9	25.2	14.3
2002 Dhjetor	413.6	285.3	.	3.5	160.1	121.7	128.3	.	.	23.9	104.4	25.1	43.8	-4.8
2003 Dhjetor	499.3	278.7	.	5.3	139.0	134.4	220.6	.	.	87.1	133.5	29.2	61.1	-6.4
2004 Dhjetor	719.5	303.5	29.8	34.6	81.3	145.5	416.0	19.1	149.3	24.4	222.5	---	87.1	-1.0
2005 Dhjetor	865.4	345.6	30.5	67.6	76.8	155.5	519.9	24.3	181.3	33.1	279.6	19.9	94.4	4.3
2006 Dhjetor	912.8	336.4	35.9	34.8	96.4	156.2	576.3	30.5	193.3	24.6	322.4	40.6	128.8	55.4
2007 Dhjetor	1,126.6	413.7	27.7	49.6	133.5	187.5	712.8	40.3	188.4	41.8	439.0	53.7	186.5	49.8
2008 Dhjetor	1,393.0	454.6	63.7	15.4	176.0	186.2	938.3	47.6	250.1	44.2	593.8	74.9	233.8	46.4
2009 Dhjetor	1,548.5	621.4	138.2	50.1	184.0	237.7	927.0	60.7	73.9	71.7	718.5	98.1	249.0	79.0
2010 Dhjetor	1,747.9	674.3	53.1	83.8	218.6	303.5	1,073.6	85.2	30.2	73.5	884.7	138.2	278.5	84.4
2011 Dhjetor	1,902.2	705.3	37.8	77.2	208.1	360.9	1,196.9	91.0	49.2	71.7	979.9	175.8	304.3	89.2
2012 Dhjetor	2,036.7	759.4	41.9	31.2	257.5	407.2	1,277.3	100.4	49.8	70.5	1,053.1	206.2	321.7	127.9

Tabela 3.1. Pasqyra e BQK-së - asetet e jashtme neto dhe kërkesat e brendshme

(Të dhëna kumulative, fundi i periudhës, në milionë euro)

Përshkrimi	Asetet e jashtme neto										Kërkesat neto ndaj qev. qendr.	Kërkesat ndaj sektorëve tjerë	Detyrimet ndaj KTD-ve
	Kërkesat ndaj jorezidentëve					Mirus: Detyrimet ndaj jorezidentëve							
	prej të cilave:												
DST-të	Paraja e gatshme	Dep.	Letrat me vlerë përveç aksioneve	Kuota e FMN-së	Alokimi i DST-ve	Llogaria e FMN-së							
2001 Dhjetor	293.7	296.2	—	150.8	145.4	—	—	2.6	—	—	-70.3	0.2	173.9
2002 Dhjetor	345.4	345.8	—	17.5	328.3	—	—	0.4	—	—	-258.6	0.3	46.2
2003 Dhjetor	454.3	454.6	—	26.6	427.4	—	—	0.3	—	—	-346.4	1.0	59.6
2004 Dhjetor	344.7	349.9	—	12.1	213.2	124.4	—	5.2	—	—	-216.8	0.1	72.9
2005 Dhjetor	394.4	397.5	—	24.5	213.4	159.5	—	3.1	—	—	-225.7	0.8	82.5
2006 Dhjetor	641.1	641.2	—	11.1	424.9	203.6	—	0.1	—	—	-472.9	0.5	94.5
2007 Dhjetor	1,057.6	1,057.6	—	63.8	759.0	229.3	—	...	—	—	-849.4	0.3	113.6
2008 Dhjetor	1,110.7	1,110.7	—	39.7	529.0	541.3	—	...	...	—	-870.5	0.3	137.2
2009 Dhjetor	1,088.3	1,198.5	60.3	218	522.3	529.7	64.3	110.2	60.3	49.1	-681.5	0.2	233.2
2010 Dhjetor	1,108.0	1,246.9	64.0	60.2	854.4	199.2	68.5	138.9	64.2	73.0	-813.1	0.5	203.6
2011 Dhjetor	1,098.8	1,234.6	65.1	13.5	1,059.3	25.0	70.1	135.8	65.7	69.4	-797.2	0.5	209.7
2012 Dhjetor	1,238.8	1,469.1	63.3	16.8	1,034.1	286.0	68.8	230.3	64.6	165.3	-837.9	0.7	302.1

Tabela 3.2. Pasqyra e BQK-së - detyrimet

(Të dhëna kumulative, fundi i periudhës, në milionë euro)

Përshkrimi	Dep. e përfshira në paranë e gjerë								Dep. e përjashtuara nga paraja e gjerë		Kap. dhe të tjera		prej të cilave:		Zëra tjerë (neto)
	Dep. e transferu eshme				Dep. tjera				Korp. tjera jofinanciare	Qeveria lokale	prej të cilave:				
	prej të cilave:		Korp. tjera financiare		Korp. tjera financiare		Kapitali	Profiti humbja e vitit							
2001 Dhjetor	8.4	8.4	—	—	7.0	—	—	12.9	10.6	2.4	4.7	2.6	1.1	23.6	
2002 Dhjetor	3.9	3.9	—	—	3.5	—	—	25.1	24.6	0.5	10.6	2.6	3.6	1.3	
2003 Dhjetor	5.3	5.3	—	—	5.3	—	—	27.4	25.7	1.7	16.1	2.6	4.5	0.5	
2004 Dhjetor	37.7	32.6	20.7	1.9	9.9	5.1	5.1	—	—	—	18.0	10.0	3.0	-0.6	
2005 Dhjetor	66.6	62.5	23.3	1.6	37.6	4.1	4.1	—	—	—	20.4	10.0	3.0	...	
2006 Dhjetor	49.9	41.9	31.0	0.4	10.5	8.0	8.0	—	—	—	25.5	10.0	6.4	-1.2	
2007 Dhjetor	57.2	46.7	22.4	3.2	21.1	10.6	10.6	—	—	—	33.8	20.0	9.2	3.9	
2008 Dhjetor	63.9	56.7	49.9	5.3	1.5	7.2	7.2	—	—	—	41.4	30.0	7.5	-2.0	
2009 Dhjetor	130.8	130.8	129.7	...	1.1	...	...	—	—	—	44.9	30.0	3.7	-2.0	
2010 Dhjetor	45.6	45.6	43.9	...	0.0	...	...	—	—	—	47.9	30.0	3.0	-1.8	
2011 Dhjetor	39.5	39.5	28.5	...	9.3	...	...	—	—	—	54.3	30.0	5.8	-1.3	
2012 Dhjetor	51.5	51.5	32.4	...	17.4	...	...	—	—	—	50.4	30.0	1.8	-2.4	

Tabela 4.1. Pasqyra e KTD-ve - asetet e jashtme neto dhe kërkesat e brendshme

(Të dhëna kumulative, fundi i periudhës, në milionë euro)

Përshkrimi	Asetet e jashtme neto								Kërk. ndaj BQK-së	Kërk. neto ndaj qeverisë qendrore	Kërkesat ndaj sektorëve tjerë				
	Kërkesat ndaj jorez.	prej të cilave:			Minus: Det. ndaj jorezidentëve	prej të cilave:		Kreditë			Kreditë	prej të cilave:			
		Paraja e gatshme	Dep.	Letrat me vlerë përveç aksioneve		Dep.	Kreditë					Korp. publike jofinan.	Korp. tjera jofinan.	Ek. familjare	
2001 Dhjetor	289.7	308.6	88.3	212.8	7.5	18.9	13.9	5.0	176.8	—	25.9	25.9	—	25.9	—
2002 Dhjetor	304.1	328.3	35.6	292.7	...	24.2	17.5	6.7	45.7	—	86.5	86.5	—	80.8	5.7
2003 Dhjetor	241.5	272.4	46.6	106.2	119.6	31.0	20.0	10.9	59.6	—	232.8	232.8	0.2	193.5	39.0
2004 Dhjetor	304.0	338.0	43.2	170.8	112.3	34.0	12.7	21.3	73.2	—	373.7	373.7	—	289.9	83.7
2005 Dhjetor	300.7	346.9	50.1	209.2	82.9	46.2	18.4	27.9	81.6	—	513.9	513.9	—	387.9	126.0
2006 Dhjetor	334.4	394.5	52.3	235.1	99.4	60.1	21.4	38.7	88.8	(2.1)	636.6	636.6	—	490.5	146.1
2007 Dhjetor	319.9	368.5	81.5	196.0	78.9	48.6	17.9	30.7	107.5	(3.9)	892.1	892.1	0.2	691.3	200.6
2008 Dhjetor	325.4	401.3	81.4	265.9	40.5	75.9	42.0	33.7	136.8	(13)	1,183.4	1,183.4	0.1	901.7	281.0
2009 Dhjetor	443.6	583.9	89.6	387.7	97.0	140.3	65.5	74.5	233.1	(164.9)	1,289.0	1,289.0	0.3	942.9	343.5
2010 Dhjetor	508.1	710.2	104.1	403.3	173.4	202.1	85.5	116.6	203.4	(116)	1,457.1	1,457.1	6.3	1,010.8	434.3
2011 Dhjetor	509.2	665.7	111.5	300.0	202.0	156.5	64.8	90.5	220.0	(12)	1,665.6	1,665.6	1.5	1,139.6	516.1
2012 Dhjetor	490.8	633.6	124.6	226.6	196.8	142.8	87.7	50.2	301.1	59.2	1,740.9	1,740.9	1.4	1,139.6	546.7

Tabela 4.2. Pasqyra e KTD-ve- detyrimet

(Të dhëna kumulative, fundi i periudhës, në milionë euro)

Përshkrimi	Dep. e përfshira në parandë e gjere										Dep. jashtë parandë së gjere	prej të cilave:		Kapital i aksionar dhe tjera	Zëra tjerë (neto)	
	Dep. e transferu eshme	prej të cilave:				Dep. tjera	prej të cilave:					Korp. tjera jofinan.	Ek. familjare			
		Korp. tjera finan.	Korp. publike jofinan.	Korp. tjera jofinan.	Ek. familjare		Korp. tjera finan.	Korp. publike jofinan.	Korp. tjera jofinan.	Ek. familjare						
2001 Dhjetor	478.4	353.1	.	.	133.9	219.2	125.2	.	.	31.3	93.9	.	.	.	20.4	-6.4
2002 Dhjetor	409.7	281.4	.	.	159.7	121.7	128.3	.	.	23.9	104.4	.	.	.	33.2	-6.6
2003 Dhjetor	494.0	273.4	.	.	139.0	134.4	220.6	.	.	87.1	133.5	1.8	1.8	.	45.0	-7.0
2004 Dhjetor	681.9	270.9	9.0	24.7	81.3	145.5	410.9	14.0	149.3	24.4	222.5	0.0	0.0	0.0	69.1	-0.1
2005 Dhjetor	798.8	283.0	7.2	30.0	76.8	155.5	515.8	20.2	181.3	33.1	279.6	19.9	0.7	19.3	74.0	3.4
2006 Dhjetor	862.9	294.5	4.9	24.3	96.4	156.2	568.4	22.5	193.3	24.6	322.4	40.6	3.0	37.1	103.3	50.9
2007 Dhjetor	1,069.3	367.1	5.3	28.5	133.5	187.5	702.3	29.8	188.4	41.8	439.0	53.7	2.0	50.3	152.7	39.8
2008 Dhjetor	1,329.0	397.9	13.8	13.8	176.0	186.2	931.1	40.4	250.1	44.2	593.8	74.9	7.3	63.0	192.3	48.1
2009 Dhjetor	1,417.8	490.6	8.5	48.9	184.0	237.7	927.2	60.8	73.9	71.7	718.5	97.9	11.2	83.5	204.2	81.0
2010 Dhjetor	1,702.3	628.6	9.2	83.8	218.6	303.5	1,073.6	85.2	30.2	73.5	883.7	138.2	9.9	112.2	230.5	86.1
2011 Dhjetor	1,862.7	665.9	10.1	67.9	208.1	360.9	1,196.9	91.0	49.2	71.7	979.9	175.8	8.0	149.7	254.3	100.8
2012 Dhjetor	1,985.3	708.0	9.6	13.8	257.5	407.2	1,277.3	100.4	49.8	70.5	1,053.1	206.2	7.8	179.8	271.4	129.2

Tabela 5.1. Pasqyra e KTF-ve – asetet e jashtme neto

(Të dhëna kumulative, fundi i periudhës, në milionë euro)

Përshkrimi	Asetet e jashtme neto						Kërkesat ndaj korp. deponituese						Kërkesat neto ndaj qeverisë qendrore	Kërkesat ndaj sektorëve tjerë	Kreditë	
	Kërkesat ndaj jorezidentëve		prej të cilave:		Minus: Detyrimet ndaj jorezidentëve	Kreditë	BQK			Korporata tjera deponituese						
			Letrat me vlerë përveç aksioneve	Kapitali aksionar dhe tjera			Dep. e transferu eshme	Dep. tjera	Dep. të transferu eshme	Dep. tjera						
2005 Dhjetor	132.1	146.4	—	145.3	14.3	14.3	54.8	27.4	23.3	4.1	27.4	7.2	20.2	—	60.0	51.7
2006 Dhjetor	198.1	210.0	38.3	170.8	11.9	11.9	66.9	39.0	31.0	8.0	28.0	4.9	23.0	—	69.5	57.7
2007 Dhjetor	244.9	278.5	100.7	175.4	33.6	33.6	72.8	32.9	22.4	10.6	39.8	6.2	33.6	—	85.4	73.8
2008 Dhjetor	157.0	214.7	79.8	128.2	57.7	57.7	113.0	57.1	49.9	7.2	55.9	7.9	48.0	—	108.3	94.0
2009 Dhjetor	168.6	253.8	97.9	144.3	85.1	85.1	200.0	129.7	129.7	...	70.3	7.4	62.9	—	130.8	109.4
2010 Dhjetor	341.3	430.5	152.5	269.3	89.2	89.2	142.8	43.9	43.9	...	98.8	8.2	90.6	—	139.7	116.9
2011 Dhjetor	462.4	544.1	3.1	533.1	81.7	81.7	137.9	27.7	27.7	...	110.4	7.3	103.1	—	128.1	102.5
2012 Dhjetor	607.6	670.8	3.3	666.5	63.2	63.2	147.7	32.4	32.4	...	115.3	9.5	105.8	13.9	122.2	98.3

Tabela 5.2. Pasqyra e KTD-ve – detyrimet, përjashtuar sektorin e jashtëm dhe atë fiskal

(Të dhëna kumulative, fundi i periudhës, në milionë euro)

Përshkrimi	Kreditë	Rezervat teknike të sigurimit				Kapitali aksionar dhe tjera				Zëra tjerë				
		Kap. neto i ek. familjare në rez. e sig. të jetës	Kapitali neto i ek. familjare në fondet pensionale	Parapag. i premive dhe rez. kundrejt kërç. Kum.	Minus: Detyrimet ndaj jorezidentëve	Fondet e kontribuar nga pronarët	Fitimet e pashpërn dara	Rezervat e përgjithshme dhe ato të veçanta	Profiti/humbja vjetore	Detyrime tjera	Minus: asete tjera	Plus: përshtatja e konsolidimit		
2005 Dhjetor	3.0	174.5	—	152.4	22.1	71.4	47.7	12.9	6.7	4.0	-2.1	4.4	6.5	—
2006 Dhjetor	3.4	251.4	—	223.9	27.5	80.5	55.2	15.8	7.9	1.6	-0.7	7.4	8.2	—
2007 Dhjetor	...	316.1	—	286.2	29.9	87.4	62.1	20.1	1.7	3.5	-0.4	9.6	10.0	—
2008 Dhjetor	1.0	288.6	—	256.3	32.3	77.4	54.0	12.7	7.4	3.4	11.3	24.2	12.9	—
2009 Dhjetor	2.9	422.3	...	380.8	41.5	77.0	53.4	19.4	7.2	-3.1	-2.7	13.1	15.8	—
2010 Dhjetor	2.9	540.5	...	493.7	46.8	82.5	59.7	13.6	7.2	2.0	-2.1	20.9	23.1	—
2011 Dhjetor	3.3	647.8	...	593.3	54.5	85.4	60.4	13.3	10.8	0.9	-6.3	16.1	22.4	—
2012 Dhjetor	4.5	806.9	...	745.1	61.8	79.3	60.5	14.6	11.2	-7.0	4.9	28.1	23.2	—

Tabela 6.1. Depozitat në euro në KTD-të – sipas maturitetit fillestar, sektorët kryesor

(Të dhëna kumulative, fundi i periudhës, në milionë euro)

Përshkrimi	Gjithsej depozita në euro														
	Qeveria	Korporatat financiare						Korporatat jofinanciare			Sektorë tjerë vendor		Jorez.		
		Korp. tjera depozituese	Ndërmjet. tjerë finan.	Komp. e sigurimit	Fondet pens.	Ndihm. financiar	Korp. publike jofinan.	Korp. tjera jofinan.	Ek. familjare	OJSHEF					
2001 Dhjetor	492.3	---	---	---	---	---	---	---	165.2	---	165.2	313.1	313.1	---	13.9
2002 Dhjetor	427.2	---	---	---	---	---	---	---	183.6	---	183.6	226.1	226.1	---	17.5
2003 Dhjetor	515.8	---	1.8	1.8	---	---	---	---	226.1	---	226.1	267.9	267.9	---	20.0
2004 Dhjetor	674.9	1.3	25.6	3.7	3.5	15.5	---	2.9	275.3	173.5	10.18	360.3	350.7	9.6	12.3
2005 Dhjetor	815.3	2.9	35.4	8.1	5.8	18.8	---	2.8	319.0	211.3	107.7	440.7	428.7	12.0	17.3
2006 Dhjetor	890.4	7.0	28.1	0.1	2.4	24.7	0.4	0.5	337.8	217.4	120.5	499.2	486.1	13.1	18.2
2007 Dhjetor	1092.0	4.1	39.1	3.1	5.6	28.3	0.4	1.7	386.2	215.5	170.7	647.0	631.9	15.2	15.6
2008 Dhjetor	1366.9	1.4	62.9	5.0	6.5	31.5	19.4	0.4	479.7	263.8	215.9	785.0	774.5	10.5	37.9
2009 Dhjetor	1640.1	165.0	78.2	6.1	5.9	43.1	22.6	0.4	371.5	121.6	249.9	962.2	948.8	13.4	63.2
2010 Dhjetor	1831.1	11.7	105.0	7.3	7.9	47.6	41.6	0.6	414.9	122.3	292.6	1220.1	1206.1	14.0	79.4
2011 Dhjetor	1980.7	2.7	117.5	9.9	6.8	57.2	43.1	0.5	406.6	128.5	278.1	1395.6	1373.4	22.2	60.0
2012 Dhjetor	2,162.8	0.7	120.0	3.8	6.2	64.3	45.3	0.4	401.7	75.6	326.1	1558.6	1535.4	23.2	81.7

Tabela 6.2. Depozitat në jo euro në KTD-të – sipas maturitetit fillestar

(Të dhëna kumulative, fundi i periudhës, në milionë euro)

Përshkrimi	Depozita në jo euro															
	Korporat at financiare prej te cilave:	of which:					Korporat at jofinanciare prej te cilave:			Sektorë tjerë vendor				Jorez.		
		BQK	Korp. tjera depozituese	Ndërm. tjerë financiar	Komp. e sigurimit	Korp. publike jofinan.	Korp. tjera jofinan.	Ek. Familjare prej te cilave:			OJSHEF					
Dep. e transferu eshme	Depozita Kursimi	Dep. tjera														
2005 Dhjetor	29.4	...	---	...	...	...	2.8	---	2.8	26.0	25.7	10.8	---	14.9	0.3	0.5
2006 Dhjetor	34.3	...	---	...	...	...	3.7	0.3	3.5	29.8	29.6	12.4	---	17.2	0.2	0.5
2007 Dhjetor	53.3	0.5	---	...	0.1	0.4	8.1	1.5	6.6	44.3	44.2	16.2	---	28.0	0.1	0.4
2008 Dhjetor	81.9	0.9	---	...	...	0.9	11.6	0.1	11.5	68.4	68.2	22.9	---	45.2	0.3	1.0
2009 Dhjetor	112.1	2.1	---	12	...	0.9	18.3	1.3	17.0	91.1	90.9	29.7	---	61.1	0.2	0.7
2010 Dhjetor	113.8	3.1	---	2.9	---	---	13.7	4.3	9.4	93.8	93.3	33.1	25.9	34.3	0.5	3.1
2011 Dhjetor	131.5	0.3	---	0.3	---	---	9.8	0.1	9.7	117.5	117.0	46.5	31.7	38.9	0.4	3.8
2012 Dhjetor	120.9	1.6	0.0	12	0.2	0.0	9.6	0.0	9.6	104.9	104.7	45.7	27.0	32.0	0.2	4.8

Tabela 6.3. Kreditë e KTD-ve – sipas maturitetit fillestar

(Të dhëna kumulative, fundi i periudhës, në milionë euro)

Përshkrimi	Gjithsej kreditë														Kreditë në valutën jo euro
	Korporatat financiare	prej të cilave:			Korporatat jofinanciare	prej të cilave:					Korporatat tjera vendore	prej të cilave:			
		Ndërmjetshme financiare	Komp. e sigurimit	Korp. publike jofinan.		Korporatat tjera jofinanciare			Ek. familjare						
						Deri në 1 vit	Mbi 1 vit dhe deri në 2 vite	Mbi 2 vite	Deri në 1 vit	Mbi 1 vit dhe deri në 2 vite		Mbi 2 vite			
2001 Dhjetor	25.9	—	—	—	25.9	—	25.9	24.6	1.3	—	—	—	—	—	—
2002 Dhjetor	86.5	—	—	—	80.8	—	80.8	67.3	13.5	—	5.7	5.7	14	4.3	—
2003 Dhjetor	232.8	—	—	—	193.7	0.2	193.5	124.7	68.7	0.2	39.0	39.0	114	16.0	116
2004 Dhjetor	373.7	—	—	—	289.9	...	289.9	111.5	111.3	67.2	83.7	83.7	15.9	15.2	52.6
2005 Dhjetor	513.9	—	—	—	387.9	...	387.9	117.9	125.2	144.7	126.0	126.0	19.5	21.0	85.4
2006 Dhjetor	636.6	—	—	—	490.5	...	490.5	128.7	127.7	234.1	146.1	146.1	19.7	24.7	101.7
2007 Dhjetor	892.1	—	—	—	691.5	0.2	691.3	174.0	122.6	394.6	200.6	200.6	24.0	29.6	147.1
2008 Dhjetor	1,183.4	0.6	—	0.6	901.8	0.1	901.7	191.0	132.3	578.4	281.0	281.0	20.9	30.9	229.2
2009 Dhjetor	1,289.0	2.3	1.2	1.1	943.2	0.3	942.9	215.7	113.0	614.2	343.5	343.5	27.0	32.1	284.5
2010 Dhjetor	1,458.7	5.7	2.6	3.0	1,014.5	6.3	1,008.3	259.4	64.3	684.5	434.3	434.2	26.5	30.7	377.0
2011 Dhjetor	1,698.1	8.3	6.6	1.7	1,137.6	1.5	1,136.1	307.8	83.4	744.8	512.4	510.9	44.0	38.1	428.8
2012 Dhjetor	1,763.4	19.8	16.3	3.5	1,171.2	1.4	1,169.8	313.4	91.7	764.8	543.0	542.6	52.2	37.3	453.0

Tabela 6.4. Kreditë e KTD-ve, sipas industrisë

(Të dhëna kumulative, fundi i periudhës, në milionë euro)

Përshkrimi	Gjithsej									
	Bujqësia	Industria, energjia dhe ndërtimi				Shërbimet				
		Deri në 1 vit	Mbi 1 vit	Deri në 1 vit	Mbi 1 vit	Deri në 1 vit	Mbi 1 vit	Mbi 1 vit	Mbi 1 vit	
2001 Dhjetor	25.9	...	...	—	3.8	3.8	...	22.2	22.2	...
2002 Dhjetor	86.5	1.5	1.5	—	13.6	13.6	...	71.4	71.4	...
2003 Dhjetor	232.8	4.7	3.9	0.8	22.2	12.6	9.7	205.8	119.7	86.1
2004 Dhjetor	289.9	7.9	3.9	4.1	47.8	22.5	25.3	234.2	89.5	144.8
2005 Dhjetor	387.9	12.5	4.1	8.4	74.2	24.5	49.7	301.1	92.4	208.8
2006 Dhjetor	490.5	16.4	3.4	13.0	97.7	28.0	69.7	376.4	120.6	255.8
2007 Dhjetor	691.5	29.0	4.1	24.9	144.5	32.8	111.7	518.0	149.5	368.5
2008 Dhjetor	902.4	37.4	4.1	33.3	160.2	28.9	131.2	704.8	126.4	578.4
2009 Dhjetor	945.5	38.2	3.8	34.4	236.7	54.8	181.9	670.5	113.2	557.3
2010 Dhjetor	1,022.8	38.2	1.7	36.5	269.3	77.1	192.2	715.3	188.5	526.8
2011 Dhjetor	1,149.5	40.5	0.8	39.7	284.7	82.3	202.4	824.4	220.5	603.8
2012 Dhjetor	1,194.2	43.6	3.0	40.6	290.4	74.1	216.2	860.2	232.3	627.9

Tabela 6.5. Normat efektive të interesit të KTD-ve

(Biznese të reja, përveç nëse ceket ndryshe)

Përshkrimi	Normat e int. në dep.	Korporatat jofinanciare									Ek. familjare							
		Dep. e transferueshme	Dep. tjera						Dep. e kursimit	Dep. e transferueshme	Dep. tjera					Dep. e kursimit		
			Më pak se euro 250.000				E barabartë ose më shumë se euro 250.00				Deri në 1 muaj	Mbi 1 muaj dhe deri në 3 muaj	Mbi 3 muaj dhe deri në 6 muaj	Mbi 6 muaj dhe deri në 1 vit	Mbi 1 vit dhe deri në 2 vite		Mbi 2 vite	
			Deri në 1 muaj	Mbi 1 muaj dhe deri në 3 muaj	Mbi 6 muaj dhe deri në 1 vit	Mbi 2 vite	Deri në 1 muaj	Mbi 1 muaj dhe deri në 3 muaj										Mbi 6 muaj dhe deri në 1 vit
2005 Dhjetor	3.12	0.26	2.07	2.37	3.40	*	2.90	*	*	1.71	0.04	1.85	2.24	*	3.33	3.87	4.04	1.74
2006 Dhjetor	3.11	0.39	2.06	2.85	4.32	*	3.11	*	*	1.53	0.03	1.93	2.35	*	3.44	4.16	4.51	1.65
2007 Dhjetor	4.00	0.48	2.68	2.93	4.35	*	4.27	4.15	*	2.45	0.02	2.55	2.75	*	3.60	4.72	5.27	2.25
2008 Dhjetor	4.42	0.53	3.09	3.97	5.32	*	3.61	4.92	*	2.85	0.11	3.21	4.60	*	4.45	4.99	3.95	2.74
2009 Dhjetor	3.98	0.72	3.42	3.42	5.03	*	3.88	4.88	*	2.63	0.34	3.09	3.28	*	4.39	5.00	5.50	2.51
2010 Dhjetor	3.38	0.63	2.44	3.08	4.96	5.14	*	3.74	*	2.07	0.55	2.58	2.63	3.15	4.49	4.77	5.14	2.21
2011 Dhjetor	3.71	0.86	0.00	2.91	4.90	5.05	*	3.88	5.25	2.20	0.48	2.49	2.47	2.88	4.21	4.56	5.36	2.06
2012 Dhjetor	3.74	0.83	*	2.79	*	*	2.67	4.02	4.75	2.15	0.54	2.30	2.46	2.84	4.20	4.52	4.76	2.06

Tabela 6.6. Normat efektive të interesit të KTD-ve - normat në depozita

(Biznese të reja, përveç nëse ceket ndryshe)

Përshkrimi	Normat e interesit	Korp. jofinan. (kreditë)									Ek. familjare						
		Kreditë investuese			Kredi tjera biznesi (jo-investive)		Mbitërheqje	Linja Kreditore	Kreditë me kushte favorizuese		Mbitërheqje	Kreditë me kushte favorizuese		Kreditë konsumuese	Kreditë hipotekare		
		Deri në 1 vit	Mbi 1 vit deri 5 vite	Mbi 5 vite	Deri në 1 vit	Mbi 1 vit deri 5 vite			Kredite me mbulesë Depoziti	Kredi tjera		Kredite me mbulesë Depoziti	Kredi tjera		Deri në 5 vite	Mbi 5 vite dhe deri në 10 vite	Mbi 10 vite
2005 Dhjetor	14.47	17.34	13.29	13.29	15.18	14.38	15.11	11.51	...	*	*	...	11.51	*	*	*	
2006 Dhjetor	14.70	*	14.50	14.50	13.60	15.18	15.72	12.36	...	*	*	...	12.36	*	13.36	*	
2007 Dhjetor	14.06	*	13.76	13.76	*	14.64	15.09	13.72	...	*	*	...	13.72	12.92	12.36	*	
2008 Dhjetor	13.79	*	13.92	13.92	14.20	13.45	15.03	13.50	...	*	19.48	...	13.50	9.81	10.82	8.13	
2009 Dhjetor	14.09	*	14.34	14.34	*	*	*	...	*	17.83	...	13.31	*	10.67	*		
2010 Dhjetor	14.31	16.13	13.95	*	18.66	14.44	12.65	13.27	7.69	*	22.57	6.55	8.56	14.56	*	11.67	10.26
2011 Dhjetor	13.69	15.89	13.55	11.68	16.40	13.80	11.78	12.12	6.10	9.88	16.44	6.01	8.58	14.02	14.31	11.99	10.83
2012 Dhjetor	12.86	15.37	12.03	10.19	15.29	13.66	10.70	11.90	5.92	*	12.46	6.11	7.97	13.06	*	10.78	9.79

## 10. Referencat

ASK (2013): Anketa e Fuqisë Punëtore 2012- Rezultatet për Gjysmën e parë të vitit, Agjensia e Statistikave të Kosovës, Prishtinë

ASK (2013): Bruto Produkti Vendor Sipas Aktivitetit Ekonomik, Agjensia e Statistikave të Kosovës, Prishtinë

ASK (2013): Bruto Produkti Vendor Sipas Shpenzimeve, Agjensia e Statistikave të Kosovës, Prishtinë

ASK (2013): Indeksi i Çmimeve të Konsumit, Prodhimit dhe Importit: Agjensia e Statistikave të Kosovës, Prishtinë

ECB (2013): *Monthly Bulletin*, European Central Bank, Frankfurt.

European Commission (2012): *EU Candidate and Pre-Accession Countries: Economic Quarterly*; European Commission, Brussels.

European Commission (2013): *Eurostat Database*;

European Commission (2013): *EU Candidate and Pre-Accession Countries: Economic Quarterly*; European Commission, Brussels.

IMF (2013): *World Economic Outlook Database*, April 2013 International Monetary Fund, Washington DC.

Ministria e Financave (2013): Raportet dhe Pasqyrat Financiare; Raporti Vjetor Financiar Buxheti i Republikës së Kosovës për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2012- Të pa audituara, Ministria e Financave, qasurë në qershor 2013.

MPMPS (2013): Raporti i Punës dhe Punësimit, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Prishtinë





Rruga e Garibaldit, Nr.33, Prishtinë, Republika e Kosovës  
Tel: +381 38 222 055; Fax: +381 38 243 763  
Web: [www.bqk-kos.org](http://www.bqk-kos.org)